

Muharrem Blakaj

# MISIONI SEKRET

Roman

Rozafa

Muharrem Blakaj

**MISSIONI SEKRET**

Roman

*Biblioteka*

K u t e l i

*Redaktorë*

Mehmet KRAJA

Sali BASHOTA

**Muharrem Blakaj**

# **MISIONI SEKRET**

Roman

Shtëpia Botuese

**ROZAFÄ**



Prishtinë

2004



# I

Tymi i gazit lotsjellës ishte ngjitur lart, deri te dritaret e banesës. Bardha, ashtu e tmerruar nga skenat e llahtarshme që i shikonte tutje në sheshin e gjerë, i mbylli dritaret. E struktur te këndi i dritares prapa perdeve, shikonte rrugën matanë, të mbushur plot me demonstrues. Turma brohoriste me të madhe. Të shtënat ishin shpeshtuar. Alarmi i makinave të policisë, si dhe buritë e makinave zjarrfikëse, e mbushën tërë qytetin dhe jehona e tyre dukej sikur e thernin kupën e qiellit, duke ua futur të dridhurat në palcë nënave, motrave, nuseve dhe fëmijëve, të dashurit e të cilëve gjendeshin midis turmës, duke u kacafytur me policinë. Nga rruga anësore Bardha pa të vraponin në drejtim të turmës trupat e njësisë speciale. Krejt në fundin e tyre pa të çapitej komandanti i njësisë speciale. Ai dha urdhër për sulm. Të veshur me xhaketa antiplumb, me maska kundër helmeve, me helmeta në kokë, me mburoja në duar dhe me shkopinj, të gatshëm për të goditur, policët u futen si pykë në mes të demonstruesve. Të shtënat u shpeshtuan. Alarmet vazhdonin me tinguj të frikshëm dhe të përvajshëm njëherësh. Paso i një rrëmujë e vërtetë. Dëgjoheshin britma të mbytura, fjalë teke, të shara, klithma, dhembje... o Zot!

Sheshi filloi të boshatisej. Makinat e policisë sillëshin vërdallë. Tymi i kaltër ngrihej përpjetë si re. Bardha pa sesi i arrestonin pjesëmarrësit në demonstratë, veçanërisht të rinjtë. Kishte edhe vajza që policët i godisnin pa mëshirë, të cilat, ashtu të gjakosura, duke i tërhequr zvarrë, i futnin në autoburg.

Në mes të sheshit dalloi një njeri të shtrirë. Ai nuk lëvizte. Policia nuk i lejoi të afroreshin ca djem të rinj, të cilët u shkëputën nga turma dhe u sulën drejt tij. U bë një përlëshje e vërtetë dhe pas pak dëgjoj të shtëna. Ata u goditën ashpër me shkopinj gome dhe, në fund, u tërhoqën në distancë. Pas pak të shtririn në mes të sheshit, policët e tërhoqën zvarrë, duke e hedhur në automobilin e policisë dhe, e ndjekur nga zhurmërima e alarmit, vetura mori drejtimin e spitalit. Ndoshta është vetëm i plagosur, mendoi Bardha me dhembje.

Zemrën e kishte të ngrirë. Shpirti i përvëlohej, kur i shikonte ato skena rrëqethëse, pa qenë e zonja t'u dilte në ndihmë. Kishte merakun e vëllait. Ishte e pamundur që ai të mos kishte qenë në ballë të demonstruesve. Nuk i pritej derisa të vinte Feri. Ndoshta ai do t'i tregonte diç më shumë për ngjarjen.

Pas pak nata mbështolli çdo gjë. Në rrugët e boshatisura nuk shihej njeri. Rrëmuja kishte mbetur, megjithatë. Dritat e neonit kishte kohë që ishin ndezur. Vetëm makinat e policisë kalonin përmes shesheve, duke lënë prapa zhurmën mbytëse. E molisur, Bardha u lëshua në minder. Se nga i erdh një urrejtje për komandantin e njësisë speciale, që kohë më parë kishte ardhur nga kryeqyteti. Befas ju kujtua biseda e parë që kishte pasur me gruan e tij, kur Feri i kishte ftuar

për drekë në shtëpinë e tyre, pak kohë pasi ata e kishin pranuar detyrën e re.

Gordana i kishte treguar për shkollimin e saj, për aventurat, dashurinë dhe martesën. Të gjitha këto sesi e kishin trazuar, edhe pse nuk ishte hera e parë që dëgjonte rrëfime të tilla nga vajzat apo nuset e fisit të gjerë të familjes së saj dhe të familjes së burrit. Këso rrëfimesh kishte dëgjuar edhe nga vajzat e fshatit, ku ishte rritur, ku ishte shkolluar dhe ku kishte dashuruar një herë në jetë. Por, aventurat e Gordanës i qenë dukur disi ndryshe. Në renditjen e ngjarjeve ajo herë pas here zinte në gojë hotelet, restorantet, baret, muzikën, diskotekat, pastaj argëtimet gjatë netëve, bile ndonjëherë deri në agim. Pastaj, ajo kishte zënë në gojë alkoolin, drogën... bërrrr, ishte rrëqethur e tëra, kur Gordana kishte përmendur drogën. Mentori i kishte treguar për efektet e drogës. Ai kishte takuar në kryeqytet të droguar dhe kishte parë veprimet, sjelljet, harenë, gëzimin e tyre, gjumin buzë trotuareve, agresivitetin dhe dehjen e atyre që e përdorin drogën. Gordana i kishte thënë se ndjehej shumë e mërzhitur në këtë vend të humbur. Këtu unë nuk njoh askënd dhe assesi nuk po e gjejë veten në këtë shoqëri të re. Edhe serbët këtu me dukën sikur janë disi ndryshe, me ngjajnë më tepër si shqiptarë se sa serbë. Nuk e lidhi dot bisedën me ta! Pastaj, këto fytyra të urryera të shqiptarëve, o zot nuk i duroj dot! Më fal, Bardha, se nuk e kam fjalën për ty, i kërkonte falje. Bardha ishte inatosur. Shtriga, kishte thënë me vete. Ke ardhur këtu, të flasësh me atë gjuhën e gjarprit, si ata që të kanë dërguar. S'kam ç't'i bëj burrit tim, se ty shpejt ta kisha treguar vendin!



E shtrirë në shtrat, Bardha përpiqej ta largonte gjumin. Dëshironte me çdo kusht të priste derisa të vinte i shoqi. Ai po vonohej. Kishte shpresuar se sonte do të kthehej. Koha ecte dhe, si për inat, ai nuk po vinte. Kishte disa ditë që ai, pa asnjë shkak, nuk kishte bërë gjumë në shtëpinë e tij. As nuk i tregonte se ku shkonte, më kë rrinte, ç'bënte gjithë kohën rrugëve, restoranteve, hoteleve apo bareve. Bardha nuk e pyeste. Një herë kishte gabuar dhe e kishte pyetur, por ishte ndëshkuar rëndë. Qysh nga e mërkura, kur kishte shkuar në punë, nuk ishte kthyer më. Para se të martohej më të, ajo kishte menduar se në qytet ndoshta do të ishte më e qetë dhe plaga e rëndë e shpirtit do t'i shërohej. Mjerisht, nuk kishte ndodhur ashtu. Kishte ndodhur krejt e kundërta. Në vend që të gjente dashurinë që e kishte humbur dikur, kishte gjetur ferrin, bashkë me të nëmurit e tij; kishte gjetur përbuzje, nënçmim dhe pranga të vrazhda, që ia kishin lidhur të dy duart e saj të buta, në vend të hallëhalleve e byzylykëve. Në shpirtin e saj prapë kishte zënë rrënjë pema e mallit dhe kujtimet e shkuara. Çdo mëngjes, kur zgjohej nga gjumi, e ndiente një lloj ngufatjeje nga ajo qetësi e rëndë dhe e trishtë e asaj shtëpie të heshtur si varri. I vetmi ngushëllim i kishin mbetur lotët. Mbyllej në dhomën e gjumit dhe shkruhej në vaj. Edhe tani kujtimet i vinin vërdallë dhe ishte gati të shpërbente. I bëhej se ishte hirushe në këtë shtëpi plot mërzi. Me këto kujtime e kishte zënë gjumi.

Si në ëndërr, e kishte dëgjuar kur i shoqi ishte shtrirë pranë saj me trupin e tij të ftohtë. Bërrrr, ishte rrëqethur një herë, pastaj ishte rrotulluar në krahun

tjetër dhe, sakaq, ishte tretur thellë në gjumin e rëndë të mesnatës.

Hapi sytë. Ishte dritë. Qenka gdhirë, mendoj, duke e hedhur vështrimin nga i shoqi që flinte qetë. Pastaj vështrimin e hodhi nga dritarja. Jashtë binte shi përzier me erë. Xhamat ishin të lagur. U ngrit qetë nga shtrati. Me pelerinën krahëve, u afrua edhe më pranë dritares. Dukej se jashtë bënte ftohtë. Era kryente me tallaze, duke hedhur shiun zhurmshëm në dritare. Gjurmët e rrëmujës së mbrëmshme dukeshin qartë në sheshin e gjerë. Bardha i shikonte nga dritarja. Mendjen e kishte të Mentori. Shikimin e hodhi nga shtrati, ku flinte i shoqi. Deshi ta zgjonte e ta pyeste, por, pasi që afruar fare pranë, u pendua. Po të kishte ndodhur diçka e keqe, ai do ta kishte zgjuar që mbrëmë për t'ia thënë. Ai kënaqej kur në familjen e saj ndodhte ndonjë zezë ditë. I vinte keq vetëm për Ademin.

Me hapë të lehtë hyri në banje. Dera kishte mbetur pakëz e hapur. Në brendi ajo dalloi uniformën e Ferit të hedhur pa kujdes në dysheme. E mori ta paloste, por në çast pa se që përllëçur, ndërsa në mëngën e xhaketës kishte njolla gjaku. Ah! bëri me vete, qenka me gjak! Prapë?!... Mjerë ai që ka pasur punë me të! Si zakonisht, ajo filloi t'i kontrollonte xhepat e rrobave, në mënyrë që pastaj rrobat e palara t'i hidhte në shportë. Në xhepin e xhaketës prapë gjeti najlonin e vogël, me pluhurin e bardhë brenda. Nuk ishte hera e parë që në xhepat e tij gjente gjëra të tilla. Ai i kishte thënë se ky pluhur ishte ilaç, të cilin ia kishte preferuar mjeku.

E mori me mend se ai kishte rrahur dikë, gjatë përleshjeve të mbrëmshme me demonstruesit. Kur ina-

tosej, ai ishte shumë agresiv, sidomos kundër atyre që ishin më të dobët se ai. Sa e sa herë e kishte përjetuar inatosin e tij mbi trupin e saj. Ia kishte mësuar mimikën dhe rregullat e tjera që kurrë në jetën e saj as që i kishte shkuar mendja se ekzistonin. Në prani të të tjerëve ata linin përshtypjen e një çifti të lumtur, për një dashuri të përsosur, për një çift të kulturuar, kurse në anën tjetër e provokonte pa shkak, derisa ajo e humbiste durimin. Pastaj e shtronte në dajak. Derisa ajo ishte nën peshën e vuajtjeve të shkaktuara nga rrahja, ai nuk e linte të qetë, i hidhej mbi trupin e saj fillak dhe i shfrynte epshet e tij shtazarake. Pas gjithë këtyre vuajtjeve, pasonin miklimet dhe fjalët e mëdha të dashurisë.

Sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, ai ishte edhe gjysmë narkoman. I kishte rastisur disa herë ta gjente në dhomën e gjumit në agoni të trishtë, apo të tretur thellë në ekstazë. Herën e parë, kur e kishte parë, ishte stepur nga tmerrri. Sikur ta kishte lajmëruar dikush, kishte ardhur Mentori.

„Sa mirë bërë që erdhe! Të lutem, shpejt, shpejt se ai po vdes!“ – kishte thirr Bardha e tmerruar, pa u përshëndetur fare me të.

„Kush po vdes? Ç’ka ndodhur!“

“Feri!... Eja në dhomën e gjumit!”

Mentori kishte hyrë me të shpejtë në dhomë. Era e rëndë e mariuhanës e bëri Mentorin të dridhej. Ishte e mundur që edhe dhëndri i tij ta përdorte drogën?! O bobo, edhe policia qenka e droguar?!

“Mos u shqetëso, Bardha. Nuk ka gjë. Është i droguar. Do t’i kalojë shpejt!” – i kishte thënë Mentori. Bardha nuk kishte dashur t’i besonte. Pastaj i kishte

treguar se çfarë duhani kishte pirë. “Ky është duhan burrash, duhan kaçak”, i kishte thënë ai.

Në mënyrë të tërthortë Bardha ishte përpjekur që marrëdhëniet me Babiçin të ftoheshin. Të vepronin si edhe të tjerët, ngadalë dhe pa u vërejtur të largoheshin dhe...

“Mbylle moj ti, kur u bërë ti të këndosh këtu? Ti s’di gjë!” – e kishte ndërprerë Feri dhe kishte vazhduar: „Ne kemi nevojë për të, prandaj duhet të mos i shkëpusim marrëdhëniet e mira që i kemi. Është kohë e keqe, s’i dihet, ndoshta do të na nevojitet ndonjëherë.”

Bardha i kishte treguar se Babiçi nuk ishte serioz me të, kishte një shikim jo të zakonshëm, pastaj kishte shumë dëshirë të fërkohej rreth saj, me një kujdes të tepruar. „Ka bërë shaka me ty“, i kishte thënë Feri.

Bardha i kishte treguar Mentorit, i cili kishte marrë flakë, sa pastaj ishte penduar pse kishte folur. Kishte frikë se do t’i dilte të vëllait ndonjë telashe me të, gjë që Bardha nuk e dëshironte. Edhe pa telasht e saj, Mentori kishte mjaft telashe me policinë.

I mori rrobat dhe u vesh. Doli në rrugë. U nis drejt dyqanit për të blerë bukën. Në çdo skaj të rrugës shiheshin gjurmët që kishin lënë demonstruesit një natë më parë. Gurë të shpërndarë, shishe të thyera, copa dërrasash, gëzhoja, këpucë të mbetura teke gjatë shpërndarjes së turmës, rroba, pllakate të shkatërruara, parulla, trakte dhe copa gazetash. Te fundi i rrugës së gjatë dukeshin punëtorët e ndërmarrjes “Putnik”, që kishin filluar pastrimin. Kohë e keqe, mendoi. Të gjithë shokët e tij e lëshuan punën, kurse ky... „Jo, jo, më mirë kështu“, i kishte thënë ai sa e sa herë, „ndoshta do të

rregullohet kjo gjendje dhe unë do të triumfoj... me kupton? Do të triumfoj!“

Furra e bukës ishte e demoluar. Dritarja ishte e thyer, kurse dera ndodhej disa metra larg, e përplasur në asfalt. E paskan shkatërruar edhe furrën, mendoj dhe prapë iu kujtua Mentori. Ai i kishte treguar se në demonstratat mëparshme kishte njohur Zllatkon me disa serb të tjerë, që ishin përzier me turmën e demonstruesve shqiptarë dhe pastaj kishin filluar nga shkatërrimet, thyerjet dhe demolimet e vitrinave, xhamave të dritareve, duke i vënë në shënjestër dyqanet e rralla serbe, derisa ishin diktuar nga turma. Policia kësaj radhe e kishte arrestuar Mentorin, por me ndërhyrjen e Ferit ishte liruar. Në mënyrë të tërthortë, pastaj, i kishte kërkuar bashkëpunim. Mentori ia kishte zgjatur duart dhe i kishte thënë: „M’i vër prangat, por atë mos ma kërko kurrë. Nuk i kam mbajtur unë pesë vite burg për të bashkëpunuar me ty dhe me ata të sojtit tënd“.

Mori rrugën për te furra e Kalldrëm-Sokakut, e cila ndodhej në mes të qytetit. Edhe atje ishte e njëjta pamje. Me hapa më të shpejtë arriti te furra e madhe e qytetit. Nga larg dalloj se aty çdo gjë ishte në rregull. Këtë e vërtetonte grumbulli i njerëzve, të cilët prisnin para sportelit.

Pasi mori bukën, me hapa të shpejtë u nis për në shtëpi. Kaloi pranë klinikës private të gjinekologjisë, të cilën nuk kishte shumë kohë që e kishte hapur një mjek i specializuar nga Beogradi. Thoshin se ishte shumë i aftë në punën e tij. Gordana këtë mjek e njihte qysh nga gjimnazi, kur kishte qenë nxënëse. Ai kishte qenë në klasën paralele me klasën e saj, por një vit më i ri se

ajo. Thuhej se ai ishte në gjendje që, vetëm me barëra popullore, gratë që nuk kishin lindur kurrë fëmijë, t'i bënte të pëlleshme. Prandaj edhe kishte ardhur këtu, që t'u dilte në ndihmë grave dhe nënave të reja. Fare në fillim, Feri i kishte thënë se edhe ajo duhej ta bënte një vizitë të ky mjek. Por Bardha nuk kishte pranuar.

Kishte dëgjuar nga Merimani, nusja e Mentorit, të cilën të gjithë e thërrisnin me emrin përkëdhelës Meri, se ai kishte ardhur për t'i shteruar apo t'i shtynte drejt abortit nënat e reja shqiptare. Ndaj kishte pasur frikë të vizitohej te ai mjek. „Më mirë mos shko“, i kishte thënë i shoqi në një rast tjetër. „S'ke nevojë. Ti je shterpe!“

Kishte arritur te rruga e Terzive. Çdo gjë dukej e përmbysur, e hallakatur, e luajtur nga vendi, si të kishte ndodhur tërmet. Në skajin matanë rrugës, pa një veturë të ndaluar dhe katër policë që kontrollonin dy djem të rinj, të heshtur dhe me duar të lëshuara poshtë. U tmerrua kur dëgjoi të përmendej emri Mentor, nga njëri polic. Për një çast iu duk sikur vërtet ishte Mentori dhe, sakaq, me hapa të shpejtë u drejtua nga policët. Në fillim e gënjyen edhe sytë, por kur u afrua më pranë, u qetësua. Nuk ishte Mentori, edhe pse nga larg iu duk ashtu. Ishte dikush tjetër. Pasi mori frymë pak e lehtësuar, me dëshpërim vazhdoi rrugën. Nga prapa shpine dëgjoi zërin e njërit nga policët, duke bërëtitur dhe duke sharë me fjalë fyese. Këto sharje e bënë që të kthente kokën prapa. Ishte kureshtarë të dinte se si do të përfundonte fati i atyre çunave. Edhe pse nuk i njihte, kishte dhembje dhe parandjenjë ogurzezë për ta. Kur i pa policët të hakërryer duke goditur me gjithë fuqinë që kishin mbi trupin e kërrusur të çunit, zem-

ra iu tkurr, sikur trumcakut kur e sulmon skifteri. Nga pesha e të rënave, çuni u kërrus pakëz nga e majta dhe bëri të largohej, por nga ana tjetër mori një goditje të fuqishme nga polici tjetër, pastaj edhe disa goditje të tjera, derisa u plandos përtokë. Shoku i tij u përpoq t'i vinte në ndihmë, por edhe ai e pësoi të njëjtin fat. Ash-tu, me fytyra të gjakosura, ua lidhën duart dhe i futën në autoburgun e policisë.

Bardha u trishtua nga kjo skenë. Nuk ishte hera e parë në jetë që shihte policët duke i torturuar të tjerët. Këto ishin bërë tanimë skena të përditshme. Kështu i torturon të rinjtë edhe Feri... o Zot, të dyja duart ju thafshin! Nëmi me gjithë afsh dhe me zë të lartë. Ishte një skenë e tmerrshme, që për një çast e la të lemerisur, në mes të trotuarit, duke e mbajtur dorën te goja. Tani iu kujtuan fjalët e Ferit, që ia kishte thënë sa e sa herë, se çdo ditë e më tepër gjendja po shkonte duke u përkeqësuar dhe për policët ishte shumë e vështirë të qëndronin në krye të detyrës. Këta s'duan të dinë për rregullat, për ligjet, por dalin në rrugë si të tërbuar, thërrasin e brohorasin lloj-lloj parullash, pastaj bëjnë teatër nxënësit se gjoja janë helmuar nëpër shkolla, e dokrra të tilla! Dokrra i duken atij, ishalla kryet e vet e hanë këta policët këtu, me gjithë atë policin tim atje, mendoj e tmerruar dhe me hapa të shpejtë iku në drejtim të shtëpisë.

Mendimet i kishte të ngatërruara. E ndjente veten të lodhur dhe disi të harruar nga bota. Kishte kohë që nuk kishte kontakte me shumë shoqe, burrat e të cilave e kishin lënë punën e policit, sepse ata nuk ishin pajtuar me ndryshimet kushtetuese që kishin filluar të

bëheshin në mbarë Jugosllavinë. Pastaj, kontaktet me prindërit dhe me Mentorin ishin ftohur kohëve të fundit. Bardha ishte në pozitë të keqe. Në një rën anë Mentori ishte kundër këtyre ndryshimeve dhe ishte lidhur ngushtë me mbarë protestat gjithë popullore për ndalimin e këtyre ndryshimeve, kurse në anën tjetër Feri ishte për mbrojtjen e tyre dhe ishte i lidhur ngushtë me urdhrat që vinin nga kryeqyteti. Dallimet në mes tyre ishte thelluar dhe, sa herë që takoheshin, ata ziheshin me njëri-tjetrin. Në fund ndaheshin shumë të zemëruar. Sikur nuk mjaftonin të gjitha këto, ajo ishte e rrezikuar edhe nga ai ujku që i vardisej. E kishte kuptuar që nderin e burrit nuk e ruante dot, sepse ai nuk kishte nder fare, por ishte e vendosur ta ruante nderin e vet, të prindërve dhe të atij!... Ah sa budallaqe që bëhem!

Nuk gjente qetësi. Skena që pak më parë e kishte parë në rrugë, disi e kishte molisur fare. Qëndronte në këmbë, prapa perdeve, me shikimin e humbur dhe të hedhur ashtu kot, diku në mesin e oborrit të shkollës së shkretuar. Sa tmerr ishte ta shikojë shkollën pa nxënës. Në vend të fëmijëve, në atë shkollë shiheshin ushtarë me mjekra të gjata, që çdo mëngjes në orën gjashtë zgjoheshin me zhurma të frikshme. Sa herë që ndihej e mërzhitur dhe e vetmuar në këtë shtëpi të zbrazët, Bardha afrohej pranë perdeve dhe me shikimin e mbërthyer në oborrin e boshatisur të shkollës, tretej në kujtimet e së shkuarës. I dukej se e dëgjonte zilen e shkollës, kur i binte axha Lekë, atje, në fshatin e saj. Dhe, ja, si vraponin fëmijët të futeshin në rresht. Pastaj, kur mësuesja u jepte shenjë, ata i lëviznin këmbët e tyre të vogla në mënyrë të harmonishme dhe hynin në klasë. Ja dhe



fusha e sportit, bosh... dhe në fundin e saj muri i ulët, me kangjellat e ndryshkur sipëri. Për një çast ju duk se e pa Besën, e cila atëherë ishte e rritur dhe ashtu kokulur truponte oborrin e shkollës, me çantën e librave të hedhur në krah. Kalonte murin, duke u mbajtur pas hekurave të rrethojës dhe dukej se, që andej, nisej për në shtëpi. Te kaçubet, tutje, e priste Keri. Bardha i kishte parë shumë herë, të lidhur dora-dorës, duke biseduar me zë të ulët dhe duke i buzëqeshur ëmbël njëri-tjetrit. Sa të lumtur i qenë dukur. Sa mirë! Sa qejf! kishte menduar me vete, duke ndaluar hapin për t'i parë sa më gjatë ashtu. Si nëpër ëndërr. Iu kujtua se, pasi kishin përfunduar atë vit shkollor, kishte dëgjuar se Besa kishte lindur një djalë... „Marrja e zotit! Lindi kopil!“ - i kishte dëgjuar kur thoshin të rriturit.

Bardha kishte mësuar shumë vjersha epike. Ato i gjente në librat e trashë të Mentorit, të cilat me ëndje i mësonte dhe ia recitonte babait, i cili i regjistronte në shiritin e manjetofonit dhe i merrte me vete në Zvicër, ku ishte duke punuar. Bardha shumë herë e kishte parë babin e saj duke i fshirë lotët, kur ajo e recitonte „Këngën e Rozafatit“. Edhe në shkollë, kur ajo recitonte, të gjithë e dëgjonin me vëmendje. Disa herë ajo ishte shpallur recituesja më e mirë shkollës dhe kishte marrë dhurata nga drejtori. Sesi iu kujtuan vargjet e një vjershe, të cilën, kur qe dashuruar me Agronin, e recitonte me gjithë afsh, sepse tamam ashtu e kishte pritur, që trimi të vinte e ta rrëmbente, sikur se djali që e kishte rrëmbyer atë vashën belkëputur të poezisë... dhe në heshtje filloi ta recitonte, por kësaj radhe me lot në sy.

*...thoni se tek burimi  
me të parë fluturën,  
thoni se ç'e zuri trimi  
atë belkëputurën...*

...dhe në vend që të dëgjonte zërin e mësueses kur i thoshte „shkëlqyeshëm“, ajo ndjeu derën të hapej dhe që andej të dilte Feri, si lugat.

\*

“Punët i kam keq“ – i tha i shoqi, porsa hyri në dhomën e pritjes.

“Pse, ç'ka ndodhur?“ – pyeti disi e shqetësuar, duke qenë akoma nën presionin e ngjarjes që pak çaste më parë e kishte parë në rrugë.

“Mbrëmë janë vrarë dy policë.“

“E pastaj?“ – pyeti ajo, pa interes.

“Gjatë përleshjes me demonstruesit, më ka humbur revolja. Kur turma u shpërnda në një skaj të rrugës, në trotuar, ishin gjetur dy policë të vrarë. Unë e lajmërova rastin për humbjen e revoles. Pastaj më dërguan te komandanti i njësisë speciale, i cili për dy orë me mbajti në arrest. Assesi nuk bindej se vërtet më kishte humbur revolja. Ai më tha se, pasi të bëhej ekspertiza, do të zbardhej çdo gjë”.

“I pe ti policët e vrarë?“

“Jo, nuk i pashë!”

“Kush të tha se janë vrarë?“

“Babiqi.”

“Pse ke frikë, pra? Ti e ke Babiqin që të mbron! E ke ruajtur për këtë ditë!“ – ia ktheu Bardha me ironi.

“Në fillim ashtu mendova edhe unë, por tani, pasi bisedova gjerë e gjatë me të, me duket se çdo gjë ka ndryshuar... Të shohim! Këtë punë nuk e di askush, përveç nesh. Edhe gazetat do të shkruajnë se ata e kanë humbur jetën aksidentalisht, në krye të detyrës. Do të shpallen heronj, kurse hetimet do të vazhdojnë në mënyrë sekrete”.

“Kundër teje?” – pyeti Bardha.

“Ndoshta, të shohim se çfarë do të sjellë ekspertiza.”

Ra heshtja. Bardha iku në kuzhinë, që të përgatiste kafënë e mëngjesit, kurse Feri mbeti në dhomë, me fytyrë të ngrysur. Ishte ndoshta tepër vonë të ndërmerre diçka. U përpoq me kot ta sillte ndërmend rrjedhën e ngjarjes. Bëri edhe një herë rikonstruktimin e ndodhisë, duke rikujtuar sesi kishte mundur t’i humbte revolja, më kë ishte kacafytur, cilin e kishte goditur me shkopin e gomës, distanca, lëvizjet, rrotullimet, përleshjet dhe mundësia që kundërshtari t’ia rrëmbente revolen nga brezi, pa e diktuar ky fare. Megjithatë, një gjë e kishte të qartë: Që në fillim të përleshje e kishte diktuar Stojanin që sillej rreth tij, në vend që të sulmonte turmën. Në fillim kishte menduar se këtë e bënte nga frika. Ndoshta ai... kush e di?!

Për të satën herë e solli ndërmend bisedën e gjatë e të mundimshme që kishte pasur me Babiqin:

„Ti je njëri ndër shqiptarët e rrallë, që akoma ndodhësh në mesin tonë. Ne kemi besim të plotë në ty, ndaj edhe të mbajmë pranë. Ndodhi një vrasje, ta zëmë! Mirë. Në kohë trazirash, ndodhin edhe vrasje, por, megjithatë, kjo vrasje nuk do të kishte peshë të

madhe, sikur të kishte ndodhur në një kohë dhe vend tjetër. Ne duhet t'i zhvillojmë hetimet, por jo në adresën tonë. Nuk do t'i kërkojmë kriminelët në radhët tona, edhe nëse vërtet ata ndodhen mes nesh. Pra, kriminelët do t'i kërkojmë në adresë të armiqve tanë, edhe nëse ata nuk ndodhën në mesin e tyre. Dhe, ja, fare lehtë u gjend zgjidhja. Me kaq problemit i vihet kapak. Por, a mjafton kjo? A e kemi përfunduar detyrën tonë? Unë them, jo! Ti sigurisht se do të pyesësh: pse? Unë do të përgjigjem se terroristët shqiptarë po bashkohen secilën ditë e më tepër kundër nesh. Ata kanë avancuar shumë në punë të kundërshtimit të ligjit, por ajo që është më e tmerrshme, më e rrezikshme, pra, është se ish-kolegët tuaj, që e kanë braktisur detyrën e policit, ata që e kanë braktisur detyrën e ushtarakut, intelektualët, mjekët, mësuesit, po përgatisin plane të fshehta kundër nesh. Ata kanë krijuar polici paralele, institucione paralele dhe, ç'është më e keqja dhe më e rrezikshme për ne, ata kanë krijuar edhe Ministri të Mbrojtjes, mu nën hundët tona! Ç'i thua ti kësaj, ë?... Ti mund të na ndihmosh. Ndaj unë pres nga ti më shumë. Ti ke lidhje me ushtarakë, ndaj përdori taktikat tuaja dhe më se largu pasnesër, dua një raport në lidhje me ushtarakët. Më kupton? Po e përsëris: për ushtarakët! Nëse nuk sjell gjë, mjerisht, ne duhet t'i fillojmë hetimet kundër vetes sonë. E kam fjalën, kundër teje. Është tragjike, apo jo?!"

Bardha i solli kafetë. Feri sikur u përmend. Pasi u shkund pak, mori filxhanin në dorë. Bardha e shikonte profilin e fytyrës së tij të hequr, hutueshëm. Nuk kishte guxim ta pyeste për Mentorin. Në këso rastesh, ai

të mbetj në qafë për hiçgjë, e jo ta pyesje për ata që gjatë gjithë natës kishte luftuar kundër tyre. Shenjat e trishtimit ai nuk i fshihte dot. E ndjeu se ai ishte i mbushur me pezëm dhe para se të zbrazej, e pa të udhës të largohej. Feri e ndoqi me sy, kur ajo çapitej për të dalë në dhomën tjetër. I pëlqente kjo çapitje e saj, por kësaj radhe nuk i bëri përshtypje. E ndjeu të rëndësishme të fillonte nga detyrat, pa humbur kohë.

“Bardha, bëhu gati se do të dalim!” – tha me një zë lutës, që ishte jashtë zakonisht të tij.

“Ku?” – pyeti Bardha, duke larguar blerin e flokëve nga fytyra.

“Përgatitu, thash, e mos pyet shumë!”

Ishte fillimi i prillit. Koha ishte e ftohtë dhe me shi. Fusha kishte filluar të bleronte. Pemët kishin nxjerrë sythat. Në rrugë pellgjet ishin mbushur me ujë. Diku të fshehur nën strehë, zogjtë kishin filluar të këndonin. Bardha rrinte e ulur në ndenjësën e parë të veturës. Vështrimin e mbante diku jashtë, duke i përkëdhelë butësisht me shikimin e saj shkurret dhe kaçubët, që dukej se iknin vetëtimthi prapa, kur vetura afrohej pranë tyre, sikur edhe ato të ishin të frikësuara nga polici i saj, edhe pse tani ishte i konvertuar në civil, por njësoj i rrezikshëm. Feri e ngiste veturën me atë pamjen të tij të rëndë. Nuk fliste. Shikonte tutje rrugën dhe, herë pas here, shante nëpër dhëmbë, kur rrota e veturës binte në ndonjë pellg.

Në kohën e drekës, arritën në fshat. Në dhomën e pritjes, përveç nënës, ishte edhe gjyshja. E shtrirë në minderin e saj, ajo kalonte ditët e fundit të jetës, në atë pleqëri të thellë, duke u treguar stërnipave dhe stërm-

besave përralla të bukura. Kur Bardha e përqafoi, ajo ndjeu të ftohtit dhe me zërin e saj të shterur, pyeti:

“Qenke bërë akull, moj bijë. Është ftohtë jashtë?”

“Si në dimër, gjyshe!” – u përgjigj Bardha.

“E, moj bijë, tash janë Plakat e Marsit“, - tha ajo mendueshëm. „U ngrohe tani ?”

“Po gjyshe, u ngroha !” - ia ktheu Bardha, duke e shikuar me dashuri fytyrën e saj plot rrudha. Iu bë se çdo rrudhë në fytyrën e saj tregonte një brengë, një mërzi, një gjëmë apo një mall, që me vite iu kishin grumbulluar, duke krijuar rrudhë pas rrudhe dhe tani e plakur, e lodhur dhe e sflitur ishte detyruar të shtrihej në shtrat dhe t’u nënshtrohej qetë peshës së tyre.

Feri kishte zënë vend në minderin e gjerë, pranë dritares. Ademi i rrinte pranë, duke i uruar mirëseardhje. Mentori, me fytyrë të skuqur lehtë dhe me sy të qullur, rrinte pak i mënjanuar. Meri i solli kafetë. Pas përshëndetjeve të para, ra heshtja. Feri, me shikimin e tij zhbirues dhe të mprehtë prej spiuni herë shikonte Mentorin, herë Ademin, i cili me të rrallë kollitej, duke mbështjell duhan.

“Kohë e keqe” – tha Ademi, sa për të thyer atë heshtje. Nuk u mor vesh në e kishte fjalën për motin e lig, apo për situatën politike, e cila ishte rënduar tepër kohëve të fundit. Sikur ishte duke e pritur këtë fjalë, Feri u lëkund qetë, duke zënë vend më mirë në minder dhe duke marrë pamje serioze. Sikur ajo fjalë të kishte qenë çelësi i muhabetit, ai, duke shikuar herë nga Mentori, herë nga Ademi, filloi të fliste për situatën:

“Vërtet kohë e keqe! Mua me duket se politika serbe tani më është e tejdukshme. Të gjitha këto trazira

kanë një qëllim të caktuar: ruajtjen e gjendjes ekzistuese dhe të kufizimeve kushtetuese për shqiptarët. Askush nuk i sheh më mirë lëvizjet politike, se sa masat e gjëra!...”

“Qenke bërë patriot, o dhëndër? Hajde, me hair, me hair! Që kur kështu?” - e ndërpreu Mentori, i befapsuar me fjalët e tij. Ishte hera e parë që e dëgjonte duke mbajtur anën e popullit të vet.

“Unë gjithmonë kështu kam qenë!”

“Ti!? Po me gëzon shumë! Më sa e di unë, ti gjithmonë ke qenë në anën e shkieve. ‘Kosova nuk humb asgjë me ndryshimet kushtetuese’, ke thënë dikur!”

“Pse i quan shkie?” – tha Feri me sedër të fyer.

“Si ti quaj, pra?”

“Serbë!”

“Unë i quaj shkie me një emërtim shumë më të butë se sa emërtimi “serbë”, që ata e quajnë veten. Fjala serb rrjedh nga latinishtja, serpent, që do të thotë: gjarpër, kurse fjala shkie rrjedh nga fjala skizmë, që do të thotë: kishë e ndarë nga mospajtimet e brendshme. Pra, do të thotë ndarje, shqyerje e në këtë rast e ka kuptimin ortodoks.”

“Ke të drejt, por, megjithatë, ata ndjehen të fyer nga ky emërtim. Edhe ne ndjehemi të fyer nga emërtimi i disa serbëve të pandërgjegjshëm që na quajnë ‘shiftari!’”

“Pajtohem! Ne ndjehemi të fyer, nga se ata qëllimisht emërtimin ‘shqiptar’ e deformojnë në ‘shiftari’, kurse unë nuk e deformova emërtimin për ta, i cili zanafillën e ka nga koha e ndarjeve të kishave latino-romane, me ato greko-bizantine, në vitin 1054 dhe...” -

tha Mentori i nxehur dhe desh të vazhdonte, por në çast ndërhyri Ademi, siç dukej, për të larguar konfliktin:

“Mbrëmë dëgjova se janë vrarë dy paramilitarë serbë. Di gjë ti si ka ndodhur?” - tha ai duke ndërruar temën e bisedës.

“Kam dëgjuar se gjatë përleshjeve me demonstruesit janë vrarë dy policë, por rrethanat nuk i kam ende të qarta!”

“Si? Policë të vrarë gjatë demonstratave!?” – pyeti Mentori kureshtar dhe vazhdoi: „Jo, jo, e ke gabim. Gjatë demonstratave është vrarë një demonstrues, një njëzet e një vjeçar nga fshati Eshkë dhe kufomën e tij e ka marrë policia!”

“Ne kemi dëgjuar se ata nuk kanë qenë policë, por paramilitarë dhe se janë vrarë për qërim hesapesh brenda tyre. Vrasja e tyre ka ndodhur në një lokal nate, e jo gjatë demonstratave”, – ndërhyri Ademi, duke mos e fshehur habinë.

“Thash, nuk i kam të njohura rrethanat për këtë rast. Dëgjova se dikush është vrarë, por saktësisht nuk e di se kush dhe si ka ndodhur”, – tha Feri me një zë të zbutur dhe njëherësh ngriti vështrimin drejt Bardhës, e cila ishte bërë gati të fliste. Shikimi i rreptë i Ferit e bëri atë të ulte kokën.

Feri e ndjeu veten në pozitë të keqe. Gjithë ato që i kishte menduar t’i shtronte në këtë ndejë gjoja të rastit, tani iu fashitën befas. Edhe me bisedën e fillimit ishte tradhtuar. E kishte ndjerë veten të pazotin, që t’i dilte mbanë qëllimit të depërtimit të tij në cakun për të cilin ishte i ngarkuar. Ishte e pamundur që brenda një kohe kaq të shkurtër ta bënte grumbullimin e të dhë-



nave që i kërkoheshin. Edhe prezenca e Mentorit ishte një pengesë serioze, bile në një çast iu duk pengesë e pakalueshme. Befas mendja i shkoj te kompromisi i dikurshëm që kishte pasur me Ademin, përmes të cilit atëherë kishte siguruar fejesën dhe martesën me Bardhën. Një fije e hollë shprese ia përshkoj gjithë fytyrën dhe buza i shkoj në gaz.

Mentori, ashtu me sy të qullur dhe të skuqur, u ngrit dhe doli. Bardha i shkoi pas. Në dhomë ra heshtja. Pas pak iku edhe Meri, duke lënë vetëm Ademin me Ferin dhe gjyshen plakë, e cila tani kotej e ulur në divan, pranë stufës.

“Me duhen shënimet e Mentorit!” – tha Feri me zë pëshpërime, duke e zgjatur kokën pranë veshit të Ademit.

“Cilat shënime?” – pyeti Ademi me sy të zgurdulluar nga kjo kërkesë e papritur e Ferit.

“Shënimet që i ka marrë gjatë mbledhjeve!”

“Kush i ka marrë?” – pyeti Ademi i befasuar, pa qenë në gjendje të kuptojë se për çka ishte fjala.

“Mentori, thash! Mua me duhen sa më parë ato shënime, që ai i ka marrë gjatë mbledhjeve! Shfrytëzoje rastin, kur ai nuk është në shtëpi dhe merri. Sa më parë m’i sill! A more vesh?”

“Luj vendit, he burrë!” – tha Ademi, duke i ra në të kërkesës së tij.

“Hë!... Unë nuk të luta, por të urdhërova! Prandaj, po e përsëris edhe një herë: Të gjitha shënimet i dua nga ti! Mos, vallë, e ke harruar që të kam në dorë e të shtypi si pleshtin, kur të dua, ë!? E harrove atë që e ke plagosur për vdekje dikur? E harrove mbrojtjen

time?...” – ia ktheu Feri me një zë të ulët dhe kërcënues bashkë.

“Jo, nuk i kam harruar, por... Për kompromis, Bardhën e kërkove atëherë, Bardhën e more... kurse kjo kërkesë e sotme me dukët e tepërt”, – tha Ademi pak i zbutur.

“Leri ato tani!... Afati është i shkurtër. Më se largu nesër në mëngjes i dua. Sa për fillim, bën t’i sigurosh edhe pjesërisht, pastaj shohim”, – tha Feri, pa ia vënë veshin ankesave të Ademit dhe përnjëherësh u ngrit në këmbë. – „Bardha le të mbetet këtu për disa ditë“, – tha ai dhe doli.

\*

Koha ishte të paraqitej të shkonte te gjykatësi hetues, për të dhënë deklaratën mbi humbjen e revoles dhe për rastin e vrasjes së policëve. Pasi mbërtheu edhe kopsën e fundit të xhaketës, u kujtua se nuk e kishte përgatitur raportin me shkrim. Në ndonjë rast tjetër, ky raport nuk do të kishte peshë aq të madhe. Zaten, kjo i kishte ndodhur në krye të detyrës. Por, vrasja e dy policëve ishte thelbi që ngatërronte çdo gjë. Humbja e revoles, kush e gjeti? Ku e gjeti? Dhe, në fund, zbrazja e disa plumbave mbi policët dhe hedhja e revoles në prapavijë, atje ku ishte komanda. Se si i dukej e gjithë kjo. Ku u zhduk pastaj Stojani? Gjatë gjithë përleshjeve, nuk e pashë më, bile as kur turma u shpërnda. Dreq o punë! Raportin zyrtar do ta shkruaj pastaj. Tani duhet të jap një deklaratë formale... mos vallë Stojani?...

Një pjesë të kolegëve të punës i gjeti në sallë. Rrinin të heshtur. Kur Feri u duk në derë, të gjithë e kthyen

kokën nga ai. Për një moment iu bë se kokat e tyre ktheheshin aq ngadalë nga ai, sikur të kishin përdredhje qafe dhe çdo lëvizje e kokave të tyre bëhej me një „ngërç“ të zgjatur, si hapja e derës së pojatës së vjetër, atje në fshat. U afrua pranë vendit të tij të përhershëm dhe tërhoqi karrigen që të ulej, por Stojani e ftoi të ulej pranë tij. Ende pa u rehatuar në karrigen e drunjtë, në derë u duk një burrë i veshur civil. Ishte një punëtor i ri, që kishte ardhur nga kryeqyteti, specialist në degën e kriminalistikës. Sot ishte hera e parë që e takonte. Pasi shikoi të gjithë me radhë, vështrimin e ndali te Feri. Ngriti dorën dhe e drejtoj kah ai. Me një lëvizje të ngadalhtë të gishtave, ia bëri me shenjë që ta ndiqte pas.

Kishte shumë vite që punonte në këtë kolektiv, por asnjëherë nuk kishte qenë në këtë zyre. Kurrë nuk i kishte shkuar ndërmend që në këtë ndërtesë mund të kishte kthina të tilla, sekrete. E po, ndërtesë shtetërore, mendoi. Burri që e përcolli i tha se duhej të priste pak. Për çudinë e tij, ai, pasi doli, e mbylli derën nga jashtë. E dëgjoi rrotullimin e çelësit në bravë. Ndoshta iu duk. Provoi ta hapte derën, por ajo vërtet ishte e mbyllur. Tani çdo gjë është e qartë, mendoi, jam i arrestuar. Ç`po ndodh me mua, vallë? I kishte rënë të rrinte i vetëm në dhomë me derë të mbyllur, por kurrë nuk i kishte shkuar në mendje se një mbyllje dere nga ana e jashtme, nga një person tjetër, mund të shkaktonte një zbrazëtimë kaq të madhe në shpirtin e tij. Për një çast vetja iu duk krijesa më e mjerë në botë. Iu duk se ishte njeri i braktisur, i tretur, i humbur, që askujt nuk do t'i dhimbsej, madje as Bardhës.

Pritja në këtë zyre ishte tmerrësisht e gjatë. Dera

e zyrës ishte e veshur më saftjan të zi dhe në shumë vende, në formë paralele, ishte e mbërthyer me pulla, të cilat ishin të tërhequra me forcë nga ana e jashtme, ku formoheshin në mënyrë të harmonishme disa gjysmë gropëza të vogla. Dera duhej të ishte shumë e trashë, ndoshta edhe e blinduar. Në çast iu kujtua se kjo dhomë duhej të kishte edhe dritaren. Ktheu kokën nga ana e kundërt e derës dhe pa një dritare mesatare, me perde të lëshuar deri poshtë mbi qilim. U afrua më pranë dhe në anën e jashtme të dritares pa hekurat e trashë vertikale. „O perëndi, ku ndodhëm kështu?“ - pyeti veten i tmerruar dhe i tëri zu të dridhej. „Kjo nuk është aspak e drejtë të më mbyllin këtu! Do të kërkoj të më dërgojnë menjëherë të drejtori. Unë, edhe pse e kam kryer punën e policit, jam ekspert i diplomuar i zbulimit dhe kundërzbulimit. Nuk ma hedhin dot mua. Unë nuk vras policë. Nuk ka asnjë provë!“

Ndryshimi i tillë nga jeta normale dhe kthimi i ngjarjeve në anormalitet, si dhe këto që i përjetonte, i dukej se të gjitha këto nuk ishin të vërteta. I bëhej se ishte në një makth, që ia kishte mbërthyer tërë qenien e tij, sikur të ishte në ëndërr të një nate të gjatë dimri, kur acari dhe stuhia, e mbështjellë me borë dhe e përzier me uturimën e ujqërve, e kishte rrethuar nga të gjitha anët.

Në çastin kur i humbi shpresat se do t'ia hapnin derën, u dëgjua rrapëllima e bravës nga ana e jashtme. Ishte po ai që më herët ia kishte mbyllur derën. Edhe kësaj radhe, si edhe më parë, zgjati dorën dhe i dha shenjë që ta ndiqte pas. „Ku po më çon, vallë?“

“Më falni, por desha të di se kush jeni ju, ku po

me çoni dhe ç`lojëra po bëni me mua?”

“Hyr në këtë dhomë, të lutem”, – tha ai, duke ia hapur derën.

Edhe kjo ishte një kthinë tjetër, që nuk i kishte rastisur ta kishte parë ndonjëherë më parë. Porsa hyri brenda, u përsërit skena e njëjtë. Dera u mbyll nga jashtë. Dallimi ishte se këtu ishte terr, nuk kishte dritare. Në të majtë, lart në tavan ishte varur një llambë elektriku, me një dritë jashtëzakonisht të dobët. Në atë gjysmerrësirë dalloi siluetën e një burri, që i doli para nga e djathta. Ashtu i trembur nga kjo befasi, deshi të pyeste se kush ishte, por në çast në anën e poshtme të gjoksit ndjeu një të goditur grushti, sa që edhe frymëmarrja ju ndërpre. I gërmuqur dhe pa mundur t`i mbushte mushkëritë me ajër, përjetoi edhe një goditje të dytë në fytyrë dhe ndjeu trupin e tij që tani më nuk e kishte nën kontroll, të mbështetej pas murit. Se nga kishte mbirë edhe një burrë tjetër. Nuk qe më në gjendje t`i numëronte të rënat. Ju bë se u përplas diku pas murit, por sakaq e kuptoj se nuk ishte përplasur gjëkund, por ishte rrëzuar mbi dysheme. I kujtohej se në fillimin e goditjeve kishte dëgjuar një klithmë, por nuk e dinte se e kujt kishte qenë. Ndoshta e atij vetë. Bëri përpjekje që të ngrihej në këmbë, por ndjeu goditje mbi kurriz, sa që e plandosi për dysheme. Goditjet vazhduan edhe ca, por tani, për çudi, nuk i ndiente më dhembjet e tmerrshme, si ato të fillimit.

Pasi erdhi në vete, hapi sytë. Ishte qetësi absolute. Bëri të ngrihej, por nuk ia doli. Ndjeu dhembje të tmerrshme, pothuaj në të gjitha pjesët e trupit. Në fillim iu duk se edhe gjymtyrët i kishte të thyera. Fy-

tyrën e kishte të përgjakur. U përpoq të fshinte gjakun me mëngën e xhaketës. I dha vetes me të gjitha forcat dhe arriti të ulej disi. Deshi të ngrihej në këmbë, por as këmbët nuk i bindeshin më. E ndiente një shkapërderdhje në trup, që nuk e kishte përjetuar asnjëherë në jetën e tij. Nuk i kujtohej që ndonjëherë të kishte përjetuar një zbrazje kaq të tmerrshme, sa shpirtërore aq edhe fizike. Ishte e çuditshme se një ditë më parë ai kishte goditur si i çmendur mbi demonstruesit dhe kurrë nuk i kishte shkuar ndërmend se një ditë më vonë do të shokërdhohej dajak nga urdhërdhënësit e tij. Tani disi i mbushej mendja se sa dhembje u kishte shkaktuar ai të tjerëve, ndërsa i kishte rrahur deri në alivanosje.

Nga jashtë, në derë, u dëgjua rrotullimi i bravës. Si zakonisht i njëjti person, me gjestet e njëjta, prapë ngritja dorës dhe shenja që ta ndiqte pas.

“Nuk mundem!” – tha me një zë të mekur, që për një çast ju duk se nuk ishte i tij, por një zë i dalë nga dheu.

“T’i thërras ata te të ndihmojnë?” – tha ai, duke i dhënë theks ironik fjalës “ata.” Ferit ju kujtuan grushtet e shqelmat që i kishte përjetuar pak më parë nga “ata.”

“Jo, jo, nuk ka nevojë, çohem vetë!” – tha dhe i dha trupit me të gjitha forcat, sa mëzi u ngrit në këmbë, duke u mbajtur pas murit. Koka i rëndonte. Që nga brenda ndiente një buçimë dhe sytë filluan t’i errësoheshin. E hetoi se do të binte, prandaj u përpoq të mbahej edhe më fort pas murit. Ishte e kotë. Më nuk kishte fuqi as gishtin e vogël ta përdorte për shpëtim. Frymëmarrja i qe shpeshtuar. Për një çast iu bë se ishte

duke u shtrirë në një shtrat të butë. Lehtë u shkëput nga muri dhe ra pa ndjenja mbi dysheme.

Kur i hapi sytë, së pari pa mbi vete tavanin e bardhë. Diku afër mesit të atij tavani, pa një llambë elektriku, që ishte e fikur. Drita vinte nga jashtë. Me mundim e ktheu kokën anash dhe pa një shtrat të rregulluar bukur, me çarçaf të bardhë. U përpoq të kujtonte se ku ndodhej. Ku kishte qenë për herë të fundit, me kë kishte qenë dhe çfarë kishte ndodhur me të. Në murin përballë tij pa të varur një orë të madhe. Dhjetë e tridhjetë e pesë minuta. Ishte e mundur të ishte akoma mëngjes?

“Si e ndjen veten tani?” – dëgjoi një zë t’i vinte nga ana e tjetër e shtratit. Me mundim ktheu kokën dhe e pa atë që foli. Ishte një burrë me mustaqe të zeza. - „Ke dhembje? Mos u mërzhit, do të kalojë. Tani je në vend të sigurt.”

Tani filloj ngadalë t’i sillte ndërmend të gjitha me radhë. Më paskan bërë për spital. Ç`po ndodhë me mua, vallë? Deshi të fliste, të kërkonte shkakun dhe shkakтарin për gjithë këtë hata, të thërriste në ndihmë, të ulërinte, të ngrihej dhe të largohej nga ky vend i mallkuar, por ishte shumë i lodhur. Dua të fle njëherë! Të pushoj! Pastaj do t’i tregoj drejtorit për të gjitha, dhe ai... sa mirë të fle, të fle qetë...qetë... Dhe u tret prapë në agoninë e mëparshme.

\*

Radovan Babiqi qëndronte në këmbë, në anën e kundërt të tavolinës. Para tij ndodhej një dosje e hapur. Edhe pse shikimin e kishte përqendruar mbi geramat e saj, nuk ishte në gjendja të lexonte se ç’kishte të shë-

nuar në atë dosje, nga distanca që ishte, por e ndjeu se diçka e tmerrshme po përgatitej kundër tij. Një frikë tinëzare ia përshkoi shpirtin dhe nga jashtë i tërë trupi ju rrëqeth. Babiqi i zgjati dorën, duke e shkundur nga dyshimi. Sikur gjithmonë i buzëqeshur, ia përgatiti kërrigën të ulej dhe pasi e rehatoi, pas shpinës së tij u soll dhe u ul në anën tjetër të tavolinës.

“Së pari të kërkoj falje në emrin tim dhe të kolektivit për torturën që ta kanë shkaktuar me urdhrin tim por, pa dashjen time. Ka ndodhur një keqkuptim në mes të urdhrin tim dhe të atyre që e kanë zbatuar atë urdhër. Ti e di që një ditë më parë ka pasur demonstrata dhe shumë të arrestuar. Unë kam dhënë urdhër që të torturohej një person tjetër, por ata të njësisë sime, pa dashje, e kanë bërë ndryshimin e qelive të burgut dhe gabim kanë hyrë në qelinë tënde. Unë i kam dënuar ashpër ata për këtë sjellje brutale. Ata janë të gatshëm të vijnë vetë dhe te të kërkojnë falje, nëse ti e dëshiron dhe e kërkon një gjë të tillë.”

“Mjafton fjala juaj, shoku Babiq”, – tha Feri qetë, sikur ishte duke folur me veten e tij dhe ndjeu një siguri të theksuar. Lëvizi pak nga vendi, duke u afruar më pranë tavolinës. Duart i vuri lehtë mbi syprinën e tavolinës, e cila për një çast iu duk jashtëzakonisht e lëmuar dhe shkëlqyese. Iu bë se pa fytyrën e vet si në pasqyrë. Pa edhe fashat që ia mbështillnin një pjesë të kokës dhe iu duk se ishte i ënjtur dhe i zbehtë në fytyrë. I trembur, hoqi shikimin nga syprina e tavolinës, duke ngritur pak kokën .

“Sipas ekspertizës del se policët janë vrarë me revolen tënde. Ndaj...”



“Nuk ka pasur policë të vrarë, shoku Babiq. Atë natë në një kafene të qytetit, për qerim hesapesh, janë vrarë dy paramilitarë. Kurse vrasja e policëve është...”

“...shpikje nga ana jonë, do të thuash? Është më mirë të dëgjosh njëherë, pastaj do të vijë radha edhe ty të përgjigjesh dhe të japësh mendimin tënd! Pra, siç të thashë, policët janë vrarë me revolen tuaj, ndaj Prokuroria e Qarkut ka dhënë urdhër për arrestimin tënd dhe fillimin e hetimeve. Ti mos ke frikë, kjo nuk do të ndodhë! Ti do të dërgohesh në një kazermë dhe do të stërvitesh fizikisht dhe moralisht për aksione diversive. Gjatë kësaj kohe, nga ana jonë, ti do të shpallësh i burgosur. Pas përfundimit të fazës fillestare të stërvitjeve, do të pasojë faza e dytë, për të cilën do të njoftohesh me kohë, duke i marrë nga ne edhe instruksionet e punës që janë përpiluar në detaje! Besoj se e ke të qartë?”

“Po nëse unë nuk e pranoj këtë detyrë?” – pyeti Feri, duke shikuar Babiqin në dritë të syrit.

“Do të zhvillohen hetimet! Megjithatë, edhe për këtë do të bësh koncesione.”

“Çfarë koncesionesh?” – pyeti Feri, duke e parë veten pisk, por jo edhe aq sa e kishte menduar këto ditët e fundit.

“Për një kohë të pacaktuar do të mbetesh vetëm... dua të them pa familje. Pastaj do të jesh nën urdhrat dhe mbikëqyrjen e rreptë të njerëzve tanë. Moszbatimi i urdhrave është vetëvrasje. Pra, mendoj se koncesioni është i domosdoshëm... gjithsesi me i lehtë se burgu!”

“Vetëvrasje apo vrasje?” – pyeti Feri, duke e shikuar zhbirueshëm.

“Edhe vrasje, edhe vetëvrasje, merre si të duash. Unë të thashë se do t’i japim instruksionet dhe do të fillosh aty ku je caktuar.”

“Ku jam caktuar? – pyeti prapë.

“Është tepër herët të flasim për këtë temë. Tani mjafton të me përgjigjesh: je apo nuk je për koncesione?” – pyeti Babiq, duke vënë pak buzën në gaz.

“Pa një sqarim nga ana e juaj, e kam të vështirë të jap një përgjigje të plotë!” – tha Feri, duke e shikuar në sy.

“Ja ku po ta them troç. I ke dy rrugë: e para, rrugën e koncesionit me ato të dhëna që ti dhashë dhe, e dyta, rruga e qelisë. Zgjidh tani!” – tha Babiq, duke e humbur atë buzëqeshjen e akullt, që pak më parë i varej në buzën e poshtme.

“Jam për koncesione,” – tha kësaj radhe Feri, prerazi.

“Je i sigurt? - pyeti Babiq, duke e vënë prapë buzën në gaz.

“Po, jam i sigurt për atë që e them.”

“Mirë. Edhe për pak kohë, pra, derisa të shërohesh plotësisht, do të qëndrosh në spital. Prej aty do të dërgojmë në një kazermë, nuk e di as unë se në cilën, por atje do t’i gjesh të gjitha, fjalën e kam për planet, ushtrimet, stërvitjet e shumë të tjera. Deri në atë kohë, ti do të shpallësh i burgosur. Nuk do të lejohet askush të vizitojë. Kur të vijë koha t’ia fillosh detyrës së re, ne do të shpallim person në kërkim, pra si i arratisur nga burgu!... Plan i mrekullueshëm, apo jo!?” – pyeti Babiq.

“Shumë i mrekullueshëm!” - tha Feri, që akoma

nuk e kishte të qartë për çfarë koncesionesh ishte fjala. Ishte i ndërgjegjshëm se koncesionet do të ishin të rënda dhe ndoshta tepër tragjike për të, por si do që të bëhej, më të lehta se sa burgu sigurisht se do të ishin. E kishte të qartë se, nëse do të fillonin hetimet kundër tij, do të ishte i detyruar të pranonte atë që nuk e kishte bërë. Sa e sa të akuzuar vetë i kishte detyruar, përmes torturave, të pranonin veprat e pakryera. Iu kujtua rasti i një të riu, që dy vjet më parë, përmes torturave çnjerezore, vetë e kishte detyruar të pranonte se e kishte dhunuar një vajzë të mitur serbe. Feri e kishte zbuluar se vajzën e kishte dhunuar ungji i saj, por për t'i humbur gjurmët e turpit, ata ia kishin hedhur fajin të riut shqiptar, i cili ishte dënuar me tetë vjet burg. Pastaj ishte rasti i rrënimt të varrezave, që e kishte bërë një serb dhe për këtë vepër ishin dënuar tre të rinj shqiptar, e sa e sa raste të tjera.

“Offff!...” – ofshau dhimbshëm, pa gjetur dot ngushëllim.

## II

Ishte një mëngjes i zyrtë, me një shi të imtë që të ndillte gjumë. Nebojsa Mariq rrinte ende i shtrirë, kur e thirri e shoqja që të zgjohej nga gjumi, se po afronte fillimi i orarit zyrtar të punës. E ndiente në tërë trupin një lodhje të thellë, sikur tani të ishte koha e gjumit, e jo koha e fillimit të punës. Pasi lëshoi një „oh“ të lehtë, u ngrit nga shtrati. Me pelerinën e hedhur krahëve, shkoi në banje. Ndaloi pranë pasqyrës, duke e parë fytyrën e tij të verdhë dhe sytë pakëz të mbufatur nga gjumi. Kishte kohë që kjo verdhësi e fytyrës ia fuste frikën. Kishte dëgjuar nga një fallxheshë, kur ishte student, se njerëzve që iu verdhet fytyra, vdekjen e kanë afër. Fjalë gabelice, mendoi. Duke e shikuar plagën e mbyllur mbi vetull, egërsohej dhe sakaq e harronte verdhësinë e fytyrës dhe fjalët e gabelicës. Eh, ajo plagë ishte histori me vete, por kishte ardhur koha e hakmarrjes! Sakaq në mendje i shkoi takimi i parë i drejtpërdrejtë që kishte pasur me shqiptarët, ku kishte pësuar një rrahje brutale.

Kishte qenë duke udhëtuar me tren nëpër Serbi. Kishte një takim pune në kryeqytetin provincial. Ishte koha e rënies se tij, ndaj në këto rrethana ai e mbante të ndezur pishtarin e zjarrit patriotik. Në kupenë e trenit,

një grup bashkudhëtarësh dëgjonin muzikë dhe bisedonin ndërmjet tyre. Një plak me plis të bardhë bisedonte diç në gjuhën shqipe. Nga toni linte të mendoje se ishte i zemëruar, por ç'e do, kur nuk e kuptonte asnjë fjalë. Ishte nevrikosur, kur nga manjetofoni i tyre kishte filluar muzika e urryer shqipe. Nebojsa ishte egërsuar dhe kërcënueshëm kishte thënë: „Fike atë m...“ Ata ishin treguar të matur. I kishin duruar edhe shumë fyerje të tjera të tij. Por e keqja kishte ndodhur pasi treni kishte filluar të ngadalësonte shpejtësinë, për të ndaluar në stacionin e Mitrovicës. Njëri nga ata, që quhej Tomë (këtë emër aty për aty e kishte dëgjuar nga një bashkudhëtarë që ishte përpjekur ta zbuste pak egërsinë e tij), e kishte goditur me shqelma në bark, pastaj me grusht fytyrës, duke i thënë se këtu i thonë Shqipëri. Nuk i kujtohej më sesi e kishin flakur jashtë. Kishte mbetur në mes të binarëve, i mbuluar me gjak. Do të hakmerrem, për këtë jam betuar edhe atëherë, tha me zë, duke e ledhatuar lehtë plagën mbi vetull, tanimë të mbyllur.

Pasi u vesh, doli në rrugë. Me hapa të shpejtë u drejtua nga zyrat e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Tani nuk e kishte larg ndërtesën e Ministrisë. Qysh kur ishte emëruar në këtë post të lartë të policisë sekrete për Kosovën, kishte marrë banesë të re, bile shumë pranë ndërtesës së Ministrisë. Kjo ndërtesë ishte ndërtuar viteve të fundit dhe kishte dëgjuar se para tij këtu kishte banuar një nëpunës i lartë federativ nga Sllovenia. Ata i kishin tërhequr të gjithë nëpunësit e tyre, në shenjë mospajtimi me politikën serbe ndaj republikave. Mirë kanë bërë, bile do të bënin mirë sikur t'i tërhiqnin të gjitha republikat të deleguarit e tyre, mendoi

dhe për një çast thellë në shpirt ndjeu një kënaqësi që nuk e kishte përjetuar prej kohësh. Ja, pra, më në fund, ia arritëm qëllimit që edhe ne të organizohemi dhe të vazhdojmë luftën aty ku na e kishte ndërprerë Tito.

Nebojska kishte punuar si nëpunës i lartë në Ministrinë e Brendshme për sektorin e Kosovës. Atëherë kishte qenë fare i ri. Sa e kishte filluar karrierën. Kishte pasur një pasion të jashtëzakonshëm që të realizonte plan-projektin për problemet e pakicave në RSFJ. Filimi kishte qenë jashtëzakonisht i mbarë. Paraardhësit e tij gjatë luftës kishin arritur që në vendet kyçe t'i kishin njerëzit e tyre. Kishin futur në dorë udhëheqësin partiake dhe ushtarake të Kosovës. Kishin organizuar në qytetin P. të Kosovës, Konferencën e Këshillit Nacionalçlirimtar dhe me miratimin e dhunshëm të delegatëve shqiptarë, ia kishin dalë që Kosova të mbetej krahinë në kuadrin e Serbisë e të Jugosllavisë. Nga këtu, pastaj, kishin filluar të realizoheshin planet e tyre për problemin e pakicave në Jugosllavinë e re. Kishin realizuar një varg projektesh, si spastrimin e terrenit nga mbeturinat e fashizmit, pastaj grumbullimin e armëve, emigrimin e shqiptarëve vullnetarë për në Turqi dhe shumë gjëra të tjera.

Rrjeti i tyre kishte arritur deri në kupolën më të lartë të Federatës. Qëllimi ishte që, me një grusht-shtet, të përmbysnin qeverinë e udhëhequr nga Tito dhe udhëheqja e shtetit të vihej në duart e Serbisë. Pas Plenumit të Katërt të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë ishte kritikuar ashpër gjoja dhuna kundër pakicave, sidomos dhuna ndaj shqiptarëve. Aleksandër Rankoviçi, me shumë bashkëpunëtorë të tij ishte shkarkuar nga

pozitat partiake dhe shtetërore. Këtij shkarkimi nuk i shpëtoi as Nebojsa.

Iu kujtua dita e parë, kur e kishin transferuar në detyrë të re, pas shkarkimit. Me një fjalim modest, me pak fjalë miradije dhe pa asnjë duartrokitje, e kishin bërë të tronditej deri në tmerr.

Pas kësaj rënieje të papritur, pa entuziazëm kishte filluar të ngjitet në karrierë, por pa ndonjë post me vlerë. Qysh në ditët e para ai e kishte ndier rëndë peshën e indiferencës. Harresa, mënjanimi dhe përbuzja kishin qenë ndjekës të vazhdueshëm të punës së tij në vitet vijuese. Rrallë kishte ndodhur që të ftohej në ndonjë detyrë speciale dhe atë zakonisht në afate të shkurtra, si, bie fjala, për përgatitjen e terrenit për udhëheqësit e lartë, kur ata vizitonin Kosovën. Kishte marrë pjesë edhe në disa detyra të rëndësishme zbulimi në shtetet e Evropës, por të gjitha pa ndonjë vlerë të veçantë për karrierën e tij.

Pas kryerjes së këtyre detyrave, pasonte prapë heshtja dhe si gjithmonë, indiferenca, pastaj harresa, mënjanimi, përbuzja...

Këto shfaqje-zhdukje kishin vazhduar deri në prill të vitit 1981, kur ishte shfaqur haptas irredenta në Kosovë. E kishte parandier se kësaj radhe do t'ia kishin nevojën. Dhe ashtu kishte ndodhur. I kishin ardhur në shtëpi dy zyrtarë të lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe i kishin thënë se duhej të organizohej, duke i treguar se kësaj radhe nuk do të kishte më indiferencë. Kemi nevojë për këmbim përvojash, i kishin thënë ata. Nebojsa kishte pranuar detyrën e re, duke iu përveshur punës, me metodat e tij të vjetra, por me fuqi

të reja. Me plane afatgjata kishte arrirë të organizonin diferencimin ideopolitik që ishte e domosdoshme për momentin. Kjo masë përçarëse duhej të futej në radhët e udhëheqjes komuniste të Krahinës, pastaj në Universitet, në ekonomi, në ndërmarrje shoqërore, në mjetet e informimit publik, në sport e kulturë, në këshillat komunale, deri te bashkësitë lokale. Kishte përpiluar një projekt-plan për kthimin e serbëve të zhvendosur në Kosovë, si dhe për dërgimin edhe të atyre që duan të punojnë e të jetojnë në Kosovë, duke përdorur privilegje shtesë. Pastaj hapjen e dosjeve të vjetra, që nuk ishin të pakta dhe përpunimin e tyre, si dhe përpilimin e dosjeve të reja. Nuk kishte harruar ëndrrën e tij të vjetër, që krahas vijes institucionale, të ndiqte edhe vijën utilitare.

Posa hyri në zyrë, sytë i shkuan mbi tavolinën e tij të punës. Pa një dëng me letra. Paska ardhur posta zyrtare, mendoi. Pasi hoqi pallton dhe e vari në varësen prapa dere, u ul qetë në kolltukun e tij të punës. Grumbullin e letrave e afroi më pranë dhe zuri t'i shikonte me radhë vetëm titujt. Ishin pothuaj dosje të zakonshme. Kishte kërkesa për dhënie urdhrash, kërkesë për klasifikimin e planeve, seleksionime, vendime etj. Një dosje me ngjyrë të kaltër ndodhej e veçuar në krahun e djathtë, jo larg tij. Ku kishte qenë kjo më parë, që s'e kisha vërejtur, mendoi duke e zgjatur dorën kah dosja. Tepër sekret, Nr.09/89 SRS, lexoi tekstin me ngjyrë të zezë, mbi kapakët e dosjes. Rrotulloi letrën e rekomandimit që ndodhej në faqen e parë, që sipas rregullave, çdo nëpunës duhej së pari ta lexonte, e pastaj të futej në brendi të dosjes. Ty të lexoj më vonë, tha sikur vetë fle-



ta rekomanduese, e shkruar me germa të zeza cirilike, ta kishte lutur që ta lexonte të parën.

Ishin gjithsej katër nëndosje. E hapi të parën dhe filloi nga leximi: Nr.217, Branković Marinko, i lindur në Kraljevë në vitin 1958. I dënuar me njëzet vjet burg për krime të rënda. Është shumë i rrezikshëm. Vuan dënimin në burgun e Pozharevcit. Për ne shumë i përshtatshëm. Merr kontakt personalisht me të. Më poshtë ishin të dhënat e tjera rreth krimit, dokumentacioni i mjekut psikiatër dhe gjendja e tij shëndetësore.

E hapi nëndosjen e dytë: Nr. 2217, Starčević Miša, i lindur më 1956 në fshatin Hum afër Nishit. I dënuar me shtatëmbëdhjetë vjet burg. Vuan dënimin në burgun e Dubravës, në Kosovë. Vrasës serik. Shumë i rrezikshëm. I përshtatshëm për ne. Të dhënat e mjekut dhe gjendja shëndetësore e tij.

E hapi nëndosjen e tretë: Nr. 1717, Milivojević Momčilo, alias Moma, i lindur në fshatin Guresh në vitin 1963, në Kosovë. Njohës i shkëlqyeshëm i gjuhës dhe zakoneve shqiptare. I dënuar për shumë delikte, si dhunues dhe vrasës posaçërisht i vajzave të mitura në vendlindjen e tij. I arratisur për disa vite në Gjermani, njohës i gjuhës gjermane. I kërkuar nga policia gjermane dhe Interpoli për trafikë armësh, droge, dhunimi, vrasje dhe prostitucioni. Shumë i rrezikshëm. Ndodhët në burgun e Sremit. Merr kontakt personalisht me të.

E mori nëndosjen e fundit në dorë. E hapi me kujdes, duke e mënjanuar, sikurse në rastet e para, letrën rekomanduese: Nr. 711, Gjergjekaj Fer, i lindur në fshatin J, në vitin 1962. Ekspert i zbulimit me akademi policore të kryer në Beograd. I burgosur për dy vepra:

Nxjerrje e sekretit shtetëror para terroristëve shqiptarë dhe vrasës i dy policëve serbë gjatë demonstratave të nacionalistëve dhe irredentistëve shqiptarë.

Zgjedhja e kriminelëve nëpër burgje, studentë vullnetarë, të rinj nga jetimoret dhe dërgimi i tyre në detyra speciale ishin metoda të vjetra në politikën serbe. Edhe në Jugosllavinë e vjetër ka pasur formacione të tilla. Në atë kohë formacionet e tilla quheshin “Komitet”. Këtyre u lihej në dorë çdo gjë që nuk mund ta bënte ligji. Kishin mundësinë e veprimit të lirë dhe në mungesë të fakteve, e bënë vetë sajimin e tyre. Vepronin në mënyrë të papenguar nga organet e rregullta dhe kishin në dorë fuqinë e jo fakteve. Polici nuk ishin, ushtri jo, gëzonin të gjitha privilegjet. Kishin të drejt të vrisnin (kuptohet, vetëm shqiptarë), të dhunonin, të plaçkitnin pa i dhënë përgjegjësi askujt.

Nuk i kujtohej mirë se sa grupe të tilla i kishin dërguar deri me tani në Kosovë. Informacionet nga terreni bënë të ditur se deliktet që nuk i zbulonin dot trupat e rregullta policore, i zbulonin ata. Një pjesë e tyre ishin të uniformuar dhe të rreshtuar në grupet paramilitare (tani për tani të quajtur ushtarë rezervë), kurse pjesa tjetër ishin pa uniforma. Ata, zakonisht, vepronin në terren, duke mbledhur informata, si dhe në shumë raste duke ndërhyrë vetë në ndriçimin e delikteve të komplikuara.

E mori në dorë letrën e dytë rekomanduese. E hapi ngadalë dhe filloi të lexonte. Këshillat jepeshin të qarta. Do të duhej të merrte kontakt sa më parë me Ministrinë e Jashtme, për një takim të mundshëm me punëtorët e Ambasadës së Jugosllavisë në Zvicër. Do të

duhej që punëtorët e konsullatës (vetëm me ata që janë të caktuar në letrën rekomanduese) të mbikëqyrnin të dërguarit me misione speciale në Zvicër, vazhdonte më poshtë letra rekomanduese. Për çdo gjë në lidhje me ata, duhet të informohet Babiq.

Ishte i lumtur, nga se këtu shihte një shans jashtëzakonisht të përkryer, pasi që në Zvicër i kishte njerëzit e tij, të cilët prej kohësh i kishte organizuar në mënyrë të pavarur. Tani edhe këtë pëllumbin do ta dërgonte në këtë grup dhe pastaj grupi do të legalizohej, le ti se ç' thotë ajo shkarravinë rekomanduese. Ti do të punosh për mua. Nuk do? E di ti se unë ta këpus kryet si zogut? Do ta provosh? Ëhë, ashtu pra, të dua të zbutur... dhe nuk dua shumë nga ti, jo, jo, një punë të lehtë e dua nga ti, shumë të lehtë. Merre lapsin dhe letrën. Shënoji emrat e atyre trimave që veprojnë në Zvicër kundër nesh dhe m'i sill mua. Mos ke frikë, nuk dua t'i vras, jo, jo, në asnjë mënyrë, por dua t'iu jap vetëm pakëz drogë, dëgjon? Drogë...ha, ha, ha!... dhe pastaj, lyp ç'të duash! Do para, ja ku i ke! Do kurva, sa të duash! Do drogë, do ta sjellim ne atje! Do armë, zgjidh!... Pastaj, kuptohet, pjesa e luanit do të jetë imja.

\*

“Është tepër urgjent” - i tha sekretarja, porsa hyri në zyrën e tij, duke ia dhënë në dorë një zarf. Ishte një letër-ankesë, e cila vinte nga një fshatar serb nga Kosova. Ai ankohej në fqinjët e tij shqiptarë, të cilët ia dëmtonin pronat, e provokonin në baza kombëtare, bile kishte edhe të atillë që kishin bërë përpjekje për t'ia cenuar nderin familjar. Pastaj ai shkruante se, së pari, kis-

hte bërë ankesë te organet komunale, por ata nuk kishin ndërmarrë asgjë, duke i kujtuar se as serbët që punonin në kuvendin komunal, nuk ia kishin marrë fare para sysh ankesën. Në fund ai e mbyllte letrën me kërkesën për armë, me të cilën, të paktën, do të kishte mundësi të mbrohej vetë nga shqiptarët. Ashtu, pra, mendoi Nebojska, planet tona kanë filluar t'i japin frutat e para. Ti nuk je as i pari e as i fundit që ankoesh dhe armë do të keni, përkrahje do të keni, para do të keni... të gjitha do t'i keni, vetëm qëndroni edhe pakëz atje... Dhe befasi ju kujtua një letër-ankesë e një fshatari shqiptar, nga një fshat i humbur diku në Kosovë, që disa vite më parë, nëse nuk gabohej kjo kishte ndodhur pikërisht atë vit, kur Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Serbisë kishte shpallur Memorandumin që Kosovës t'i merrej statusi i autonomisë, i njohur në Kushtetutën e vitit 1974. Këtë letër ai ia kishte adresuar Kryetarit të Federatës Jugosllave, i cili në atë kohë ishte ai shqiptari S.H. Fshatari shqiptar ankohej se gjoja policia ia pasqeshin mbytur një djalë në burg, kurse tjetrin ia kishin burgosur, por pa bërë asnjë faj kundër shtetit... Sa ishte bërë teatër me atë letër, sa kishin diskutuar rreth saj dhe gjithmonë po nga ata komunistët naivë: Jo është bërë tejkalim i kompetencave nga ana e policisë, jo nuk është shqyrtuar në mënyrë të drejtë fajësia apo pafajësia e tij, jo ai e ka varë veten, jo e kanë torturuar deri në vdekje, jo vetë i kanë fajet, se ata gjithmonë kanë qenë kundër shtetit dhe shumë broçkulla të tjera si këto, dhe pastaj me urrejtje i kishin dërguar dy sekretarë të atij shqiptarit tjetër, që ishte kryetar i Jugosllavisë, për ta hulumtuar çështjen nga afër. Se çfarë kishte ndodhur

pastaj, nuk i kujtohej më. Kurse sot te ne çdo ditë vijnë letra të tilla. Strategjia kishte filluar t'i jepte frutat e para. Caktoi me të shpejtë njërin nga vartësit e tij që të udhëtonte në Kosovë, për ta parë çështjen nga afër. Mori dosjet dhe shkoi në zyrën tjetër, ku ishte sekretarja. I la mbi tavolinën e saj dhe i tha që urgjentisht t'ia bënte caktimin e datave.

Caktimi i datave ishte bërë ashtu siç i kishte renditur vetë. Tani kishin mbetur edhe ca përgatitje anësore, më të cilat merreshin dy vartësit e tij.

Ishte duke e pirë kafënë e mëngjesit, kur cingëroi zilja e telefonit. Ishte njëri nga vartësit e tij, që e lajmëronte se nga ana e tyre çdo gjë ishte gati. Udhëtimi do të bëhej me helikopter. Vartësi e lajmëronte se shoferi e priste të porta. Pasi u përshëndet me gruan, doli. Nebojsa u ul në ndenjësën e prapme të automobilin. Deri në pistën e helikopterëve, që ndodhej në anën e prapme të stacionit të policisë, ai nuk foli fare. Nuk ishte zakoni i tij të rrinte i heshtur, por sot sesi e ndiente veten. Porsa arritën në pistë, i pa të dy vartësit e tij që ishin fare pranë helikopterit, duke e pritur. Ata i dolën makinës anash dhe në shenjë respekti ia hapën derën. Me hapa të shpejtë Nebojsa u drejtua kah helikopteri.

Ishte një ditë e bukur vjeshte. Nga lart Nebojsa i shikonte fushat. Nëpër lugështaja, ku rrezet e diellit akoma nuk kishin arritur të depërtonin, si një tis i hollë e i bardhë, bryma e kishte mbuluar tokën. Në shumë vende shiheshin traktorët, duke mbjellë grurin, elbin apo ndonjë drithë tjetër të bardhë. Kemi një fushë të bukur, mendoi, por kemi pak... Tani sa e kemi filluar

luftën. Dalëngadalë dhe do t'i zbojmë të gjithë shqiptarët nga Kosova, pastaj do ta gllabërojmë edhe Maqedoninë. Edhe që andej do ta zbojmë krejt elementin jo sllav dhe të vendosim popullsi serbe. Eh... shumë pak jemi shtuar viteve të fundit!

Pas një dreke të majme në hotelin "Grand" të qytetit, kishte ardhur koha e takimit. Pritja ishte organizuar në një dhomë të vogël, në ndërtesën e burgut. Me urdhrin e drejtorit, gardianët e sollën Milivojeviq Momçillon – Momën. Nebojsa për një copë herë mbeti i hutuar. Ju duk se para tij ishte një fëmijë, e jo një kriminel, siç ishte i përshkruar në dosje. Moma kishte një fytyrë të njomë, me ca qime të rralla në faqe. I ngjante më tepër një çuni mitar - adoleshent, se sa një krimineli ordiner dhe për një çast dyshoi se ndoshta ishte bërë ndonjë ndërrim me ndonjë të burgosur tjetër. Ai kishte një palë sy që shkëlqenin padjallëzish. Nuk ishte i zhvilluar aq mirë fizikisht. Kishte një trup të ulët dhe thatak. Tani iu kujtua se, kur e kishte lexuar dosjen e tij, kishte marrë vesh për krimet rrëqethëse që ai kishte kryer. Çudi, prapa kësaj fytyre me tipare femërore të jenë të fshehura ato krime të tmerrshme? E kishte pararenduar një burrë kallushan, shtatlartë e muskuloz.

„Si të quajnë” – pyeti Nebojsa, për t’u siguruar se personi nuk ishte ndërruar me ndonjë tjetër.

“Milivojeviq Momçillo.”

“Aha, ti qenke Moma.”

“Po”, – pohoi Moma me mospërfillje.

“Jeni të njoftuar për këtë takim?”

„Po.”

„Je dakord?”

„Sigurisht!“

„E njeh mirë gjuhën shqipe?“ – pyeti Nebojsa, duke u përpjekur ta hetonte me një shikim ngultas në sy.

„Shumë mirë, jam rritur me fëmijë shqiptarë“

„Sa je i njohur me zakonet e tyre, me muzikën, folklorin, epet, e traditat tjera?“

“Si të them, i njoh deri diku.”

“Do më thënë, i njeh pak?”

“Po, pak,” – u përgjigj Moma, duke shikuar hutueshëm.

“Duhet të përgatitësh edhe në këtë drejtim.”

Moma rrudhi krahët, duke e thartuar fytyrën.

“Mirë. Tani do të njoftoj, shkurt, me misionin që je ngarkuar. Ky është një mision sa fisnik, aq edhe patriotik, por edhe i rrezikshëm. Ti do të veprosh në Zvicër. Kolegë pune do të kesh një shqiptar, por i njëjti nuk duhet të marrë vesh se kush je dhe për kë punon. Ai duhet të njoh ty si shqiptar. Në banesë, në automobil, në klube e kudo që të jesh, duhet të jesh komplet shqiptar. Të mendosh, të këndosh, dhe të veprosh vetëm shqip. Si shqiptar do të kërkosh azil politik, me emrin Ylber Kraqa, alias Beli. Ditëlindjen dhe vendlindjen do ta kesh atë që në të vërtetë e ke. Krejt dokumentacionin e ke të rregulluar në këtë emër. Me bashkëfshatarët tuaj nuk duhet të kesh asnjë kontakt. Do t’i ripërtëris lidhjet e vjetra me biznesmenin Aleks Peroviç dhe do të vazhdosh aty ku e keni ndërprerë veprimtarinë tuaj kontrabanduese, por kësaj radhe jo me armë e prostituta, por vetëm me drogë. Pra, do të kesh mision sekret, mision droge dhe gjithmonë nën urdhrat tona. Çdo urd-

hër që të vijë nga eprorët, duhet ta zbatosh, përndryshe e paguan me kokë. Për gjësende private nuk guxon ta rrezikosh procesin, kurse para, drogë e armë do të kesh sa të duash! Furnizimi do të behët vetëm përmes nesh. Para se të shkosh në Zvicër, do të dërgojmë në një bazë ushtarake që të stërvitësh fizikisht dhe psikikisht. E ke rreptësisht të ndaluar të kesh kontakte me lokale të hapura serbe. Informacionet shtesë do t'i marrësh gjatë kohës së stërvitjes.”

Për një copë herë Nebojsa nuk foli. Me një buzëqeshje të varur në buzë shikonte Momën, i cili iu duk i hutuar fare. E kishte të qartë se në takimin e parë nuk mund t'ia sqaronte të gjitha.

“Pasi të përfundojnë edhe ca formalitete, ti do të largohesh nga këtu. Do të qëndrosh në një bazë ushtarake, derisa t'i përgatisësh ato që i përmenda më sipër. Pra, bisedën e shpalli të mbyllur. Për sa biseduam, asnjë fjalë! Qartë?”

“Si urdhëro!”

“Shko tani,” – dhe me gishtin tregues Nebojsa shtypi sustën e alarmit. Në derë u dukën gardianët.

Për takimin e tij në Kosovë ishte njoftuar me kohë. Tani kishin mbetur edhe disa përgatitje anësore. Nuk ishte hera e parë që udhëtonte në Kosovë. Vetë posti që mbante, ia impononte që të kishte lëvizje dhe vizita të shumta si në Serbi, ashtu edhe në Kosovë e Mal të Zi. Pa dashur iu kujtua takimi i fundit që kishte pasur në një jetimore në kryeqytet. Aty ishte takuar për herë të parë me Sllavicën, drejtoreshë e institutit (që tani mbante kontakte të rregullta me të), e cila ia kishte ofruar të gjitha të dhënat për të rinjtë që ishin



në moshën e shërbimit ushtarak. Sllavica i kishte propozuar që, sa për fillim, të merreshin ushtar fëmijët me prejardhje shqiptare, rome dhe të tjerë, duke ia dhënë një listë të gjatë me emrat e tyre. Sllavica kishte qenë shumë e kujdesshme në punën e saj. Qysh kur e kishte filluar punën instituti, ishin mbajtur listat sekrete me prejardhjen e fëmijëve. Këto shënime ndodheshin në arkiv, atje ku ishte e ndaluar të hynte personeli tjetër, përveç drejtorit dhe punëtorëve të autorizuar. Të gjithë fëmijëve u kishin vënë emra serbësh, pavarësisht se nga vinin ata. Pastaj, për çdonjërin kishin sajuar një lloj historie që tregonte prejardhjen e fëmijës dhe tragjedinë që gjoja kishin pësuar prindërit e tyre, ku ata ose kishin humbur jetën tragjikisht, bie fjala në komunikacion, në ndonjë ngatërresë të rastit, ose nga ndonjë sëmundje e pashërueshme, apo kishin pasur ndonjë ndarje apo zhdukje tjetër. Dokumentet e sajuara mbaheshin në arkivin qendror dhe kishte të drejt çdo qytetar t'i hulumtonte. Ndodhte të vinin nënat e vërteta dhe t'i kërkonin fëmijët e tyre. Natyrisht se ato dërgoheshin në këtë arkiv dhe këtu ishte e pamundur të bëhej ndonjë zbulim i mirëfilltë. Kuptohet që pastaj Sllavica, në mënyrë sekrete e gjente menjëherë të vërtetën dhe nëse ajo që e kërkonte fëmijën ishte nënë serbe, kishte fatin që ta njihte, ta përqafonte, ta ledhatonte, apo ta rikthente prapë fëmijën e vet, kurse po të ndodhte që nëna të ishte jo serbe, nuk e kishte të njëjtin fat. Fëmijët me prejardhje jo serbe ishin të edukuar në mënyrë të veçantë. Që në moshë të re atyre iu mësonin për historitë dhe trimëritë që kishin bërë serbët gjatë historisë dhe, në anën tjetër, ua futnin në shpirt urrejtjen ndaj po-

pujve të tjerë, e sidomos ndaj shqiptarëve. Me këtë urëjtje fëmijët rriteshin dhe fitonin një dëshirë të zjarhtë për të luftuar kundër popujve jo serbë, sidomos kundër shqiptarëve që kishin ardhur nga Shqipëria (sipas mësimdhënësve të tyre) dhe ua kishin rrëmbyer tokën e shenjtë serbe, Kosovën. Ata ishin rritur duke zbatuar urdhra dhe ishin jashtëzakonisht të bindur dhe shumë korrekt në zbatimin e urdhrave. Prandaj, edhe nga ky institut kishin dërguar shumë të rinj që të luftonin në Slloveni, Kroaci e Bosnjë. Tani kishte lindur ideja që një grup nga këta të rinj të dërgoheshin në Kosovë.

Me këto mendime zbriti nga helikopteri dhe u drejtua nga makina që e priste. Pasi e shikoi orën, sesi i erdhi dhe i tha shoferit që ta ngiste makinën në drejtim të jetimores së qytetit. Shoferi, disi i hutuar nga ky urdhër i papritur i shefit të tij, ktheu kokën prapa, që të vërtetonte se a kishte dëgjuar mirë, apo shefi i tij kishte bërë ndonjë shaka. Pasi që u bind se shefi i tij nuk kishte bërë shaka, e shtypi gazin dhe vetura doli në rrugë.

Pasi u rehatua në ndenjësën e prapme të veturës, Nebojsa nxori nga xhepi pakon dhe ndezi një cigare. I dukej se makina po ecte shumë ngadalë dhe sakaq e hodhi vështrimin jashtë, duke shikuar njerëzit që ecnin trotuarit. Ishte rrëmujë e vërtetë, por Nebojsës nuk i bënte përshtypje. Tani ai ishte tretur në mendime, duke kujtuar takimin e parë me Sllavicën. Atëbotë, ai kishte shkuar për vizitë pune në jetimorën e qytetit. Në takimin e parë kishte ndjerë një lloj ngrohtësie tek ajo grua, që po u afrohej të dyzetave. Ishte një grua e mbajtur mirë, me një trup mesatar dhe mjaft mirë të zhvilluar. Ajo mbante veshur një fustan të shkurtër, pakëz pro-

vokativ, ngjyrë vjollce, me disa lule të rralla të lakuara në formë gjysmëharkore. Kishte flokë të gjata dhe të bojatisura bionde.

Sllavica kishte përgatitur tavolinën dhe kolltukët në arkivin qendror. Përveç dosjeve të sajuara, ajo kishte sjellë edhe dosjet origjinale që ndodheshin në arkivin sekret. Për çdonjërin nga kandidatët, ajo i kishte sqaruar Nebojshës prejardhjen e vërtetë. Ajo nuk kishte harruar t'i tregonte se cili nga kandidatët i plotësonte kushtet të ishte në krye të listës. Ai quhej Raviq Goran. Ishte shumë i ashpër, i rreptë dhe jashtëzakonisht inteligjent. Rridhte nga prindër shqiptarë. E ëma e kishte lindur kur kishte qenë vajzë shtatëmbëdhjetë vjeçe, kuptohet jashtë martese. Ajo kishte qenë e shtrënguar ta mbante të fshehtë lindjen e foshnjës nga prindërit. Kishte pranuar që të jetimores të përkujdeseshin për fëmijën e saj. Më vonë, ajo ishte martuar pikërisht me të dashurin e zëmres se saj dhe disa herë radhazi kishin ardhur për ta kërkuar të birin e tyre, por Sllavica nuk ua kishte dhënë. Ç'është e vërteta, Goranin ajo e kishte dashur në mënyrë të veçantë nga fëmijët e tjerë dhe gjithherë kishte pasur një lloj smire ndaj tij, vetëm pse ai rridhte nga prindër shqiptarë. Ajo e kishte mësuar ta thërriste Sllavicën nënë. Tani ajo e ndjente detyrë patriotike që Gorani i dashur i saj të rreshtohej në radhët e bijve më të mirë të popullit serb, për ta luftuar irredentën në Kosovë.

“Paske intelekt të hollë!”- i kishte thënë Nebojs-ha.

“Si urdhëron, zotrote, për këtë ditë i kemi rritur dhe edukuar. Le t'i vrasin vetë prindërit, vëllezërit dhe

motrat e tyre,” – ishte përgjigjur Sllavica krenare.

“Megjithatë, unë kisha pasur dëshirë që të takohe-  
sha me këtë çun!” – kishte shprehur dëshirën Neboj-  
sha. Sllavica menjëherë e kishte lajmëruar sekretaren  
që ta thërrisnin Goranin të vinte në arkivin qëndror.  
Gorani kishte ardhur dhe Sllavica e kishte njohur atë  
në vija të trasha rreth aktivitetit të zyrtarit. Gorani, pa  
dashje, i kishte parë dy dosje të hapura mbi tavolinë, ku  
Nebojsha e shikonte herë njëherë, herë tjetrën, dhe herë  
Goranin. Një emër, e dy dosje, kishte menduar kalimthi  
dhe prapë ishte koncentruar në fjalët e zyrtarit të lartë,  
të cilin i kishte rastisur ta njihnte përmes TV-së, por as-  
njëherë nuk i kishte shkuar ndërmend se do ta takonte  
në mënyrë kaq të papritur, edhe pse Sllavica kohë më  
parë i kishte premtuar një takim të tillë. Pas pak ai ishte  
përshëndetur me Nebojshën, duke ia shtrënguar dorën  
miqësisht dhe ishte larguar nga arkivi.

Sllavica, qetë-qetë, i kishte shërbyer me kafe dhe  
ia kishte vënë afër shishen e konjakut. Nebojsha kishte  
filluar të pinte, sikur të ishte në shtëpinë e tij. Edhe ajo  
i kishte kthyer ca gota, të gjitha për shëndetin e njëri-  
tjetrit, duke u shikuar në sy, sikur të ishin vërtet miq  
të vjetër. Sllavica ishte afruar pranë tij dhe kishte bërë  
sikur shikonte dosjen që e mbante në dorë Nebojsha,  
duke i dhënë udhëzimet për emrin që ndodhej në dosje.  
Ajo ishte kërrusur pranë Nebojshës, fare afër cepit të  
supit të djathtë. Gërsheti i saj e kishte gudulisur lehtas  
mbi faqe e mbi vetull dhe, sakaq, kjo gudulisje Nebo-  
jshës ia kishte kujtuar një histori të vjetër, që i kishte  
ndodhur në internatin e universitetit, ku kishte studiuar.  
Kjo gudulisje, ky ngacmim dhe kujtimi i asaj historie

në internat e kishin nxehur edhe më keq Nebojshën, i cili tani kërkonte vetëm një shkëndijë që të hidhej mbi trupin e bukur të Sllavicës. Prandaj, me dorën e majtë e largoi dosjen dhe ngadalë, me dorën e djathtë, filloi ta ledhatonte, si pa dashje, dorën e saj. Si dukej, edhe Sllavica ishte e mësuar me ledhatime të tilla, prandaj reagimi i saj ishte rrëshqitës, por edhe tërheqës për Nebojshën, i cili bëri sikur e largoi dorën e vet nga dora e saj dhe, me një lëvizje të lehtë, ia rrëmbeu belin. Ajo, qetë-qetë, ia kishte vënë dorën rreth qafës se tij të trashë dhe ishte mbështetur e tëra në trupin e tij. Nebojsha ishte ngritur në këmbë dhe me një shikim të rrufeshëm, plot zjarr, i kishte afruar buzët e tij pranë buzëve të saj. Sllavica jo vetëm që nuk e kishte kundërshtuar, por duke ia vënë të dy duart rreth qafe, i ishte qasur edhe më afër, duke e futur këmbën e tij në mesin e këmbëve të saja gjysmë lakuriq, duke thithur buzët e tij që tani më ishin të ngrohura nga rakia. Ajo, lehtas, ishte ulur mbi tavolinën e punës dhe ngadalë kishte filluar të zhvishej...

Kishte kohë që Sllavica kishte menduar një aventurë të tillë. Ajo i kishte vënë syrin një nëpunësi të ri, që sapo ishte emëruar në katedrën e inventarit në jetimore. Ajo e kishte fiksuar në memorien e saj qysh ditën e parë, kur ai kishte ardhur për të paraqitur kandidaturën. Gjatë bisedës, ajo ishte dashuruar në disa tipare të tij. Kishte kohë që i shoqi i kishte vdekur. Në ditët e para pas vdekjes së tij, ajo ishte betuar në veten e saj se për së gjalli nuk do ta tradhtonte kurrë kujtimin e tij. Tani kishte kaluar koha e aventurave, do të qëndronte besnike, të paktën tani kur kam një karrierë jashtëzakonisht të bujshme, kishte menduar. Por,

pas takimit të parë me nëpunësin e ri, disi kjo ndjenjë iu kishte fashitur dhe marrëzisht i kishte lindur dëshira e zjarrtë që ta shijonte edhe më tutje kënaqësinë e të punuarit në zyrë, siç e kishte shijuar shumë herë në karrierën e saj. Në shumë raste i kishte dhënë shkak nëpunësit të ri që të afrohej pranë saj, por ai gjithmonë i kishte rrëshqitur nga dora dhe i qe larguar.

Kur i kishte ardhur lajmi se një nëpunës i lartë nga Ministrija e Punëve të Brendshme do të vinte për ca punë tepër sekrete, ajo ishte përpjekur që të ishte sa më e përgatitur dhe t'ia bënte një pritje ashtu siç e donte nderi. Kurse, në anën tjetër, kishte menduar se kishte ardhur koha të bënte çmos që të ngjitej në karrierë, ndoshta përmes tij. Ajo kishte miq në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ku menjëherë kishte marrë kontakt me ta, duke kompletuar imazhin e saj me të dhëna të reja për nëpunësin e lartë.

Me t'u takuar sytë e saj me sytë e tij, kishte pasur një ndjenjë përulje, siç ndodh zakonisht te nëpunësit e vegjël, kur qëndrojnë kundruall të mëdhenjve, që rrallë iu rastis të takohen me ta. Por sytë e këtij nëpunësi të lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme se ç'kishin diçka të veçantë. Tamam ashtu siç e kishte menduar. Në fillim e kishte ndjerë veten disi të hutuar dhe të pazonjën që t'u bënte ballë atyre shikimeve dhe nuk kishte gjetur vrimë se ku t'i fshihte sytë! Thellë në shpirt ajo e dinte se këto ishin shikime nazeqare, përmes të cilave kërkonte arritjen në cak...

Duke i mbyllur dosjet, i kishte ardhur një e qeshur e madhe, sa zërin e saj e kishte dëgjuar edhe sekretaria në fundin e korridorit dhe disi një ndjenjë gëzimi e

kishte përshkuar në të gjithë qenien, duke ia gudulisur lehtë zemrën. Ia kishte arritur qëllimit. Mbetej të shihet se sa kohë do të ishte e zonja ta mbante këtë lidhje të re.

Sllavica për Nebojshën kishte përgatitur një dosje të re, ekstra. Kishte gjetur edhe shumë emra të çunave me prejardhje shqiptare, të cilët ishin mjaft të përgatitur nga çdo aspekt. Gjithashtu, kishte bërë edhe seleksionimin e tyre, duke e bërë një caktim provizor që ata të dërgoheshin pikërisht në ato rrethe ku edhe i kishin prindërit dhe fisin e tyre. Në fillim Sllavicës i kishte ardhur keq për këtë sjellje të saj ndaj këtyre çunave, por sakaq e kishte larguar nga mendja, duke e ditur se po bënte një punë patriotike në njërin anë, dhe një stimul për karrierën e saj, në anën tjetër. Sllavica ishte njoftuar për udhëtimin e Nebojshës në Kosovë, prandaj kishte punuar një kohë të gjatë, bile shpesh duke i marrë dosjet në shtëpi, që t'i përfundonte para se ai të arrinte. Dhe ia kishte arritur qëllimit. Dosjet ishin gati, të përpiluara në detaje, kurse Nebojsha ishte fare pranë derës...

\*

Udhëtimi i tij në Kosovë ishte njoftuar edhe përmes mjeteve të informimit. Në aeroportin ushtarak afër Prishtinës do ta prisnin zyrtarë të lartë të Krahinës të Kosovës e Metohisë. Pas një fjalimi që do ta mbante para masës së tubuar në Fushë-Kosovë, ai do të merrte pjesë në një mbledhje mbyllur, që do të mbahej në ndërtesën e Komitetit Krahinor dhe aty, në prani të përfaqësuesve besnikë serbë, do të lexonte një raport në pika të shkurtra, që ishte i përpiluar në formë ma-

nifesti.

Ishte shumë i lumtur që më në fund do të merrte pjesë personalisht në një tubim kaq të lartë, para masës, sidomos në një mbledhje të partisë, ku do të kishte rastin t' i shikonte për së afërmi kundërthëniet politike në mes të udhëheqësve të lartë krahinorë serbë dhe atyre shqiptarë, të cilët tani ishin para zhdukjes. Kishte informacione se përçarja në mes tyre kishte arritur deri në atë pikë, sa që ishte i sigurt se fjalimi i tij do t' i sillte të gjitha gjërat në nivelin e duhur, pra në atë të ndarjes definitive. Ky ishte synim i tij i mëhershëm. Ishte betuar se do të bënte çmos që të shkatërronte në themele bashkim-vëllazërimin në mes të serbëve dhe shqiptarëve, edhe ashtu të brishtë. Pastaj, do të bënte edhe një rirënditje të kandidatëve dhe një ndryshim sekret të çdonjërit nga udhëheqësit e lartë krahinor, duke u dhënë shumë më shumë kompetenca zyrtarëve serb. Rëndësi të veçantë, për momentin, do të kishte ndërtimi i disa nën komisioneve, si ai politik, juridik, ushtarak, ekonomik, shëndetësor dhe kulturor. Nën komisioni politik do të merrej me çështjen e fjalimeve, bisedave, replikave, komunikatave etj. Nën komisioni juridik do të merrej me dhënien e kompetencave për fuqizimin e urdhrit ekzekutiv, pastaj zëvendësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve shqiptarë me kuadër të përgatitur serb. Nën komisioni ushtarak do të merrej me largimin e të gjithë kuadrove shqiptare, që ishin të inkuadruar në mbrojtjen territoriale dhe civile të Kosovës dhe që kishin përgatitje shkollore, duke i zëvendësuar me oficerë serbë. Proteksioni civil do të merrej me koordinimin e punës dhe sinkronizimin e përbashkët me obligues ushtarakë dhe



obligues policorë, si dhe plotësimin me obligues nga mbrojtja civile, duke formuar shtabe civile territoriale dhe shtabe të përbashkëta, që do të kishin një bashkëpunim të ngushtë në mes të policisë sekrete, policisë së rregullt, grupeve paramilitare, militare dhe grupeve të tjera civile të armatosura. Nën komisioni ekonomik do të merrej me të ardhurat ekonomike të Krahinës, ku do të futeshin sektorët e bankave, ndërmarrjet e mëdha shoqërore, doganat, hoteleria si dhe menaxhimet tregtare. Nën komisioni shëndetësor do të kishte në gjirin e vet kontrollin e medicinës mjeko-ligjore, të spitaleve, të ambulancave, barnatoreve, drogërive etj. Dhe nën komisioni kulturor do të merrej me censurimin e literaturës në gjuhën shqipe, me kontrollin e shtëpive botuese, shtypin ditor, mjetet e informimit, teatrin, koncertet, ndeshjet sportive etj.

Këto ishin bazat kryesore të veprimeve të mëtutjeshme të koordinuara mirë. Mendohej se gjatë procesit dhe varësisht nga rrethanat do të kishte variacione, por pa e dëmtuar bazën.

Fjalimi i tij para masës në Fushë-Kosovë ishte i shkurtër dhe inkurajues për popullatën serbe. Aty Nebojsa nuk harroi të përsëriste citate nga fjalimi i famshëm i ideologut të denjë të tij, që kohë më parë i qe drejtuar masës në Gazimestan, ku ndër të tjera u kishte premtuar serbëve se askush nuk do të guxonte të luante më me fatin e tyre, siç kishte ndodhur gjer tani.

„Edhe populli serb, sikurse edhe popujt e tjerë të Federatës Jugosllave, ka të drejtë të jetojë, të punojë, dhe t’i kërkojë të drejtat e veta. Këtë duhet ta ketë të qartë edhe Federata, dhe mbarë bota, qofshin ata miq apo armiq të Serbisë. Prandaj, vëllezër e motra

të ndershme serbe, ju bëj thirrje që mos të ju dhimbset asgjë për atdheun tuaj, për popullin tuaj hyjnor, për femijët tuaj, për stërgjyshërit tuaj që luftuan ndër shekuj me trimëri dhe patriotizëm të rrallë për t'i mbrojtur kufijtë, kulturën, gjuhën, fenë dhe kishat që janë ruajtur dhe mbrojtur me aq shumë gjak e sakrifica ndër shekuj dhe që sot kanë ardhur buzë zhbërjes nga terroristët shqiptarë. Bashkohuni rreth flamurit, rreth kishës sonë të shenjtë ortodokse, rreth kulturës dhe gjuhës së zotit, në luftë kundër të pafeve, të pabesëve, të nëmurve të zotit, deri në zhdukjen e tyre dhe të kthimit të lirisë në tokën e shenjtë serbe të Kosovës. Le ta dinë të gjithë armiqtë e popullit serb se aty ku jeton një serb, aty është Serbi, dhe ne do ta marrim me hir apo me pahir, me dëshirë apo pa dëshirë, me paqe apo me luftë! Ne luftën do ta fitojmë gjithsesi, qoftë me pëlqimin e bashkësisë ndërkombëtare, qoftë pa pëlqimin e saj, qoftë edhe kundër vullnetit të bashkësisë ndërkombëtare!... Rroftë populli hyjnor serb! Rroftë Kosova serbe! Rroftë Serbia jonë e madhe!“

Brohoritjet nuk kishin të ndalur. Jehona e zërave të masës që buçitnin si në kor, dukej sikur thernin kupën e qiellit, duke e mbushur edhe ajrin tani më të rënduar me re kërcënuese. Turma buçiste dhe hidhte sloganet e tyre. Duam armë! Jashtë shqiptarët nga Kosova jonë! Rroftë Serbia! Kosova është Serbi. Dhe pastaj, si në revansh, turma ua merrte këngëve çetnike:

*Gjurgjev dana çetnički sastanak,  
Mítrov dana çetnički rastanak.*

Disa pleq të emocionuar nga këto këngë, të cilat ua kujtonin luftërat e tyre që i kishin bërë kur e kishin çliruar Kosovën nga thundra pesëqind vjeçare osmane dhe ia kishin bashkangjitur Serbisë, ishin tubuar në një qoshe dhe të veshur me veshjen e tyre kombëtare, me sy të përlotur nga gëzimi dhe emocioni, brohorisnin me gjithë qenien e tyre. Ata kishin kërkuar edhe një takim me Nebojshën. Nebojsha kishte zbritur nga foltorja dhe duke i përqaftuar pleqtë, u kishte premtuar se nuk do të kishte fuqi në botë që do të guxonte më të luante me ndjenjat e popullit serb.

Pasi e shpalli tubimin të përfunduar para mase, Nebojsha u largua nga foltorja dhe, i shoqëruar nga policia, u drejtua për në godinën e Kuvendit Krahinor.

Në një sallë të improvizuar, Nebojsha kishte ftuar më besnikët. Ai, në pika të shkurtra, i njohu për punën dhe qëllimet e këtij takimi. Edhe pse mbledhja kishte karakter konsultativ dhe çështjet për unifikimin e Serbisë duhej të viheshin në diskutim, Nebojsha i urdhëroi besnikët e tij se brenda në sallë rrjedha e mbledhjes duhej të merrte kahjen e faktit të kryer, deshën apo nuk deshën udhëheqësit shqiptarë të Krahinës. Ai, gjithashtu, dha edhe disa udhëzime të fshehta sesi duhej të menaxhohej situata.

Pas konsultimeve me të pranishmit, Nebojsha, bashkë me stafin e tij, hynë në sallën e madhe, e cila ishte e mbushur me delegatë. Kryetari i Kuvendit, pasi e hapi mbledhjen, ia dha fjalën Nebojshës, i cili e kishte të ngulitur në kujtesë elementin e fjalimit, që me vite të tëra ai nuk bënte tjetër, pos që e përsëriste si refren: diferencimi ideopolitik, mospajttime, kritika, dënime,

kurse në anën tjetër për të privilegjuarit shpërndante lëvdata, urime, dekorata. Dalja e tij në foltore u shoqërua me duartrokitje frenetike. Ai, duke shikuar në një pikë të papërcaktuar, e filloi fjalimin:

“Vendimet e Kuvendit të Serbisë, që janë marrë kohëve të fundit, kanë të bëjnë kryesisht me unifikimin e Serbisë. Këto vendime janë votuar njëzëri nga delegatët e Kuvendit të Serbisë. Nuk e shoh të arsyeshme që edhe një herë të behët votimi i tyre këtu. Jam i sigurt se për këto vendime nuk do të ketë ndonjë kundërshtim nga ana e delegatëve të Kuvendit Krahinor.”

“Me sa di unë, çështja është në diskutim!” – foli dikush nga mesi i sallës.

„Jo. Çështja është diskutuar dhe votuar nga delegatët e Kuvendit të Serbisë“

„Por jo edhe nga delegatët legjitimë të Kuvendit të Kosovës!“

“Me duket se jemi keqkuptuar. Megjithatë, më vonë do t’i jap të gjitha sqarimet. Pra, siç e thashë, ne luftën duhet ta fillojmë këtu...”

Një tollovi në mesin e sallës bëri që Nebojska ta ndërpriste fjalimin. Dikush fliste me zë të lartë dhe pje-sa më e madhe e delegatëve ishin ngritur në këmbë.

Pas disa shtyrjeve, u dëgjuan të shtëna. Nebojska nuk arriti të dallonte se kush qëllloi, por pa se delegatët u shpërndanë me të dëgjuar krismat. Tutje, në mesin e sallës pa atë që pak më parë kishte folur. I plagosur rëndë, përpëlitej në kërrigën e tij. Pastaj vari kokën poshtë, sikur donte të merrte diçka nga dyshemeja. Në gjoksin e tij të gjerë pa këmishën e tij të bardhë që skuqej nga gjaku. Lëvizjet e tij të gjithë i morën si përpëlitjet e fundit të njeriut që po jepte shpirt. Ishin zh-

gënjyer. Ai nxori revolen dhe qëilloi kuturu. Njëri nga të ardhurit nga kryeqyteti, me revole në dorë që qëndronte përballë tij, bëri disa hapa prapa, duke u përplasur për dysheme. Plumbi e kishte goditur mbi vetullën e djathtë. E shtëna e dytë bëri që njeri që gjendej pranë foltores ta mbante barkun me të dy duart. Të shtënat e fundit e qetësuan të plagosurin. Ai rrëshqiti lehtas nga fronti i tij, duke u rrotulluar mbi dysheme.

Të pranishmit u turrën në drejtim të viktimës, kurse ai që pak më parë kishte zbratur disa plumba mbi viktimën me revole në dorë, iku drejt Nebojshës.

“Kishte kohë që i kundërshtonte vendimet tona.”

“Filloi etapa e re e luftës sonë,”- tha Nebojsha në vend të përgjegjës.

### III

Për shkak të dështimit të hetimeve, që po zbatoheshin kundër ish inspektorit të zbulimit Fer Gjergjlekaj, ishte caktuar paraburgimi në afat prej gjashtëdhjetë ditësh, konform urdhrit ekzekutiv, kishte deklaruar prokurori publik. Këtë e kishte konfirmuar edhe gjykatësi hetues. Ai kishte deklaruar së Feri kishte bërë shumë delikte, të cilat kishte ardhur koha të shkoqiteshin një e nga një dhe të kompletoheshin në thyerje ligji për kundërvajtje. Përveç këtyre veprave që e rëndonin, ai tani akuzohej edhe për korrupsion. Për këtë shkak, para disa vitesh, ai e kishte humbur detyrën e inspektorit, duke e zbritur në shkallën e policit të thjeshtë, pa asnjë kompetencë.

Bardha kishte bërë përpjekje që t'i dilte në ndihmë, jo vetëm përmes avokatit, por edhe përmes Babiqit. I kishte shkuar në shtëpi. Kishte biseduar me Gordanën, pastaj edhe me Babiqin. Në fillim fjalët e tyre i qenë dukur inkurajuese, por pastaj nga shikimet zhbiruese të Babiqit disi kishte rënë në plogështi të plotë dhe, ashtu e penduar pse kishte ardhur këtu, e kishte ndier veten keq. Pastaj, edhe biseda kishte marrë një ngjyrë interesi të papërmbajtur nga ana e Babiqit. Ai, në një farë mënyre, linte të kuptohej se synimin e kishte te paratë dhe te trupi i saj fillak, që ia shtonin

epshin. Duke mos pas fuqi t'i bënte ballë shikimit provokues të Babiqit, Bardha ishte ngritur dhe kishte dalë jashtë, e ndjekur nga një premtim i ftohtë nga ana e tij. Në mënyrë të tërthortë ai ia kishte bërë me dije se ajo duhej të vinte më shpesh për të marrë informacione shtesë. Edhe pas përshëndetjes së dhunshme, deri në fundin e korridorit të gjatë e kishte ndjekur zëri i tij, që vinte si i venitur, herë provokativ e herë lutës.

Pasi që në mënyrë të tërthorët ia kishte bërë me dije Babiqit se nuk do të shkonte më në zyrën e tij, pa vonesë kishte marrë vendimin nga komuna për largim nga banesa. Aty do të vendosej një inspektor i lartë i Sigurimit Shtetëror, i cili para një kohe kishte ardhur nga Serbia, si përforcim i masave të dhunshme. Bardhës i qe dashur të kërkonte ndihmë nga vëllezërit e saj, pasi që familja e Ferit nuk e kishte honepsur fare. Të gjitha plaçkat i kishte dërguar në shtëpinë e prindërve. Por, pak më vonë kishte plasur sherri me prindërit e Ferit, për shkak të plaçkave. Ata i qenë kërcënuar që sa më parë t'ua kthente të gjitha, se për ndryshe do ta lajmëronin në polici. Deshi apo nuk deshi Bardha, kishte pranuar që të gjitha ç'kishte t'ua kthente, pa pasur të drejtë të shkonte edhe ajo bashkë me plaçkat në shtëpinë e burrit.

Atë ditë, kur ata kishin ardhur për ta marrë pajën e saj të nusërisë, sesi i ishte ndjerë Bardha, sikur kishte një boshllëk në brendi. Ishte shkrehur në vaj. Tani ajo kishte mbetur e vetme. Ishte e pa mbrojtje. Mentori që gjithherë i dilte në ndihmë, kishte kohë që ishte larguar nga vendi. E kishte ndjerë Bardha se, sa herë që Mentori mungonte, diçka e rëndë, e tmerrshme do të ndodhte në jetën e saj. Edhe atëherë kur Mentori

ishte në burg, Ademi e kishte shfrytëzuar mungesën e tij dhe e kishte fejuar dhe martuar, pa e pyetur fare. Kur ai ishte liruar, çdo gjë kishte qenë akt i kryer. Çdo përpjekje për përmirësimin e atij gabimi, kishte qenë e vonë. Shkakun e largimit të tij nuk e dinte të saktë, por kishte dëgjuar nga nusja e tij se edhe kësaj radhe ishte marrë me çështje politike. Ajo i kishte thënë se ai, bashkë me shumë shokë, kishin bërë përpjekje për të formuar e Ministrinë e Mbrojtjes.

Bardha u dridh nga fjalët që dëgjoi. I erdh mirë që ishte larguar me kohë, se, në të kundërtën, do ta kishte pësuar sikur herën e parë, kur ishte burgosur gjatë kohës së studimeve si kadet në Akademinë Ushtarake në Beograd. Befas iu kujtua Bardhës seanca e gjyqimit të Mentorit. Një kohë të gjatë trupi gjykues ishte marrë me leximin dhe zbërthimin e vargjeve që gjatë bastisjes ata i kishin gjetur të shkruara në notesin e tij. Pasi i mbylli sytë, sikur ishte duke lexuar në notesin e Mentorit, ju kujtuan disa nga vargjet:

*...atdheu im rënkon,  
me dhembje e dënesë!  
Trupin kur ia hanë  
duke i hequr pjesë!...  
Mushkri e zemër  
Nga dora e kirurgut  
që rri n' kryeqëndër!...*

Pastaj kishin vazhduar debatet: Cili është atdheu i juaj që rënkon? Nga kush rënkon? Kush ia ha trupin? Cilat janë mushkëritë? Cila është zemra? Pastaj, cili është kirurgu? Kryeqendra?... Dhe në çast ju duk



se e pa Mentorin me atë pamjen e tij të qetë, duke iu përgjigjur pyetjeve të tyre, sikur të ishte duke folur në odë me shokët e tij, atje në fshat, e jo para gjyqit: At-dheu im është toka ku unë kam lindur, ku jam rritur, toka e të parëve të mi, kurse rënkimi i saj vjen nga dhembjet që ia shkaktoni ju, duke i hequr pjesë, duke e shfrytëzuar nëntokën e pasur për interesat tuaja...

Policia, bashkë me Babiqin, kishin ardhur disa herë për ta kërkuar. Dy herë ishte bastisur e tërë shtëpia. Mentori nuk kishte lënë gjurmë. Bardha kishte pasur shumë frikë se mos ata do t'i hidhnin ndonjë material propagandues dhe pastaj do ta merrnin atë si provë faktike. Për këtë ishte e sigurt se ata do ta bënin, po që e nevojshme për ta. Feri i kishte treguar Bardhës se ai vetë, në disa raste, gjatë bastisjeve në shtëpitë e atyre që ua kishin vënë syrin për t'i burgosur e që nuk kishin pasur prova të mjaftueshme, ua kishte futur ndonjë trakt, pamflet a ndonjë libër të ndaluar dhe pastaj fare lehtë i kishin burgosur.

Edhe tani, kur ia kishin rrëmbyer të gjitha rrobat e nusërisë (fustanet e modës që Feri ia kishte blerë herë pas here, e që ai nuk ia kishte blerë për një dashuri të çiltër që kishte ndaj saj, por për t'i fshehur paudhësitë e tij që i bënte ahengjeve nëpër kafene, bareve të ndryshme të mbushura plot me kurva të ardhura nga Serbia), nuk iu kishin dhimbsur fare.

Kishte raste krizash (tani çuditërisht të shpeshtuara), që, pasi ngopej së qari ashtu e shtrirë në shtrat, zinte fillin e kujtimeve të se kaluarës.

...Ishte shtator. Sot fillonte dita e parë e shkollës. Bardha ishte zgjuar herët në mëngjes dhe pasi kishte veshur teshat e reja që ditë më parë ia kishte dhuruar i

ati, të sjella nga Zvicra, kishte bërë gati edhe librat, duke i futur në çantë. Ishte kujdesur të mos harronte edhe “ditarin”, në të cilën i kishte të shënuara titujt e librave që i kishte lexuar gjatë pushimeve të verës. Aty kishte të shënuar edhe shumë ngjarje mbresëlënëse. Kishte edhe disa poezi si dhe shënime-kujtimi të shoqeve të saj. Flokët i kishte ndarë në mes. Në njërën anë flokët i rrinin të shpupuritur butësisht mbi supe, kurse në anën tjetër i kishte lidhur prapa me një fjongo të kuqe. Nuk kishte harruar që, nga lulet që i kishte mbjellë vetë në kopshtin e vogël para shtëpisë dhe ishte kujdesur gjatë gjithë verës për to, të këpuste më të bukurat për t’ia dhuruar kujdestares. Dhe ashtu, duke u përgatitur për ditën e parë të vitit të ri shkollor, ajo këndonte me zë të ulët këngën e preferuar, që zakonisht e këndonin në kor, bashkë me shokët dhe shoqet e klasës:

*Të rashë pas, moj, të rashë pas,  
Rrugës kur shkoje për gjimnaz !*

Dhe, ashtu e gëzuar e me këngë në gojë siç ishte, kishte bërë të dilte në oborr. Aty, të pragu i derës, gati sa nuk ishte përplasur trup me trup më Ademin. Ai e kishte shikuar nga koka te këmbët dhe pastaj shikimin e kishte ndalur në tufën e bukur të luleve, që Bardha me një kujdes të veçantë e mbante në dorë. Sikur ato lule të ishin shkaktari kryesor që Ademi ta rrëmbente nga dora dhe me një zemërim të papërmbajtur ia kishte përplasur për tokë, duke ju hakërryer:

“Shkon në shkollë ti, apo shkon nuse?”

“Në shkollë“, - ishte përgjigjur Bardha dhe gjithë

ajo hare, gjithë ai shend që pak më parë nuk kishte mundur ta fshihte dot, tani ju shemb dhe u bë një me dheun që e kishte nën këmbë.

“Ne kështu i përcjellim vetëm nusët. Hyr brenda, sa s’ t’i shkula flokët me rrënjë, moj e përdalë!”

Bardha, e dëshpëruar, ishte kthyer në dhomë. Në asnjë mënyrë nuk ishte në gjendje ta kuptonte shkakun e vërtetë të këtij ndalimi të papritur. Por, megjithatë, ajo kishte vendosur që fshehurazi të shkonte në shkollë. Dhe ashtu bëri.

Pas shumë ndërhyrjeve të drejtorisë së shkollës në njërën anë, dhe të Mentorit në anën tjetër, ai kishte pranuar që Bardha të vazhdonte lirshëm edhe këtë vit të fundit të shkollës fillore, duke u zotuar që në asnjë mënyrë nuk do ta lejonte që t’i vazhdonte mësimet në gjimnaz.

\*

Ishte mesnatë. Të gjithë flinin. Edhe Bardha kishte kohë që bënte përpjekje të flinte, por nuk e zinte gjumi. Dafina e vogël, mbesa e saj, ishte shtrirë pranë, duke e gudulisur lehtë me flokët e saj të artë, që iu kishin shpërndarë mbi jastëk. Kishte kohë që Dafinën e kishte kapluar gjumi. Ajo flinte e shkujdesur dhe për një çast Bardhës iu kujtua vetja kur ishte vajzë në moshën e saj. Edhe ajo, në atë kohë, kishte qenë e shkujdesur. Tërë ditën kishte vrapuar pas luleve, pas fluturave, kishte hipur në pemë, kishte luajtur me shoqet guracak, kishte vrapuar pas shqerrave dhe pas qengjave në pranverë, kishte luajtur vizak, pastaj lojën e nuseve... dhe në mbrëmje, kur kthehej në shtëpi, derisa zinte të

errej nata dhe të dilnin yjtë në kupën e qiellit, luante me vajzat e fqinjëve në oborrin e tyre të madh, atje prapa pojatës së vjetër, duke vrapuar pas xixëllonjave... dhe në fund, dalëngadalë, duke dëgjuar përrallën e gjyshes, e zinte gjumi. Kurrë nuk i kishte shkuar mendja se do të kishte një fat të tillë!... dhe duke e shikuar vajzën e vogël që gërhiste qetë në atë mugëtirë që e krijonin rrezet e arta të hënës, e uronte që ajo, të paktën, të mos kishte fatin e saj.

Të lehurat e qenve sikur e tundën nga ajo amulli kujtimesh dhe kërceu nga shtrati. Me hap të lehtë, sikur të kishte frikë se mos e zgjonte nga gjumi të mbesën, u afrua pranë dritares. Në dritën e hënës dalloi siluetat e policisë, që e kishin mbushur tërë oborrin.

“Uf! Të mjerët ne! Policë...ushtarë!” – klithi si e hutuar dhe hapi derën. Doli me të shpejt në korridor. Por, ishte vonë. Ata kishin zënë çdo kënd të shtëpisë. Ishin shumë. Hynin e dilnin nëpër dhoma, si në ndonjë kafene. Krejt shtëpia ishte nën kontrollin e tyre.

“Ku është Feri?” - pyeti dikush prapa krahëve të saj. Bardha ktheu kokën të shihte se nga i erdhi ai zë, sepse i tingëlloi si i njohur. Nuk kishte gabuar. Ishte Babiqi. Nuk kishte frikë. Ishte në mesin e familjes së saj. Çfarëdo që të ndodhte janë të gjithë këtu, kurse të kishte pranuar të shkonte atje, edhe sikur mos të kishte ndodhur asgjë, nuk do të shpëtonte pa njollë.

„Në burg është ai. Pse, çfarë ka ndodhur?”

„Ishte në burg, por është arratisur dhe për këtë ju duhet ta dini, sidomos ti!“ – dhe Babiqi bëri me gisht në drejtim të Bardhës.

„Ne nuk kemi asnjë lajm, që nga dita kur e keni

arrestuar. Ku ta dimë ne?“ – tha Bardha këtë radhë, por shikimi i mbërthyer i Babiqit në gjoksin e saj e bëri të kujtohej se këmisha e natës nuk ishte mbërthyer deri lartë nën gushë dhe pjesa e epërme e gjinjve të saj të zhvilluar, ishin lakuriq. Me të dy duart ajo filloi t’i mbërthente kopsat. Kurse në kokë i buçitën fjalët e Mentorit, që ia kishte thënë, pasi ata e kishin burgosur Ferin: „Ai nuk është fare në burg. Jam i sigurt që ai ndodhet jashtë, i rekrutuar për ndonjë detyrë speciale!“

„Kontrolloni çdo dhomë në imtësi!“ – urdhëroi Babiqi.

Tani më ishin zgjuar të gjithë. Dafina ia kishte kri-sur vajit, duke e bërë Bardhën të kthehej me vrik në dhomën ku ishte vajza. Babiqi e shikoi derisa ajo u fut në dhomën përmbri tij, pastaj e urdhëroi policin që ndodhej pranë të mos lejonte lëvizjen e askujt, derisa vazhonte kontrolli. Vetë u fut në dhomë, pas Bardhës.

“Bardha, ti je shumë e bukur“, - i tha ai, posa hyri në dhomë, duke e mbyllur derën prapa krahëve të tij. Bardha, në vend që të përgjigjej, mori Dafinën në parzme, duke u përpjekur ta qetësonte. Babiqi, kur e pa se ajo nuk po e honeps fare, ia rrëmbeu brutalisht çupën nga duart, duke e përplasur për dysheme. Dafina u mpak. Me sy të përplotur dhe duke zgjatur duart e saj të vogla, sikur kërkonte ndihmë nga Bardha, e cila me një lëvizje të shkathëta arriti ta tërhiqte vajzën nga dyshemeja. Babiqi ia rrëmbeu prapë nga dora dhe me një brutalitet të paparë e hodhi jashtë nga dera, sikur ajo të ishte një trup i ngurtë e i pashpirt dhe jo njeri. Vajza e mpakur u përplas të këmbët e gjyshes, e cila e mori në prehër. Babiqi e përplasi derën.

„Nëse kundërshton, do ta vras Dafinën, në vend, para syve tuaj“, - dhe, pa një pa dy, e rrotulloi mbi shtrat, i cili akoma ruante ngrohtësinë e Dafinës.

Me të gjitha forcat ajo përpiquej të lirohej nga duart e tij. Bardha kishte piskatur, duke kërkuar ndihmë, por askush nuk kishte mundësi t'i ndihmonte. Që të gjithë ishin në të njëjtën pozitë. Bardha i dha trupit me të gjitha forcat dhe u gjend jashtë kontrollit të tij. Babiqi, duke e parë se mund ta humbte betejën, e sulmoi për të dytën herë, duke e goditur shuplakë fytyrës, sa i hëngri krahu. Pastaj e rrëmbeu nga supet dhe e rrotulloi mbi shtrat dhe nga brezi nxori revolen, duke ia drejtuar tytën e zezë e të ftohët nën mjekër. Bardha, pa ju trembur syri fare, ia largoi dorën që i dridhej dhe prapë i doli nga kontrolli. Babiqi kësaj radhe përdori grushtin, duke e goditur në gjoks. Bardhës për një çast ju errën sytë. Ju bë së e gjithë pesha e shtëpisë rëndonte mbi kurrizin e saj. Pas disa luhatjeve, ra pa ndjenja. Pa vetëm duart e Babiqit që u zgjatën në drejtim të saj, dhe pastaj ... errësirë. Errësirë dhe qetësi bashkë.

\*

Pas asaj agonie, të cilën Bardha nuk ishte në gjendje ta përcaktonte se sa kishte zgjatur, e kuptoi se ishte e dhunuar, e turpëruar dhe e shkatërruar fizikisht. Ndiente dhembje në gjoks, aty ku e kishte goditur Babiqi. Të koka i rrinte e ëma. Ajo, me lot në faqet e saj të vyshkura, përpiquej t'i jepte ndihmë. Kishin lajmëruar edhe një mjek, por ai po vonohej. Fëmijtë ishin mbledhur rreth saj. Meri me sy të përlotur përpiquej t'i vinte në ndihmë. Dafina, e lemerisur, qante fare pranë.

Lotët e ngrohtë të saj i pikonin mbi faqe. Por, sikur mos të mjaftonin të gjitha këto, Bardha, si në agoni, dëgjoji zërin e ngjirur të Ademit. Ai tani kishte ardhur dhe, në vend që t'i dilte në ndihmë, iu hakërrye Bardhës:

“Për të gjitha këto, ti je shkaktare! Por ky është vetëm fillimi. I mjeri vëllai im se çfarë fëmijësh të prishur ka rritur. Ai qeni na bëri berbat shtëpinë, duke dashur të krijonte gjoja Ministri të Mbrojtjes. Kjo bushtra, kur e hetoi punën e tij, e lajmëroi te jarani i vet, e ai trimi iku, duke na i lënë këmbët e arushës në dorë. S’ju vjen turp!...”

Bardha deshi të fliste, të kundërshtonte. Ato që i tha Ademi, nuk ishin të vërteta. Kjo nuk kishte pasur ndonjë lidhje me të, se burri i saj, Feri, që vetë Ademi ia kishte „zgjedhur“, këtë “jaranin” ia kishte sjellë në shtëpi sa e sa herë, por Bardha asnjëherë nuk kishte mundur ta gjente veten në këtë shoqëri të re. Sa herë që kishte ardhur për vizitë, kishte folur fjalë që Bardhën e kishin bërë të skuqej, duke e detyruar t’i ultë sytë e saj kaleshë, kurse Ferin të qeshte e të zgërdhihej si idiot... Dhe, ashtu në atë agoni siç ishte, Bardhës filluan t’i përfytyroheshin ato ditë të trishtueshme...

...edhe Bardhës, kishin thënë vajzat e mëhallës, asaj qurraveceje, asaj vajze të përdalë që i kishte dalë nami për ikjen dhe martesën, për gjakun e derdhur për shkakun e saj, për kthimin e saj te familja e prindit... dhe hop, befas, si në përrallë, i kishte dalë fati që shumë shoqe të saj ia kishin pasur zili. E përdala, kishin thënë ato, s’la gjë pa bërë dhe prapë i buzëqeshi fati, dhe ç’fat se! Të martohej me Ferin! I ri, i shkolluar, me detyrë të zgjedhur, me banesë në qytet, me ve-

turë të re, me orendi të reja, televizor me ngjyra dhe të gjitha të mirat... dhe çudia kishte ndodhur, kur Bardha e kishte kundërshtuar këtë martesë, sepse këtë xhevahir ia kishte gjetur Ademi dhe nga smira Bardha nuk donte të martohej me të. Dhe pastaj ishte hapur gryka e thas-hethënavë: Jo atë akoma e mban shpresa e dashurisë së parë, për atë studentin e ri, që u gjend i plagosur për vdekje, pikërisht për shkakun e saj, sa e marrë që është, edhe pse ajo dashuri u la me gjak, ajo prapë nuk heq dorë, duke ëndërruar se ai do ta kthejë prapë, sa budallaqe! Jo, moj, nuk është fjala aty, fliste e dyta, ajo tani ka gjetur një tjetër jaran, shumarin... ha, ha, ha... Jo, moj, unë kam dëgjuar se ka filluar ta dredhë bishtin me mësuesin!... uf qyqe, ai është plak, moj!... Plak, plak, por ende beqar... por edhe ai është sikur ajo... ha-ha-ha... Më duket se po i shoh duke ecur krah njëri-tjetrit, si gjysh e mbesë, ha, ha, ha!...

Feri në fillim kishte qenë shumë i sjellshëm me të, i dashur, i sinqertë. Ishte kujdesur që mos ta lëndonte në asnjë mënyrë, duke ia kujtuar të kaluarën e saj të hidhur.

Shumë kolegë të tij kishin qenë të befasuar që Feri kishte pranuar një martesë të tillë. Përveç përgojimeve si vajzë e rritur në fshat, e përdalur, jo e ndershme, naive, e pashkolluar, e cila nuk kishte as edukatën familjare që t'u përgjigjej kërkesave të kohës moderne, shoqërisë së civilizuar të Ferit, njerëzve me autoritet që do t'i takonte t'u shërbente gjatë vizitave familjare, pastaj pjesëmarrja në netët e gjata të festave shtetërore, aty ku do të nevojitej që edhe ajo të dinte të vishej bukur, të prezantohej para eprorëve të burrit të saj, të



merrte pjesë në vallëzim, ta njihnte muzikën dhe llojin e valles që duhej luajtur, duke treguar kulturë, emancipim, edukatë... Të gjitha këto Bardhës i mungonin... Por arsyetimi intim, dhe në veten e tij, ku të tjerët nuk kishin nevojë të dinin për këtë intimitet, ishte pikërisht bukuria e saj që, siç dukej, as ajo vetë nuk ia dinte vlerën. Natyrisht se Feri i kishte nuhatur edhe rrethanat e tjera, përfshirë edhe përgojimet që i bëheshin Bardhës, e cila, nga ana e saj, duke qenë e pafuqishme t'u bënte ballë, përfshirë edhe trysninë e Ademit, kishte pranuar të martohej me të, i cili, nga ana tjetër, në rrethanat normale nuk do të kishte as më të voglin shans që kjo bukuroshe të bëhej nuse e tij. Ai, gjithashtu, e kishte pikasur se ajo ishte e rritur në një shoqëri që nuk i shkonin për shtat lajkat, mendjemadhësitë, por sinqeriteti dhe arsyeja e shëndoshë, gjë që nuk i shkonin fare natyrës së Ferit. Megjithatë, e kishte në zemër dhe në sytë e tij çdo ditë e më shumë ajo bëhej më simpatike. E zbritur nga një fshat malor, me vete Bardha kishte sjellë edhe një lloj egërsie tipike malësore dhe prandaj detyrë parësore e Ferit kishte qenë zbutja e saj. Kishte bërë përpjekje që zbutjen e saj ta bënte duke përdorur metodat që kishin përdorur mësuesit e tij, atje në kryeqytet për t'ia zbutur dhe zhdukur egërsinë malësore që kishte pasur edhe vetë para se të shkonte atje. Për egërsinë e saj i kishte folur edhe Ademi, i cili ngutësisht ia kishte lëshuar në dorë këtë xhevahir, këtë zanë mali, si të ishte ndonjë mall pazari, sikur të kishte frikë se nga çasti në çast do t'i humbte freskia.

Bardha ishte përpjekur të harronte të kaluarën. Donte që ta harronte edhe djaloshin që ia kishte rrëm-

byer zemrën dhe duke ndërhyrë të tjerët në mes të asaj zemre të rrëmbyer, e kishin plagosur edhe më keq. E ndiente se kjo plagë e hapur në zemrën e saj nuk do të shërohej aq lehtë dhe mendja i vajti të ajo ditë që për herë të parë e kishte takuar Agronin.

Ishte ditë pranvere. Të gjitha vajzat e mëhallës kishin veshur teshat e reja dhe ishin stolisur bukur, me flokë të krehura dhe të lidhura me fjongo të kuqe. Disa prej tyre mbanin flokët të lëshuara. Edhe Bardha ishte në mesin e tyre. Ishte e gëzuar. Ajo kishte veshur një fustan të gjatë, që shëmbëllente me lulet e pjeshkës. Flokët i kishte lëshuar ëmbëlsisht mbi supe. Shamia e saj bojë vjollce, e lidhur paksa me naze rreth qafës së bardhë, me cepat që lëshoheshin lehtas mbi gjoks, fërgëllente mallëngjyeshëm. Ashtu në grupe-grupe, të qeshura e të hareshme, ato zbritnin ngadalë tatëpjetë livadhit, duke shkelur lehtë mbi barin dhe lulet e njoma të pranverës. Tutje, në fund të livadhit, atje ku ndahet kufiri i fshatit me fshatin tjetër fqinj, ishte shtëpia e Ademkurtëve. Ata kishin dasmë. Ishte dita e divanit, dita e nuseve. Vajzat e reja të fshatit mblidheshin tufatufa, të veshura dhe të stolisura bukur, shkonin për t'i uruar nuses mirëseardhjen dhe për ta shijuar më përseafërmi bukurinë e saj, sjelljet, rrobat, duvakun, ojmet dhe çarçafët e qëndisura për ditën e nusërisë. I shikonin dhe nuk ngopeshin me bukurinë dhe shkëlqimin e tyre dhe natyrisht që çdonjëra e paramendonte veten nuse, me një pajë edhe më të bukur, edhe më të madhe dhe me duvakun e bardhë... Andej nga oda e burrave dëgjohej çiftelia dhe ritmet e këngës, që Bardhës akoma i buçiste në vesh:

*Çou Rexho, çou djalo,  
Çou ma i miri i nanës-o,  
Se s'ka nana tjetër-oo!...*

Në derë, me një aparat në dorë, u duk një djalë. Bardhës i mbetën sytë në fytyrën e tij. Ai ishte i shkujdesur dhe duke u larguar në distancë, kishte vënë fotoaparatin në sy dhe - çkrapp! Fotoaparati nxori një dritë të fortë, sa që Bardhës për një çast iu errësuan sytë. Ai ia bëri edhe disa fotografi nuses dhe pastaj u kthye nga vajzat, duke pyetur se cila kishte dëshirë të bënte ndonjë pozë me nusen. Ai për një moment u duk si i hutuar. Sytë i kishin mbetur të gozhduar në fytyrën e Bardhës. Ishte një shikim i zjarrtë. Asaj për një çast iu duk se shikimi i tij e përvëloi gjithë qenien e saj. Shikimet u kryqëzuan, por Bardha nuk mundi më t'i bënte ballë shikimit të tij dhe uli sytë përtokë. Pas pak ajo çoi sytë dhe e pa edhe një herë djalin në sy... dhe prapë e njëjta skenë. Disa prej shoqeve të saj u afruan pranë nuses dhe bënë fotografi. Bardha nuk pranoi. Erdhi koha që të ktheheshin në shtëpi. Pasi shikimet e tyre u kryqëzuan edhe një herë, ajo doli në oborr. Së bashku me shoqet u nisën përpjetë livadhit, duke shkelur mbi lulet e reja, të cilat në sytë e Bardhës çuditërisht nuk e kishin atë shkëlqimin, freskinë dhe bukurinë e mëparshme.

Çou Rexho, çou djalo!... i ushtoi në vesh refreni i këngës dhe pastaj refreni pasues, që mbaronte me shikimin e zjarrtë të djaloshit.

Pas disa ditësh ata ishin takuar për herë të parë, pranë shtëpisë së saj. Në një gavër muri, prapa poja-

tës së vjetër, Agroni i kishte thënë se këtu do t'i gjesh letrat e mia. Pastaj, ti do të më shkruash dhe do t'i lësh po këtu dhe unë do të vij e do t'i marr. Mirë? Po, mirë, ishte përgjigjur Bardha e skuqur nga turpi. Aty linin letrat dhe përmes tyre ata caktonin edhe kohën e takimeve. Shumë herë kishte shkuar dhe ishte kthyer e zhgënjyer. Nuk kishte gjetur asgjë. Sa gëzohej kur gjente letrën. Ajo me të shpejt shkante në dhomën e saj dhe fillonte nga leximi. Pastaj ia shkruante përgjigjjen dhe fshehurazi e vinte në zgavrën e murit, duke e mbyllë prapë me gurë. Sa ishte dëshpëruar kur Ademi një herë ia kishte kontrolluar librat dhe ia kishte gjetur të gjitha letrat, që ia kishte dërguar Agroni. Ia kishte marrë dhe kur kishte ardhur i ati nga Zvicra, ia kishte dhënë si provë.

\*

Ishte akoma errësirë, kur autobusi gërhiti me trishtim duke u kthyer drejt rrugës kryesore, duke marrë drejtimin e kryeqytetit. Udhëtarët, me sy të skuqur nga pagjumësia, kishin filluar të dremitinin. Disa bisedonin me zë të ulët. Një vajzë e vogël, sigurisht e ulur pranë nënës së saj, akoma qante. E ëma përpiquej ta qetësonte, por edhe sytë e saj ishin të mbushur. Herë pas here grua e re vinte dorën pranë xhamit dhe venëronte përjashta. Errësirë. Tek-tuk shihej ndonjë dritë e rrallë, që sakaq zhdukej në natë. Pas disa përpjekjeve, sigurisht se kishte parë siluetën e shtëpisë së saj, apo ndoshta vetëm siluetën e fshatit të saj. Ajo uli kokën dhe ia plasi vajit. Në këtë kor vaji u bashkua edhe një grua e re, e cila ishte e ulur fare pranë saj. Udhëtarët kthyen kokat nga të dy nuset e reja dhe duke mos pasur

askush ndonjë fjalë ngushëllimi, ulën kokat në shenjë dëshpërimi. Nga mesi i autobusit u panë edhe disa gra të moshave të ndryshme, që ia kishin krisur gjëmës. Sigurisht se ato nuk qanin se u vinte keq pse dy nusët e reja, por nga se kishin hallet dhe mërzitë e veta. Kishte mjaftuar që vetëm dikush ta gërvishte pak atë plagë të dhembjes së përbashkët dhe pastaj, si në kor, të qanin gjysma e udhëtarëve.

“Pushoni, more, se nuk kemi mort”, – u dëgjua një zë, atje tutje, nga mesi i autobusit.

“Lum si ti që nuk je duke e parë këtë mort!” – iu përgjigj Bardha me një zë të ulët, sa ai që foli nuk e dëgjoi fare: Ai pyeti prapë, por Bardha nuk foli më. Fjalët e Bardhës i përsëriti një burrë plak:

“Lum si ti që nuk je duke e parë këtë mort, të tha zonja!” – tha plaku, duke treguar me gisht drejt Bardhës.

“E shof, besa!...” – tha burri mendueshëm, duke ulur kokën.

Kishte filluar të agonte. Në mugëtirën e hirtë të mëngjesit vjeshtak, Bardha shikonte e dëshpëruar përtej xhamit. Bregore, pyje, fusha, livadhe, ara, tek-tuk shihej ndonjë qerre e tërhequr nga kuajt apo qetë, diku shihej ndonjë traktor... dhe në hyrje të një fshati pa disa fëmijë të tubuar, që shkonin diku... sigurisht në ndonjë shtëpi-shkollë të improvizuar, pasi shkollat i kishin ndaluar për fëmijët shqiptarë, kurse lokalet i kishin grabitur për nevojat e ushtrisë dhe të paramilitarëve serb. Tutje në horizont, andej nga lindja, qielli ishte përflakur. Po agonte një ditë e re. Po agonte një ditë e bukur, një ditë që Bardhën nuk do ta ngryste në vendlindjen e saj, një ditë që Bardhën do ta degdiste

diku larg ndër dhera të huaja... dhe ju kujtuan vargjet që ua recitonte fshehurazi mësuesi i gjuhës shqipe, para se të fillonte mësimin:

*...Lamtumirë vendet e mia  
Që po zhdukën dal nga dalë...*

“Lamtumir vendlindja ime! Lamtumirë shtëpia ime! Lamtumirë, o Drini i bardhë! Lamtumirë nëna ime plakë! Lamtumirë dashuria ime! Lamtumirë Agroni im i shtrenjtë!... me fal... me fal se nuk e mbajta dot besën... me fal se me detyruan te të tradhtoj, por... të dua... shumë të dua...deri në vdekje të dua!... ah, ajo ditë...“, psherëtiu thellë dhe valë të ngrohta lotësh iu lëshuan tatëpjetë faqeve.

\*

“...Pengesa kryesore është Ademi. Edhe shpresat e fundit që i pata të babi, u shuan. Kategorikisht janë kundër kësaj fejese“, - tha Bardha me një zë mallëngjyes dhe të dëshpëruar.

“Po të grabita që sot, moj Bardha, a do të vije ti?” – kishte pyetur Agroni, disi i ndrojtur.

Bardha kishte rrudhë krahët dhe fytyra i kishte ndritë nga një lumturi e çastit. Mendja i kishte shkuar te pengesa për shkollë që kishte pasur nga Ademi dhe Bardha, pa e pyetur fare, kishte shkuar në shkollë dhe kishte triumfuar. Edhe tani do ta provonte fatin.

Ishte pranverë. Koha kishte filluar të ngrohej. Njerëzit, ashtu si të përgjumur nga ai dimër i acartë që kishte marrë atë vit, kishin filluar të dilnin nga shtëpitë dhe t’i ktheheshin punës. Bilbilat ia thoshin

këngës diku të fshehur prapa rremave dhe ndër strehët e shtëpive, që kishin filluar të pikonin nga bora që po shkrihej nën rrezet e ngrohta të diellit. Diku thellë, në oborrin e fqinjëve, u dëgjua një kakarisje pule. Një gjel këndonte në atë melodinë e tij fare pranë tyre. Kurse tutje, nga fundi i livadhit, dëgjohej kënga e kushëririt të Bardhës, i cili, siç thoshin të tjerët, kishte rënë në dashuri me një vajzë të fshatit fqinj:

*O shkoj një mot, edhe gjysmë viti  
Se ç'u deshëm moj gocë e lalës  
kush s'e diti...*

Të strukur prapa pojatës së vjetër, aty pranë lajthishtës, Agroni dhe Bardha e dëgjonin këngën pa folur dhe duke e shikuar njëri-tjetrin në dritëzat e syrit.

“Këndon për ne, ” - tha Agroni, pasi ai e kishte përfunduar këngën.

“Po, ai këndon edhe për ne!” - ia ktheu Bardha.

“Si thua, ikim?”

“Po, ikim. Ku?”

“Në shtëpinë time, pra!”

“Donë me m'rrëmbye!?”

“Po!” – dhe e rrëmbeu nga dora. Bardha e ndoqi pas. Të kërrusur, ata kaluan gardhin dhe dolën në livadhin matanë. Fare pranë gardhit, si hije nate, u avitën pranë burimit dhe aty e thyen rrugën, duke u futur në zabel. Ecën sa ecën dhe pranë një kroi të vogël, u ndalën të pushonin. Pasi u freskuan dhe e shuan etjen me ujë të ftohtë borë të asaj gurre mali, ata vazhduan rrugën tatëpjetë shpatit. Nga kodra shiheshin shtëpitë e fshatit të Agronit. Pasi u ndalën në një vend të hapur,

Agroni i tregoi se ku ndodhej shtëpia e tij. Zbritën me të shpejt, si dy pëllumba dhe ranë në anën e pasme të shtëpisë, ku ndodhej një kapixhik i vjetër. Agroni e sh-tyu lehtë dhe sakaq ata u gjendën në oborr. Fëmijët që luanin në oborr, posa i panë, vrapuan duke thirrur:

“Oj loke, oj loke, erdhi nusja!”

“Ç’ nuse zeza, moj loke... e mjera lokja, e mjera!... Unë nuk kam prit nuse të grabitur, por kam pritur nuse me duvak e me dyqind krushq!... ” - dhe gjyshja plakë e Agronit e mbështolli Bardhën në përqafim.

„Nuk të paska gënjyer syri, Agron! Kjo po shndrit-ka si yll i sabahut, more bir. U trashëgofshi!“ – kishte thënë mixha Sylë, duke i marrë ngrykë.

Kjo lumturi nuk kishte zgjatur shumë. Të nesërmen herët kishte ardhur Ademi me disa shokë dhe me rrëmbim kishin hyrë në shtëpinë e Agronit. Ata, me një sjellje të vrazhdët kishin thyer dhe përmbysur çdo gjë dhe ashtu të hakërryer siç ishin, e kishin marrë Bardhën me vete, duke e goditur me grushte e shqelma, derisa dhunshëm e kishin futur në një veturë, që ishte e ndaluar në rrugë. Pastaj ishin zhdukur në drejtim të fshatit të tyre. Edhe në shtëpi e kishin keqtrajtuar. Si gjithmonë, kësaj vorbulle të këtyre ngjarjeve u printe Ademi, ungji i saj. Por të gjithave do t’u vinte kapak Bardha, sikur ata, me kaq sa kishte ndodhur ta linin të qetë Agronin. Pas disa ditësh, në një rrugë anësore, ishte gjetur Agroni i plagosur për vdekje.

\*

“Arritëm, këtu është stacioni i fundit” – u dëgjua shoferi t’u drejtohej udhëtarëve të lodhur e të dërrmuar nga rruga e gjatë. Bardha pa nga dritarja me shpresë



se do ta shihte Mentorin. Ishte një ditë e zymtë, me një shi të hollë.

“Bardha, Bardha...hej, këtej moj...” – u dëgjua një zë femre që vinte nga ana e djathtë.

“Ua!...Lulja!” – përplasi duart nga gëzimi dhe sakaq u shkëput nga Meri, duke ju hedhur në qafë. - „Uf Lule, Lule! Sa mirë që të takova! Sa me paska marrë malli, moj!”

“Unë u befasova kur të pashë! Mirë bërë që erdhe. Edhe mua me paska marrë malli me të pa...”

“Ku është Feri?” - pyeti Agimi prapa krahëve të tyre, duke hedhur hapat e mëdhenj që t’u afrohej.

“Feri? Si je Agim?” – tha Bardha dhe me një frymë vazhdoi: – „Nuk e dini ju se çfarë na ka ndodhur ne?” – pyeti Bardha paksa e hutuar, në vend të përgjegjës.

“Po, po, ne i kemi dëgjuar që të gjitha, prandaj të pyes se përse nuk ka dalë që t’ju presë këtu?” – pyeti për të dytën herë Agimi, paksa i hutuar.

“Ku, këtu? Unë s’po marr vesh asgjë...Ai është në burg!”

“Jo, moj Bardha, ai nuk është në burg, ai është këtu në Zvicër.” – Kësaj radhe foli Lulja.

“Si?!... Ai këtu?!... Po për Mentorin, dini gjë ju?” – Pyeti Bardha, kurse me vete mendoi: Qenka e vërtetë arratisja e tij nga burgu. „Ai nuk është fare në burg. Jam i sigurt që ai ndodhet jashtë, i rekrutuar për ndonjë detyrë speciale!” – I ushtuan në vesh fjalët e Mentorit.

“Babi, babi...gjyshi!” – klithi Dafina duke i hapur krahët në drejtim të tyre. Të gjithë kthyen kokën anej. Tani Dafina ndodhej në krahët e gjyshit.

## IV

Zilja e telefonit binte me ngulm. Si nëpër ëndërr, Besimit i bëhej se e dëgjonte. Sa përfundonte refreni, ashtu i përgjumur, thoshte me vete: Më duket se jam në ëndërr. Por refreni përsëritej. U ndie vetëm atëherë, kur Sandra, e cila ishte e shtrirë pranë tij, e tundi fuqishëm nga krahu. Pasi u përmend, u ul në shtrat, dhe e mori dëgjuesen, duke u përgjigjur me një “alo” të trashë, si të mos qe zëri i tij. Nga ana tjetër e receptorit dëgjoi një zë që në fillim nuk e njohu, por pastaj sikur ta kishte shpuar dikush me hosten, u ngrit në këmbë dhe, duke e tërhequr kabllon e telefonit, me aparatën në dorë, doli në dhomën matanë. Megjithatë, edhe që andej dëgjohehin fjalët, por pasi biseda zhvillohej në gjuhën shqipe, Sandra e siguruar se nuk ishte ndonjë telefonatë për të, u kthye në krahun tjetër, duke e mbuluar edhe kokën me batanije, që të mos dëgjonte bisedën.

“Po, e kam të qartë, si urdhëro... ma jep adresën... ëhë! Po, po e kam të qartë... ëhë, e di atë doganë!... në sa ora? U bë!... mirupafshim... Si!?... vetë po shkoj, pra!... Në rregull... e di edhe garazhin. Po, ashtu siç jemi marrë vesh... Mirupafshim!” – dhe lëshoi receptorin lehtë mbi aparat.

Duke u përvjedhur në majë të gishtërinjve, Besimi hyri prapë në dhomën e fjetjes dhe ashtu hajnisht, filloi të vishej. Sandra e dëgjoi dhe për një çast, e përgjumur, e rëmbeu nga dora dhe e tërhoqi nga vetja.

“Po shkon në punë, shpirt? Kush ishte në telefon?”

„Jo, jo, me doli një punë tjetër!”

„Në ora tre të mëngjesit!?” – tha ajo, pasi kishte parë orën, që gjendej mbi komodinën fare pranë shtrattit.

“Po, në ora tre. Kur të kthehem, bisedojmë. T’i them të gjitha. Mirë?”

“E di, e di. Kur të kthehesh ti, s’me tregon asgjë, si gjithmonë, enigmatik!” – tha Sandra me naze, pasi ishte ngritur në këmbë, duke e mbështjellë trupin e saj të brishtë me pelerinë.

“Të tregoj, pra! Kësaj radhe, po. Të betohem!”

“Të vij dhe unë me ty?”

“Nuk kam kohë të pres, derisa ti të përgatitësh. Mirupafshim, schatz.” – dhe pasi e puti në gushë, me xhaketën në dorë, doli me vrap. Sandra, me buzë të varura, mbylli derën me bravë. Njerëz të çuditshëm, mendoj, derisa hapat e tij dëgjoheshin akoma duke i kaluar shkallët dy e nga dy. Shumë të çuditshëm, mendoj për të dytën herë, dhe u shtri në shtrat.

Vetura e tij tani çante në drejtim të magjistrales. Duhej të shkonte te një pompë e karburanteve, fare pranë kufirit, në kohë të caktuar, që fugoni të mos priste, por as Besimi nuk guxonte të ndalej e të priste gjatë aty. Këtë urdhër e kishte marrë herën e fundit, kur ishte takuar me Belin, siç e quanin një burrë thatak, trupvogël, rreth të tridhjetave, të cilit nuk dihej emri,

adresa, nacionaliteti, vend punësimi, profesioni... Me një fjalë, një njeri enigmatik. I kishte thënë se, pasi të lajmërohej përmes telefonit, ai duhej t'i dilte para, për ta udhëzuar një furgon, deri në adresën e caktuar, pra, në garazhin e Zekiqit. Në atë takim ai i kishte dhënë edhe kodin e marrëveshjes.

Rreth njëqind metra afër kufirit, zvogëloi shpejtësinë, duke e kthyer veturën në të djathtë të rrugës, në sheshin e gjerë, ku ndodhej pompa e karburanteve.

Qetësinë e natës e çau zhurma e automobilit, i cili me shpejtësi marramendëse dhe pa e respektuar shenjën e policit të doganës që të ndalej, mori drejt daljes. Doganierët u përpoqën ta ndalonin, por vetura çau në drejtim të tyre dhe në momentin kur u duk se u shpëtoi doganierëve, sesi e humbi kontrollin dhe me një të frenuar të rrufeshme, derisa nga gomat i doli tymi, me pjesën e pasme u përplas për shtyllën e betonit, që ndodhej në territorin e Zvicrës dhe aty u ndal. Policët doganierë, me armë në duar, të gatshëm për zjarr, u turrën drejt veturës. Me duar të ngritura lartë, nga vetura dolën një vajzë dhe një djalë. Pasi i urdhëruan t'i mbështetnin duart mbi veturë, ata filluan t'i kontrollonin. Në ato çaste në doganë ia behu një furgon me ngjyrë të bardh, i tipit „Fiat Dukato“. Doganierët e zënë me veturën, i bënë një kontroll të shpejt furgonit, pastaj i dhanë shenj të vazhdonte rrugën. Besimi, pasi e kishte mbushur rezervuarin e veturës se tij me karburant, ose kishte bërë se gjoja e mbushte, u ul qetë-qetë në veturën e tij, ndezi motorin dhe shtypi gazin, duke dalë në rrugë. Përmes sinjaleve u morën vesh dhe tani çdo gjë shkonte sipas planit.

\*

Nga ana e pasme ishte dera e madhe e garazhit, që shërbente kryesisht për makinat e mëdha. Shoferi, me ndihmën e Zekiqit, e futi furgonin në brendi të garazhit.

Si zakonisht, Zekiqi së pari ndërroi rrobat. Veshi pantallonat dhe xhaketën që ishin të ngjitura njëra me tjetrën. Rrobat e mekanikut ishin të qëndisura me emblemen e garazhit “Fiat Garage”, të shkruara me germa të mëdha e me bojë të përhimët. Mbi xhepin xhaketës, mbi anën majtë, ishte i shkruar emri i tij, por nuk dallohej mirë, sepse ishte i përlyer me vajra e me katran. Pasi u mëshoi edhe një herë flokëve me dorën e majtë, u afrua ngadalë pranë furgonit. Dukej sikur e kishte ndërmend ta merrte me të mirë furgonin, ta ledhatonte, që të mos egërsohej, siç bën zakonisht nallbani kur i afrohet ndonjë kali hamshor. Duke e shtypur sustën, motori i vinçit nxori një zhurmë të zgjatur, e cila në qetësinë e natës dëgjohej i dyfishuar dhe ndillte njëfarë frike. Befas iu duk sikur dikush përgjonte nga jashtë dhe, sakaq, lëshoi sustën. Mbajti vesh. Asgjë! Budalla! Të ka hyrë frika në palcë, frikacak! E shau veten, duke e shtypur sustën prapë. Dalëngadalë furgoni ngjitej lartë. Zekiq mori frymë thellë. Për një çast iu duk se, me këtë lartë ngritje të furgonit, kishte kaluar edhe rreziku. Me të shpejtë mori çelësin e madh që rrotullohej me shtypjen e ajrit që vinte nga kompresori dhe filloi lirim e vidave.

Fresku i agimit kishte filluar të shpërndahej bashkë me mugëtirën. Në xhadenë kryesore, që kalonte fare pranë garazhit, kishte filluar të shtohet rrëmuja. Komunikacioni kishte filluar të dendësohej. Njerëzit

shpejtonin secili në punën e tij. Që nga larg u dëgjua sirena e një autoambulance. Pastaj u dëgjua zhurma e trenit, i cili kaloi mbi urën metalike, duke lënë prapa një kërcëllimë mbyhtëse. Pranë garazhit dikush ishte ndaluar që ta mbushte automobilin e tij me karburant. Sigurisht se diçka nuk shkonte mbarë, sepse ai shante në italisht. Zekiq u detyrua të dilte dhe të pyeste se çfarë i kishte ndodhur. Pasi Zekiq e evitoi problemin, ai u qetësua dhe vazhdoi punën e tij. Nga ndërtesat përreth filluan të vërshonin fëmijët, dikush me çantë, dikush me ndonjë libër të vetëm në dorë dhe ata më të vegjlit, me shirit të kuq të varur mbi kraharor, që tregonin se ata ishin fare të mitur, parashkollorë. Të gjithë drejtoheshin kah shkolla.

Brenda një ore çdo gjë ishte në vendin e vet. Kur erdhi shefi, e gjeti duke punuar në riparimin e furgonit, të cilin, siç i tha shefit, e kishin sjellë gjatë natës për riparim dhe ishte tepër urgjent. Zekiq i tregoi shefit se cilën pjesë duhej t'ia ndërronte furgonit dhe shefi, përmes telefonit, bëri porosinë.

Myshterinjtë filluan të dyndeshin në garazh. Dikush kishte ardhur ta merrte makinën e tij. Dikush kishte pasur ndonjë defekt të vogël në automobil dhe kishte ardhur ta riparonte para se të shkonte në punë. Erdhën edhe shoferët e makinave që kohë më parë Zekiq, krejt sipas planit, i kishte mbushur me “mall”. Ishin gjithsej tre veta. Kurrë nuk i kishte parë, sepse makinat i kishin sjellë aty për „riparim“ të tjerë njerëz. Zekiq këtë truk e dinte, kurse shefit as që i interesonte se kush vinte e kush shkonte. „E ka çelësin“, kishte pyetur një herë shefi. „Po“, ishte përgjigjur Zekiq. „Atëherë, bëje pagesën dhe - Hasta la vista!“

Përmes mimikës Zekiq e informoi shoferin se çdo gjë ishte në rregull, sipas planit. Furgoni ishte i parkuar jashtë, pranë derës së madhe. Pasi ai e bëri pagesën te arka, shoferi u largua. Zekiq e ndjeu veten të lodhur. Zakonisht në këso rastesh ndihej i lodhur, siç dukej, jo aq nga puna, por më tepër nga frika. Tani ishte koha që të tërhiqej nga vendi i punës dhe të fshihej në vendin e tij të preferuar, që askush nuk mund ta gjente, për të pritur reaksionin e parë, pas gjithë asaj pune të lodhshme e të frikshme.

Dita kishte filluar të thyhej. Edhe pak dhe do të përfundonte orari i punës. Zekiq iku ndër të parët. Shefi e kuptoi dhe i dha leje që të largohej. Zekiq e lajmëroi gruan se kishte mbledhje të Partisë Opozitare Serbe. Doli në rrugë. Disi e ndjeu veten më të sigurt në mes të gjithë atyre njerëzve. Koha kishte filluar të ftohej dhe pasi u mbështoll mirë me shallin bojëkafë, hyri në veturën e tij, që ndodhej e parkuar në skajin e rrugës. “Më ndihmo, o Zot!” - tha me vete dhe bëri kryq.

\*

Takimi ishte caktuar në ora shtatë, plus minus dhjetë minuta. Vendtakimi ishte në një shtëpi të vjetër dhe të vogël, në dalje të qytetit. Në pamjen e parë të bënte përshtypjen se në këtë shtëpi nuk banonte askush. Në oborrin e vogël para shtëpisë, që ishte i rrafshuar me zhavorr, luanin ca fëmijë. Shoqëruesi priu i pari drejt hyrjes. Ai nuk i ngjiti shkallët përpjetë, por në anën e majtë të derës zbriti një palë shkallë dhe u gjend para një dere tjetër. Nxori nga xhepi çelësin e vogël dhe e sollti lehtë në derë. Ajo u hap, duke bërë ngërrc të zgjatur. Zbritën edhe një palë shkallë. Aty nuk ishte ndonjë

shtëpi banimi. Ishte një bodrum i madh dhe gjysmë i boshatisur. Pasi shoqëruesi shtypi sustën, u ndez një dritë dhe në fundin e atij podrumi u duken mobilie të vjetra e të hedhura pa kujdes. Ishte qetësi. Nuk dëgjohej asgjë, përveç hapave të tyre. Shoqëruesi mori drejtimin nga mobiliet e hedhura pa kujdes dhe ua bëri me shenjë që të uleshin diku, ku të mundeshin dhe rrudhi krahët me një buzëqeshje të ngurtë, në shenjë shfajësimi.

“Duhet të prisni një grimë!” – tha shoqëruesi dhe u kthye nga kishin ardhur.

Këta kërkuan në atë rrëmujë dhe pasi gjetën disa kolltukë të vjetra, u ulën. Në atë qetësi u dëgjuan hapat e shoqëruesit të tyre, por befasia ishte se ai nga jashtë ua mbylli derën me bravë. Besimit i shkoi mendja të arrestimi i tij, sepse njeriu që i shoqëroi iu duk sikur të ishte po ai, dhe pastaj zëri i tij i qetë dhe në fund, brava. Sa e urrente bravën, dhe një palë mornica ia përshkuan trupin.

“Pse e mbylli derën?” – pyeti si me vete. Beli e shikoi me një palë sy të akullt dhe nuk foli. Bëri një lëvizje të trupit nga ana e majtë, duke bërë përpjekje që të ulej më mirë dhe nga xhepi nxori kutinë e duhanit dhe ia zgjati Besimit. Pasi ndezën nga një cigare, Beli, ashtu i shushatur siç ishte, u kthye edhe më shumë nga ana e Besimit dhe me një shikim pakëz më të zbutur dhe me një buzëqeshje të lehtë të varur në buzët e tij të ujta, ngriti njërën vetull pakëz lartë dhe tha:

“Nuk e mbylli derën për ne, por që t’mos hyjnë fëmijët këtu. E sheh, kjo shtëpi është “Foyer für asylbewerber”. Tani ka përfunduar orari zyrtar i punës dhe këtu nuk ndodhet askush që përkujdeset për të, përveç



atyre që banojnë këtu. Edhe ky djali këtu banon. Ky kujdeset për pastërtinë e këtij objekti. Ke armë me vete?“

“Po, pse ka ardhur puna deri te armët?”

“Jo, ashtu kot të pyeta.”

Bënte ftohtë. Ora ishte 17:03 minuta. Kishte akoma kohë. Ndërkohë, qetësinë mbytyse të atij bodrumi e prishi zhurma e hapave që, nga ana e derës, vinte si e mbytur. U dëgjua rrotullimi i bravës dhe fill pas saj, u dëgjuan hapat që po afroheshin. Përcjellësi u kthye prapa, duke e mbyllur derën, por kësaj radhe jo me bravë.

“Gutenabend” – përshëndeti njëri që qëndronte në ballë të asaj çete të vogël të përbërë nga pesë veta. Ishte një burrë i gjatë, me flokë të zeza dhe të gjata deri mbi supë. Kishte një mjekër të dendur, jo të gjatë. Mbante një palë syze të errëta dhe të mëdha. Nuk deshi të ulej. As shokët e tij, që rrinin prapa tij, nuk pranuan të uleshin.

“Sa kilogram i keni?”- foli ai me një gjermanishte të çalë me theks arab.

“Për sa jeni në gjendje ta bëni pagesën?” – pyeti Beli.

“Kjo është çështje private, por nuk ka rëndësi, në mundë t’i përgjigjemi një kërkesë deri në njëzet kilogram! E keni të pastër apo është e përzier?”

“Sipas nevojës suaj, kemi të pastër, por kemi edhe të përzier. Me vete kemi edhe paracetamol, përziers, të ardhur nga Holanda”

“Ne, me dëshirë e marrim të gatshëm, të përzier” – tha ai, duke e kthyer vështrimin nga shokët e tij. Ata pohuan me kokë.

“Ne kemi njëzet bukë!”

”Mirë.”

“Doni ta provoni? “ - pyeti Beli

“Sigurisht!” – u përgjigj prapë i pari.

“Për pagesën e mëparshme, si qëndron puna? E bëni sot, apo... ” – pyeti Beli.

“Edhe ajo është e rregulluar, e bëjmë sot.”

Beli i bëri me shenjë Besimit. Ai u ngrit dhe me hapa të qetë doli. Të dera e hyrjes takoi shoqëruesin. Ai ishte ulur në prag dhe kishte filluar të luante me fëmijë.

Mugëtira e mbrëmjes kishte filluar ta mbështillte këtë pjesë periferike të qytetit. Automobilat qarkullonin në rrugën matanë. Tutje, në anën e djathtë, shiheshin ndërtesat e mëdha të fabrikave dhe të magazinave gjigante të ndërmarrjes “Migros”, ku dritat nëpër rrugën kryesore i shndrisnin deri në disa kate, kurse pjesa e epërme e tyre dukej e mugët dhe pa shenja jete. Fare pranë oborrit të ndërtesës se vjetër, që Beli më parë e quajti „Foyer für asylbewerber“, ndodheshin disa kangjella të ndryshkura hekuri, kurse pas tyre një renditje harmonike e pemëve me trupa të vegjël, që tani në këtë stinë të vjeshtës dukeshin të zhveshura, jo vetëm nga gjethet, por edhe nga bukuria. Dukeshin sikur të ishin lakuriq dhe nuk dihej se çfarë pemësh ishin. Drita e dobët e oborrit i bëri fëmijët që të linin lojën dhe të mblidheshin ngadalë në dhomat e ngrohata, pranë prindërve të tyre. Kur u turrën fëmijët drejt derës, Besimi i vërejti se disa ishin fëmijë zezakësh, apo nga Sri Lanka, kurse dy të tjerë i dëgjoi të flisnin turqisht. Çudi, kanë ardhur nga anë e kënd i botës këtu dhe jetojnë në harmoni...

“Si të quajnë?” – pyeti Besimi.

“Hut Shkami,” – u përgjigj tjetri.

“Ke kohë që merresh me këtë punë?”

“Jo, unë vetëm ndërmjetësoj në këso rastesh. Të merrem seriozisht me këtë zeje, duhen investime të mëdha, që mua me mungojnë.”

“Nëse dëshiron vërtet të merresh me këtë punë, unë të ofroj drogë sa të duash, dhe atë veresie. Pagesën e bën kur ta kesh shitur drogën. Fitimin e ndalë për vete, ndërsa borxhin e kthen. Më beso, ky zanat ka fitime përrallore...”

“E besoj. Nuk është aspak punë e ndershme, por unë akoma nuk kam leje pune, familja nga Kosova po kërkojnë para. Ata mendojnë se, posa të arrish në Zvicër, paratë të presin të gatshme. Kështu kam menduar edhe unë, para se të vija këtu. Të gjithë presin nga unë!” – tha Huti, me një zë të ulët, sikur kërkonte mëshirë.

“I bie një herë me të shpejtë: bam, bam, bam dhe i shpëton ata edhe veten. Por duhet të llogarisësh edhe rrezikun... Takohemi një herë tjetër dhe bisedojmë më shtruar. Mirë?”

“Shumë mirë!”

“Eja, tani, ata kërkojnë mallin!”

“Shkojmë.”

Beli qëndronte i heshtur në kolltukun e tij. Dukej se kishte ndërruar vend. Ishte afruar edhe më afër murit, duke e mbështetur kolltukun e tij pas murit. Dorën e djathtë e mbante nën sqetull, kurse të majtën e kishte mbështetur për faqen e tij të lëmuar e pa qime. Edhe kur u afruan Besimi me Hutin, nuk bëri ndonjë lëvizje. Vetëm vështrimin e çoi pak më lartë, duke i ngritur

vetullat e tij të holla jashtë mase. Përcjellësi, me hapa të lehtë, u afrua pranë një grumbulli me dërrasa të mobileve të shkatërruara dhe filloi qetë, pa bërë zhurmë, t'i largonte ca sosh. Pastaj, nën atë grumbull dërrasash, doli një komodinë e vjetër. Shoqëruesi i dha shenjë që në këtë punë t'i ndihmonte edhe Besimi. Të dy së bashku ngritën pezull komodinën dhe e vendosën në mënyrë të drejtë, në mes të Belit dhe të tjerëve. Pasi bëri një shtrirje të kurrizit, duke nxjerrë nga goja një „oh“ të lehtë, nxori nga xhepi një çelës të vogël dhe hapi një derëz të komodinës. Në brendi u dukën pako të vogla, të mbështjella me kujdes me një najlon bojëhiri.

„Provoje!“ - tha Beli me një zë të ulët, sa që mezi u dëgjua. Ai prapë kishte atë qëndrimin e tij të ngurtë. Pa asnjë lëvizje, ai shikonte si i përhumbur në një amulli. Çdo lëvizje e bënte me kujdes. Të njëjtën gjë e bënte edhe Besimi, kurse shoqëruesi nuk ishte më pranë tyre. Se ku ishte zhdukur, pa u parë fare. Ishte qetësi e thellë. Askush nuk pipëtinte. Dëgjohej një „Fësh-fësh“ nga lëvizjet e burrit të gjatë e me syze të mëdha, gjatë kontrollit të cilësisë.

„Cilësore!“ – tha më në fund.

„Sa bukë janë gjithsej? – pyeti ai me mjekër.

„Të thash më parë, njëzet.“

„Cili është çmimi i fundit? Do të ketë ndonjë lehtësim, nëse ne i marrim njëherësh të gjitha?“

Beli luhati kokën në shenjë mohimi.

„Mirë, pra! Paratë!“ – dha urdhër mjekra. Beli u afrua pranë çantës dhe nga mesi i njërit nga dengjet nxori një bankënotë. Ktheu kurrizin nga të pranishmit dhe e shikoi në dritë bankënotën. Pastaj, nga xhepi nx-

ori një letër të bardhë dhe pasi e vendosi bankënotën mbi të, filloi ta fërkonte. Në letrën e bardhë la shenjë ngjyra e bankënotës.

“Në rregull. Janë origjinale!”

Pasi u bë pagesa, ata morën pakon me drogë dhe dolën. Shoqëruesi ua hapi derën.

Beli hapi çantën dhe nxori disa tuba parash dhe pas një llogarie të shkurtër, ia zgjati Besimit disa sosh.

“Këto janë për ty, kurse të tjerat janë për njerëzit tuaj. Tani është koha të ikim! Unë po dal, kurse ti eja pas pesë minutash. Mirupafshim!” – tha Bel, duke ia zgjatur dorën.

“Mirupafshim! Ku do të takohemi për ta pirë nga një? – i tha Besimi me buzë në gaz.

“Do të gjejmë kohë edhe për këtë!” – tha Bel me një zë të ulët dhe doli.

Sa njeri i çuditshëm. Di të ruhet shumë më mirë se sa unë që jam i specializuar për këto punë. Ka lindur talent, është për t’ia pasur lakmi, mendoi dhe me hapa të shpejtë u drejtua nga vetura e tij. Kishte një ndjenjë gëzimi për fitimet marramendëse që ia sillte biznesi i tij. Kurse, në anën tjetër, ndiente një zymtësi për shkak se dy ditë më parë ishte grindur me Sandrën. Do t’i kalojë inati, kishte menduar. Zënka kishte ndodhur për shkak se ai kishte qëndruar gati tërë natën në një lokal, ku grumbulloheshin shumë shqiptarë. Ajo disa herë e kishte kundërshtuar për shkak të vizitave të tij të shpeshta në këtë lokal, i cili, sipas saj, ishte lokal jo për t’i kaluar orët e mallëngjimit me bashkëvendësit, por për të matur forcën fizike dhe trimërinë. Para ca kohësh aty kishte pasur grindje, rrahje dhe shkrehje

armësh. Me këto mendime ai hyri në dhomën e madhe të pritjes. Mbi tavolinën e ulët ishin gazetatat ditore, që i parapaguante Sandra, si dhe shumë pliko. Filloi t'i hapte ngadalë. Fletëpagesa e rrymës, mendoi, qiraja, po kjo? Dhe vazhdoi leximin:

“Ftesë: Për shpirtin e prindërve të ndjerë, ndjesë paçin, ju ftojme të merrni pjesë në festën e Mevludit, që mbahet në sallën Gemeinde Kirche Weisstrasse 21 Schlieren, me datë 12. 6. 1996 në ora 18:00. Pjesëmarrja e juaj do të na nderojë. Me respekt, vëllazëritë Dini dhe Vali.”

Në korridor u dëgjuan hapat e gëzueshëm të Sandrës, derisa ai mendonte se plani do të realizohej ashtu siç e kishin paraparë. Ajo erdhi si gjithmonë e qetë. Kuptohej se akoma nuk i kishte kaluar zemërimi. Nuk përshëndeti fare. Ajo, pasi hoqi këpucët, hyri në dhomën e gjumit. Besimi nga këndi e shikonte me një epsh të tepruar. Ajo kishte filluar nga zhveshja. E ndjente se nuk do të përmbahej, prandaj u afrua fare pranë, kur Sandra ishte gati lakuriq. Shikimi i tij mbi trupin e saj të bukur, nuk kishte asnjë lidhje me grindjen. Këtë e ndiente edhe Sandra. Edhe ajo ishte e këtij mendimi, por në veten e saj, pa e shfaqur. E ndjente dhe e dëshironte atë shikim të zjarrtë të tij, prandaj edhe lëvizjet i kishte nazeqare. Nuk do të kundërshkonte, po t'i afrohej Besimi. Ajo këtë e priste, bile me padurim. Disi, në mënyrë provokative, gjoja se po i hiqte rrobat, me duart e saj të vogla ledhatonte lehtë pjesët delikate të trupit, si pa e vënë re fare shikimin e Besimit. Dhe përpiquej ta përmbante veten nga nervoza për vonesën e tij. E ndjeu se ai do të afrohej. Dhe ashtu ndodhi. Ai tani ishte pranë saj. Ajo ndjeu dorën

e tij, kur e lëshoi lehtë mbi supin e saj gjysmëlakuriq. Ai mbajti qëndrim, duke pritur reagimin. Kundërsh-tim nuk kishte, por as qasje të mëtejme nga ana e saj. Atëherë, qetësisht e tërhoqi kah vetja dhe e mbështolli në përqaqim. Me një buzëqeshje të papërmbajtur, ajo iu hodh në gjoks, duke i afruar buzët e saj të kuqe pranë buzëve të tij.

“Sot mora një thirrje për mbledhje,” – tha Besimi.

“Ku e gjen edhe ti të ikësh, sa herë që unë jam e gatshme për...”

“Jo sot, schatz, të dielën!”

“Aha...” - ia bëri ajo, me një zë të zgjatur dhe qetësisht e tërhoqi drejt shtratit. – „Dhe unë do të mbetëm fare e vetme në këtë shtëpi të trishtë.“

“Ti me ke thënë se do t’i vizitosh prindërit?”

“Ë, ë... do të rri këtu... ah... ahh!...”

\*

„...Një kohë të gjatë kam punuar inspektor i policisë dhe kam pasur një jetë të bujshme, aventuriere! Pas orarit të punës i gjeja baret me luksoze dhe, pasi të gjitha ishin të paguara nga ata që i kisha „zënë” në kundërvajtje gjatë ditës, si pije, meze, raki dhe, ç’ ishte më e mira, edhe bukuroshe të reja, që kishin ardhur nga Serbia, ha, ha, ha!... Pastaj, kur iu ndihmova demonstruesve, duke e vrarë një polic serb, ata me burgosën... dhe deshi zoti ika!“ – fliste Besimi, i ngazëllyer nga koha e shkuar, duke tundur duart dhe me ton të lartë përpiqej t’ua mbushte mendjen tre-katër burrave që i kishte për ballë, se kishin të bënë jo me një njeri do-sido, por me një të tillë që ka pasur një karrierë të bu-

jshme, me pozitë të lartë në shoqëri, me përvojë të shkëlqyer në atë mjedis ku kishte jetuar dhe për çështje të lartë patriotike dhe kombëtare kishte qenë i shtrënguar të arratisesh. Si të gjithë patriotët e tjerë, që ndodheshin të strehuar këtu, kishte vendosur t'i dilte zot atdheut që ishte në rrezik, vazhdonte të fliste Besimi. Askush nuk reagoi për ato që ai i tha. Ra një heshtje mbytëse.

„Po ju, ku keni punuar para se të vini këtu?” – pyeti njëri shokun që e kishte për bri, sa për ta thyer atë heshtje gjumashe.

“Kush, unë?” – pyeti burri, disi i çuditur nga kjo pyetje e papritur.

“Po, po, ti.” – ia ktheu tjetri prerë.

“Unë gjithë jetën jam grindur me këtë”, – dhe bëri me gisht nga ai që pak më parë e kishte quajtur veten inspektor të policisë. Besimi u skuq lehtë. Tërë fajin ia hodhi Dinit, i cili i kishte thënë se të gjithë të ftuarit “ishin tanët”. U zgjat edhe më fort kah ai, të shikonte se cili ishte ai që u përgjigj. Tjetri kishte kyçur gojën dhe nuk fliste më. Ishte një burrë shtatlartë, me një palë sy të trishtueshëm, të fshehur thellë prapa xhamave të syzave. Ai shikonte në drejtim të tij, me një shikim ironik dhe në buzë i varej një buzëqeshje cinike. Besimi, për të mos i ulur sytë para tij i turpëruar, vuri buzën në gaz, duke zbuluar dhëmbët e tij të verdhë. Do te të kushtojë shtrenjtë kjo përgjigje ironike që me bëre të skuqem para këtyre burrave, mendoi duke e larguar shikimin nga ai dhe u ngrit. Në korridorin e ngushtë u takua me Dinin. Pas një bisede të shkurtër që pati me të, Besimi, me një buzëqeshje cinike dhe me një shikim ironik dhe triumfues bashkë, u kthye dhe u ul në vendin e vet.



Salla kishte filluar të mbushej me burra të mos-have të ndryshme. Në ballë ishte vendosur një tavolinë e madhe, e mbuluar me një beze të bardhë dhe në mesin e saj, ishte vendosur një vazo e madhe e mbushur me lule lloj-lloj ngjyrash. Edhe tavolinat e tjera ishin të stolisura me lule, por jo edhe të mbuluara me beze. Tavolina në ballë ishte e rezervuar. Hetohej lehtë se ata që ishin të ftuar të uleshin në atë vend të stolisur bukur, ende nuk kishin arritur. Në mesin e sallës, poshtë në dysheme, ishte vendosur një televizor i vogël, kurse në fundin e sallës ishte vënë një kamerë e madhe me këmbë të gjata. Kameramani i bënte provat e fundit. Ndihmësi i tij mbante në dorë një kamerë pak më të vogël dhe herë pas here e lëshonte në veprim, që ta provonte nëse ishte në vijë harmonike me dy televizorët dhe kamerën e madhe. Ai provonte edhe mikrofonin, duke numëruar:

“Einz, zwei... einz, zwei...” - dhe zëri i tij i trashë mbushte sallën, pasi kalonte për bukuri përmes zmadhuesve, duke i mbytur zërat e të pranishmëve që bisedonin në mes vete me zë të ulët.

“Erdhën!... ngrehuni në këmbë ju lutëm! Erdhën!” - thirri Dini.

“Selam alejhi” – thirri kryehoxha, posa u duk në derë, i veshur me një xhybe të zezë që i arrinte deri në fund të këmbëve. Në kokë mbante çallmë. Kishte një palë sy të lëvizshëm dhe zhbirues, si dhe një mjekër të zezë e të gjatë. Pas tij hynë në sallë edhe katër të tjerë, të veshur pothuaj njëjtë, por në vend të çallmës ata mbanin në kokë plisa të bardhë, që dukeshin si ojme të qëndisura.

“Alejhi selam” – u përgjigjën të pranishmit duke e u ngritur në këmbë. Zhurma e karrigeve e mbyti atë zë të përbashkët, sa që mezi u mor vesh se vërtet xhemati ia kishte kthyer selamin imamit.

Pasi zunë vendet sipas rangut, hoxhallarët i dhanë shenjë xhematit që të qetësoheshin dhe të mbanin vesh se kishte ardhur koha që tubimi të fillonte. Kryehoxha, pasi u kollit sikur donte ta pastronte zërin, ngriti vetullat lartë dhe, duke e përqendruar vështrimin në një pikë të pacaktuar, i dha zërit që buçiti i dyfishuar nga zmadhuesit, sa që e bëri kameramanin të vraponte pranë aparaturës dhe ta ulte zërin.

“Bismil-lahi Rrahmani Rrahim! Në emër të Allahut xhenëshanehu, po fillojmë lutjen hyjnore për shpirtin e prindërve të Nuredinit, rahmetli-muvludin, që atyre Allahu iu ndihmoftë dhe ua shëndritë rrugën e shtruar me lule drejt xhenetit!... Amin!”

“Aaaamiiiiinnn” – buçiti edhe zëri i xhematit në sallë.

Pastaj njëri nga hoxhallarët, me një zë të hollë, filloi të këndonte në një melodi arabe, por me fjalët në gjuhën shqipe:

*“Bismil-lahi themi ne kur të fillojmë  
Emrin e All-llahut ne ta përkujtojmë...”*

Në sallë kishte rënë heshtje. Vetëm zëri i imamëve dëgjohej. Ata filluan të këndonin në kor, kësaj radhe në gjuhën arabe:

*”Essalatu vesselamu alejke ja Resul All-llah...”*

Njëri nga me të rinjtë, që deri më tani kishte qëndruar në një skaj i pavërejtur, befas tërhoqi shikimet e të pranishmëve, kur me zërin e tij melankolik filloi të këndonte, sa që edhe dejtë e fytit iu fryn, duke marrë ngjyrë të kaltër, ndërsa nga zori iu skuq fytyra. Që në fillim la përshtypjen se nga zori do të ndërpriste këngën, por ai vazhdoi, tani me zë më të pastër dhe më kumbues:

*“Prej mevludi, i vdekuri ka dobi  
Profeti do ta përkrahë me kënaqësi...”*

Një redaktor gazete, i cili ndodhej i ulur fare pranë hoxhës, kishte vënë duart në faqe dhe vështrimin e kishte mbërthyer në një pikë të pacaktuar, mbi parketin e lëmuar të dyshemesë. Fare pranë tij ishte i ulur botuesi, kurse pak më tutje ishte edhe realizuesi kompjuterik, një djalë i ri me balluket e lëshuara mbi vetullat kaleshe.

Njëri nga ndihmësit e hoxhës, që ishte i ulur fare pranë tij, kishte kthyer kokën nga ai dhe me dorën pranë gojës, i pëshpëriste diçka në vesh. Hoxha lëvizte kokën në shenjë pohimi dhe pastaj sytë e tij të rumbullakët i drejtoj nga Dini, duke ia bërë me dorë. Dini e përshëndeti me kokë dhe me dorën e majtë në faqe, u kthye nga Besimi. Me një lëvizje të lehtë koke i dha shenjë që ta ndiqte pas.

Edhe në korridorin e ngushtë, derisa ata i zbrisnin shkallët e vjetra dhe të drunjta, i ndiqte pas zëri paksa i molisur i hoxhës. Dinit i dukej zëri lutës i hoxhës sikur i thoshte të kthehej prapa, se atë që e kishte ndërmend

ta bënte nuk ishte e shkruar as në Kur'an. Por tani hoxha këndonte në arabisht dhe nuk dihej se ç'thoshte, e luste të kthehej, apo e uronte të vazhdonte rrugën e nisur.

Në oborr ishte errësirë. Që larg nga rruga vinin rrezet e dobëta të dritave të neonit, që ndriçonin atje tej trotuarin e gjerë. Një freski e hollë i bëri gjethet e plepit të shushurinin. Ata, pa folur fare, u drejtuan kah makinat e tyre. Hynë në makinën e Besimit. Ai nxori nga xhepi telefonin mobil. Pasi formuloi një numër, e afroi dëgjuesin pranë veshit. Në anën tjetër u përgjigj një zë i thellë mashkulli, në gjuhën gjermane:

“Pantiq, klinika private dentare, urdhëroni ju lutëm!”

“Me falni për shqetësimin, unë quhem Besim, kam një shok dhe dua ta sjell urgjent në klinikë. Ka dhembje të forta të dhëmballës.”

“Silleni menjëherë. Si quhet ai?”

“Nuredin Keliqi.”

“Nu-re-din... Ke-li-qi... çdo gjë është në rregull, Mirëupafshim!” – u dëgjua ai duke e ndarë emrin në rrokje për ta shkruar në regjistrin e pacientëve.

“Ju faleminderit shumë dhe mirupafshim. Bukur!” - tha Besimi, pasi e kishte mbyllur telefonin celular. - „Merre veturën tënde dhe më ndiq pas.”

Pas pak veturat e tyre ishin në një rrugë të ngushtë që të shpinte në një lokal nate, në periferi të qytetit, pranë një zabeli. Posa kthyen në drejtim të autoparkut, Besimi i fiku dritat. Ashtu bëri edhe Dini. Në gjysmerrësirë ata i parkuan veturat e tyre, por nuk dolën jashtë. Pas pak çastesh ia behu edhe një veturë. Pasi u parkua, u dallua silueta e një burri, i cili shikoi majtas

dhe djathtas, se mos e përgjonte kush. Mbi rrotën e veturës se tij, ashtu i kërrusur, kërkoi apo la diçka, dhe me hapa të shpejtë iku drejt hyrjes.

Nga çasti në çast duhej të vinte sinjali për fillimin e aksionit. Pasi e kontrolloi edhe një herë revolen e tipit “Colt”, Besimi fshehu dorën nën sqetullën e majtë dhe u mbush frymë. Mendja i shkoi te një aksion që disa muaj më parë e kishte organizuar dhe kishin pasur sukses. Por, më pas, disa nga shokët që kishin marrë pjesë në aksion, ishin arrestuar. Edhe kësaj radhe Besimi, për veten e tij, kishte siguruar mos zbulimin, kishte punuar në mënyrë profesionale, duke humbur çdo gjurmë. Kam profesion të mirë, mendoi.

Nga telefoni celular erdhi alarmi. Pas katër cingërimave, ai u mbyll. Besimi doli i pari. Pasi bëri disa hapa në drejtim të hyrjes, ai u ul pas veturës që pak më parë ishte parkuar aty. Dini tani ndodhej fare pranë tij. Besimi mori çelësin mbi rrotën e veturës dhe ia zgjati Dinit. Ai me të shpejtë hapi automobilin dhe nga ulëset e pasme rrëmbeu një çantë. Pasi e hetoj se ç’kishte brenda, ia bëri me kokë se çdo gjë ishte në rregull. Besimi, me një shikim të shpejt hulumtues majtas e djathtas, i dha shenjë të ikte, duke ia marrë çelësin nga dora. Dini iku në drejtim të veturës se tij. Ndezi makinën dhe fare qetë u largua. Besimi, pasi shikoi edhe një herë rretheqark, u nis në drejtim të veturës dhe e ndoqi pas Dinin.

Kur u kthyen në sallë, hoxha akoma ishte duke kënduar pjesë nga suret e Kur’anit. Qetë dhe pa bërë zhurmë që të dy u ulën në vendet e tyre të mëparshme. Dini, me dorën e majtë mbante faqen. Fytyra e tij shprehte dhembje dhe pikëllim bashkë. Askush nuk e

dinte nëse kjo pamje e fytyrës i vinte nga dhembjet e dhëmballës, nga fjalët mallëngjyese të hoxhës që i thoshte për shpirtin e prindërve të tij të vdekur, apo për viktimat e tij të posa vjedhura. Punë e madhe, mendoi me vete. Drogë kam vjedhur!

Në fund e mori fjalën kryehoxha. Pasi i shikoi të pranishmit me radhë, sikur nga fytyrat e tyre donte të lexonte tekstin që e kishte formuluar me kohë në mendjen e tij, u kollit lehtë dhe pastaj, me një zë artificial dhe aktoresk, tha:

“Ndodhemi këtu në mes të botës krishtere. Jo vetëm në mes të fabrikave të tyre, jo vetëm në mes të shkollave të tyre, jo vetëm në mes të spitaleve të tyre, por edhe në mes të kishave të tyre. Para se të vija këtu, në këtë sallë, mbi portën e lartë të kësaj ndërtese ishte e shkruar me germa të mëdha “Gemeinde kirche”, që do të thotë në shqip: “Kisha e komunës.” Pra, islami po e mbërthen nga gryka krishterimin, i cili nga paqartësia e tij, nga edukata shkatërruese e tij, nga mësimet degjeneruese të tij ndaj njerëzve e sidomos ndaj femrave, shumë njerëz, popuj dhe shtete kanë filluar ta braktisin dhe ta përqafojnë fenë, gjuhën dhe fjalën e Allahut xheneshanehu. Këtë pranim të hapur, këtë adhurim të paparë ndonjëherë në jetën e Islamit, këtë dashuri të madhe për Kur’anin, për Muhamedin alejhi salam, më se miri e ilustron autori anglez Michael H. Hart në veprën e tij: “Njëqind njerëz që e ndryshuan historinë e botës”, ku Muhamedin e vë në vendin e parë. Kjo ka bërë që adhuruesit e krishterimit të gjenden ngushtë, të gjendën në një mëdyshje, në një udhëkryq dhe i ka shtyrë t’u bien kambanave të alarmit, duke derdhur gjithë shafranin e tmerrshëm propagandues, të

helmueshëm dhe të hidhur si zeheri për ta shkatërruar Islamin. Kur një i krishterë ka një dashuri kaq të lartë ndaj profetit tonë, atëherë, a do të arrijnë të tjerët të depërtojnë deri te shkatërrimi i Islamit? Estaifurullah tybe istiukfa! Unë them: Jo! Fuqia e tyre është e vogël para fuqisë së Allahut fuqiptotë, mëshiruesit dhe mëshirëbërësit! Lum si ai që e dëgjon fjalën e Allahut! Lum si ai që merr dhe e shpërndan fjalën e shenjtë të Muhamedit alejhi selam! Lumë si ai që me itikat e besim të fortë i përgjigjët thirrjes së shenjtë të Allahut dhe ata do ta kenë të hapur derën e xhenetit dhe do të rrojnë në lumni në botën e amshueshme! Amin!“

“Amin!” – u përgjigjën edhe disa nga të pranishmit.

\*

“Vrasje në mes shqiptarëve të Kosovës”, – tha Sandra duke e hedhur gazetën përpara Besimit. Ai, me sy të përgjumur, e mori gazetën në dorë. Në faqen e parë ishte shkruar me germa të mëdha:

„Prapë shqiptarët e Kosovës”

Qërim hesapësh në mes të bandave mafioze rivale. Epilogu: një i vdekur në vend dhe dy të plagosur lehtë. Në mesin e të plagosurve edhe një mysafir rasti. Policia e heton rastin...“

“Ndodhin në çdo shtet të botës gjëra të tilla“, – tha Besimi, - „dhe kjo nuk do të thotë se të gjithë popujt janë të njëjtë, kriminelë.”

“Këtë nuk e thotë askush”, – tha Sandra duke marrë gazetën, meqë Besimi nuk kishte shfaqur ndonjë interes të veçantë për atë që shkruante atje. Këtë mosinteresim e bëri vetëm në sytë e saj, kurse në veten e

tij mendoi ndryshe. Nuk i erdh aspak mirë që kishte ndodhur ajo vrasje, pikërisht atje dhe ndoshta për fajin e tij. Sidoqoftë, për veten e tij kishte një grremç të sigurt nga të mbahej. Frika vinte se kjo ngjarje mund të ishte fillimi i dyshimit. Ndërsa fillimi i dyshimit sillte drejt tij shikimet zhbiruese të spiunëve, të detektivëve, të përgjuesve të specializuar në këto delikte dhe lëvizjet e tij do të bllokoheshin. E dinte mirë se ç' do të thoshte, kur sytë e aparatit shtetëror kthehen në drejtim të dikujt për hetim...do të thotë zbu...(o Zot! dhe ai iu shmang fjalës fatale zbulim)... dhe me një shikim të trishtueshëm dhe të frikshëm e për lau Sandrën, e cila, me kokën ulur mbi gazetë, lexonte në heshtje atë që Besimi i saj e kishte filluar mbrëmë dhe të tjerët e kishin përfunduar ndër kohë. Ndoshta është e shkruar në gazetë... dhe një dridhje tmerruese ia përshkoj krejt trupin. Nuk i pritej derisa ajo ta ketë përfunduar së lexuari dhe komentuari atë artikull njoftimi, i cili për Besimin, në këto momente krize, dukej tmerrësisht i gjatë.

“Çdo gjë për momentin mbetet e errët“, – tha Sandra qetë-qetë, duke lënë gazetën mbi tavolinë. – „Ç’ke? Nuk ndjehesh mirë?“

“Mirë jam, por... sesi me erdhi!...” – tha ai dhe, i lehtësuar nga fjalët e saj, doli në ballkon.

Pas pak u vesh dhe doli.

Në klub e priti xha Hima. Ishte i shqetësuar. Kishte një pamje jo të zakonshme, me një fytyrë të vrrarë. I kishte ikur ajo buzëqeshja e përhershme. Pasi e përshëndeti, u ul në një karrige pranë tij. Në sallën e madhe kishte pak njerëz. Ata bisedonin me zë të lartë. Tema e bisedës ishte e njëjtë për të gjithë: Krimi



i mbrëmshëm që kishte tronditur nga themeltë edhe një herë mërgatën shqiptare.

“More vesh gjë ti?” - pyeti Hima, duke u lëkundur lehtë mbi karrige.

“E pashë në gazetë.”

“Vrasje misterioze!”

“Si ndodhi?” – pyeti me ndrojtje Besimi.

“Asgjë nuk është e qartë tani për tani. Koha do t’i sqarojë të gjitha. Por... kam dhembje, mor bir... dhembje dhe turp bashkë!” – tha xha Hima me zë të ultë, sikur dëshironte të mos e dëgjonte askush atë që tha.

“Dhembje dhe turp bashkë!” - përsëriti Besimi, duke ulur kokën në shenjë dëshpërimi.

Më kot e kërkoi Dinin. Në klub priti gati një orë, por ai nuk erdhi. Nuk ishte as në shtëpi, as në klubin e Valit. As në sallën e bilardos nuk e gjeti. I thanë se kishte pasur një takim urgjent me pronarin e një agjencie turistike. Fjala ishte për një dërgesë simbolike nga vëllezërit e tij që jetonin në Kosovë, por ngarkesa kishte përfunduar në qytetin Sant Morritz.

U kthye në banesë. Sandra nuk ishte në shtëpi. U ul në kanape dhe hapi televizorin, me shpresë se do të mësonte diç më tepër për vrasjet e një nate më parë. E ndiente se edhe vetë ishte një personazh i skajshëm në këtë ngjarje, që befasi i kishte sjellë një çrregullim të papritur, një frikë që prej ditës që kishte ardhur në këtë shtet nuk e kishte përjetuar asnjëherë më parë. Ishte i lodhur.

Lehtë u shtri mbi kurriz dhe me shikim drejt tavanit të bardhë të dhomës së miqve, u përpoq ta zbraste trurin nga çdo mendim, por ishte e kotë. Një frikë tinëzare iu kishte mbështjellë rreth gjithë qenies së tij

dhe nuk e linte të qetë. Ishte frika se mund të zbulohet dhe... këtu shkëputej nga gjithë ai mondanitet dhe pasuri përrallore, që sapo kishte filluar ta shijonte. Pastaj, do të pasonte edhe humbja e dytë, që gjithashtu ishte e rëndë. Zbulimi, burgosja, apo... vrasja e tij nga... (o Zot, sa tmerr, dhe përnjëherësh e largoi nga koka emrin e atij që në këto rrethana duhej ta vriste). Në fund, çka do të thoshte xha Hima, kur do ta merrte vesh se intelektual, trimi, politikani, patrioti që me fjalimet e tij të zjarrta i bënte të derdhnin lot përmallimi mërgimtarët, u burgos, apo u vra në fushën e kriminalitetit?!... Tmerr!... Jo, jo, nuk është tmerr. Unë jam i paemër, i patrajtë, i pa mbiemër, i pa datëlindje, i pa moshë, i paatdhe... unë jam hiç, asgjë, askush, i humbur. Po, po i humbur!...

Zilja e derës e largoi nga ato vegime të tmerrshme, por edhe e ktheu në realitet, duke e tmerruar edhe më tepër. Nuk ishte shtypja e sustës së ziles në stilin e Sandrës. Mos janë “ata”, mendoj, dhe zemra filloi t’i rrihte me shpejtësi. Cingërrima u përsërit. Me hap të frikshëm u afrua pranë derës dhe duke venë syrin në vrimën e saj, pa jashtë. Ishte Dini. E hapi derën me të shpejtë. Disi u hutua, kur e pa atë në derë. Ishte e mundur që të mos jetë arrestuar akoma, pyeti veten me ankth, kurse atij i uroi mirëseardhje.

“Dërgesa ndodhet në Sant Morritz“, – tha Dini, duke mos e fshehur frikën.

“E mora vesh! Kam menduar gjatë për këtë çështje“, – tha Besimi mendueshëm.

“Nuk kam njeri të përshtatshëm që ta dërgoj atje...”

“Unë mendoj ta dërgojmë atë burrin me syze, si

thua ti?” – tha Besimi, duke shikuar ngultas në sy Dinin, i cili i dukej fare i hutuar.

“Ai nuk pranon!” – ia ktheu Dini i ndrojtur.

“Nuk them që ai të merret pikërisht me transportimin e drogës, bile as që duhet ta kuptojë qëllimin e vërtetë! Në këtë rast, ne duhet ta përdorim atë për t’i ç’orientuar përgjuesit, nëse ata ekzistojnë. Më kupton çka dua të them? Kurse, me transportimin e drogës të merret një ekip tjetër!”

“Ku ta gjejmë atë ekip?!”

“I kemi njerëzit tanë të rryer në këto punë! Ku ndodhet ai tani?”

“Kush?”

“Ai burri me syze, pra!”

“Ai punon...”

“Lajmëroje përmes telefonit celular në vendin e punës dhe thuaji që të shkojë pikërisht në Sant Morritz për të transportuar ca makina, ose diçka tjetër, kurse sa për transportimin e drogës ka se kush merret!...”

“Po nëse nuk pranon? ” – pyeti Dini, me fytyrë pakëz të çelur nga ideja e Besimit.

“Gjej mënyrë ta bindësh! Kërko të takohesh me të personalisht dhe gjej njëqind arsye për ta bindur, si për shembull shëndeti...”

“E gjeta, e gjeta!... Këtë punë ia lëmë Valit. Ai i beson Valit dhe për fjalën e tij ai do të pranojë pa asnjë hezitim të shkojë në Sant Morritz! Super! Pastaj, drogën mund ta transportojë vetë Vali, apo dikush tjetër! Si thua ti!”

“E sheh, pra? Ta provojmë një herë! Ideja është e mirë!” – tha Besimi, pa ndonjë entuziazëm të veçantë.

## V

Zëri i thekshëm i një gjeli e bëri Fer Gjergjlekaj të përmendej. Hapi sytë. Në fillim nuk iu kujtua se ku ndodhej. Pas pak i njohu orenditë dhe ndjeu një ngazëllim të papërmbajtur, kur pa veten në dhomën e tij të dikurshme të dhëndërisë. Ngriti pak kokën dhe shikoi drejt valixhes që ndodhej në këndin e dhomës, e qetë dhe e heshtur. Më në fund arritëm, ju drejtua valixhes, pastaj u rrotullua në krahun tjetër dhe u përpoq të rikthente gjumin. Ishte e pamundur. Pas ca përpëlitjeve të kota, u ngrit përgjysmë nga shtrati dhe u shtriq. Ashtu, me fytyrë të mbufatur nga gjumi, u afrua afër pasqyrës së madhe që ndodhej e vendosur mbi komo, duke shikuar fytyrën e tij të lodhur. I dukej vetja më i lodhur sesa mbrëmë, kur ishte shtrirë pas gjithë asaj rruge të gjatë e të mundimshme. Ndjeu se akoma veshët i ushtonin nga zhurma mbytëse e motorit të autobusit. Duhej të ishte bërë vonë.

Kurrë në jetën e tij nuk kishte pasur dëshirë të zgjohej herët në mëngjes. Sikur të ishte atje, tani do të ishte në gjumin më të ëmbël. Për të dita ishte për të fjetur, sidomos pjesa e parë.

Nëna ishte e gëzuar për ardhjen e tij të papritur. Ajo kishte kohë të gjatë që e kishte pritur këtë ditë të lumtur, që i biri t'i kthehej, në fillim nga burgu, kurse

tani nga mërgimi. Ajo rrinte e ulur pranë tij, duke e shikuar me dashuri.

I ati, si gjithnjë, rrinte i mënjanuar dhe pinte duhan. Ai nuk ndjehej aspak i gëzuar për ardhjen e tij. Kishte një parandjenjë të keqe. Kur e kishte parë të hynte nga dera e oborrit, ishte rrëqethur, jo nga gëzimi por nga frika. Ishte përpjekur t'i sqaronte rrethanat në të cilat ndodhej vendi, sepse, siç thoshte ai, ti nga larg e ke të vështirë t'i kuptosh ato ngjarje që ndodhin këtu, pa i përjetuar vetë.

Feri u përpoq ta siguronte se ishte i “garantuar” nga njerëz me pozita të larta. Bile, pozitat e atyre që e kishin “garantuar” ardhjen e tij për vizitë disaditëshe në gjirin familjar, ishin pozita jo të ish-kolegëve të tij, por të rangut republikan. Madje, nuk ishin shqiptarë, por serb! Këta njerëz ia kishin mundësuar që të arratisej nga burgu, ia kishin mundësuar inkuadrimit në punë të “zgjedhur” atje në Perëndim, ku kishte pasur fitime të majme. Nga ato fitime i kishte ndihmuar edhe atij.

Plaku e shikonte me dyshim e me dhembje bashkë. Rrethanat, për të cilat i fliste i biri, ishin më tepër një përpjekje e tejdukshme për t'ia mbushur mendjen dhe për ta shfajësuar veten. Edhe më parë plaku i kishte dërguar të fala atje ku jetonte, duke ia tërhequr vërejtjen se rruga në të cilën ndodhej nuk ishte rrugë e mirë. Fjalët që ishin përhapur për sjelljet e tij në Perëndim, kishin ndikuar në ftohjen e marrëdhënieve të tij me bashkëfshatarët, të cilët kishte kohë që nuk e qasinin dhe nuk ia jepnin vendin e merituar, që dikur e kishte gëzuar në mesin e tyre.

Ja ndërpreu bisedën, duke i thënë se koha e miqë-

sisë me serbët kishte kaluar. Tani ne jemi në një kohë tjetër, jemi në ndarjen definitive të gjërave, duke filluar nga ato më të imtat, nga pazaret e deri të ato më të lartat, pra të politika, kultura, sporti e tjera. Ata na i kanë rrëmbyer të gjitha. Edhe shkollën, ku ti ke qenë nxënës, e kanë shndërruar në pikë kontrolli policor. Çdo gjë është nën kontrollin e tyre. Por, ne tani kemi institucionet tona paralele. Prandaj edhe ti duhet të largohesh një herë e përgjithmonë nga ata “miqtë” e tu të Republikës së Serbisë. Pastaj i tha që, sa të rrinte, mos të dilte e të sorollatej poshtë e lartë, siç e kishte pasur zakon, sepse ishte me rrezik. Derisa të merret vesh se kush je, të përlej paramilitarët. Pastaj e pyeti për Bardhën, ku ishte dhe në ç’ mardhënje ishte me të. Si gjithmonë, në vend të arsyes së shëndoshë, Feri kishte filluar t’i humbte nervat. Mos e përmend atë bushtër. Ajo nuk është më gruaja ime, ishte përgjigjur plot nerva. Nëna u përpoq të hynte ndërmjet këtyre bisedave dhe ta largonte sherrin.

Në shtëpi mungesën e Bardhës më se shumti e ndjente e ëma. Edhe pse e dinte si kishin rrjedhur ngjarjet, edhe pasi i kishte dëgjuar fjalët e fundit të Ferit, ajo prapë kishte dëshirë të dinte për fatin e saj. Feri u shti se përmendja e emrit të saj e bënte nervoz. Humbja e saj ishte njëra nga pjesët e kompromis-marrëveshjes në mes tij edhe Babiqit.

Pas pak, në derë u duk fqinja e parë. Ajo, si zakonisht, filloi të dërdëlliste për zotësinë e Ferit, i cili, siç thoshte ajo, ishte bërë shembull për rrethin. Në fillim të karrierës së tij si inspektor i zbulimit, këto fjalë të fqinjës e kishin inkurajuar dhe e kishin bërë krenar, kurse

sot ia shtuan edhe më tepër zemërimin. Në vend të arsyes, ai ju hakërrye asaj me fjalë të rënda. Si guxon ti, kllloçkë, të dërdëllisësh për zotësinë time? E di vetë unë zotësinë time dhe nuk ka nevojë askush të më tregojë se sa i zoti jam, kush jam, ishte shfryrë me inat Feri. Ajo ishte larguar e zhgënjyer, duke thënë si me veten e saj se, të gjithë ata që kalojnë disa vjet në mërgim, bëhen budallenj, e humbin arsyen.

Derisa ra muzgu i mbrëmjes, ai nuk doli nga shtëpia. Gjatë tërë ditës nuk ndërroi pothuaj asnjë fjalë me askënd. E ndjente veten të braktisur dhe për këtë fajin ua hidhte atyre që nuk e kishin honepsur fare. Pas kaq vitesh që kishte kaluar në mërgim, e kishte merituar një pritje më të mirë. Takimin e parë me anëtarët e familjes e kishte menduar fare ndryshe. Kishte menduar se ata do të ishin shumë të gëzuar. Do t'i rrinin për bri, duke e pyetur se si i dukej ai vend ku jetonte. Pastaj, kishte pritur ta pyesnin për gjuhën, për njerëzit, zakonet, punën, rrogën, shpenzimet e përditshme, për rrethin e shoqërinë, për klubet ku takohej me bashkëvendësit, ku do të mburrej me patriotizmin e tij, me fjalimet e zjarrta e patriotike që kishte mbajtur gjatë mbledhjeve. Do t'u tregonte për paratë që kishte paguar në llogari të ndihmave, të cilat i kishte të dokumentuara, pastaj do t'u tregonte për automobilin, të cilin, kur të vinte herën tjetër, do ta merrte me vete dhe, sipas nevojës, do t'ia falte të vëllait. Pastaj do të shfletonte albumin e fotografive dhe do t'ju tregonte Sandrën e tij të bukur dhe ata do të mahniteshin me bukurinë e saj. Por, kishte ndodhur befasia. Ata, jo vetëm që nuk e kishin pyetur për të gjitha këto, por kishin filluar ta

qortonin pse kishte ardhur! E kishin qortuar se kishte bërë punë të pahijshme atje. Dhe, kulmi kishte arritur kur i kishin thënë që të hiqte dorë prej atyre punëve. Dhe, vërtet, tani e ndjente veten të penduar pse kishte ardhur.

Pasi u err, u vesh sipas zakonit të tij dhe doli në rrugë, pa i thënë askujt asnjë fjalë. Mori një taksi. Asfalti ishte shkatërruar edhe më keq. Gropat ishin bërë të shpeshta dhe të mëdha. Shoferi ishte i detyruar të ngiste ngadalë veturën. Në udhëkryqin e parë ai mori anën e djathtë, që për një çast e bëri Ferin nervoz.

„Unë të thashë të me dërgosh në qytet!”

„Në qytet po shkojmë. Nuk mund të kalojmë rrugës kryesore, që bie pranë shkollës. Ka kontroll të vazhdueshëm atje dhe keqtrajtime nga ana e policisë serbe.“

„Ashtu?“ – tha Feri i hutuar.

Vetura kishte hyrë tani në fshatin Eshkë. Kaloj pranë shtëpisë së Ademkurtëve. Kishte qenë në atë shtëpi dhe kishte marrë shumë para duke ju premtuar se do t’u ndihmonte në zbulimin e djalit të tyre, që ishte duke u rritur diku në një jetimore në kryeqytet. Bile, në fund, në pamundësi që të arrinte ndonjë rezultat, u kishte sugjeruar që të zinin një avokat. Ai ua kishte dhënë pastaj adresën e avokatit të mirënjohur Pavleviq Dragolub, i cili e kishte marrë lëndën e tyre. Nuk kishte më dijeni se çfarë kishte ndodhur pastaj.

Vetura u ndal pranë trotuarit, në periferi të qytetit. Zbriti nga vetura dhe pasi bëri pagesën, sakaq u gjend në trotuarin e rrugës kryesore. Vetë këmbët e shpinin drejt qendrës së qytetit. Rruga, jashtë zakonit të dikurshëm,



dukej e zbrazët. Nuk kishte më njerëz që i mbushnin trotuaret dhe sheshet në këtë kohë të mbrëmjes. As në korzo nuk kishte njerëz, si dikur, që shëtisnin deri në orët e vona të natës. Nuk kishte as të rinj, të cilët dikur në këtë kohë shiheshin trotuareve, duke biseduar me të njohurit e tyre. Kaloi pranë lulishtes së bukur të qytetit, e cila për një çast ju duk se nuk ishte ajo lulishtja e dikurshme. Ishte e shkretuar fare. U afrua edhe më pranë, duke shikuar në mesin e lulishtes, ku më parë kishte qenë i vendosur busti i militantit komunist, Ali Kelmendi. Busti nuk ishte më aty. Në vendin e tij ishte i vendosur një monument tjetër. Në këtë lulishte dikur defilonin të dashuruarit, duke bërë shëtitjet e gëzueshme të dashurisë, e sidomos të fejuarit, që rrinin të përqaftuar deri në orët e vona të natës. Kurse sonte, në këtë mbrëmje kaq të bukur vere, lulishtja ishte pothuaj fare e boshatisur.

Ç'kishte ndodhur, vallë, kështu? Ku ishin fshehur gjithë ata njerëz, që dikur shëtisnin të gëzuar në këtë korzo? Ku janë të rinjtë që shëtisnin deri në orët e vona të natës, në lulishten e dashurisë, siç e quanin dikur ata? Ç'është ky ndryshim? Dhe, befas, iu kujtua Xha Hima, i cili, sa herë që e takonte te stacioni i autobusëve në Zürich, i thoshte se këto agjenci turistike, pak nga pak, po e bëjnë zbrazjen e Kosovës nga të rinjtë. Ndoshta ata autobusë e kanë zbrazur edhe qytetin e tij!? S'ka sesi komentohet ndryshe ky fenomen që Feri nuk e kishte parë asnjëherë nga afër. Atje, në Zürich, ishte krejt ndryshe, ishte vështirë ta dalloje ditën nga nata. Lëvizjet e shumta dhe të gjalla të njerëzve, automobilat, dritat, rrugët, rrokaqiejt, zogjtë ishin të

lirshëm dhe të gëzuar. Në rrugë, në sheshe dhe në çdo vend dëgjoje njerëz të moshave të ndryshme që bisedonin shqip. Të bëhej se nuk je në Zürich, por diku në një lagje të banuar me shqiptarë, diku në një qytet të Kosovës. Kurse këtu, në këtë qytet që dikur e kishte ditur se si frymonte, e kishte ditur se kur ishte i gëzuar, kur ishte në zi, apo kur ishte i inatosur dhe i egërsuar, ishte një boshatisje e varfër dhe pikëlluese. Ishte një boshatisje edhe e gjuhës shqipe. Ndoshta është gjuhë e ndaluar, dhe prapë mendja i shkoj të xha Hima, që i thoshte se gjuha shqipe është gjuhë e ndaluar, shkolla shqipe është shkollë e ndaluar, edhe populli shqiptar është popull i ndaluar! Më mirë të thuhet është popull i truar, mendoi.

Në kafenenë që dikur, në kohën kur kishte qenë inspektor (dhe befasi iu kujtua ai mëngjes i tmerrshëm i arrestimit), kishte kaluar net të tëra të gëzuara dhe të mbushura me dashuri, pije dhe lojë bixhozi, nuk ishin më ata njerëzit e zakonshëm. Për një çast ju duk se ishte i tepërt në këtë mes. Në fundin e sallës pa një fytyrë të njohur. Pastaj edhe një dhe më vonë pa edhe një tjetër. Por, megjithatë, në vete ndjente një zbrazësi shpirtërore, që ndoshta i vinte nga një mungesë e gjatë në këtë midis. As vajzat që shërbenin dikur, nuk ishin më ato që i kishte njohur vetë. Bisedat e zhurmshme për një çast ia kujtuan një kafene në periferi të Beogradit të Ri, ku kishte kaluar një kohë të lumtur të jetës së tij. Edhe kur kthehej nga Beogradi për vizitë në shtëpi të prindërve, disi ndihej i mërëzitur dhe i dukej dita e gjatë. Mëzi e priste kohën e largimit. Për çudi, këtë ndjenjë e kishte edhe tani. Se si i erdhi në kokë një mendim krahasues.

Që në rini të hershme veshët e tij ishin mësuar të dëgjonin biseda në gjuhë të huaj. Kishte pasur një simpati të jashtëzakonshme për atë gjuhë, të cilën e kishte mësuar shumë rrjedhshëm atje në Beograd, ndoshta edhe më mirë se sa gjuhën e tij. Bile, kishte pasur momente që e kishte urrye gjuhën e vet, sepse në disa raste ajo i prishte shumë punë. Pastaj, kur kishte shkuar në Zürich, kishte hasur në një gjuhë tjetër. Në fillim i kishte ardhur shumë vështirë që të fillonte belbëzimet e para dhe, pasi kishte filluar jetën e përbashkët me Sandren, kishte vërejtur se ishte dashuruar në atë gjuhë. Edhe në meset e mërgimtarëve, që e zotëronin mirë gjuhën gjermane, kishte dëshirë të komunikonte me atë gjuhë. Edhe tani, në këtë kafene, ndiente një dëshirë të zjarrtë që t'i dëgjonte këto biseda në gjuhën gjermane dhe pastaj të inkuadrohej edhe vetë. Por, pasi nuk e fliste askush, as gjuha serbe nuk do t'i prishte shumë punë, prandaj priste ndonjë rast të përshtatshëm që të inkuadrohej në bisedë. E kishte çelësin për t'u marrë vesh me secilin që mund ta takonte.

Atje, në mërgim, kishte dëgjuar nga mërgimtarët e moçëm, sesi ndikonte ndarja e gjatë nga familjet e tyre, nga vendi ku kishin lindur dhe ishin rritur. Dalëngadalë ata adaptoheshin më jetën në dhe të huaj, larg familjeve dhe të dashurve të tyre, kështu që, edhe kur shkonin për pushime, zakonisht një herë në vit, ata edhe pranë familjeve të tyre e ndjenin mungesën e lokaleve ku tuboheshin mërgimtarët, ngase në vendlindje nga ndryshimet e përditshme që bëheshin, ndjeheshin më të huaj se sa që ishin atje në mërgim, ku e kalonin pjesën më të madhe të jetës. Për çudi, këtë ndjenjë kishte fillu-

ar ta përjetonte edhe Fer Gjergjlekaj. I dukej shumë e largët dita që kishte arrirë në këtë mes, ku kishte kaluar pjesën më vitale të jetës së tij, por edhe më e largët i dukej dita kur do t'i thoshte lamtumirë këtij rrethi dhe të zhdukej që këtej.

Pronari i kafenesë, Ejup Agiq, e njohu. Dukej se ai ishte shtuar në peshë. Faqet iu kishin gufuar dhe në fytyrë dukej më i bardhë.

„Ka vite që s'të kam parë. Sa u gëzova që të pashë. Urdhëro, çfarë dëshiron të pish?”

“Dopio konjak”, – tha Feri dhe buzëqeshi me dashamirësi, duke tundur kokën. Edhe ai buzëqeshi dhe iku, duke ia vënë dorën mbi sup miqësisht.

Feri, me një shikim të butë, për lau gjithë të pranishtimit. Fytyrat e njohura, që pak më parë i kishte parë, nuk shiheshin gjëkund. Në skajin ku dikur uleshin pensionistët, tani aty ishin ulur disa burra me uniforma ushtarake. Ata bisedonin në mes veti dhe, herë pas here, e hidhnin shikimin nga ana e tij. Bisedonin me zë të lartë dhe shanin dikë, duke e përmendur emrin Stojan. Feri, pa dashje, u tkurr, me të dëgjuar atë emër dhe një palë djersë ia mbuluan ballin. Edhe pse ishte “i garantuar,” kishte një lloj dyshimi në ata të cilët e “garantonin”. Kishte frikë se ata mund t'ia punonin përsëri, sikurse herën e parë, ndoshta edhe më keq dhe me ndrojtje, vjedhurazi, edhe një herë hodhi vështrimin nga ana e tyre. Ishin fytyra të panjohura. Të gjithë trupmëdhenj dhe me mjekra të zeza e të gjata. Në prehër mbanin automatikët. Në brez, në rrypinë e gjerë u vareshin revolet dhe thikat.

“Ç'më ka gjetur belaja me ta”, – tha kamerieri pasi kishte zënë vend pranë Ferit. – „Vijnë këtu, kërko-

jnë pije dhe meze dhe kurrë nuk paguajnë, por e keqja nuk qëndron këtu. Për shkak të tyre, më janë larguar edhe shumë njerëz të tjerë të ndershëm, që dikur vinin këtu. Ka kohë që shqiptarët nuk vijnë fare në këtë lokal, vetëm ndonjëri, sa për të bërë dënim-pagesën për ta dhe largohet i shushatur dhe kokulur. Vetë pamjet e tyre të frikshme i kanë bërë njerëzit që të largohen. Me beso, edhe unë që ju shërbej, kam frikë nga ata. Kur dehen, nuk dinë se ç'flasin. Behën agresivë dhe shumë të rrezikshëm. Për një fjalë të pamatur, të shkon koka dhe pastaj, jo vetëm që nuk i merr kush në përgjegjësi, por fajet për vrasje ua lënë shqiptarëve, në emër të gjoja hakmarrjes. Pastaj, nga vetë këta e pësojnë shumë njerëz të pafajshëm. Armët i kanë gjithmonë të mbushura dhe, të them të drejtën, kam frikë nga ndonjëri, apo nga ndonjë plumb qorr. Më i rrezikshmi ndër ta është Gorani. Deri tash ai i ka varrë disa nga shokët e vet, por nuk dihet se sa shqiptarë ka varrë. Thuhet se ka varrë, dhunuar e masakruar shumë,“ – dhe duke u afruar edhe më afër tij, i pëshpëriti të veshi – „Nëse nuk ke ndonjë lidhje të fortë, më mirë ik që këtej, se po të futi Gorani në dorë, do ta pësosh keq.”

“Cili është ai?” – pyeti Feri me kureshtje.

“Është i ulur në të majtë të derës, i vetëm fare. Ai gjithmonë rri i vetmuar dhe në kujtime. Thonë se është rritur jetim.”

Ndërkohë, dera e kafenesë u hap dhe hyn brenda dy burra të veshur me rroba zyrtarësh. Kamerieri, pasi kërkoi falje, u ngrit dhe iku në drejtim të mysafirëve. Feri njërin e njohu. Ishte Stojani. Qenka bërë edhe ky dikush, mendoi. Ata pasi shikuan tavolinat me radhë,

biseduan diçka me kamerierin dhe hynë në kthinën e ndarë, që ishte për mysafirë të zgjedhur. Sa e sa herë Feri kishte kaluar net të tëra në atë kthinë. Pas pak burrat me uniforma u ngritën në këmbë. Duke bërë zhurmë, njëri pas tjetrit ata dolën. I fundit doli Gorani, i cili me një shikim të vrazhdë e për lau Ferin dhe kaloi fare pranë tij, duke shikuar si i marrë dhe u drejtua kah dera. Ky shikim për të ishte i pakuptimtë, i frikshëm dhe torturues. Në kafene mbretëroi qetësia.

Pas pak prapë erdhi kamerieri. Ai e ftoi të shkonte në kthinën e ndarë. Edhe kamerieri tani e kishte kuptuar se si qëndronte puna. Feri u ngrit në këmbë dhe e ndoqi prapa kamerierin.

Kthina kishte ndryshuar shumë. Ishte shndërruar në një kabare moderne. Në formë gjysmëharku ishte banaku me karriget e larta e të palëvizshme. Nga taveni vareshin llamba të bukura, që sa nuk preknin mbi banak, me një dritëz të kuqërremtë dhe të dobët, kurse mbi banak ishin të vendosura shandanë tunxhi të skalitura bukur me qirinj të ndezur. Në kënde ishin të vendosura tavolina të ulëta, me divane të bukura, me ngjyrë të kuqe. Në këndin e djathtë, prapa derës, ishte ulur Stojeni. Kurse në karriget e larta pranë banakut rrinin të ulura tri vajza dhe një burrë. Feri, pasi u përshëndet me Stojanin, zuri vend pranë tij.

Në fillim të bisedës Feri ishte i ndrojtur. Fliste për punën e tij në Perëndim, duke i anashkaluar shumë gjëra, për të cilat kishte vendosur t'i mbante të fshehura. Edhe të folmen e kishte të vështirë dhe me ndërprerje. Kishte përshtypjen se në këtë mënyrë do të arrinte që aksionet që i kishte bërë në mënyrë të pavarur, mos t'i zinte në gojë, sepse kishte frikë se

do t'i kërkonin llogari edhe për ato. Pastaj, me qëllim të largimit të bisedës nga fitimet e tij, nxori bllokun e shënimeve nga xhepi, duke i treguar shënimet që kishte arrirë t'i mblidhte, kohëve të fundit. Ai i tregonte emra njerëzish, adresa sallash të mbledhjeve, vendime, pastaj pagesa, fletëpagesa për çështje humanitare, ndihma në të holla, organizime të oficerëve për luftë, blerje armësh, përpjekje që të bashkoheshin subjektet politike në luftë të përbashkët e shumë çështje të tjera që ishin aktuale. Ferit, në një moment, iu duk se Stojani nuk kishte interes për këtë bisedë. Ai, pasi e mori bllokun e tij dhe e futi në xhep, e bëri me dije se atë do ta kontrollonte gjatë orarit zyrtar të punës, kurse sonte ai kishte ardhur këtu që të takohej me mikun e tij më të ngushtë, siç e quante ai Ferin, dhe dëshironte të pinte dhe të bënte qejf. Pasi e pyeti edhe për shumë çështje, filloi t'i tregonte se ato që Feri i kishte përgatitur, ishin gjëra të pakta, bile po thujt ishin hiç, në krahasim me ato që i dinte vetë. Stojani i sqaroi shumë çështje rreth organizimit të mërgatës, aktivitetëve të tyre të përbashkëta, vendtakimet, mbledhjet e partive politike, pastaj, taksat apo ndihmat që mërgimtarët i paguanin në emër të gjoja të qeverisë së Kosovës. Pastaj nuk harroi të prekte edhe organizimin mafioz të shqiptarëve, që ka lidhje të drejtpërdrejt me terroristët që veprojnë në Kosovë, të rebeluar kundër shtetit. Foli edhe për shumë çështje të tjera, duke lënë edhe shumë sosh në mjegull, të pasqaruara dhe me fjalë të largëta e të ftohta, që Feri nuk i kuptonte dot.

Po afrohej mes i natës. Feri e dëgjonte me gojë hapur Stojanin. Pasi ai kishte zbratur shumë goga njëren pas tjetrës, kishte filluar të bisedonte me ton

edhe më të ulët, duke nxjerrë shumë gjëra në shesh, për të cilat Feri nuk kishte dëgjuar më parë. Ai i tregoi se bos i mafies serbe ishte i lidhur ngushtë me mafien ruse dhe në këtë mënyrë që të gjithë ishin të kontrolluar nga shërbimet sekrete serbe dhe ruse. Në këtë kontroll janë të angazhuar një pjesë e mirë e zyrtarëve të lartë shtetëror serb, të cilët, pas sanksioneve të vëna në vitet paraprake, e shohin drogën si të vetmin financim për shtetin. Si baza të rëndësishme për deponimin e drogave që vinin nga vendet e tjera, ai përmendi Maqedoninë dhe Qipron. Pastaj përmendi edhe shumë emra udhëheqësish të lartë të Serbisë. Feri shikonte i hutuar. Nuk ishte hera e parë që dëgjonte biseda të tilla.

Dalëngadalë biseda kishte filluar të venitej. Stojani kërkoi që njëra nga vajzat të vinte dhe të ulej pranë tij. Ai burri që e kishte shoqëruar Stojanin, kur kishin ardhur në kafene, tani kishte filluar vallen me një vajzë, pasi kishte filluar muzika. Feri, me gjithë habinë që ia kishte shkaktuar biseda e Stojanit, vjedhurazi e hidhte shikimin nga njëra vajzë që i kishte lënë përshtypje të këndshme, me t'u takuar sytë e tyre, në shikimin e parë. Stojani sikur e kishte kuptuar këtë pozitë të Ferit, prandaj e thirri vajzën, duke e njohur me mikun e tij.

Feri u ngrit në valle. Muzika nuk kishte të ndalur. Disa herë u shuan dritat. Më në fund filluan nga dashuritë dhe secili me femrën e tij u ndanë në pjesë të ndryshme të lokalit. Dritat u shuan fare. Të ndezur mbetën vetëm qirinjtë, që ndodheshin mbi banak. Me dritën e tyre të zbehtë, qirinjtë nuk arrinin dot të ndriçonin qoshet e errëta të lokalit, ku si hije në gjysmerrësirë shiheshin trupat e bukur të vajzave lakuriqe. Në zhurmën e



muzikës, si në të rrallë, dëgjohej ndonjë “ah” apo “oh” e vajzave, që tani ndodheshin të shtrira nën peshën e atyre burrave, të cilëve pak më parë u kishin shërbyer. Këtë ritual e ndoqi edhe Feri me vajzën flokëverdhë, e cila, ashtu gjysmëlakuriq, tundte vithet sipas ritmit të muzikës, me belin e mbërthyer nga dora e tij, e cila disi e shqetësuar kishte filluar një lëvizje ledhatuese, duke u ngjitur lartë deri të shpatullat dhe, pastaj, si pa të keq, duke u fshehur prapa flokëve të gjata, që i binin të shpupuritura mbi supet e saj të bardhë dhe lakuriq. Me një lëvizje të trupit në anën tjetër, Feri ndërronte pozitat e duarve, duke ia vënë dorën tjetër rreth belit dhe ashtu duke e ngjitur lart, nën ledhatimin e lehtë të flokëve, ia prekte lakuriqësinë e nxehtë, përvëluese. Dihatjet e vajzave të tjera, që vinin edhe më të shpeshta dhe më zë të lartë, e bënë Ferin që ta tërhiqte vajzën fare pranë, duke u ngjitur një me trupin e saj. Ajo e ndjeu afrimin e trupit dhe dorën e tij të fuqishme që e tërhiqte. Andaj, si me lajka i rrëshqiti nga dora dhe u largua pakëz, duke vazhduar dridhjen e vitheve sipas muzikës. Ajo e dinte se ai këto ledhatime i kishte me të pabesë, por pikërisht ajo pabesi e bënte më tërheqës, duke e lëshuar trupin e saj të nxehur mbi gjoksin e tij. Feri nuk priti më. Dora e tij rrëshqiti ngadalë mbi gjirin e saj të gufuar, duke e shtrënguar lehtë. Një “ah” e dalë nga goja e saj e bëri atë që të tërhiqej bashkë me vajzën në drejtim të këndit të errët, atje tutje, prapa banakut, ku ishte divani bosh.

\*

I hakërryer, shtyu derën e oborrit. Flakët kishin

përpi çdo kënd të shtëpisë. Edhe pojata e vjetër ishte duke u djegur, pastaj mullarët... Nga e kthente kokën, shikonte vetëm zjarr, zjarr dhe shembje të trarëve që digjeshin. Deshi të pyeste fqinjin e parë, se çfarë kishte ndodhur, por ai iku pa i folur fare. As vëllai i tij nuk i foli. Ai e shikoi vrazhdë dhe me plot urrejtje, duke u larguar në drejtim të grumbullit të njerëzve, atje në mesin e oborrit. Askush nuk bënte as përpjekjen më të vogël që të shuante zjarrin. Ç'kishte ndodhur, vallë? Pse nuk e shuajnë zjarrin? Pse nuk më flasin? Ndosh-ta e kanë bërë me qëllim, pasi i kanë gjetur paratë në çantën time dhe për ta fshehur grabitjen, e kanë djegur shtëpinë, pojatën, mullarët... dhe pastaj me ato para t'i ndërtojnë të reja... A është e mundur kjo, vallë?...

“Ku është çanta ime?” - pyeti Feri me një zë të thekshëm dhe të vrazhdë, pasi ishte afruar pranë grumbullit të njerëzve, ku në barin e njomë pa babanë të shtrirë dhe të përgjakur. Përbri tij ishte shtrirë nipi shtatëmbëdhjetë vjeçar, i mbuluar me gjak.

“Me thoni se çfarë ka ndodhur?!” - thirri për të dytën herë. Për çudi, tani ai nuk e ndjente fare se ishte i dehur. Mendja i qe kthjelluar. Ishte këmbëngulës të dinte se çfarë kishte ndodhur dhe prapë zemra ia bëri “tak” për çantën e tij, të cilën një ditë më parë e kishte sjellë nga Zvicra, me njëqind peripeci dhe me shumë shpenzime.

“Shiko, or bir tutje, nga dera e oborrit!” – tha plaku me gjysmë zëri, duke u përpjekur ta ngrinte dorën. Feri pa andej nga i thoshte i ati, duke menduar se atje diku, e fshehur në një qoshe, ishte çanta e tij. Në mugëtirën e agimit ai dalloj një arkivol. Një dridhërimë e lehtë

ia përshkoi zemrën. Dikush paska vdekur, mendoi për një çast. Por nuk ishte në gjendje ta përcaktonte se cili kishte vdekur. Ndoshta babai, mendoi vetëtimthi dhe sakaq u qetësua, kur u kujtua se njeriu i vdekur nuk flet. Atëherë, kush ka vdekur pra? Shikimin e rrotulloi për të dytën herë mbi të pranishmit. Nëna ishte gërmuqur pranë nipit të plagosur. Babai ishte i shtrirë dhe kunata përpiquej t'i jepte ndihmën e parë, duke ia larë plagën e gjoksit me ujë. Vëllai rrinte në gjunjë pranë të birit të plagosur.

“Kush ka vdekur, babë?” – pyeti ai me një zë të përvajshëm, duke harruar për një çast thesarin e tij.

“Ende s’e ke marrë vesh, a?” – ia ktheu plaku me zë të lodhur nga therjet e plagëve, të cilat kishin filluar të ftoheshin dhe dhembjet ishin bërë të padurueshme. – „Ti ke vdekur, o bir, ti!”

“Unë?!“... – dhe instinktivisht preku gjoksin me dorë. – „Unë jam gjallë, babë, a s’me sheh, a?”

“Për mua jo!... për ne ti je i vdekur. Ti je i gjallë vetëm për ata që të kanë ‘garantuar’... Për ata po!... Ik nga këtu!... Ik, o pjellë e keqe!... Ik, o bukëshkalë! Ik, o haram... e haram të qoftë buka e misrit që ta kam dhanë! Ik, zhduku që këtej, se ti nuk je djali im...ti je vetë i mallkuemi!...”

“Ku është çanta ime?” – pyeti kësaj radhe me një zë lutës dhe shikimin e drodhi nga njëri te tjetri, duke u përpjekur të hetonte se cili nga ata do t’ia jepte përgjigjën. Vetëtimthi ndjeu një lumturi, duke mendar se të gjitha do të rregullohen me paratë që i kishte në çantën e tij. Me ato para ai mund të ndërtonte pallate luksoze, mund të ndërtonte vila!

“Çantën tënde e ka marrë ai që të ka ‘garantuar’ të vish këtu dhe nuk është shqiptar, por ‘serb’ dhe me ‘pozitë’ të lartë në kuadrin ‘republikan’ e që quhet Babiq!” – tha plaku me një zë të lodhur, sa që fjalët e fundit mezi u dëgjuan. Nga dhembjet ai ra në agoni.

“Ah!...” – ia bëri Feri, sa mezi u dëgjua ky lloj rënkimi dhe duke e parë situatën, me hapa të shpejtë u kthye nga dera e oborrit. Ishte hera e parë që, pas kaq vitesh, kishte rënë në dëshpërimin e asaj dite që Babiq e kishte arrestuar. Ishte në dëshpërim të madh, që për kompromis kishte flijuar Bardhën, duke e lënë në dorë të Babiqit, vetëm për egoizmin e tij. Kurse sot, prapë me egoizmin e tij të pangopur, kishte humbur çdo gjë. Këtë nuk do ta fali kurrë, o Babiq!...dhe me kokën ulur, me një urrejtje të papërmbajtur u gjend në derën e Agjencisë Turistike “Globi Tours.”

Rrezet e para të diellit kishin rënë mbi fushën e gjerë që ndodhej para pamjes së tij të venitur. Ishte një ditë e bukur vere, por për të ishte një ditë e zezë si futa. Kishte arritur në një lloj zgripi që, edhe po të donte, nuk mund të dilte dot. Kishte humbur çdo gjë. Edhe atë pak autoritet që mendonte se e kishte pasur në gjirin e familjes, tani nuk e kishte më. Ishte i mallkuar nga prindërit e tij, nga vëllezërit e motrat, nga shokët që ishte rritur me ta, nga fqinjët, nga fshatarët, nga të gjithë... edhe nga Bardha. Ishte hera e parë, pas kaq vitesh, që e kujtonte Bardhën me gjithë qenien e tij dhe për një moment e urreu veten. E ndiente se ishte njeri i tepërt në këtë botë. Vetëm një shpresë e mbante akoma: hakmarrja!

Pronari i agjencisë “Globi Tours”, me të kuptuar

se si qëndronte puna, iu gjend pranë. Ai e dërgoi në një shtëpi të nipit të tij, e cila ishte bosh. Aty u kujdes që t'i jepte zemër, duke i ofruar edhe ndihmë në para. Tri ditë ai nuk doli fare nga shtëpia. Ditën e katërt, kur kishte ardhur koha që autobusi të fillonte rrugën, ndër udhëtarët e fundit ai hyri në autobus, duke u ulur në ulëset e fundit, gjë që e bënte që të ishte larg pamjes së atyre policëve, të cilët rastësisht mundë ta njihnin dhe t'i nxirrnin telashe të tjera.

\*

Ndodhia në fshatin Buron, përveç njoftimeve në gazetata e pavarura që botoheshin jashtë censurës shtetërore, pëshpëritej vesh më vesh nga njerëzit, bile edhe nga ata që e quanin veten parimorë dhe nuk përziheshin në punë politike. Ishte pak e habitshme sesi kishte mundur të ndodhnin dy gjëra rrënjësisht të kundërta me njëra-tjetrën dhe pikërisht të dyja brenda të së njëjtës natë, në të njëjtën familje. Diçka misterioze kishte në këtë mes dhe pikërisht ky misteriozitet e bënte edhe më të rëndë kuptimin e së vërtetës. Në kafenenë e vetme të fshatit, tani i dëgjoje ata që ndienin kënaqësi që në raste të tilla të gjykonin ngjarjen, duke folur me zë të lartë: Ai horri, që ndodhet i fshehur diku në Perëndim, i bëri të gjitha. Ne e kemi ditur që ai ka qenë dhe është njeri i tyre, prandaj, me të ardhur këtu, ne ia tërhoqëm vërejtjen e parë, duke ia vënë arkivolin në mes të oborrit. Por ai, për t'i fshehur gjurmët e veta, i dërgoi ish kolegët e tij të punës, për t'ua bërë prindërve atë që ua bënë dhe për t'i shpallur viktimë para nesh dhe për t'i fshehur veprimet e tij, që i bën prapa shpinës

së popullit të vet. Por a e beson kush këtë?

Ata që e dëgjonin, tundnin kokat, duke pohuar në heshtje dhe duke i miratuar ato që i thoshte folësi. Por kishte edhe nga ata që i jepnin të drejtë familjes së dëmtuar, që kishte mbetur nën qiellin e hapur, të rrahur dhe të plagosur për vdekje, dhe akuzonte strukturat e fshatit, bile edhe popullin që nuk iu kishin gjendur në ndihmë, për t'i shpëtuar nga më e keqja. Pasi të merret vesh sesi qëndron puna, ata duhej të distancoheshin apo t'i qasnin.

Kështu mendonin ata, por jo edhe kronisti, i cili në mëngjes herët kishte marrë lajmin sesi kishte ndodhur bastisja, plaçkitja, përleshja në mes të paramilitarëve dhe policisë në njërën anë dhe anëtarëve të familjes Gjergjlekaj në anën tjetër. Lajmësi e kishte njoftuar se kjo kishte ndodhur si pasojë e ardhjes të papritur të Ferit nga mërgimi. Ai nuk kishte harruar të shtonte se, sipas raportit të pronarit të agjencisë së udhëtimeve „Globi Tours“, Feri kishte sjellë me vete një shumë të madhe parash, ndoshta më shumë se një milion marka gjermane, apo ndoshta deviza të tjera në kundërvlerë. Thuhej se pikërisht ky thesar ishte bërë shkak për kontroll. Nuk ishte e qartë akoma se nga e kishin marrë vesh ata ardhjen e tij, por sipas lajmësit, ata kishin qenë të njoftuar në detaje për ardhjen e tij dhe, posa e kishte kaluar autobusi kufirin shtetëror, kishte qenë nën kontrollin e rreptë dhe tinëzar të spiunëve. Edhe shtëpia e Gjergjlekaj, atje në fshat, kishte qenë nën kontrollin e rreptë të spiunëve. Madje, ata kishin arritur t'i zinin pikat strategjike, para se të arrinte vetë Feri në shtëpinë e tij. Ata kishin zënë pozicionet në shtëpitë përreth dhe,

siç thuhej në njoftim, njëri nga spiunët më të regjur të qytetit P. kishte marrë pjesë në përgjimin profesional, duke arritur që të futej pa u diktuar fare në shtëpinë e familjes Gjergjlekaj. Ai, siç vazhdonte njoftimi, kishte zënë vend në një skaj të errët në tavanin e shtëpisë, duke kontrolluar çdo lëvizje të anëtarëve të familjes, si dhe duke e dëgjuar me vëmendje çdo bisedë të tyre. Ai, nga tavani, duke shikuar nga një vrimë e vogël bren-dinë e dhomës së gjumit të Ferit, kishte parë qartë se ku e kishte fshehur thesarin. Pastaj kishte dëgjuar edhe një bisedë telefonike nga telefoni i tij mobil, por që ai nuk e kishte marrë vesh se çfarë dhe me kënd kishte biseduar, sepse biseda ishte zhvilluar në gjuhën gjermane, por në këto rrethana ishte i sigurt se kjo bisedë nuk do të ndikonte në aksionin e ardhshëm. Ai kishte qëndruar tërë ditën në atë pozitë, derisa Feri kishte dalë nga shtëpia. Për daljen e tij e kishin njoftuar përmes radiolidhjes që ai e mbante me vete. Pastaj, kur shtëpia e tyre ishte rrethuar diku rreth mesnatës, para se ta çanin derën ata nga jashtë, nga tavani i shtëpisë kishte zbritur përgjuesi, duke mbajtur në dorë revolen të gatshme për zjarr dhe me maskë në fytyrë, i kishte detyruar anëtarët e familjes ta hapin derën. Në ballë të tyre kishte qenë Babiq i maskuar dhe fill pas tij, kishte hyrë rrëmbyes-hëm duke përmbysur çdo gjë që i vinte në dorë Gorani i tmerrshëm, i vetmi pa maskë në fytyrë. Pastaj ata kishin shkuar drejtë e në dhomë, ku përgjuesi me maskë e kishte nxjerrë në shesh thesarin, duke e hapur para syve të plakut, i cili nga zemërimi i kishte sulmuar, duke ia hequr maskën nga fytyra Babiqit dhe në këtë çast, këtij sulmi i ishte përgjigjur me zjarr Gorani, duke e

plagosur atë për vdekje. Pasi ata kishin kontrolluar dhe kishin marrë çdo gjë që kishte pasur ndonjë vlerë për ta, për t'i zhdukur gjurmët e plaçkitjes, ia kishin vënë flakën shtëpisë.

Për kronistin parësore ishte njoftimi, të cilin e kishte përgatitur familja Gjergjlekaj dhe që duhej të botohej si sqarim mirëkuptimi për bashkëvendësit e tyre. Ai e mbante në dorë duke e lexuar herë pas here. Ai kishte kohë që e kishte pritur një reagim publik të ngjashëm nga Gjergjlekajt.

Duke i mbledhur shkresat e shpërndara mbi tavolinën e tij të punës, ai e hodhi vështrimin tej dritares. Kishte filluar të errej. Në rrugë njerëzit kishin filluar të rralloheshin. Çdonjëri ikte drejt shtëpisë, sa pa e zënë ora policore.

\*

Sikur të mos kishin mjaftuar të gjitha ato të liga, që e kishin gjetur gjatë rrugës, të ligat e tjera e prisnin në shtëpi. Në vend që t'i gëzohej të vetmit njeri që i kishte mbetur akoma pranë, kishte ndodhur ajo që më së paku e kishte pritur. Gjatë mungesës së tij, Sandra e kishte kontrolluar podrumin, duke gjetur sasi droge, para e armë. Ajo, e tmerruar, në fillim kishte dashur të lajmëronte policinë, por kishte pasur frikë se ata nuk do ta kuptonin, ndaj nga frika kishte ikur nga shtëpia, duke u strehuar të një shoqe. Porsa kishte arritur Besimi, ajo ia kishte zbrazur në fytyrë të gjitha, duke e përzënë nga banesa dhe duke ia hedhur valixhet jashtë. Ai ishte përpjekur të sqarohej, por kishte qenë e pamundur. Ajo kishte qenë aq e egërsuar, sa që Besimi kokulur, i ngar-



kuar me valixhet e tij që më parë ia kishte përgatitur Sandra, ishte larguar. Strehë kishte gjetur te Koli.

Besimi u zgjua i llahtarisur. Ëndrrat e kishin sjellë para çmendje. Sa i mbyllte sytë, përpara i dilte babai me atë pamjen e tij të vrazhdë, i verdhë si mejtja dhe me zërin e tij të mpakun, që gjithmonë i thoshte të njëjtën fjalë: „Për ne ti je i vdekur!“ Pastaj e ndiente një rënkim apo një vaj, që një herë i dukej se ishte rënkimi i nënës, por më vonë i bëhej se ishte vaji i Bardhës e pastaj ai vaj shndërrohej në zërin kërcënues të Sandrës. Ai zë bëhej si i çjerrë dhe i dukej se ishte zëri i Babiqit, i përzier me një zë femre që i vinte si dihatje epshi e përzier me një të qeshur të zgjatur, që i shëmbëllente një të qeshure shtrige. Disa herë u rrotullua dhe, nga lodhja e rrugës së gjatë, prapë qepallat i rëndoheshin, dhe prapë nga e para. Babai, pastaj zëra të përzier, kërcënimi i Sandrës dhe hingrizja e shtrigës. Disa herë u ngrit nga shtrati. Koli flinte i qetë. Ai nuk i dëgjonte këta zëra. O Zot! Po çmendëm, mendonte dhe vendoste mos të flinte më, deri në agim. Shkonte në dhomën e pritjes dhe e hapte televizorin. Pasi fillonte prapë t’i rëndoheshin qepallat, si në vegime prapë fillonte tundja e tij nëpër të njëjtën ëndërr, me të njëjtët njerëz dhe, në fund, qeshja e shtrigës që gjithmonë ishte e padukshme.

Me këtë torturë e zuri mëngjesi.

Nuk i pritej që të takohej me Belin. Ishte një situatë që medoemos duhej të konsultohej me të. Pasi u vesh, i shqetësuar doli në rrugë. Së pari shkoi në lokalin e klubit dhe si gjithmonë, aty takoi xha Himën. Ai, kur e pa, hapi duart dhe e mori në përqaftim.

“Vetëm një javë e bërë në familje?” - pyeti ai.

“Kisha ndërmend të rrija më gjatë, por më diktuan dhe të them të drejtën, m’u deshtë ta ndërpres në gjysmë pushimin dhe të kthehem.”

“Po, or bir, është një situatë e rëndë për mbarë popullin tonë. E lexova në gazetë se në fshatin K. kishin arrestuar dy vëllezër, në fshatin Buron e kishin djegur një shtëpi, kishin rrahur dhe kishin plagosur të zotët e shtëpisë. Në Drenicë kishin bërë përpjekje që të futeshin në një shtëpi, por kishin hasur në rezistencë, duke lënë edhe policë të vrarë...”

“E ke gazetën?” – pyeti Besimi.

“E kam, or bir, po ç’e do!” – fliste xha Hima si me vete, pa e vënë re shqetësimin në fytyrën e Besimit dhe vazhdoi: – „Këtu është burgosur një bandë shqiptarësh, që merreshin me shitjen e drogës, kurse atje vrasje, burgosje, internime, plaçkitje dhe sikur të mos mjaftonte kjo, ka akoma edhe të atillë që edhe në këto kohë të vështira punojnë për interesa të serbëve. Ja, lexoje këtë njoftim!” – tha xha Hima, sikur të dinte se vetëm edhe këto njoftime i kishin munguar Besimit, duke ia lëshuar në dorë ca gazeta. Ai uli kokën mbi gazetë. Njoftimi ishte tronditës. Ishte hera e parë prej së njihej me xha Himën, që e ndjeu se do të zhgënjehej para tij. Iu bë se edhe pa folur, ai e kishte zbuluar të fshehtë. Pati frikë se do të zbulohej nga ai edhe pa folur fare, apo ishte zbuluar që më parë dhe xha Hima nuk dëshironte t’i tregonte i pari se kush ishte, por e linte që Besimi të rrëfehej vetë para tij. E mblodhi disi veten pa rënë shumë në sy dhe filloi nga e para, duke e lexuar më qartë dhe pa paragjykime njoftimin:

### *Njoftim*

*Familja Gjergjlekaj nga fshati Buron distancohet nga biri i tyre Fer Gjergjlekaj, azilant në Zvicër, i cili kundër dëshirës sonë ka vite që punon për interesa serbe, duke e dëmtuar rëndë çështjen tonë kombëtare. Këtë distancim e bëjmë, pasi ai vuri dorën e tij të tradhtisë edhe mbi familjen e tij të ngushtë. I ftojme të dëmtuarit nga dora e tij tradhtarë për mirëkuptim me familjen Gjergjlekaj. Presim me dëshirë që populli të na pranojë prapë në gjirin e tij të ngrohtë.*

*Me nderime, familja Gjergjlekaj*

“Fat”, – tha Besimi me zë të lartë, sa që e bëri xha Himën ta shikonte disi i hutuar.

“E ç’fat, more bir, ky është fat i zi për të gjithë ne, po ku po e sheh ti atë fat!?”

“Jo, jo, xha Himë, thashë fat që e kanë zbuluar dhe e kanë shpallur me kohë përmes gazetës, pa pasur mundësi që t’i dëmtojë edhe të tjerët, që nuk e kanë ditur se ai është tradhtar”. – Kurse me veten e tij me fjalën fat nënkuptoi që familja nuk kishte dhënë ndonjë fotografi, që ta botonte bashkë me njoftimin në gazetë, e pastaj do të shkatërrohej çdo gjë para kohe, pa arrirë të hakmerrej kundër atyre që e kishin sjellë në këtë situatë. Ishte fat që ai, para xha Himës, nuk ishte Fer Gjergjlekaj, por Besimi, kurse para organeve zvicerane ishte Mal Dalani. E ç’lidhje kishte ky njoftim me të në këtë mes? Asgjë!

Si për inat, nuk e gjente se nuk e gjente Belin. Sa e sa herë e kishte thirr në telefonin mobil, duke i lënë edhe porosi, por ai nuk ishte ndier fare. Nuk la vend pa e kërkuar. Nuk ishte askund. Sikur ta kishte lëshuar

toka. E kërkoi edhe në një lokal serb, që disa herë e kishte gjetur aty. Bile, Besimi hyri aty me ndrojtje. Më në fund e la. Vendosi të kthehej e të pushonte në banesën e Kolit. Tamam kur kishte marrë fund kërkimi, fare pa prituri u takua me të në trotuarin e gjerë të rrugës kryesore, në çastin kur Besimi ishte duke shkuar në drejtim të parkut të madh të qytetit, ku e kishte të parkuar veturën. Beli ishte duke ardhur nga ana e kundërt. Pasi u përqaftuan si miq të vjetër, Besimi i tregoi se çfarë i kishte ndodhur dhe planet për të ardhmen.

“Jo, tani!” – tha Beli, duke e ledhatuar lehtë mbi shpatull me dashamirësi. – „Kam instruksione të reja. Do t’i marrim edhe disa aksione të përbashkëta dhe, në fund, edhe unë do të të ndihmoj në planin tënd. Ne jemi ortakë të vjetër dhe unë do t’i kompensoj disa nga humbjet tua. Më beso se edhe unë kam qenë në këtë mendje, por nuk kam pasur guxim të të tregoj, kurse tani ne do të jemi të pandarë.”

Nga ngazëllimi i doli një psherëtimë.

Muzgu i mbrëmjes kishte filluar të afrohej. Ishte i rraskapitur. Pas takimit me Belin, e ndiente veten pak më të qetë. I vetmuar, mori rrugën drejt liqenit. Shëtiste qetë-qetë, i humbur në mesin e asaj turme spontane, që e rrethonte dhe që në pamje të parë i dukej e pabrenga. Në këtë shëtitje ai gjente një lloj qetësie shpirtërore dhe me veten e tij thurte plane. Besimi nuk e kishte dashur kurrë vetminë, por sa herë që kishte pasur tronditje të mëdha si kjo e fundit, kishte ndier nevojë të domosdoshme që të rrinte vetëm. Bile në një rast mjeku e kishte këshilluar që, në rast të krizave të thella shpirtërore, është e rekomandueshme të shëtitet i

vetmuar në ndonjë mal, ku do të kishte mundësi të fliste me zë të lartë dhe mllefin e grumbulluar ta shfrynte, sikur të ishte duke ia thënë të gjitha troç atij që e kishte mllefosur.

Edhe kësaj radhe Besimit nuk i bënte ndonjë përshtypje sipërfaqja e valëzuar e liqenit. As për pulëbardhat nuk kishte ndonjë simpati. Ai me veten e tij thurte plane, duke tundur duart dhe dukej sikur ishte duke folur me dikë. As zhurmën e makinave nuk e dëgjonte më.

Ishte i humbur në botën e tij.

## VI

Pasi e lidhi kravatën ushtarake, një copë herë u mor me rregullimin e jakës së këmishës dhe pastaj u afrua edhe më pranë pasqyrës, duke shikuar fytyrën e vet të lëmuar. Për një çast ju bë se në anën e kundërt të pasqyrës pa fytyrën e asaj vajze mitare, me ato vetullat kaleshe dhe me lotët si pika vese që kishin mbetur të varur në cepat syve të kaltër, si qielli pa re. I trembur, u largua një hap prapa, duke tundur kryet për ta bindur veten se nuk ishte në ëndërr. Kishte shumë kohë që ajo pamje nuk i shqitej nga mendja, duke e trazuar në çdo kohë. Ishte i sigurt se atë ditë, ajo vajzë kishte dashur t'i thoshte diç, këtë e kishte kuptuar nga shikimi i saj. U largua nga pasqyra, duke dashur që edhe ato mendime t'i hiqte nga mendja. Me dorën e majtë i ra lehtë faqes, duke e tërhequr nga poshtë lartë për të vërtetuar se ishte rruar bukur, ashtu siç e donte nderi ushtarak.

Jashtë bënte ngricë. Të ftohtit ju duk se për një çast ia preu si me brisk faqet e lëmuara dhe sikur donte të mbrohej nga ajo prerje, e mbuloj fytyrën me duar.

Qyteti dukej i përgjumur. Në rrugë nuk kishte shumë njerëz. Rrallë, tek-tuk, shihej ndonjë kalimtar i rastit. Sa më afër që i afrohej qendrës së qytetit, aq më tepër shtoheshin lëvizjet e njerëzve. Dritat e neo-

nit ishin akoma të ndezura. Mbi asfaltin e rrugës shihet qartë shtresa e hollë e akullit, që kishte zënë gjatë natës. Poshtë, te kryqëzimi i rrugës, pa kur rrëshqiti dhe u rrëzua një grua e trashë. Ajo u ngrit ngadalë, duke pëshpëritur diçka por, ishte larg dhe nuk u dëgjua se çfarë tha. Në një rast tjetër, Gorani do të shkulej se qeshuri, por kësaj radhe sikur nuk i doli gazi.

Tani ndodhej përballë Bankës Komerciale. Befas ju kujtua filiala e saj në kryeqytetin provincial, ku muaj më parë vetë kishte marrë pjesë në mbikëqyrjen e shkarkimit dhe deponimit të disa tonelatave droge në bodrumet e saj. Kjo sasi droge mbikëqyrej nga sigurimi shtetëror, kurse transportimi i saj bëhej nga “Tigrat”. Kjo organizatë kishte një rrjetë të gjerë të veprimit në tërë Evropën. Forcimi i saj, dhe i organizatave të tjera si “Shqiponjat e bardha”, “Bereta e kuqe,” “Dora e zezë” e shumë të tjera, kishin bërë që, përveç monopolit të mbikëqyrjes së trafikut të drogave, të armëve, naftës, cigareve, të diktojnë edhe lëvizjet në politikë, duke korruptuar shumë udhëheqës të policisë sekrete, ndoshta edhe urdhërdhënësin e tij, Nebojshën.

Në ndërtesën e ministrisë, fare në hyrje, u paraqit të portieri, duke ia zgjatur letër-ftesën. Ai, pasi e shikoi me dyshim, mori dëgjuesen e telefonit dhe formoi një numër. Foli me zë të ulët, pastaj duke ia zgjatur letrën, i tha të hynte brenda dhe të priste deri në një urdhër të dytë.

Hyri në një dhomë të gjerë dhe u ul në stol. Ashtu kot, psherëtiu.

Pritja në këtë dhomë misterioze Goranit ju duk e gjatë. Skena të llahtarshme i vinin vërdallë në kokë.

Viktima, zjarre, eksplozime, klithje, kujë... këto e mundonin dhe ditën. “Ti çdo gjë mund të jesh, por më se paku serb. Ha, ha, ha!... Ti i përngjanë atij shqiptarit të vogël, ha, ha, ha!...” – i ushtuan në vesh fjalët e Stojanit. Idiot, pederast, mirë ta bëra!... mendoi.

Kishte raste, gjatë netëve kur ishte në gjumë, t'i vinin vërdallë ato viktima. Ato klithnin me zërat e tyre të çjerrë dhe të frikshëm, si kujë grash, si vajë fëmijësh, si mallkim i pleqve që nuk lëviznin dot, si klithje vashash që pamëshirshëm dhunoheshin nga ai vetë dhe shokët e tij. Dhe ato viktima dilnin nga mesi i flakëve të shtëpive që digjeshin, depërtonin nga zjarri, ngriheshin nga prushi, dhe ashtu përvëluese, si gacat, e tërhiqnin zvarrë nëpër tokën e shkruar. Edhe pse ishin të vrara, të gjakosura, me koka të prera, me fytyra të shkallmuara, me flokë të shpupurishura, ato e sulmonin! Provonte të qëllonte me armë, por as armët nuk i bënë punë. Dhe viktimat, me zëra të çjerrë, gjithnjë i afroheshin, kurse shokët e tij, atje tutje, zgërdheshin duke qeshur me tragjedinë e tij dhe, pastaj, ikja bëhej e pashmangshme, e gjatë, e pafund, ndoshta e përjetshme!

Në fundin e korridorit pa një grua që vinte në drejtim të tij. E njohu, ishte sekretarja e Nebojshës. Sa herë vinte në zyrën e tij për konsultime dhe për të marrë urdhra të reja, ajo e shoqëronte.

“Si jeni, zoti Raviq?” - pyeti ajo duke ia zgjatur dorën me respekt.

“Mirë, ju faleminderit! Ju si jeni? ” - u përgjigj Gorani, duke u ngritur në këmbë.

“Mirë. Shkojmë tani?” - tha ajo me zë të butë.



“Shkojmë!” – tha Gorani dhe e ndoqi pas. Kaluan nëpër korridorin e gjatë dhe, pas pak, arritën të dera e zyrës së tij, e cila ishte e veshur me saftjan të zi.

“Si shkojnë punët atje?”

“Jo edhe aq mirë! Po këtu, ka diçka të re?” – pyeti Gorani, duke e shikuar profilin e saj të këndshëm.

„Ç’të them?! Frika nga lufta është dominante. Zyrtarët thonë se presioni ndërkombëtar është shtuar, deri në kërcenim të hapur,“ – tha ajo, duke e shtyrë derën. Për një çast Goranit ju duk aq e rëndë ajo derë e mbështjellë me saftjan të zi, sa që iu bë se gruaja me atë trup të imtë dhe të brishtë nuk do të kishte fuqi kurrë ta shtynte. Por dera u hap lehtë. Ajo hyri brenda.

“Urdhëroni,” – i tha gruaja, duke ia mbajtur derën të hapur.

Pasi ia zgjati dorën, Gorani u ul në kolltukun që ia afroi Nebojshta. Ishte pak i hutuar nga ajo pritje, nga ato lëvizje të tij disi artificiale, që nuk i shkonin fare natyrës së tij. Kishte një nervozë që nuk e fshihte dot. Gorani e vriste mendjen për shkakun e ftesës.

Nebojshta e nisi bisedën ngadalë, duke shikuar herë Goranin, herë një dosje të trashë me ngjyrë të kaltër që e kishte përpara. Mbi kapakun e saj, me germa të mëdha cirilike, shkruante: “Sekret Nr. 09/89 SRS”

“Të huajt na akuzojnë se ne gjoja bëjmë krime mbi popullsinë civile. Si thua ti? Ti je në vendin e ngjarjeve, janë të vërteta këto që thonë ata?” – pyeti Nebojshta me një vështrim të akullt dhe zhbirues njëherit, kurse dorën e mbante mbi dosje, duke lëvizur gishtërinjtë me nervozë. Gorani thartoj buzët, duke e futur trurin në lëvizje, për të gjetur përgjegjen adekuate. Zëri kumbues i

tij, e bëri që sakaq ti shpërvjeltë prapë buzët në gjendjen e mëparshme, duke u liruar nga ajo situata e vësh-tirë dhe njëherësh duke i dhënë të kuptojë se ai nuk e kishte me të, por me veten e tij: – „Natyrisht që nuk janë të vërteta,“ – u përgjigj aty për aty vetë Nebojsja. – „Ne kemi të drejtë ta mbrojmë shtetin tonë dhe lufta jonë bëhet për unifikimin e Serbisë. Këtë ne e kemi arritur me 23 mars të vitit 1989. Tani vetëm i mbrojmë këto vendime. Me Kushtetutën e vitit 1974 vetëm Serbia, nga të gjitha republikat e Federatës Jugosllave, është ndarë arbitrarisht në tri pjesë. Vojvodina dhe Kosova kishin marrë prerogativat ekuivalente të shteteve të pavarura. Ne nuk e kemi shfuqizuar autonomitë e tyre, por i kemi suprimuar prerogativat e shtetit. Kurse tani, ne nuk jemi duke zhvilluar luftë kundër islamit, siç na akuzojnë të huajt, por kundër separatistëve shqiptarë, të cilët në mënyrë të njëanshme e shpallën Kosovën etnikisht të pastër dhe atë zyrtarisht, kur dihet fakti që në krahinë jetojnë me qindra mijëra serb, dhe ata shumë më herët sesa shqiptarët.”

Pasi u shkund pak, sikur donte të gjente atë fillin e bisedës që e kishte ndërprerë, Nebojsja vuri duart mbi syprinën e tryezës dhe vazhdoi të fliste. Gorani e shikoi ngultas në sy. Ishte hera e parë që dalloj një të çarë mbi vetullën e tij të majtë. Vallë, si i kishte ndodhur?...

“...Dhe na quajnë të jashtëkohshëm, por ne nuk jemi të jashtëkohshëm. Ne gjithmonë kemi ecur me kohën...”

Derisa Nebojsja fliste, shikimin e kishte të mbërthyer nën mjekrën e Goranit, tamam në vendin ku duhej të ishte i shënuar numri dymbëdhjetë, sikur ai t’ishte

orë. Gorani u dridh nga ky mendim dhe bëri një lëvizje nga ana e majtë, sikur donte të merrte diçka nga dyshe-meja. Pastaj prapë përqendroi shikimin mbi vetullën e majtë të Nebojshës, pikërisht aty ku ishte shenja e plagës së mbyllur. Ishte i shpërqendruar fare nga ajo se çfarë thoshte Nebojsha. I shihte vetëm buzët e tij pakëz të fryra duke i lëvizur ngadalë, kurse vetullat e tij të trasha, me atë shenjën e plagës mbi, herë uleshin mbi sy, duke krijuar mërrola të frikshme, herë ngriheshin lartë, duke e mbuluar një pjesë të vogël të plagës së mbyllur dhe duke i zgurdulluar sytë mnershëm.

„...Kurse ata, pasi i kanë mbushur xhepat plot me miliona marka dhe dollarë në mënyrë jo legjitime, dhe për shkak të divergjencave të theksuara politike mes nesh, me kërcënojnë mua dhe të urrejnjë ty...”

“Si?... kush?... pse të me urrejnjë mua?” - i dolën këto fjalë shpotitëse Goranit, sikur të kishin dalë nga një zgavër druri, siç del rrembyeshëm një zog nga pyl-li.

“Për shkak të prejardhjes tënde, pra! Pastaj, për shkak se ti ke vrarë paramilitarë dhe nuk ke dhënë asnjë përgjegjësi. Ata e dinë se këtë mbrojtje e ke nga unë, ndaj ata me urrejnjë edhe mua. Këtë ata nuk e thonë haptas, por veprojnë prapa krahëve tanë, duke i rrembyer paratë tona dhe duke na kërcënuar me vrasje.”

Gorani mbeti i nemitur. Ishte hera e parë që flitej kaq hapur për prejardhjen e tij dhe kjo vinte nga një zyrtar i lartë, që deri në ato momente kishte pasur një konsideratë të jashtëzakonshme për të. Deshi të insistonte të dinte më tepër për prejardhjen e tij, por nuk kishte fuqi ta bënte një pyetje të tillë. Mendja i shkoi sakaq

të Misha dhe fjalët e tij për ngjashmërinë me atë çunin shqiptar, pastaj fjalët: „Ti ç’do gjë mund të jesh, por më së paku serb!“ Një lloj frike se ndoshta prindërit e tij, rastësisht, mund të ishin shqiptarë, ndoshta ai është... o Zot! Me kokë të mbufatur nga gjithfarëlloj mendimesh, si një ëndërr e keqe, iu kujtua takimi i parë që kishte pasur me Nebojshën dhe dy dosjet e hapura para tij. Ndoshta... po arkivi sekret atje në jetimore, ç’fsheh?

“...Jemi në prag të luftës,“ - vazhdoi Nebojsha. – „Siç e dimë, lufta është vrastare. Lufta gëlltit shumë njerëz. Por dyfishi i gëlltitjeve të këtyre njerëzve behët kur në luftë ka tradhti. Kjo është esenca. Tradhtia është në mesin tonë, ajo na vret, na poshtëron, na plaçkit, na dhunon dhe humbja është e tmerrshme! Ndaj, ne duhet t’i luftojmë ata. Duhet t’i luftojmë njësoj sikur i luftojmë edhe armiqtë tonë të jashtëm, sepse edhe këta janë njësoj armiq, por këta janë armiq të brendshëm dhe shumë më të rrezikshëm se sa të jashtëmit. Për armiqtë e jashtëm je në dijeni dhe përgatitësh për luftë kundër tyre, kurse për këta të brendshmit nuk e di dhe natyrisht se pason humbja, gjë që ne nuk e dëshirojmë. Prandaj, të kam ftuar ty të me ndihmosh në këtë punë kaq të rëndë dhe delikate!”

“Mua?!” – pyeti Gorani, pa e fshehur dot habinë.

“Po, po, pikërisht ty. Ti tani e tutje do të punosh në një dikaster tjetër. Atje nuk do të kesh punë me shqiptarët, me ushtarakët, me policinë, do të jesh civil. Do të kesh punë vetëm me mua në njërën anë, dhe me vartësit tu, në anën tjetër.“ “Kam frikë se...”

Fjala i mbeti në grykë nga cingërima e telefonit. Nebojsha ngriti lehtë dorën e majtë, që kishte kohë që e

mbante mbi dosje, duke i dhënë shenjë që të ndërpriste bisedën dhe, në të njëjtën kohë, ngriti dorën e djathtë, duke e marrë receptorin.

“Urdhëro, po... erdha!” – dhe me lëvizje të shpejtë lëshoi vullshëm receptorin mbi aparat. – „Më fal, por duhet të të lë vetëm për disa çaste,“ – tha ai dhe me të shpejtë doli nga dera, andej ku ishte e ndara e sekretares së tij.

Vështrimi i Goranit mbeti i ngulitur mbi dosje. Zgjati dorën dhe e tërhoqi. Ishte e hapur dhe, pasi i kishte picërruar sytë mbi geramat, ai lexoi me zë të ulët. Me një lëvizje të shpejtë, nga xhepi nxori një bllok të vogël dhe shënoi diç në të, duke e shikuar herë dosjen herë bllokun. Pastaj e largoi tutje, duke e futur bllokun në xhepin e xhaketës ushtarake, nga e kishte nxjerrë pak më parë. Dera u hap furishëm dhe Nebojska u gjend në zyrën e tij. Gorani, në shenjë respekti, u ngrit në këmbë.

“Ku e lamë? Po... Pra, ngjarjet do t’i shikosh nga distanca. E merr me mend, në podrumet e Bankës Komerciale në kryeqytetin provincial? Aty është baza juaj e ardhshme. Por, para se të fillosh detyrën e re, ke edhe një punë të vogël. Ma merr mendja se e ke të qartë. Pak më parë të thashë se janë disa që me kërcënojnë mua dhe të urrejnë ty. Ai që i ka mbështjellë të gjitha punët tona është Babiq. E di që ti nuk do të besosh, por unë kam prova të mjaftueshme dhe, që të mos keqkuptohemi, unë do t’i komunikoj të gjitha me radhë, pa pasur frikë se po zbuloj ndonjë sekret shtetëror.”

Dosjen me ngjyrë të kaltër, që ndodhej pranë tij, e tërhoqi nga vetja dhe filloi së shfletuari. Pasi kërkoi një

grimë herë, nxori një letër nga dosja.

“Ja njëra!” - dhe ia zgjati letrën Goranit, i cili e mori në dorë dhe filloj nga leximi. Letra ishte e shkruar me makinë dhe me alfabet latin.

Zürich, korrik 1997, Sekret nr. 07/97ZH: Raport gjysmëvjetor:

Sipas udhëzimeve tuaja dhe sipas raportit të vitit të kaluar, ju njoftojmë se:

Përveç grupit të Schliere-s, që pjesërisht u shkatërrua vitin e kaluar, ne kemi marrë edhe një varg veprimesh të tjera shtesë:

Shkatërrimin e degëve dhe të nëndegëve të njëjtë grup që vepronin në Schafhausen, Lausanne, S.Morritz, Luzern, Bülach dhe disa nëngrupe të tjera të parëndësishme. Me keqardhje ju njoftojmë se në këtë përfshirje nuk ka pasur asnjë drejtues politik të diasporës shqiptare, përveç disa njerëzve naivë, që me punën tonë kemi arrirë t’i infiltrojmë në këtë rrjet, pa dijeninë e tyre. Shkatërrimin e një grupi në rrethinën e Bernës që ne e kishim krijuar më parë, e që kishte filluar t’i rrezikonte interesat tona. Pjesën e shëndoshë të këtij grupi, me ndihmën tonë dhe me pëlqimin e tij, ia kemi dërguar bashkëpunëtorit tonë nr.120. Jemi duke i tërhequr edhe disa grupe të rinjsh shqiptarë, në mesin e të cilëve ka edhe veprimtarë të ashtuquajturave “parti politike” si dhe drejtues klubesh, restorantesh dhe disa biznesmenë të vegjël.

Ju njoftojmë se kohët e fundit kemi pasur vësh-tirësi në furnizim.

Dhe në fund: sipas udhëzimeve tuaja, spiuni nr. 78, pasi i është marrë dërgesa në vlerë valutore në 2 mi-

lionë DM, është kthyer në bazë, por shumë i zhgënjyer. Pres urdhrin tuaj për veprim të mëtutjeshëm.

Me respekt i juaji: 1717.

“E shikon? Kemi pasur vështirësi në furnizim, thotë. Kjo s’është e vërtetë. Këtu ka grabitje, vjedhje. Ne kemi dërguar atje drogë të mjaftueshme, bile shumë më tepër sesa ka qenë porosia. Kurse shuma e parave që përmendet këtu e vërteton këtë,“ – tha Nebojska dhe vazhdoi: - „Kurse ky këtu është një raport i shkruar nga Babiq. Merre dhe lexoje, dhe do të bindësh vetë.”

P. Korrik 1997, Sekret nr. 07/97P. Raport plotësues:

Sipas planit tonë të studiuar mirë, në terren çdo gjë ka shkuar shumë mirë, me përjashtim të disa të papriturave spontane. Gjatë përleshjeve me anëtarët e familjes së bashkëpunëtorit tonë nr.78, të cilët kanë arrirë të me heqin maskën, kështu që mua personalisht me kanë njohur, si dhe Goranin i cili sipas urdhrin tim ka qenë i pamaskuar. Pas kësaj kemi qenë të shtrënguar të marrim aksione shtesë dhe të vrazhda ndaj disa anëtarëve të familjes së tij që, seriozisht e kishin rrezikuar aksionin tonë.

Thesari ndodhet në dorën tonë. Për shumën dhe gjësendet e tjera do t’ju njoftojë në raportin plotësues, porsa t’i kemi bërë depozitimet bankare.

Me nderime, i juaji 242.

“Mua nuk me duhet raport mbi mbarëvajtjen e aksionit, mua me duhet raport për shumat, më kupton? Për shumat! Pastaj, pse Babiqi duhej të vepronte i maskuar, kurse ti i pamaskuar? Këtu ka diçka të dyshimtë. Ja, shikoji raportet e tjera, si atë të janarit, të shkurtit, e

me radhë. Vetëm raporti i gushtit njofton për një shumë të pacaktuar parash, por ai lidhet drejtpërsëdrejti me shumën që e jep raporti nr: 07/97ZH. Kurse, deri tani nuk ka asnjë raport mujor, që është dashur ta dërgonte. Pra, ai, që nga gushti e tutje, punon i rebeluar, pa dhënë asnjë informatë udhëheqjes shtetërore. Ministri i Brendshëm më ka sugjeruar që këto çështje të arsyetohen me shifrën 001. Pra, të mbetët punë e “Tigrave”, gjë që në esencë e kam pranuar. Sesi duhet të veprojmë tutje, ne i kemi duart e lira, ndaj të kam ftuar ty. Pas aksionit, bëhet zhblllokimi i shumave të lartpërmendura. Nëse do të kemi luftë frontale me terroristët shqiptarë, ose do të përballemi me ndonjë agresion të jashtëm, këto parallogariten të humbura, bashkë me pronarët ilegjitimë të tyre, kupton? Si rrjedhojë, të gjitha do të jenë në dorën tonë. I vdekuri nuk flet, nuk dëshmon! Pas krimit, si gjithmonë qëndrojnë shqiptarët. E ke të qartë?

“Po.”

“Planin dhe udhëzimet e tjera do t’i kesh gati së shpejti. Shko tani e çlodhu, deri në një ftesë tjetër.”

“Si urdhëron, zoti Mariq.”

“Mirupafshim.”

“Mirupafshim!” – dhe pasi i shtrëngoi dorën, doli.

I poshtër, tha Nebojsa me vete, porsa Gorani mbylli derën. Idiot. Bir kurve shqiptare. Do t’i lesh kockat si qeni, atje ku ke lindur!

Pas një pauze, i kënaqur ndezi një cigare.

Ishte pasdite janari. Të ftohtit kishte mbështjellë gjithë qytetin. Nga jashtë ndërtesat gri të ministrive



dukeshin sikur të ishin tkurrë dhe kishin humbur befas atë krenarinë e akullt, që e kishin pasur dikur. Kjo, ndoshta, dukej nga të ftohtit. Kurse, brendia e tyre ishte përvëluese, nga tensionet e ngritura politike.

Pas gjithë atyre kërcënimeve, Nebojsa ndiente një rënie të heshtur dhe të tmerrshme karriere. Kjo vinte si rrjedhojë e ngritjeve të shumë njerëzve të papërgjegjshëm në shumë poste kyçe. Ishte logjike që ata urdhrat e tij nuk do t'i zbatonin. Përpjekjet për ngritje në karrierë kishin dështuar, ndaj kishte frikë se rënia kishte filluar. Dhe kjo rënie nuk do të ishte si të tjerat, kjo do t'ishte një rënie fatale, do t'ishte një rënie pa shpresë për ngritje të sërishme, do të ishte ndoshta rënia e fundit... Dhe u tmerrua nga ky mendim, i cili kishte kohë që, në mënyrë tinëzare, ia kishte pushtuar tërë qenien e tij.

Gjatë rrugës për në shtëpi qyteti ju duk më i zbrazët, disi i shkretë. Në rrugë kishte pak lëvizje. Afër një kontejneri pa një plak, që hallakaste diçka, por nuk e dalloi se a ishte duke hedhur, apo duke kërkuar diç. Vutura kaloi pranë kafenesë se pensionistëve. Nga jashtë, prapa xhamave të lagur dhe vende-vende të avullt, arriti të shihte në brendi një tollovi të vërtetë. Të ftohtët i ka bashkuar në këtë kafene. Ndoshta në shtëpitë e tyre nuk kanë ngrohje të mjaftueshme, ndoshta nuk kanë as bukë. Ata s'kishin marrë pensione me muaj të tërë. Thuhej se çdo ditë nga ura e madhe hidheshin në lumë një apo dy të tillë. Në shpirt ndjeu një dëshpërim, sepse edhe vet ishte në rrugën e pa kthim të pensionimit. U dridh i tëri, kur e mendoi veten plak pensionist, duke zvarritur këmbët drejt urës për t'u mbytur në lumë... Ja

edhe ura tragjike... Të këmbët gjigante të urës pa një grumbull të rinjsh të droguar. Në mesin e tyre dalloi edhe shumë vajza të reja, me flokë të ngjyrosura në të kuqe, të verdhë apo të gjelbër, kurse djemtë me flokë të gjata dhe më koka gjysmë të rruara. Këtu ka politoksikomanë, shanky, penner, panker... ah rinia jonë!... këtë drej droge është dashur t'ua shpërndajmë falas të rinjëve shqiptarë e pastaj nuk do të kishim më nevojë...

“Gospodin Markoviq, gospodin Markoviq!” – ia preu mendimet një zë që vinte nga jashtë, andej nga trotuari, ku vetura qëndronte e ndaluar në semafor.

Ktheu kokën ngadalë, duke menduar se tani do t'i ndodhë diçka e tmerrshme. Drej o punë, mendoj me vete.

“Me fal për shqetësimin...” – vazhdoj zëri i mëparshëm, duke ju drejtuar dikujt që akoma nuk kishte mundur ta pikaste së kush ishte. Një burrë, që ishte duke ecur fare pranë veturës dhe prandaj Nebojsa nuk ia shihte dot fytyrën, ndaloi duke u kthyer prapa duke nxjerrë dorën nga xhepi. Nebojsa ndjeu një ngazëllim, kur pa dorën e tij bosh të zgjatej drejt dikujt. Dyshimi i frikshëm se nga ai xhep i mallkuar mund të dilte ndonjë armë, sakaq u fashit. Por, megjithatë, me një lëvizje të shpejtë dore, ai mbylli xhamin e veturës.

Për një çast Nebojsa pati përshtypjen se kalimtarët e rastit e kishin njohur. Ju bë se dikush e shikonte me vërejtje, kurse një burrë me mjekër të thinjur, me buzëqeshje dashamirëse, e përshëndeti kur po kalonte bri veturës. Uli kokën më tepër dhe në vend që t'ia kthente përshëndetjen me një lëvizje koke siç bënte

zakonisht, shau me vete që vetura nuk po lëvizte nga vendi. Por, në çast, ajo lëvizi drejt urës së tmerrshme (sesi i erdhi ky emërtim i rastit për urën) dhe u zhduk në mesin e automobilave të tjerë, në rrugën e gjerë.

E ndiente veten të lodhur. Së pari zgjodhi një muzikë klasike dhe e lëshoi manjetofonin, pastaj u shtri në kanape. Pa dashje, sytë i shkuan të ora e madhe e murit. Ishte një orë e bukur, që e kishte blerë gjatë një udhëtimit zyrtarë në Moskë. Për një çast u ndie i lumtur, se ajo orë tregonte kohën jashtë orarit zyrtar. Sikur e njëjta orë të ishte e varur në murin e zyrës së tij, me siguri se do të tregonte kohën zyrtare, kohën politike të ngurtësuar, ashtu sikur ngurtësoheshin edhe ngjarjet politike. Koha jashtë zyrës është kohë civile. Ajo lëvizë bashkë me ngjarjet, duke ua lënë vendin njëra-tjetrës. Kurse koha politike ngurtësohet në një ngjarje dhe pastaj si akrepat e një ore të prishur qëndrojnë në të njëjtin vend. Ata prapë mund të lëvizin, por vetëm në mënyrë mekanike. Me duket se edhe akrepat e kohës sonë politike tani lëvizin vetëm në mënyrë mekanike. Orë e prishur, mendoj duke i mbyllur sytë.

...Dhe iu bë se ishte i lodhur, jo vetëm nga puna, por edhe nga kërkimi i ushqimit në kontejnerët e mbushur plot me mbeturina të ngrira nga acari. Pasi nuk kishte gjetur asgjë për të ngrënë, i dëshpëruar, kishte shkuar të ura e tmerrshme. Aty ishte ndalur mbi harkun gjigant dhe ishte hedhur në lumë... Përpiquej të lëvizte, por nuk lëvizte dot. As zëri nuk i dilte. I llahtaritur, i hapi sytë. Ishte djersitur nga tmerri.

\*

“Sa kohë nevojitën për kopjimin e këtyre çelësave?” – pyeti Gorani.

“Të gjithë i do? Ah, jo, të lutem! Këtë çelës nuk guxoj ta kopjoj pa pasur vërtetimin e pronarit, ky është çelës i mbrojtur nga shteti!”

“Edhe unë jam i mbrojtur nga shteti!” – tha Gorani, duke i treguar lejen speciale.

“Aha, brenda një ore i ke të gatshëm.”

“Mirë, do të pres këtu, derisa t’i kopjosh.”

“Kopjimi i çelësave behët për shumë arsye. Këtë e di unë. Dikush i bën për t’i pasur rezervë, dikush tjetër këtë e bën për të vjedhur, kurse njerëzit si ju, zotrote, i bëjnë për çështje të sigurimit shtetëror. Edhe çelësin e veturës e do?” – pyeti ai duke e shikuar Goranin ngul-tas në sy.

“Të thashë, të gjithë i dual!”

“Do t’i bëj, mor djalë, do t’i shkrij fare. Këtë zanat e kam që tridhjetë e pesë vjet. Eh, sa lloje çelësash kam kopjuar unë, ti nuk do ta besosh, por ta them unë: Çelësa bankash kam kopjuar, çelësa të kasafortave të ministrive, çelësa ushtarakësh, të detektivëve, të spi-unëve, të hoteleve, të kafeneve, të shtëpive publike, pastaj çelësa burgu, çelësa të dhomave të fjetjes, kur m’i sillnin vajzat apo nuset e reja për t’ua dhuruar, pastaj dashnorëve të tyre...ha, ha, ha!... eh, sa të lehtë me dukeshin ata çelësa, si era të lehtë me dukeshin, si fladi i pranverës, bile nganjëherë i pyesja se kujt do t’ua dhuronin dhe ato shkuleshin së qeshuri... por tani kanë ardhur kohë të vështira. Po ndodhin shumë krime, vjedhje, plaçkitje, vrasje, të them të drejtën po kam frikë nga njerëzit... sidomos nga të rinjtë, kur

më futën këtu në punishten time, si xhind, me flokë të rruara apo të bojatisura... Por, kur po shoh djem si ti, më ngrohet prapë zemra dhe mendoj me veten time se ka akoma njerëz që vërtet do të luftojnë kundër këtyre rrugaçëve!...”

Gorani qëndronte pranë tij në këmbë. I dukej njeri i çuditshëm. Ai, me një shkathtësi të veçantë, edhe punonte edhe fliste, sikur të ishte duke folur me veten e tij. Pasi i përfundoi, Gorani e bëri pagesën dhe doli.

Në rrugë kishte filluar të errej. Dritat e neonit ishin të ndezura. Të ftohtit e kishte shtrënguar edhe më. Pellgjet e mbushur me ujë kishin ngrirë krejt. Krongjij akujsh qëndronin të varur në strehët e shtëpive. Në rrugët periferike nuk kishte drita. Për të arritur më shpejt në banesën e tij, Gorani kishte zgjedhur rrugët e errëta dhe të shkreta të lagjeve periferike të qytetit.

\*

Ndërtesa ishte hijerëndë dhe e ftohtë. Dukej sikur ishte e tkurrur dhe e lodhur nga pesha e viteve dhe e dimrit të akullt. Që larg Gorani vërejti se dritaret e sallës së madhe ishin të gjitha të mbyllura. Si hije rrëshqiti fare pranë dritareve të dhomës së dezurnit, e cila ishte e ndriçuar. Si zakonisht, dritaret e podrumit të lavatriçeve ishin të hapura. Eh, sa herë kishte ikur nga ato dritare dhe, pasi kishte kaluar pjesën më të madhe të natës nëpër “disco” të qytetit, ishte kthyer me të gdhirë dhe prapë ishte futur brenda, pa u diktuar fare. Edhe kësaj radhe e përdori të njëjtën taktikë, por nuk shkoi drejt ish dhomës së tij të gjumit, por drejt arkivit qendror dhe, sakaq, me çelësat që i kishte në dorë, e

hapi derën, duke u gjendur në brendi të arkivit. Pasi e njihte në detaje edhe radhitjen e dosjeve, ashtu në atë gjysmerrësirë, ai e gjeti dosjen e tij. U afrua pranë dritares dhe, në dritën që vinte nga neoni i rrugës, arriti t'i gjente të dhënat e amzës dhe një certifikatë të lindjes, të cilën e mori me vete.

Në korridor ishte errësirë dhe qetësi. Për të kaluar deri në arkivin sekret, duhej medoemos të kalonte pranë derës së dezurnit. Edhe pse përpiqej të ecte sa më lehtë, prapë se prapë çizmet e tij të rënda nuk i bindeshin. Për një çast ia mori vetes inat që nuk kishte mbathur diçka më të lehtë. I kërrusur dhe në maje të gishtërinjve, kishte arritur pranë derës së arkivit sekret. Zemra i rrihte fuqishëm. Kishte një parandjenjë të keqe. Sikur të ishte diçka e mirë, ata nuk do ta krijonin fare edhe një arkiv sekret, krahas arkivit qendror. Si për inat, as duart nuk i bindeshin. Mezi arriti të gjente çelësin për ta hapur derën. Pas një përpjekje të gjatë, dera më në fund u hap, duke lëshuar një ngëëerrrrc të zgjatur. Ju bë se ishte aq e fortë jehona e saj, sa që nga çasti në çast priste të dëgjoheshin hapat e dezurnit në korridor. Pasi kishte ndaluar për disa çaste, duke pritur se mos do të kishte ndonjë reagim, e shtyu derën dhe prapë ajo ngërrc e zgjatur.

Pasi hyri brenda, për t'u siguruar, e mbylli derën me çelës dhe e hapi dritaren, që në rast nevoje të hidhej jashtë. Pastaj filloi nga kontrolli. Arkivi ishte i madh. Kishte shumë dosje të vendosura nëpër rafte. Në fillim u përpoq që në atë mugëtirë ta gjente raftin me shkronjën "R" sipëri, por ishte e pamundur t'i dallonte shkronjat, ndaj e përdori llambën e xhepit. Drita e llambës lëvizte

ngadalë mbi germat. Ja germa “R”, tha me të pëshpëritur, pastaj “Ra”, “Rad”, “Ras”, derisa e gjeti “Rav”. Raviq Darko, Raviq Stefan, Raviq Goran, ja kjo është, tha me vete dhe zemra ia bëri tak. Çfarë do të dalë nga ajo dosje e tmerrshme si vdekja? Llambën e xhepit e futi në gojë, për t’i pasur duart e lira dhe filloj nga shfletimi. E hapi dosjen ngadalë, sikur të kishte frikë se ajo vërtetë ishte kutia e padorës dhe, posa të hapej, do t’i nxirrte në sipërfaqe të gjitha të këqijat e botës.

Në ballë të dosjes me germa të mëdha shkruante Raviq Goran, pastaj në brendi gjeti të shkruar në formë certifikate:

„Raviq Goran, i lindur me 9. 08. 1975 në fshatin Eshkë, Kosovë, nga nëna Besa Kamberi, e lindur me 17. 05. 1960 dhe babai Ker Ademkurti, i lindur me 21. 11. 1956.“

“O Zot!... po çmendëm!...” dhe për një çast ju bë se dëgjoi një gjëmë të llahtarshme, një dridhje të rafeteve, rënie të dosjeve në dysheme, thyerje xhamash... dhe ashtu, i mpakur, vuri duart mbi fytyrë për të mos parë e dëgjuar kataklizmin! Pastaj, me sy të zgurdulluar, u përpoq të gjente një shteg për t’u larguar nga ajo rrëmujë, nga ai tërmet dhe... pasi hapi sytë, e kuptoi se jashtë qenies së tij nuk kishte ndodhur asgjë! Çdo gjë ishte në vendin e vet. Dollapët, dosjet të renditura dhe të heshtura, dritaret, xhamat... Rrëmuja, tërmeti, kataklizmi kishte ndodhur në shpirtin tij... U hap kutia e Padorës, mendoi. O zot, ç’kam bërë!... dhe sytë i përqendroi prapë në fletën e bardhë, që e mbante në dorë, duke vazhduar leximin:

„I pa pagëzuar nga prindërit. I lindur jashtë

martese. Për t'iu shmangur problemeve familjare, me pëlqimin e të dy prindërve, bëhet adoptimi i tij në jetimore. Pas adoptimit, kompetecat për të i takojnë jetimores.“

Në faqen tjetër gjeti të shkruar:

„17. 02. 1979. bëhet kërkesa e parë nga prindërit legjitimë të tij për kthimin e fëmijës. Drejtorati i jetimores e hedh poshtë kërkesën si të papabazë.“

“O Zot, nënshkrimi i Sllavicës!... ajo i ditka të gjitha...”

Kurse në faqen pasuese vazhdonte:

„Me 23. 08. 1984 parashtrohet kërkesa e dytë nga prindërit e tij legjitimë për rikthimin e Goranit në gjirin familjar. Kërkesa hidhet poshtë si pa bazë juridike nga ana e drejtorisë së jetimores.“

“Prapë nënshkrimi i saj!...”

Pasi e mori pak veten, vazhdoi hulumtimin në dosje. Gjeti edhe disa shënime të parëndësishme. Fare në fund pa edhe një letër:

Shkurt 1989.

Avokati Pavleviq Dragoljub, nga Fushë-Kosova, me autorizimin e prindërve legjitimë të Raviq Goran, shtron kërkesën për informata të plota për fëmijën e tyre që me datë 9. 08. 1975, me pëlqimin e tyre, është bërë adoptimi në jetimore.

Për shkak të situatës momentale politike, drejtoria e sheh të arsyeshme që për momentin mos të japë asnjë informacion lidhur me rastin e lartshënuar...”

Pasi i palosi me kujdes të gjitha fletët që ndodheshin në dosje, i futi në xhepin e xhaketës. Dosjen boshe e la prapë në vendin e vet.



Kishte kohë që në shpirt i kishte të ndara dy botë. Njëra ishte bota e përditshme, bota e qartë, e prekshme, e kapshme, konkrete... dhe, në anën tjetër, ishte bota e panjohur abstrakte, e mistershme. Ishte një botë e mugët në fillim, dhe pastaj e errët si nata! Edhe pse kishte pasur një dëshirë për ta njohur atë botë, fillet e së cilës nuk kishin qenë të largëta nga qenia e tij fizike (në të njëjtën ndërtesë), se kishte njohur dot. Ajo botë ishte mbajtur e fshehur. Nuk e kishte akoma të qartë pse ishte dashur të mbahej e fshehur prejardhja e tij dhe e të gjithë atyre që ishin të radhitura nëpër raftet e arkivit sekret. Prania e shumë dosjeve tregonte qartë se çdo dosje kishte në vete një mister që individi, të cilit i takonte ajo, nuk e dinte. Pa dashur, iu kujtuan shumë moshatarë të tij, që pas shumë vitesh e kishin njohur familjen, nënën apo babin, vëllezërit e motrat dhe shumë prej tyre ishin kthyer përgjithmonë në gjirin familjar. Ata i kishin shkruar pastaj, duke i treguar për dashurinë e nënës, për ngrohtësinë e saj, për dorën e saj të lehtë dhe ledhatuese. Ah, sa do të dëshironte që të paktën një herë ta përjetonte atë dorë të lehtë, atë ledhatim, atë dashuri nëne! Dhe do ta kishte përjetuar atë dorë, atë ledhatim nëne, atë dashuri prindërore, atë ndodhje në mesin e motrave dhe të vëllezërve sikur mamaja... (ç'mama ore, shtriga, thuaj), t'i kishte pranuar kërkesat e prindërve të mi. Ata më kanë dashur. Ata më kanë kërkuar. Ata kanë angazhuar edhe avokat!...ata me donë mua!... kurse unë?! Do t'i gjej... nëse nuk i kam vrrarë vetë!... Ndoshta avokati e di?

Tani kishte një lehtësim në shpirt. Nuk jetonte më në dy botë. Nuk ishte i dyzuar. Ishte i ndarë në një botë

të vetme. Si gjithë njerëzia. Ishte një. Ishte shqiptar!

E dinte se ishte i grabitur arbitrarisht. E dinte se ishte rritur dhe edukuar për një qëllim të caktuar dhe një pjesë të jetës ia kishte kushtuar pikërisht këtij qëllim - caktimi që ishte prerë dhe farkuar nga dikush tjetër dhe pa dijen e tij. Se a kishte kohë akoma për rishqyrtrimin e këtij qëllim-caktimi, mbetej të shihej.

Kishte ardhur koha të mendonte, të planifikonte dhe të vepronte ashtu siç ishte në të vërtetë, i pavarur, si shqiptar!

\*

Kupetë ishin të mbushura plot me pasagjerë. Edhe korridoret nuk ishin më të lira se sa kupetë. U mbështet pranë dritares dhe, me shikimin e humbur diku jashtë, priste i heshtur derisa të nisej treni. Vërshëllima e trenit ishte sinjal i nisjes. Mori frymë thellë dhe ndezi një cigare. Ashtu siç rritej shpejtësia e trenit, rritej edhe rrapëllima e hekurt e vagonëve.

Pasagjerët bisedonin me njëri-tjetrin. Nga ana e majtë dëgjoji dikë duke sharë. Ishte një burrë i trashë, me një hundë të madhe, që i kishte dalë si gungë sipëri mustaqeve. Fliste më zë të lartë dhe vazhdonte të shante. Disa herë tentoi të hapte derën e një kupeje, por një grua që ishte pranë tij nuk e lejonte duke e tërhequr me gjithë fuqinë nga dora. Ajo i fliste diç të veshi në formë të pëshpërimës dhe pastaj ai sikur qetësohej. Por sa dukej se i ranë nervat, ai prapë merrte zjarr. Të sharat ishin të rënda. Në fund u dëgjua duke sharë nënën shqiptare. Gorani e mori me mend se ai ishte i inatosur me dikë që ndodhej në atë kupe dhe sigurisht se ai duhet të ishte

shqiptar. Pa humbur kohë, u afrua pranë burrit.

“Ç’ke që shanë?” – pyeti Gorani

“Si, ç’kam?! Dua të ulem aty!” – dhe tregoi me gisht nga kupeja. Gorani zgjati pak kokën dhe pa në brendi. Ishte një burrë, një grua dhe katër fëmijë të rritur.

“E sheh? Nuk paska vend të lirë!” – ia priti Gorani.

“Ata le të çohen dhe të dalin menjëherë jashtë, janë shqiptar! Unë dua të ulëm. Por ç’ti bëj që s’po me le gruaja, se ua kisha treguar vendin atyre unë, për dritare i kisha nxjerrë jashtë!”

“Mos i nga më!” – tha Gorani prerë dhe mospërfillës.

“Kush je ti që me urdhëron mua? Shikoje ti punën tënde! Edhe ata menjëherë duhet të dalin jashtë!” – dhe me të shpejt hapi derën e kupesë, duke iu drejtuar atyre i nxehur, me fytyrë të skuqur nga inati: – „Hej! ju shiftari, dilni jashtë menjëherë!”

“Të thashë, mos i nga më!” – tha Gorani me inat, duke e shtrënguar për jakët e këmishës. – „Të urdhëroi ta mbyllësh menjëherë gojën, sa s’ti hodha trutë n’erë, a more vesh?” – Dhe, porsa burri deshi të fliste diçka, Gorani e ndërpreu duke i thënë me kërcënim: - „Mora vesh thuaj!” - dhe me inat e shtyu tutje.

“Kush je ti? Je serb apo shqiptar? Përse i mbron?” - tha ai tani, me një ton lutës dhe përlulës bashkë.

“Shqiptar jam!” - dhe nga xhepi nxori lejen speciale, duke ia afruar të hunda. Ai, sikur ishte duke folur vet me veti lexoi emrin, pastaj me sy të zgurdulluar e shikoi Goranin. - „Mos i nga më, për herë të fundit të

thashë!”

Burri iku duke e tërhequr pas vetës një thes. Pasi e mbështeti thesin në një skaj që ishte pak më i lirë, pa bërë zë, u ul. Nxori nga xhepi kutinë dhe nderzi një cigare. Herë pas here ia hidhte vështrimin tinëzisht Goranit. Gruaja i qëndronte pranë.

Gorani nuk lëvizi nga dera e kupesë, ku ishin të ulur shqiptarët. Kishte një dëshirë të ishte i ulur pranë tyre dhe të bisedonte me ta, por nuk kishte vend të lirë dhe ata as nuk e qasnin. Ishte hera e parë në jetë që ishte në anën e shqiptarëve. Për një çast i erdhi mirë që e kishte atë zotësi t’ju ndihmonte. Sikur ta kishte ditur që nga fillimi që ishte shqiptar, sigurisht që do të kishte vepruar ndryshe.

Pas disa ndaljeve, treni filloj të lirohej. Burri, që pak më parë kishte bërë zhurmë, kishte zbritur. Korridor i ishte liruar thuaja krejt. Qëndronte i ulur në një gjysmë karrige rezervë, që ndodhej e ngjitur në të ndarën në mes të dy kupeve. Mendimet i vinin të ndërprera. Copa bisedash, pjesë urdhrash, certifikata të lindjes, avokatë që gjurmonin, vula, nënshkrime...

I mbështetur, kishte filluar të kotej. Iu bë se e gjeti shtëpinë e tij. Ishte një plak i thinjur, që i thoshte se kjo është një kolibe e vogël, por është shtëpia ku ke lindur ti! E sheh? Dhe Gorani ktheu kokën, duke parë një fushë të gjerë dhe të mbushur me lule të kuqe e të bardha bashkë. Fare pranë tij ishte një shtëpi e vogël, shumë e vogël sa që filloi të çuditej se si ishte e mundur të hynte njeriu në këtë shtëpi, kur nuk kishte vend as për një mace. Pastaj, në anën tjetër pa një lumë me ujë të pastër dhe një urë të vjetër. Kishte urdhër ta ka-

lonte atë dhe të dilte në anën tjetër. Nuk ia kishte besën asaj ure, sepse ajo ishte gati për t'u rrëzuar. Sakaq u gjend në ujë. Dukej se ishte ujë i qetë, por pasi ra në të, iu bë se shkonte rrëmbyeshëm. Kërkonte ndihmë, duke e zgjatur dorën. Se nga doli një grua dhe ia zgjati dorën. E tërhoqi në breg. Ajo i fliste shqip. Ia kishte vënë dorën mbi sup dhe, duke e tundur, i fliste shqip. I bëhej se ajo ishte duke e përkundur. Hapi sytë dhe e pa në fytyrë. Ishte fytyra e nënës se tij. E kishte parë edhe herë të tjera. E njihte. Kush me ka thënë se unë nuk e njoh nënën time?... Dhe ajo vazhdonte të fliste shqip, duke buzëqeshur...

Treni lëvizi, duke ia humbur për një çast ekuilibrin. Gorani u mbajt instinktivisht pas karriges ku ishte i ulur, duke hapur sytë. Nga kabina dëgjohej zëri i gruas që fliste shqip. U ngrit dhe shikoi në brendi. Nuk ishte ajo fytyrë e ëndrrës. Ajo fytyrë e ëndrrës duhet të jetë nëna ime! Thonë se edhe ëndrrat tregojnë!

Mëngjesi e zuri në stacionin e provincial. Zbriti me të shpejt nga treni dhe mori një taksì. Pasi ia dha shoferit adresën, u mbështet për ndenjësën e pasme, duke shikuar nga rruga. Koka i ushtonte akoma nga rrapëllima e trenit. Akoma nuk ishte rehatuar mirë, kur vetura ndaloj pranë një dere. Shoferi i tregoj se kjo ishte adresa.

“Me prit derisa të mbaroj punë!” – i tha Gorani shoferit. Ai pohoi me kokë.

Zbriti nga vetura dhe sakaq u gjend në një zyre. Një burrë i imtë, me kokë tullace, me një palë syze të varura në maje të hundës rrinte i qetë, duke shfletuar disa letra. Kur pa se u hap dera, ai ngriti sytë nga letrat

që i kishte të shpërndara mbi tavolinë.

“Nuk kam kohë sot, të lutëm eja nesër!”

“Si? Nesër? Me fal, por unë kam disa pyetje të shkurtra. Nuk do t’u marr shumë kohë. Jeni ju avokati Pavleviq Dragoljub?” – pyeti Gorani.

“Po, unë jam.”

“Në vitin 1989 ju keni pasur një palë për t’iu ndihmuar për gjetjen e fëmijës së tyre? Ju kujtohet kjo?”

“Do ta kontrolloj arkivin tim dhe do ta gjej, ndaj të lutëm eja nesër... ah jo nesër se jam i zënë, eja, eja...”

“Jo nesër, as pasnesër as pas një jave, por sot!” – e ndërpreu Gorani. - „Këtë punë duhet të ma përfundosh sot, dhe atë tani, menjëherë!”

“Unë kërkoj shumë para për raste urgjente!”

“Kërko dosjen një herë, pastaj kërko paratë!” – tha Gorani me ton urdhërues.

“Eja pas një ore dhe çdo gjë do të jetë gati!” – tha avokati, duke u ngritur në këmbë për t’i dhënë shenjë Goranit se vërtet e kishte ndërmend ta gjente dosjen.

”Jo, do t’pres këtu. Nuk kam shumë kohë!”

“Në cilin vit the?”

“Në vitin 1989”

“Mirë, në vitin 1989. A të kujtohet muaji?”

“Po, muaji shkurt.”

“Viti 1989, muaji shkurt, a të kujtohet kush me ka angazhuar dhe për kë?”

“Po, të ka angazhuar Ker Ademkurti dhe Besa Kamberi për të kërkuar Raviq Goran!”

“Aha! Po, po tani po me kujtohet ky rast. Me duket se e kam rregulluar. Përse të duhet?” - pyeti, duke

kontrolluar me duar në raftin e madh. – „Shkurt. Kjo? Jo, s’është. As kjo nuk është. Kjo duhet të jetë! Jo, nuk është as kjo! Ah po, kjo është, e gjeta!“ – Me dosjen në dorë, ai u ul në kolltukun e tij dhe i hapi kapakët e dosjes me ngjyrë hiri. Sakaq i humbi ajo buzëqeshje, që pakë më parë me shpoti i lëvizte nëpër fytyrë. Një lloj tërheqjeje në fjalë, si dhe një shikim zhbirues, e bënë avokatin e imtë e tullac që të tkurrej edhe më nën ngushtimin e sakos se tij të zezë.

“Me falni, zotëri, por, para se të hapi dosjen dua të di se cili jeni ju dhe përse e kërkoni pikërisht këtë dosje?”

“Është kohë lufte dhe mua nuk me pëlqejnë aspak prezantimet. Me një fjalë, është fshehtësi ushtarake.”

“Me vjen keq, por kjo dosje nuk ka përfunduar akoma. Për shkaqe politike në atë kohë unë kam qenë i shtrënguar ta ndërpres hetimin...”

“I njeh ti tani ata njerëz?” – pyeti Gorani

“Besoj se po. Ata kanë ardhur disa herë tek unë. Me kanë paguar mirë, edhe pse unë nuk kam pasur mundësi t’ju ndihmojë më tepër.”

“Mua me duhet dosja!” – tha Gorani, duke e shikuar hutueshëm në sy.

“E kthen prapë?” – pyeti avokati.

“Nuk e di se si do të ndodhë. Unë po e dërgoj në komandë dhe pastaj...” – dhe rrudhi krahët, duke i shtrirë duart përpara, në shenjë shfajësimi.

“Mirë, meqë është puna kështu, merre!” – tha avokati serioz, duke ia zgjatur dosjen.

\*

Fshati Eshkë i tëri ishte i boshatisur. Shtëpitë ishin të djegura, të shembura, krejt gërmadha. Ngado që vështroje, shkretë. Ishte ajo shkreti që gjatë verës vetë Gorani e kishte krijuar, duke e lënë në mes të flakëve, zhurmës e zallahisë. Në qendër të fshatit pa ndërtesën e bukur, në të cilën dhunshëm i kishin mbajtur të mbyllura vajza e nuse të reja shqiptare, të cilat i kishin dhunuar dhe masakruar pamëshirshëm. Qëndroj disa çaste para saj, duke shikuar me përbuzje slloganin e unitetit serb, që me katër „C“ cirilikë formonin „Samo Sloga Srbina Spasava“, që ishte simbol lufte dhe që dikur vetë e kishte shkruar me krenari. I erdhi turp nga vetja e tij për ato krime e masakra që i kishte bërë.

Gorani u sorollat në çdo skaj të fshatit, duke kërkuar ndonjë njeri të gjallë. Asgjë nuk pipëtinte. Nga larg i erdhi si e venitur pallja e një lope dhe pastaj si përgjegje u dëgjuan ca të lehura qenesh. Mbajti vesh andej nga erdhën zërat dhe pa e kuptuar as vetë, mori pikërisht atë drejtim. Afër përroit dalloi një lëvizje. Vrapoi në drejtim të asaj hijeje që i erdhi si vegim dhe kur u afrua buzë lumit, pa një plak. Sakaq u gjend përballë tij. Ishte i lodhur dhe i rraskapitur. Kur e pa Goranin, ai u tremb.

“Si quhesh?” – pyeti Gorani me një zë të butë, që për një çast ju duk se nuk i shkonte fare natyrës së tij.

“Mark.” – tha plaku, duke shikuar me dyshim.

“Ku janë banorët e tjerë të fshatit?”

“Ë!?” - ia bëri plaku, duke i rrudhur krahët me dyshim.

“Fol, mos ke frikë! Unë do të ndihmoj, po pate nevojë!” - tha Gorani me ton lutës.

“Paramilitarët i kanë përzënë, nuk e di se ku



ndodhen tani!” – tha plaku me një mosbesim të përm-bajtur.

“E njeh ti Ker Ademkurtin?” – pyeti pas një heshtje të shkurtër Gorani.

“Po, e njoh,” – u përgjigj plaku, duke shikuar i hutuar.

“Ku ndodhet ai tani?” – pyeti prapë Gorani.

“Nuk e di!” – përgjigj plaku me mospërfillje.

“Ku e ka shtëpinë?”

„Poshtë, nën xhade.“

“Cila është shtëpia e tij?”

“Ja, ajo atje!” - dhe ngriti dorën duke e zgjatur në drejtim të disa shtëpive të shkatërruara, që Gorani nuk e përcaktoi dot se për cilën shtëpi e kishte fjalën plaku.

“S’ e dalloj dot se cila është.”

“Eja me mua,” - tha plaku ende i frikësuar.

Plaku ecte ngadalë, duke kërkuar vend të përshtatshëm për ta vënë këmbën në mesin e atyre mbeturinave. Ndihej një erë e rëndë shkrumbi.

Gorani e ndiqte pas. Nuk fliste. Fytyra e gruas së ëndrrës i rrinte pezull mbi kokë. I bëhej se ajo i pëshpëriste diç pranë veshit, por nuk e kuptonte. Nga të dyja anët e krahëve i vinin zëra të çakërdisur, si në një episode filmi. Në kujtesë iu shfaqën skena nga ngjarjet e asaj dite. Sa më shumë i afroheshin shtëpisë, aq më tepër i kristalizoheshin ato ngjarje. I bëhej se acoma dëgjonte copa urdhrash, sharje nga ana e tij dhe e shokëve të tij, klithje njerëzish që po largoheshin, vaje fëmijësh dhe krisma armësh, të vrarë, të plagosur, të mbuluar më gjak dhe tërheqja zhagas e atyre që ishin të plagosur, me fuqi të humbura, të molisur... Pastaj,

britma trishtuese të shtazëve që digjeshin të gjalla, të mbyllura nëpër stalla, që kishin marrë flakë. Iu kujtua Stojani, i skuqur deri të veshët nga droga dhe rakia, kur si në prall ja kishte lëshuar në dorë një vajzë të bukur, që gjer aty e kishte tërhequr zvarrë... dhe në atë gjendje ekstaze që i qe dukur një bukuri e shndritshme, vezulluese, si ngjyrat e ylberit. Për një çast u tkurr, kur pa se ishin afruar të vendi që kishte bërë dashuri me të... dashuri me dhunë! Aty për aty i doli përpara fytyra e saj e heshtur dhe ai shikim... O zot! Nuk ishte hera e parë që e kujtonte atë shikim, ata sy të kaltër e kaleshë që e shikonin mëshirshëm...

“Kjo është shtëpia e Kerit,” – tha befas plaku, duke treguar me gisht shtëpinë gjysmë të djegur.

Gorani eci drejt hyrjes. Plaku ndaloi të dera. Kishte frikë. Gorani e ftoi. Plaku nuk lëvizi.

“Të lutem, eja më ndihmo, ndoshta do të gjej ndonjë dokument... apo ndonjë fotografi...”

Plaku nuk foli. Gorani e shikonte ngultas. Çudi që tani ai nuk egërsohej, siç e kishte zakon. E shikoi plakun butësisht, sikur t’i lutej që t’i dilte në ndihmë. Por plaku nuk e kuptonte qëllimin e tij. Frika se, pasi të hynte brenda mureve të shtëpisë, do të ndodhte tmerri nuk i shqitej. Gorani e pikasi këtë mëdyshje të tij. Ai qetë doli nga shtëpia. U afrua pranë plakut dhe me zë të butë e ftoi të hynte brenda.

“Me vraj këtu e mos me fut në shtëpi të huaj,” – tha plaku i vendosur.

“Nuk të vras, jo!” – tha Gorani dhe vazhdoi me një ton të mallëngjyeshëm. – „Kjo është shtëpia ime... është shtëpia e prindërve të mi, me kupton? Unë jam djali i Kerit... jam djali i Besës... e din ti, o plak?”

“Si?” – tha plaku i hutuar. – „Ti?... i biri i Kerit?... ai i humburi? Ai i rrituri diku në jetimore? Ah, more bir, shumë të kanë kërkuar të gjerët! Nëna jote gjithmonë thoshte se nuk mund të vdes pa e gjetur djalin tim!” – fliste plaku, duke u afruar gjithnjë drejt hyrjes.

Në brendi vinte një erë e rëndë shkrumbi. Në skajin e djathtë të dhomës së pritjes ndodhej një tavolinë gjysmë e shkatërruar, kurse fare pranë, në dysheme ishte televizori i përmbysur. Çdo gjë ishte e përmbysur, e hallakatur, e djegur apo gjysmë e djegur. Në murin përballë akoma ishte vitrina e madhe me xhama të thyer. Në brendësi kishin mbetur libra të nxira nga tymi dhe pjesë gazetash, copa xhamash të thyer, tesha të hallakatura si dhe në qoshe, pranë një djepi të boshatisur ndodhej akoma një shishe e mbushur përgjysmë me qumësht, siç dukej e përgatitur për foshnje, por gjatë zallahisë e harruar aty. Gorani, pa humbur kohë filloi t'i hapte dollapët dhe të kontrollonte në brendi. Shihej se ishte i shpejtë në këtë drejtim. Pas pak, me një grumbull letrash dhe fotografish në duar, u kthi nga plaku, i cili vetëm shikonte i hutuar.

“Me thuj, të lutem, cilët janë këta në fotografi?” – pyeti Gorani, pasi ishte afruar fare pranë plakut.

“Këta nuk i njoh. Ndoshte janë miq. Ky këtu është Dreni. Kurse këtu është Dreni me motrën e vet, Shqipen, ndërsa ky këtu është Kujtimi.”

Gorani për një çast u shkëput nga fjalët e plakut. Sytë i kishin mbetur të mbërthyer në një fotografi që plaku e mbante në dorën tjetër. Pa folur, Gorani zgjati dorën dhe e mori fotografinë nga dora e plakut, duke e shikuar nga afër. Nuk fliste. Shikimi i kishte mbetur i

ngrirë. Plaku fliste duke i treguar disa nga fotografitë, që ai i mbante në dorë, por Gorani nuk dëgjonte më. Është e mundur kjo? Ju bë se e thirri një zë nga brenda tij. O zot, sa shumë i përngjan gruas së ëndrrës! Dallimi ishte vetëm se gruaja në ëndërr kishte pasur të hedhur krahëve një pelerinë të bardhë, që i hapej prapa shpinës valëvitshëm dhe flokët i kishte të gjata dhe disi të përflakur, kurse kjo e fotografisë nuk e kishte as pelerinën e hedhur krahëve, as flokët e përflakur...

“Kjo është Besa... kurse ky pranë saj është Keri. Këta poshtë ulur janë fëmijët e tyre.”

Sytë e Goranit u ndalen në shikimin e gëzueshëm të vajzës që ia kishte dhuruar Stojani ditën e djegies së fshatit. Ishin po ata sy që pak më parë e kishte ndier përvëlimin e tyre. Kurse tani iu bë se ata sy, si atëherë, edhe tani kërkonin diç nga ai. Ata sy nuk e shikonin mëshirshëm si dikur. Tani e shikonin gëzueshëm, butësisht dhe me një dashuri... dhe para sysh, si në vegime, pa vajzën që befas rrëshqiti nga fotografia dhe, po me atë buzëqeshje, po me atë shikim, i afrohej duke e shikuar gërmushëm në sy, o zot!... çfarë sysh! mendoi dridhshëm.

“Kjo është Rina,” – tha plaku, duke e shkëputur nga vegimet dhe vazhdoi me ndrojtje. – „E kanë dhunuar paramilitarët dhe e kanë masakruar! Atje tutje e kam varrosur me duart e mia. Çfarë vajze ishte!... për ta pirë në kupë! Unë, në vend të nënës se saj, e kam vajtuar sipas zakonit,” – tha plaku me zë të dridhur dhe lotët i vërshuan faqeve. Edhe Goranit ju mbushën sytë me lot.

Pa folur, mblodhi fotografitë dhe i vendosi në

dosjen të cilën gjatë gjithë kohës e kishte mbajtur në dorë. Me një shikim të përlotur, ia zgjati dorën plakut.

“Nëse mbijeton, falë me shëndet prindërit e mi, motrat e vëllezërit!” - tha me zë të gulçuar, duke ia kthyer krahët plakut.

Dita kishte filluar të thyhej. Gorani, pasi u ulë në ndenjësën e prapë me të automobilin, i tha shoferit që të merrte drejtimin e kryeqytetit provincial. I shkërmoqur në mendje dhe shpirt, u përpoq t'i mbyllë sytë. Nuk kishte më dëshirë të shihte as fushën e përvëluar, as xhadenë boshe, as shtëpitë e djegura.

Edhe nëse shërohet plaga, shenja e saj do të mbetet, mendoi, dhe mendja i shkoi te shenja plagës së mbyllur mbi vetullën e Nebojshës.

\*

Se nga i vinte një shije e hidhur në gojë. Disa herë u mbllaçit, duke i lëpirë buzët dhe, porsa i dukej se iu kishte larguar dhe e harronte, prapë i vinte e njëjta shije e hidhur dhe e thatë. Me mundim arriti të kapërdihej. Kishte etje. Jashtë xhamit të djersitur të autobusit nuk dallonte asgjë. Ishte i lodhur nga bredhjet e ditës. I bëhej se kjo kishte qenë dita më e gjatë në jetën e tij. Kishte harruar fare se kur ishte zgjuar, kur e kishte shijuar atë agim të ftohët dhe të kthjellët dhe pastaj... Ishte e pamundur që të gjitha këto i kishte përjetuar brenda një dite! Me sy të mbyllur dhe nga tundjet e autobusit, si në vegim, iu kujtua kur ishte fëmijë atje në jetimore. I mbyllur prapa atyre mureve të mistershme dhe të frikshme, kur i dëgjonte hapat e rëndë të kujdestares, e cila sorollatej nga reparti në repart, me

shkop në dorë, duke i kërcënuar apo goditur në kokë, herë njërin e herë tjetrin nga fëmijët që guxonin të hapnin derën për të dalë sadopak në korridorin e gjerë, për të lozur. Sa herë e kishte përjetuar atë vërshëllimë të atij shkopi mbi kokë, duke e bërë që të mblidhej grusht para kujdestares. Kishte raste kur ajo e kishte goditur pa mëshirë mbi kokën e tij të rruar. Dhembjet ishin të tmerrshme dhe vaji i tij fëmijëror ishte i heshtur, i dridhshëm, i mjerë dhe i pa mbështetje. Shpirti i tij i vogël kishte ndier një tulatej plot nderim të dhunshëm e të gërshetuar me frikë e nënshtrim ndaj atyre që, përmes shkopit dhe shuplakave, ia thurnin edukatën hyjnore e mitike serbe. Çfarë edukate!...tha me zë të ulët dhe ps-herëtiu me dhembje.

Për të dytën herë bëri përpjekje të mbyllte sytë sadopak. Ndoshta nga lodhja dhe nga të ftohtit e ditës që fare pa e diktuar i kishte arritur deri në palcë, nuk e kishte diktuar këtë lodhje, që tani i ulur në ndenjësën e butë të autobusit dhe nga ngrohja kishte filluar ta ndiente drobiten e trupit. Sa dëshironte të flinte vetëm pak, t'i mbyllte sytë dhe të flinte i qetë, pa brenga, si dikur. Do të pranonte t'ishite fukara por i qetë, i lumtur pa këto brenga, që askush nuk i dinte dhe askujt nuk mund t'ia thoshte. Kishte mbetur si pika e shiut e varur në gjemb. As nuk binte, as nuk qëndronte dot.

Nga çanta e vogël, e cila kishte kohë që iu kishte bërë si shok besnik dhe i pandashëm, nxori dosjen. E shikoi trishtueshëm dhe me duar që i dridheshin e hapi kapakun e saj. I bëhej se një zë nga brenda saj e thërriste, i lutej që ta hapte dhe sikur i thoshte se edhe ti je këtu, në këtë dosje, në mesin tonë... edhe në fotografi

je... pranë nesh! Edhe nëse nuk e gjënë veten në shikimin e parë në fotografi, do ta gjesh pastaj, ja sikur tani, që e gjete veten të shkruar në këtë dosje, ashtu do ta gjesh veten edhe në fotografinë tonë të përbashkët, se edhe ti je aty, tamam sikur në dosje! Shikimin e kishte të mbërthyer në fotografi dhe ashtu iu bë se vërtet ishte duke komunikuar me ta, si të ishin të gjallë. Si një ëndërr e largët iu kujtua ai mëngjes, i cili, sa më shumë që zbardhëshin misteret e dosjeve, aq më tepër i kristalizojë edhe ajo ditë që tinëzisht kishte hyrë në jetën e tij dhe ishte shndërruar në një ditë tmerri, që e kishte shkaktuar vetë: Pasi kisha ngrënë mëngjesin, në zyrën e komandës, kishim filluar të drogoheshim, bashkë me disa shokë të tjerë. Pas drogimit, për disa çaste nuk pashë asgjë. Mu bë se dëgjoja një muzikë. Ato tone të përkryera që larg më vinin si të valëzuara, me ca ritme që nuk i ndaja dot, si muzika e himnit shtetëror, pastaj shndërrohej në tingull të dridhshëm alarmi. Mu bë se ishte duke gdhirë një agim i bukur, plot me drita vezuluese. Pastaj mu bë se rashë në ekstazë. Nuk e di më se sa ka zgjatur kjo, por, kur i kam hapur sytë, pashë Stojanin pranë meje. Ai fliste me mua. Nuk e di se çfarë thoshte, por fliste dhe ishte jashtëzakonisht i gëzuar, i qeshur. Me bëhej se ai lozte valle, sipas ritmit të muzikës. Nuk me kujtohet as tani sesi kemi arritur deri te ato shtëpi. Nuk e dija se në cilin vend isha dhe përse isha aty. Kush me kishte dërguar në atë lagje, pranë atyre shtëpive dhe pastaj ajo rrëmujë e paparë ndonjë herë në jetën time. Njerëz të gëzuar, të qeshur, të lumtur, që si me britma gëzimi silleshin vërdallë dhe pastaj largoheshin tutje, deri në tretje. Ishte e mundur që

njerëzit, kur janë të lumtur, të gëzuar, të jenë njëherësh edhe të rrezikshëm dhe të ashpër? Një turmë njerëzish, burra, gra, fëmijë iknin pranë meje. I shikoja se ishin të trishtuar, të tmerruar, por nuk e kisha të qartë pse ata duhej të ishin ashtu të tmerruar, të trembur, nga kush? Mua me dukej se ata i shikoja në kinema. Me lindi dëshira që t'i prekja njerëzit që luanin në kinema. Kujdestarja, atje në jetimore, më kishte thënë se ata njerëz që luajnë në film, nuk prekën dot, nuk kapën, ata janë vetëm hije, hije drite e artistëve të regjistruara në shiritin e filmit... ha, ha, ha, sa budallaqe që është treguar, ja ku i kam njerëzit e kinemasë, hijet e regjistruara në shiritin filmik, por unë i prek, ja... dhe sakaq zgjata dorën dhe kapa një fëmijë që ikte pranë meje. Ishte fare i ri, e kapa nga gryka dhe e hodha tutje, pastaj e godita me thikën time... kurse nëna e tij, sigurisht ashtu e kishte rolin, çirrej duke qarë... dhe unë qëllova me revole. Ajo u rrotullua... ja kështu! Isha i sigurt që edhe regjisori do të jetë i kënaqur me këtë skenë... Pastaj u largova tutje. E ndjeja veten të lodhur. Tutje, ishte i shtruar një qilim i kuq. E pashë dhe e preka. Isha i lodhur. Goja me ishte tharë. Pastaj etja. Kisha etje, por nuk gjeja ujë. Do të pushoj pak, thashë dhe u ula. Por nuk qëndrova gjatë aty. Një plak më lëshoi diç në dorë. I njoha ato letra që plaku mi dha. Ishin para. Deviza. Eh, për këto para me ka dërguar mamaja këtu. Sa do të gëzohet kur unë do t'ia dhuroj gjithë këto para! Po, po, të gjitha do t'ia dhuroj asaj! I futa paratë në xhep. Por plaku nuk me shqitej. Ai fliste dhe me dorë tregonte nga turma. I thashë të shkonte, por ai nuk shqitej. Nxora revolen dhe qëllova. E pashë plakun që u rrëzua, duke mbajtur



gjoksin me duar. Ra mbi qilimin tim të kuq, ku isha duke pushuar. Sa budallaqe që ishte kujdestarja!... Ç'kam, vallë, kështu? Pse me djegin sytë? Edhe fytim'u ka tharë fare. Ndoshta nga tymi. Nga vjen ky tym, vallë? Aha! Nga shtëpitë që po digjen. Mu bë se me thirri dikush. Ktheva kokën andej dhe pashë Stojanin. Ai ecte disi valëvitshem. Krah tij ecte një vajzë. Mu duk se ishte e bukur. Me erdhi një dëshirë që edhe unë të jem pranë asaj vajze! Stojani vazhdonte ecjen, pa me shikuar fare. Pastaj ai erdhi drejt e te unë. Kjo është për ty, me tha. Për mua? Oh, sa mirë! E mora vajzën nga krahu. Ajo kundërshtoi. Unë e shtrëngova edhe më fort dhe e tërhoqa kah vetja. Stojani qeshte tutje. Me dukej se ishte i lumtur. Pse, vallë, qesh ai kështu? Ai me ndëron. Ndërsa vajza përpëlitej me kokën ulur. E tërhoqa prapë kah vetja vajzën. Poshtë, në një livadh, pranë një lisi binjak, e rrëzova vajzën. Nuk më kujtohet se si kisha arrirë deri në atë vend kaq të mrekullueshëm. M'u bë se aty ishte një shtrat i gjerë, i mbuluar me çarçaf të blertë. Vajza përvjeli pakëz buzët. E pashë. I kishte të kuqe, disi si petalet e lules, dhe pastaj i pashë dhëmbët saj të bardhë. Në fillim m'u dukën ashtu, por nuk ishin të bardhë. Çfarë ngjyre ishin, vallë? Kurrë në jetën time nuk kam parë ngjyra më të bukura. Shkëlqimi i tyre ishte vezullues. Ajo rrinte e qetë. Mua mu bë se ajo me dashuronte. E shikova gjoksin e saj, pak të fryrë. Por nuk pashë gjë. Kishte të veshur një xhakëtë të gjelbër, apo një ngjyrë tjetër, që nuk më kujtohet tani dhe unë ia hoqa nga trupi. Ajo kundërshtoi. Por unë kisha fuqi, ndaj nuk e pyeta fare. Pastaj, sesi me lindi një dëshirë e zjarrtë të bëja dashuri me të. Isha i gatshëm për shpërt-

him. Ajo më dashuronte. Isha i sigurt. Ia pashë fytyrën të skuqur nga epshi. Nuk vonova dhe u gjëndra mbi trupin e saj. Ajo klithi trishtueshëm, kur unë depërtova... dhe m'u bë se ajo tani qante. Eh, nuk kam kohë tani të shikoj se çfarë bën ajo, qesh apo qanë! Derisa unë isha duke shfryrë epshet e mia, prapë m'u bë se ajo ishte e lumtur. Ajo qeshte. Ishte një qeshje e ëmbël, që kurrë në jetën time nuk e kisha parë që njeriu të qeshë kaq gjatë dhe kaq ëmbël. Dhe nga ai gaz pashë sesi lotët i rridhnin nga sytë. Ishin lot apo me dukeshin mua? Jo, jo, këta nuk qenkan lot, qenkan krongjij akujsh! Krongjij akujsh nga sytë?! E tmerrshme! Ajo mbylli sytë. I pashë qerpikët e saj të zinj... jo nuk ishin të zi, ishin në një ngjyrë tjetër, që unë kurrë nuk e kisha parë, por të bukur dhe të papërshkrueshëm. Dhe aspak nuk gabova. Ajo ngriti ngadalë qerpikët, duke i zbuluar sytë, që m'u bë se kishin ngjyra të shumta dhe ishin të shndritshëm, si drita e ndonjë ylli që shquhet atje lart në gjithësi. Por unë isha i kënaqur. Dhe nga kjo kënaqësi ndieja nevojë të lëvizja pandërprerë, dhe ... oh sa mirë!... Ohhh!... Jam i lodhur. Nga me erdhi gjithë kjo lodhje? S'ka gjë. Do të pushoj pak. Nuk do të lëviz fare për ca çaste, pastaj... ndoshta prapë kisha humbur në ekstazë. Kur hapa sytë, pashë se isha vetëm. M'u duk vetja në gjendje të mjerë. Tutje dëgjova zhurmë. Pashë Stojanin të shtrirë përmbys. Ç'bën ai, vallë? Ngrita pak kokën dhe pashë me mirë. Poshtë tij ishte vajza ime! Më bëjnë sytë, apo është ajo? U ngrita në këmbë. Ajo ishte. Nxora revolen dhe i thirra Stojanit. Ai u ngrit shpejt nga frika. E pashë kur largohej, por unë isha i neverikosur dhe nga inati që ai ma kishte rrëmbyer fem-

rën time, e qëllova me revole. Ai ra përmbys. Pastaj e shikova vajzën. E përdala, mendova. Do të bësh dashuri me të gjithë paramilitarët? Edhe pse ajo qante, unë e qëllova me revole. Ajo u rrëzua, por ishte gjallë. Bushtra, mendova, dhe me thikën time e godita në të gjitha pjesët e trupit. Dikur ajo u qetësua. E pashë të qetësuar. Pastaj e fshiva tehun e thikës me fustanin e saj dhe u largova tutje!...Agrooon, Agroooooon! dëgjova një grua të thërriste dikë. Pak metra larg meje, pashë një paramilitar që e goditi gruan me breshëri automatiku. Ajo u plandos për tokë. Pash kur pranë saj kishte mbetur i palëvizur edhe një fëmijë. Ndoshta ai flinte, mendova, dhe u afrova ngadalë për të mos bërë zhurmë. Nuk doja ta zgjoja nga gjumi... Agroooooonnnn! e dëgjova prapë zërin e mekur të gruas që po jepte shpirt... Çfarë emri? – thash me vete.

Pa e diktuar, autobusi kishte ndaluar në stacionin e fundit në kryeqytet. Pasi i futi fotografitë në dosje që e mbante të hapur në dorë, e mbylli atë ngadalë, sikur t'i kishte mbyllur në brendi të saj edhe kujtimet e hidhura. Nga xhepi nxori dorëzat dhe ngadalë i futi në dorë. Me çantën në sup, doli jashtë. Të ftohtit ia preku egërsisht fytyrën. Ishte akoma herët. Dritat e neonit i shndrisnin ftohtë trotuaret e zbrazëta. Qyteti flinte akoma i qetë. Rrallë, ndonjë automobil, apo autobus shihej në rrugë. Gorani shpejtoi hapat. Pa dashur edhe një herë i shkoi dora në brez. Revolja ishte aty. Pa e pasur mendjen fare aty, e rregulloi edhe një herë jakën e palltos dhe me dorë të ngritur i dha shenjë një veture taksie që vinte me të shpejtë prapa krahëve të tij. Vetura ndaloi. Gorani i tha adresën.

Pa u ndier, ishte afruar pranë derës. Rrugët ishin të qeta. Çelësat i mbante në dorë. Para se të hapte derën, shikoi edhe një herë prapa, pastaj majtas dhe djathtas dhe, pasi u bind se nuk ishte duke e përgjuar askush, futi çelësin në bravë, duke e rrotulluar lehtë. Në korridor ishte errësirë. Qetë u afrua te dera dhomës së pritjes. Errësirë dhe qetësi. Thonë se gjumi i mëngjesit është i rëndë, mendoi. U afrua pranë dritares. Pasi ndezi dritën, fare qetë ia vuri në tytë revoles antizhurmuesin. Çantën me dosjen brenda e rregulloi mirë, duke e hedhur prapa shpine dhe gjalmin krahaqafë.

“Mama!” – thirri, kur ishte afruar fare pranë derës së dhomës së gjumit, ku ajo flinte, duke i rënë lehtë derës.

“Kush është?” – u dëgjua ajo nga brenda.

“Jam unë, Gorani”

“Ti?... ç’kërkon tani?... Erdha, erdha!...”

Pas pak çastesh, dera u hap. Me pelerinën e natës bojë lule pjeshke, me sy të mbufatur, ajo doli në korridor.

“Ç’ka ndodhur?” – pyeti ajo, pa u përshëndetur fare me të.

“Ti solla paratë, mama!”

“Pse, tani?”

“Kam urdhër nga Nebojsa, udhëtoi sot urgjent!”

“Si?!... Nga Nebojsa? Si s’më ka thënë gjë ai?”

“Kush është atje, Sllavica?” – erdhi një zë burri andej nga dhoma e gjumit.

“Gorani!” – tha ajo duke ecur drejt dhomës së gjumit. Gorani e ndoqi pas. Në shtratin përrallor, që gjendej në ballë të asaj dhome magjepsëse, pa Nebojs-

hën të shtrirë dhe të mbuluar me batanije deri në grykë. Vetëm fytyra i shihej në dritën e dobët të abazhurit, kurse sytë i shprehnin trishtim dhe frikë bashkë.

“Ç’kërkon këtu, kaq herët?” – pyeti Nebojsja, duke tërhequr batanijen deri të goja.

Gorani nuk foli. Me hapa të ngadalshëm dhe pa u ndier fare që i hidhte mbi tepihun persian, u afrua edhe më pranë shtratit. Sllavica qëndronte në këmbë në anën tjetër. Me këmbën e majtë Gorani shtyu derën furishëm. Përplasja e saj shkaktoi një krismë, që në mes të asaj qetësie ju bë Sllavicës së dëgjoji një tërmet.

“Më solli dosja nr. 7/75 nga arkivi sekret i jetimores!”

“Do t’i sqaroj të gjitha!” – foli Nebojsja, që kishte mbetur në një pozitë të vështirë. Nuk ishte në gjendje as të lëvizte.

“Jo, zoti Mariq. I kam sqaruar të gjitha vetë. Me vjen mirë që të gjeta edhe ty këtu, se përndryshe nuk do të kisha arritur kurrë atje ku ishe... Por, ti, mos ke frikë, do të shpallësh hero...” – dhe me një lëvizje të shpejt nxori revolen dhe i dha zjarr. Plumbi i parë e goditi fare pranë plagës së shëruar mbi vetull, kurse plumbi i dytë në gjoks, në anën e majtë, ndoshta mes për mes zemrës.

Për një çast Sllavica mbeti e nemitur. Pasi e mori pak veten, deshi të klithte, por shikimi i tërbuar i Goranit e mbërtheu në vend. Ajo, me duar në faqe, e tmeruar filloi t’i lëvizte këmbët që i dridheshin në drejtim të derës. Vërshëllima shurdhuese e armës e bëri atë të ndalonte. Plumbi e kishte goditur në kokë. Sakaq ajo u përplas mbi trupin e Nebojshtës. Gorani e futi revo-

len në brez dhe fare qetë, sikur mos të kishte ndodhur  
hiçgjë, doli nga dhoma e gjumit. Pasi mbylli derën me  
bravë, u gjend në garazhin e Sllavicës. Qetë hyri në  
veturën e saj dhe doli në rrugë. Për herë të parë, pas  
kaq ditësh, e ndjeu veten të lehtësuar. Edhe gjumi iu  
kishte larguar fare. Në shpirt kishte një pushtim, si afsh  
të nxehtë, që ia ledhatoi zemrën dhe iu ngjit ngadalë  
përpyetë, duke i dhënë një fuqi dominante.

Kishte filluar të agonte. Nga ana e lindjes shihej  
një përflakje alli, që paralajmëronte agimin e acartë, por  
me një ditë të bukur dhe pa re. Vetura çante në drejtim  
të magjistrales. Lamtumirë, skëterrë!... tha me vete,  
derisa ishte duke ia ndërruar shpejtësinë mercedesit.

## VII

„Njëqind dollarë, kushtojnë pesë SFr, nuk zbres më poshtë në çmim,“ – tha prerë Hoffmann.

„Është çmim i lartë. Unë nuk paguaj asnjë rapp më tepër se tre SFr,“ – tha Besimi.

“Mirë, sa dollar i do?”

“Të thash, varet nga çmimi”

“Nëse i blen mbi një milion, do të jap në çmimin e caktuar nga ti, nëse blen nën një milion, atëherë nuk ndryshoj asgjë nga çmimi.”

“Po nëse i blej pesë milionë?”

“Aha!? Ti i do të gjitha? Ke të drejtë, atëherë. Kështu po! Pajtohem plotësisht. Më fal se qenkemi keqkuptuar!”

“S’ka gjë. Për transportimin e tyre duhet të presim, derisa të bëjë organizimin.”

“Mirë. Merremi vesh përmes telefonit.”

“Në asnjë mënyrë. Pas dy javësh, në kohën e njëjtë plus-minus gjysmë ore në restorantin “Mövenpick”, në vendin e quajtur Würenllos. Takimi është i rastësishëm,“ – fliste Besimi, sikur me veten e tij, duke mbajtur gazetën përpara.

“Mirë. Megjithatë, unë dua kapar.”

“Para vetes i ke. Numëroji, janë dhjetëmijë SFr.”

Kishte kohë që Besimi përpiquej për arritjen e një kompromisi për blerjen e disa miliona dollarësh të falsifikuar. Pas përpjekjeve intensive, bashkë me Belin, kishin gjetur tregun dhe kishin bërë shitjen e tyre. Pjesën më të madhe e kishte shitur në Ukrainë dhe Rusi, ku edhe do të bëhej pastrimi i tyre. Kurse mbetjen e kishte përgatitur që ta dërgonin në shtetet ballkanike. Transportimin e tyre e kishin marrë përsipër blerësit. Punë e tij ishte vetëm ndërmjetësimi.

Që nga pësimi që kishte pasur vitin e kaluar, Besimi kishte punuar në mënyrë intensive për të korrigjuar atë, që, për shkak të pakujdesisë, të fatit apo të papriturës e kishte humbur. Me gjithë përpjekjet e tij për të humbur çdo gjurmë të paudhësive të tij, siç dukej, nuk kishte pasur sukses. Pa e kuptuar as vetë, kishte rënë në gjurmë të rrethit që e rrethonte. Pa ndonjë bujë të madhe ishte bërë në atë rreth i papërfillshëm. Njerëzit, te të cilët dikur kishte qenë të thuash idhull, tani nuk e honepsin më. Pëshpëritej gjithnjë e më afër rrethit të tij se nuk kishte qenë gjë as puna e tij. Dukej njeri i shkolluar, i aftë, i dashur dhe patriot, kurse në të vërtetë kishte qenë një hiç!... Rruga që kishte marrë kishte kohë që ishte vërejtur. Tani nuk ishte koha që të ruhej nga bashkëvendësit. Ishte një kohë kritike, që më tepër duhej të ruhej nga organet e sigurimit shtetëror. Ishte i ndërgjegjshëm se, po u hetua, nuk do të shpëtonte si herën e parë, për shkak të interesit që ata kishin pasur për të. Nga kjo frikë, që tinëzisht i kishte zënë vend në shpirt, ai kishte filluar të dyshonte në shumë njerëz, edhe në ata me të cilët ishte në shoqëri çdo ditë, si në Kolin, Arianitin, Hutin... I vetmi që akoma i besonte,



ishte Beli. Sikur të mos mjaftonte e gjithë kjo, prapë në gazetë kishte lexuar një njoftim të ngjashëm me prononcimin e familjes së tij, por që kësaj radhe vinte nga ish gruaja e tij, Bardha.

Të papriturat vijnë të rrufeshme, mendoi. Ato, me dashje apo pa dashje, zënë vend në qenien tuaj. Dhunshëm marrin timonin në duart e veta, duke të diktuar rrugën. Ato zënë vendin e të priturve, të planifikuarave dhe nuk të lënë shteg për mendim, për kthyerie prapa, për rrugëdalje dhe, ashtu jashtë vullnetit, të tërheqin drejt të panjohurës... dhe mbetesh në duart e fatit!... Le të dalë ku të dalë!

Pasi kishte lënë punën, për të mos rënë në sytë e organeve të entit për inkuadrim, Besimi kishte arritur ta bënte një kontratë pune me një biznesmen turk. Kushtet që ishin të shkruara në kontratë përputheshin me ligjet e punës, kurse kushtet e marrëveshjes të pashkruar favorizonin interesat e tyre. Kështu, Besimi çdo muaj e paguante biznesmenin turk, e ai nga ato para ndante pjesën e tij konform marrëveshjes, kurse pjesën tjetër ia paguante Besimit rrogën mujore përmes llogarisë bankare, konform kontratës së punës.

\*

Ishte ditë e shtunë. Koha ishte e zyrtë. Në dukje të parë të mbetej përshtypja se ishte një ditë vjeshte, nga ato ditët e mërzitshme që të ndjellin lodhje dhe gjumë.

Lëvizjet në qytetin e madh, që akoma dukej i përgjumur, ishin të ngathtë dhe të rralla. Në rrugët kryesore, të lagura nga shiu që akoma vazhdonte të binte, kalonin vetura dhe kamionë të ndryshëm, duke

mbytur atë gjysmë qetësi mëngjesi që sapo kishte filluar të lëkundet nga gjumi i natës. Në Langstrasse shitësit kishin filluar t'i nxirrnin mallrat e tyre buzë trotuarit. Kishte në mesin e atyre mallrave rroba të mëndafsh-ta, fustane, poluvera, kostume meshkujsh e femrash të markave të njohura, si Versaçi, Giani, Armani, Boss, Valentino, Paco-Cobana, pastaj batanije, çarçafë të bukur e të qëndisur, vello për nuse, pelerina e shumë gjëra të tjera.

Në këndin e djathtë fare, pranë kafenesë, ishte një kioskë dhe përbri tij kishte zënë vend një kamion-kuzhinë, me banak të hapur. Në pllakën e varur sipëri shkruante „Imbis“. Një burrë me mustaqe qëndronte i heshtur, duke shfletuar gazetën. Dukej se me lezet e rrufiste kafenë në tas plastik, nën strehën e „Imbisit“. Pranë tij ishte një grua e re. Kalimtarët e rrallë venin e vinin pa interes. Shiu vazhdonte të binte.

Në anën e djathtë të rrugës ndaloi një veturë. Ajo jepte shenjë se donte të kthehej nga ana a djathtë. Ndërtesa ishte e lartë, kurse në katin përdhes ishte një derë e madhe, gjysmëharkore, e mbyllur me grila. Kur vetura u afrua ngadalë pranë portës së madhe, grilat në mënyrë automatike u ngjitën lart. Vetura lëvizi dhe sakaq u gjend në brendi të ndërtesës. Grilat e derës u lëshuan teposhtë, duke u përplasur lehtë mbi pragun e hekurt.

Në të majtë të asaj dere ishte një vitrinë e madhe xhami. Në brendi të saj ishin të vendosura orë dore të llojeve dhe tipave të ndryshme, si Shopard, Kartie, Piage, Roleks etj. Kishte edhe gjësende të arta dhe të argjendta, si unaza me gurë të çmueshëm xhevahiri: Smark, Rubin, Safir, Brillant etj. Pastaj kishte byzylykë,

vëthë, gjerdane të artë e të argjendtët. Mbi derë ishte vendosur pllakati me mbishkrim: „IWC UHREN”. Një burrë dhe një grua e re kishin kohë që qëndronin pranë vitrinës, duke i shikuar me admirim ato orë të përkryera dhe, duke diskutuar rreth tyre.

Nga larg u dëgjuan të rënat e kambanës. Tregonin orën. Pronari, një burrë i trashë rreth të pesëdhjetave, u duk në brendi të bizhuterisë. Me hapa të ngadaltë hapi derën. Pastaj u kthye drejt banakut. Pasi u ul, mori në dorë gazetën. Spikeri i radios lokale vazhdonte me lajmet e shkurtra të mëngjesit. Zilja automatike me një „ding-dong“ trishtues për një çast mbyti zërin e spike-rit dhe bëri pronarin t’i ngrinte sytë nga gazeta, duke kthyer shikimin nga dera.

“Guten morgen,” – përshëndeti gruaja me një buzëqeshje të ëmbël.

„Morgen mitenand,” – ia ktheu pronari dhe vazhdoj. – „Çfarë mund të bëj për ju?”

„Jemi të interesuar për këtë komplet orësh dore,” – dhe gruaja i tregoj me gisht në brendi të vitrinës.

„Po, këto janë orë të përkryera, nga firma e njohur IWC. Janë të praruara në 18 karat ar, ka edhe të praruara në ar të bardhë, apo ar të kuq po ashtu 18 karat. Janë orë të lehta dhe petake, me një trashësi 1,85 mm, me diametër 36 mm, me xham safir dhe qëndrueshmëri prej 9 gradësh. Çmimin e keni parë sigurisht, pra kjo e praruara në ar kushton 5.150 SFr, kurse kjo tjetra e pruar në arë të bardhë kushton 5.500 SFr. Pastaj...”

„Po kjo orë dore këtu, sa kushton?” - pyeti gruaja.

„Kjo është një orë me ngjyrë të artë dhe e pruar,

e tëra në 18 karat ar të verdhë. Edhe mbështjellësin rreth dore e ka nga i njëjti ar. Me mekanizëm automatik dhe rotor platin. E mbrojtur nga magneti dhe me një qëndrueshmëri nën ujë deri në nëntëdhjetë metra. Ka xham safir, treguesin e datës me xham zmadhues. Qëndrueshmëri prej 9 gradësh. Kushton 19.500 SFr. Kjo është e përdorshme për të dy gjinitë...” – Pronari fliste qetë duke shfletuar një katalog ku ishin shumë orë të madhësive dhe ngjyrave të ndryshme.

„Shumë e bukur, ë?” - tha gruaja e mahnitur. Burri i qëndronte pranë, duke pohuar me kokë ato që thoshte gruaja.

“Po kjo, sa kushton?” – pyeti prapë gruaja, duke e vënë gishtin mbi katalogun që pronari e mbante në dorë.

„Ah, kjo është orë unicate. Nuk e kemi ne në shitje. Kjo blihet vetëm me porosi. Nga këto orë brenda vitit prodhohen vetëm dy sosh. I përket një përkryerje teknike, “II Distriero Scafusia” nga familja e orëve IWC, që nuk mund të përshkruhet as me fjalë. Për prodhimin e saj janë të angazhuar shumë specialistë, të cilët humbasin qindra orë pune për t’i farkuar pjesët e imta nga platini dhe ari. Ka 76 gurë rubini dhe 21 funksione komplekse. Përveç sekondave, minutave dhe orës së saktë, ka treguesin Destriero, që tregon datën kalendarike, ditën e javës, muajin, vitin, deçenien dhe shekullin. Është një orë e përkryer. Çmimi i saj është 350.000 SFr dhe...”

„Mos lëvizni!” – tingëlloi thekshëm një zë i përzier bashkë me ritmin e ziles. Dy burra të maskuar, me revole të drejtuara drejt pronarit dhe çiftit, tani më kishin zënë vend në mes të dyqanit. Pronari ngriti du-

art lartë. Ashtu veproi edhe çifti. Të maskuarit e sh-  
tynë pronarin të futej në kthinën matanë. Me të shpejt  
ata u kujdesën që ta mbyllnin derën nga brenda dhe  
këtë punë e detyruan ta bënte gruaja e re, e cila kishte  
filluar të dridhej. Njëri merrej me pronarin në kthinën  
matanë, kurse tjetri, i përkulur prapa banakut, kishte  
filluar rrëmbimin e orëve, unazave, zinxhirëve dhe  
stolive të tjera, që gjendeshin në vitrinë. Të gjitha, pa  
ndonjë kontroll, i fuste në një çantë diplomatike. Plaç-  
kitësi me vete mori edhe disa broshura dhe katalogë të  
orëve e stolive të tjera, bile edhe katalogun që pak më  
parë pronari e kishte shfletuar për t'u dhënë informaci-  
one myshterinjve, që kishte mbetur i hapur mbi banak.  
Pasi u mbush çanta e parë, ai e hapi të dytën. Pastaj të  
tretën. Në fund, me revole në dorë, të dy u bashkuan  
në kthinën ku ndodhej pronari i lidhur. Ata ia morën  
çelësat e veturës dhe u turrën drejt garazhit, duke e lënë  
pronarin të lidhur për karrige, me duar të lidhura prapa  
shpine, me këmbë të lidhura dhe me gojë të mbyllur  
me shirit ngjitës plastike. Ata mbyllën edhe derën që e  
ndante kthinën nga dyqani, pastaj telefonin që ndodhej  
në banak dhe atë që ndodhej në kthinë ata i morën me  
vete. Pas pak roleta i derës së madhe gjysmëharkore u  
hap. Vetura, e cila rreth njëzet minuta më parë kishte  
hyrë nga ajo derë, tani, ashtu qetë, siç kishte hyrë edhe  
doli. Në kthesën e parë ajo mori nga e majta, në drejtim  
të autostradës. Sirena e alarmit të veturës së policisë i  
mbushi rrugët e qytetit.

Rruga të shpinte në një fshat malor. Ishte një rrugë  
që përdorej zakonisht për punë, si dhe i takonte një  
zone të lejuar për shëtitje. Në mesin e pyllit ishte një

shtëpi e vogël, që përdorej për deponimin e mjeteve të punës si sëpatë, sharrë e gjëra të tjera që nevojiteshin për pastrimin e malit në sezonin e pranverës. Në një shesh, jo larg asaj shtëpie, ishin të ndërtuara oxhaqe të sheshta për ndezjen e zjarreve gjatë piknikëve.

Vetura u ndal fare pranë gurrës. Currili i ujit rridhte qetë në lugun e drunjtë, i cili ishte i mbushur me ujë deri në buzë. Shiu vazhdonte të binte me një ritëm të shtuar. Besimi doli nga vetura. Pasi mori çantat diplomatike që i kishte të vendosura në ndenjëset e prapme, i tha Kolit të sillte shpejt bidonët e benzinës, që një ditë më parë i kishin fshehur në një kaçube, jo fort larg nga gurra. Koli ishte i shkathët për këto punë. Ai i solli bidonët dhe me të shpejt e bënë spërkatjen e veturës, duke i hedhur benzinë në brendi, mbi motor dhe gjetiu. Pastaj i vunë flakën. Rreth njëqind metra larg, e fshehur ndodhej vetura e tyre. Pa humbur kohë, ata u gjendën në rrugën e asfaltuar, që të shpinte drejt qytetit.

Besimi e kishte plotësisht veten në dorë. Ishte i larguar nga dyzimet dhe frika e mëparshme. Në shpirt kishte një qetësi dominante, që, si mburojë, i rrinte pezull mbi kokë, si t' ishte një ogur i mirë që do ta mbronte nga çdo e papritur. I bëhej se tanimë rreziku kishte kaluar.

Derisa priste në veturë, Besimi thithte duhan. Pranë tij Koli kotej. Kishte kaluar rreth një orë pas aksionit. Radioja lokale kishte dhënë menjëherë njoftimin. Edhe drejtimin se nga kishte ikur vetura e kishte dhënë të saktë. Kurse kërcënimin që Koli e kishte bërë në gjuhën gjermane gjatë aksionit, ata e kishin cilësuar si “gjuhë gjermane me theks ballkanik”. Beli erdhi. Ai

nuk foli shumë. Mori çantat diplomatike dhe iku. Koli i lehtësuar psherëtiu.

„Ky është një aksion që e kemi kaluar me se lehti dhe me një shpejtësi konstante,“ – tha Koli.

„Ëhë! – tha Besimi duke ndezë motorin e veturës. - „Sonte do të luajmë barbut.”

\*

Ndodhej në tehun e ndarjes nga të qenit i zgjuar, në njërën anë, dhe të qenit në gjumë, në anën tjetër, kur nga dhoma matanë buçiti kënga boshnjake, që Besimin e shkëputi nga ajo agoni e çastit, duke i hapur sytë mallëngjyeshëm.

Në dhomën matanë jetonte një boshnjak. Quhej Muradif. Kishte ikur nga lufta. Ishte i kursyer në biseda. Pas orarit të punës, rrinte zakonisht i mbyllur në dhomën e tij dhe kryesisht i vetmuar. Thuhej se gjatë luftës e kishte humbur familjen. Pa e pyetur fare, Besimi kishte marrë për shfrytëzim lokalim e podrumit që i takonte Muradifit. Ai nuk e kishte shfrytëzuar. Besimi kishte blerë një dry të madh dhe e kishte mbyllur. Në atë podrum Besimi kishte fshehur shumë para të gatshme dhe shumë gjëra të tjera të vlefshme, si bizhuteri, aparate elektronike, kompjuterë dhe sasi të konsiderueshme drogash. Ishte i sigurt se në rast kontrolli, ajo pjesë e podrumit nuk do të kontrollohej dhe çdo gjë do të mbetej aty. Për këtë e kishte njoftuar edhe Belin, të cilit ia kishte besuar kopjen tjetër të çelësit. Koli nuk ishte përzier fare. Ai thesarin e tij e kishte fshehur në vend tjetër të sigurt.

Në kokën e tij vërshuan kujtimet. Kënga boshnjake i solli nostalgji për të kaluarën. Thellë në zemër

ndieu një mallë që kishte kohë që nuk e kishte ndierë. Sikur e kishte harruar fare rininë e tij. Për një çast mbeti si i hutuar. Tani më gjumi i mesit të asaj dite të trishtë dhe plot shi u tret. I yshtur nga mallëngjimi, ai u ngrit nga shtrati. Sakaq, para sysh i doli ajo pamje e trishtuar që e kishte parë me sytë e tij, në oborrin e shtëpisë së tij që po digjej. Babanë e shtrirë dhe arkivolin në fundin e oborrit. “Ti ke vdekë... vdekë... dekë... ekë... ekëëë!...” i jehuan në vesh fjalët e t’et. Vërtet kam vdekur. Si rrodhën ngjarjet dhe mbeta fillikat vetëm? Karafil beg!...

I vrarë nga këto mendime, doli.

Pasi kishte ardhur nga Kosova, në vitin e parë të qëndrimit në këtë vend e kishte provuar të shkonte edhe në klube dhe lokale serbe. Këtë e kishte bërë në shoqëri me Belin. Që në fillim nuk i kishin pritur mirë. Më vonë, kur marrëdhëniet kishin filluar të merrnin një kahe tjetër, ata i kishin sulmuar. Falë pronarit të lokalit, që me të shpejtë kishte ndërhyrë, duke i larguar nga lokali, se do ta kishte pësuar shumë keq nga disa të rinj malazias.

Lufta në Kosovë dukej se ishte e pashmangshme. Mërgata ishte e organizuar si asnjëherë më parë. Mblidhnin ndihma në para, ushqime, veshmbathje, barëra. Nga mërgata kishin shkuar shumë vullnetarë për të luftuar. Shqiptarët, kudo që ishin, jepnin ndihma për Kosovën. Atdheu në rrezik, thoshin ata. O sot, o kurrë!... Kurse Besimi, për këtë, fajin ua kishte hedhur partive politike, që nuk kishin gjetur akoma një gjuhë të përbashkët. Këtë e thoshte para bashkatdhetarëve, sa për tu arsyetuar, kurse në fakt arsyeja e vërtetë ishte krejt tjetër.



Një pjesë e madhe e popullit në Kosovë, e detyruar që t'i lëshonte vatrat e veta, jetonte nëpër male, nën qiellin e hapur. Kishte marrë vesh se edhe familja e tij ishte larguar nga shtëpia dhe jetonte e fshehur ndër miq, diku në Dukagjin. Me mundim kishte rënë në kontakt me ta. Ata as që donin të dëgjonin më për të. E vetmja nëna kishte pranuar në një rast të ndërronte disa fjalë me të. Ajo i kishte thënë se ne mirë jemi dhe në fund i kishte thënë se ndoshta do të mbushesh mend. Kaq.

Besimi jetonte i tërhequr. Me xha Himën kishte kohë që nuk ishte takuar fare. Kishte përshtypjen se ai kishte nuhatë diçka për sjelljet e tij, si dhe për misionin që i kishin ngarkuar. Këto ia kishte thënë një ditë Koli, derisa po kalonin me veturën e tij buzë ndërtesës së klubit. Tani largohej në rrethët e largëta, ku njerëzit nuk e njihnin. Kishte filluar të shkonte në fshatin Butchwil. Atje kishte muzikë shqip. Vinin njerëz nga anë të ndryshme. Besimi rrinte zakonisht i vetmuar. Dëgjonte muzikë dhe shikonte çiftet dhe të rinjtë, kur ngriheshin në valle. Zemra ia donte të hidhej edhe vet në valle, por si? Grumbullimi i të zezave ishte aq i madh, sa që vetëm gota e birrës dhe shpresa se do t'i vinte koha një ditë e të hakmerrej kundër atyre që ia kishin shkatërruar jetën, e mbante akoma. Ata me ndanë nga gruaja, mendonte herë pas here, me ndanë nga prindërit, nga vëllezërit e motrat, nga fisi dhe fshati, dhe me plaçkitën... Eh, sikur ta kisha Bardhën! Ndoshta edhe ne do të na gëzonte zoti me ndonjë fëmijë... Dhe sonte unë nuk do të isha i vetmuar këtu. Do të hidheshim edhe ne në valle, ja, si ai çifti atje. Sa të lumtur që janë! Do të këndonim dhe do të kërcenim, pastaj do të shko-

nim në shtëpi dhe do të kënaqeshim me fëmijët tanë!... Dhe ne... Kush ne?! Çfarë, more! Mbaruan të gjitha! Ajo në shtëpi të vet, e unë... Unë as shtëpi s'kam. Si jam katandisur! Kam mbetur në shtëpi të botës, duke u strukur nga të gjithë. Tutu nga serbët, tutu nga shqiptarët, tutu nga policia, tutu edhe nga hija ime... O Zot, deri kur kështu!? As paraja nuk paska vlerë!...

Nëpër klubet e shqiptarëve nuk shkonte pothuajse fare. Edhe nëse ndonjëherë shkonte, disi nuk e ndjente veten mirë, kur njerëzit e kthenin kokën nga ai dhe e shikonin me mospërfillje. Një pjesë e madhe e kishin marrë vesh se çfarë pune kishte kryer, para se të vinte këtu. Një pjesë tjetër ishte e njohur me punën që e bënte tani. Kishte edhe nga ata që dikur i kishte torturuar. Njëri e kishte shikuar vëngër, me një urrejtje të papërmbajtur. Kurse një tjetër e kishte sulmuar me fjalë të rënda. I gjithë klubi ishte kthyer në anën e tij dhe Besimi kishte qenë i detyruar të dilte jashtë, i turpëruar. Këto nuk i duronte dot. Ishte një lloj përçmimi nga ana e tyre. Pastaj i druhej edhe hakmarrjes, që dikush mund ta bënte, edhe pse ndodheshin në vend të huaj. Ec e dije se cilin e ke keqtrajtuar para shtatë-tetë vitesh. Pastaj, sikur e gjithë Kosova ka ardhur këtu. Lehtë ishte atëherë, kur unë erdha së pari. Nuk të njihje askush, edhe po të rrije gjithë kohën në klube apo në lokalet plot, me muzikë shqipe. Kurse sot, në çdo hap takon fytyra të reja, që kanë ardhur taze nga Kosova. Ata që i kam keqtrajtuar, nuk janë të paktë. Mjafton një të me diktojë, pastaj, edhe nëse nuk më godasin, mjafton vetëm vërshëllima mbi kokën time e asaj shpate hakmarrëse, që unë me vite e kam kultivuar.

I mbetur fillikat dhe i pastrehë, pjesën me të madhe të kohës e kalonte nëpër kafene. Gjatë ditës ai shëtiste nëpër kafene të qytetit, kurse në mbrëmje mblidhej në lokalet e kazinove, ku në mënyrë ilegale luhej barbuti, letrat dhe lojëra të tjera bixhozi.

Zakonisht zinte vend në anën e djathtë të derës dhe ia fillonte të pinte birra. Si gjithherë, i pari arrinte në këtë lokal. Pastaj vinte Koli, Huti, Arianiti, Dauti, Zefi e shumë të tjerë, që nuk i njihte me emra. Ndaheshin në dy grupe. Në njërin anë luanin shqiptarët, kurse në anën tjetër italianët, turqit apo serbët. Ishte e vërtetë se në këto lojëra më të mirët ishin turqit dhe serbët. Mirëpo, edhe Besimi me Kolin ishin lojtarë të mirë. Besimi i kishte edhe meritat e veta. Ai shpesh edhe bënte hile dhe ishte jashtëzakonisht i shkathtë në këtë drejtim. Edhe pse ishte e ndaluar biseda gjatë lojës, Besimi gjente arsye dhe duke folur arrinte t'i hutonte të tjerët dhe fitimi i mbetej atij. Kur ishte i dehur, ishte edhe trim. Ai i nxirte të gjitha paratë nga xhepi dhe i hidhte mbi tavolinë dhe, ashtu inatçor siç ishte, duke bërë hile, i skuqur flakë nga inati, shante më shumë Kolin që e kishte partner se sa kundërshtarët që ishin në avantazh. Kur ndodhte që të ishte vetë në avantazh, atëherë ai nuk pushonte së përqeshuri palën kundërshtare.

\*

I nxehur pak nga vera, Besimi liroi kravatën. Fytyra i shndriste nga hareja. Herë pas here e ngriste lartë dorën e djathtë, duke e valëvitur në ajër, sikur të ishte duke e valëvitur shaminë, kur i printe valles dhe, sipas ritmit të muzikës, lëvizte kokën. Në sallën e madhe

jehonte ëmbël zëri i motrave Libohova, këngëtare të njohura të ardhura kohët e fundit nga Tirana. Një burrë rreth të tridhjetave, i ulur në tavolinën përballë, përpiquej të ndiqte ritmin e këngës, por nuk e arrinte dot, sepse gjuha ju kishte trashur dhe zëri i dilte me vështirësi dhe, pasi nuk këndonte dot, shante me fjalë të ndyta, duke thyer gotat mbi dysheme. Pronari ia tërhoqi vërejtjen. Ai sikur u qetësua.

Përbri Besimit kishte zënë vend Koli. Ishte një shok nga ata të heim-it të azilantëve. Me të kishte banuar në të njëjtën dhomë për pesë muaj rresht. Edhe tani ishte duke banuar me të, që nga dita kur e kishte përzënë Sandra nga banesa. Në fillim me të kishte qenë i rezervuar. Por, me kalimin e kohës, kishte vërejtur se ai ishte një i ri i përkryer. Gjatë bisedave ai e kishte njohur se cili ishte. Një kohë Besimi e kishte pasur në dorë dosjen e tij, kuptohet pa emër, por vetëm me të bëmat e tij. Po ta kishte zënë atëherë, do të kishte larë lesh mbi kurrizin e tij. Tani ndryshonte puna. E kishte partnerin më besnik. Koli kishte dezertuar nga ushtria jugosllave. Ishte i shoqërueshëm dhe fjalëpakë. Nuk nxitohej në biseda dhe përpiquej t'i përshtatej bisedës, duke lënë përshtypje të mira në rrethin që e shoqëronte. Orientohej dhe iu nënshtrohej shpejt dëshirave të tjetrit, duke treguar një maturi të lakmueshme. Në vendlindje ai kishte qenë disa herë i arrestuar dhe i burgosur, si delikuent i mitur. Më vonë ai kishte bërë disa vjedhje dhe plaçkitje të stilit profesional, pa lënë gjurmë. Në të shumtën e rasteve, Besimi mblidhte informacione dhe instruksione, duke ia dhënë atij. Thyerjet, vjedhjet apo plaçkitjet i bënte zakonisht i vetmuar, apo, në raste spe-

cifike, i shoqëruar nga Besimi.

“Kam instruksione të reja,” – tha befaz Besimi.

“Ku?” – pyeti Koli kureshtar.

“Në magjistralen 14, në fshatin e quajtur L. Në dalje të fshatit ndodhet një pompë karburantesh.”

“Ma jep një skicim më të hollësishëm!”

“Porsa të hysh nga dera e jashtme,“ - dhe me lapës bëri një katror, pastaj në njërën anë bëri kryqëzimin e vijave, duke treguar se ku ndodhet dera. - „Në krahun e majtë, afërsisht dhjetë hapa larg, ndodhet dera e zyrës. Porsa të futesh në zyrë, në të djathtë ndodhet thezori, me një madhësi rreth gjysmë metri. Kujdes, ka të instaluar alarm!”

“S’ka gajle, ia bëjë çarën atij. Sesi e kam një vullnet të papërshtueshëm për një aksion të tillë sonte. Besoj se do të kthehem prapë këtu.”

“Jo, jo, takohemi në banesë.”

„Mirë. Ika unë!“

Koli u ngrit dhe, pasi përshëndeti me kokë, doli. Muzika vazhdoi me buçimë. Zëri melankolik i vajzave që këndonin në duet, buçiti këndshëm.

*Mora rrugën nga Janina,*

*Isha vetëm...*

Besimi mbushi gotën. Kurse burri që ishte ulur në tavolinën përballë, përpiquej të këndonte dhe, meqë nuk e zinte dot ritmin e këngës, duke u gajatur shikonte nga pronari dhe në vend që ta hidhte prapë gotën mbi dysheme, ngrinte dolli... ”Për shëndetin e pronarit!”

Pasi bëri pagesën, në mes të asaj zallahie, Besi-

mi doli. Fresku i mesnatës ia ledhatoi butësisht fytyrën dhe ballin e djersitur. Ishte një natë e bukur vere, me një qiell të mbushur plot yje. Hëna e plotë derdhte rrezet e argjendta mbi sipërfaqen e qetë të liqenit, që shtrihej para pamjes së tij. Rrallë e tek qetësinë e natës e therte ndonjë zhurmë veture, që kalonte rrugës fare pranë vendparkingut të veturave. Besimit i pëlqeu të freskohej për ca çaste në vetmi, pranë veturës së tij, duke thithë duhan në qetësi. Edhe pse kokën e kishte të rënduar nga vera që kishte pirë, kjo natë disi i ndillte kujtime.

Me këmbë e shtypi bishtin e cigares mbi asfalt. Hyri në veturë dhe ndezi motorin. Sakaq u gjend në rrugë. Mori drejtimin e klubit.

Klubi ishte një ndërtesë e lartë, e veçuar, buzë malit. Dikur ajo kishte qenë shtypshkronjë. Në katin përdhese akoma ndodheshin makinat e tipit “Original Heidelberg Zylinder.” Një kohë të gjatë ndërtesa ishte përdorur nga Partia Komuniste e Kurdistanit, për të shtypur materiale propagandistike kundër Turqisë. Në katin e parë ndodhej një sallë e madhe. Aty mbaheshin mbledhje të PKK-së, si dhe në raste të rralla ishte përdorur edhe nga lëvizja marksiste-leniniste e shqip-tarëve, që vepronte në perëndim. Kati i tretë kishte pasur arkivin dhe magazinat, kurse kati i katërt ishte përdorur për banim. Me kalimin e kohës, këtë ndërtesë e kishte marrë me qira një biznesmen turk. Ai e shfrytëzonte si magazinë mallrash për dyqanet e tij, kurse katin e katërt ia kishte dhënë me qira Besimit. Me një investim të vogël, Besimi e kishte rinovuar dhe e kishte shndërruar në një apartament të bukur. Me ndihmën

e Big-mamasë ai kishte arrirë të krijonte një agjenci shoqërimi të quajtur “Nacht Service.” Të punësuarat ishin vajza të ardhura nga Afrika, pastaj nga Çekia, nga Rusia, nga Bosnja, si dhe dy shqiptare, të cilat kishin ardhur nga Kosova, pas të dashurve të tyre, por që kishin dështuar rrugën dhe kishin përfunduar në duart e tij. Besimi ishte prezantuar se ishte turk, duke e fshehur identitetin e vet para tyre. Ato e kishin diktuar se ishte shqiptar dhe i kishin kërkuar ndihmë. Në vend të përgjegjës, ai i kishte sharë në gjuhën turke:

“Çeneni kapat oruspu!...”

Nga jashtë ndërtesa dukej e qetë. Dritat ishin të fikura. Dritaret të mbyllura. Rreth e qark mbretëronte qetësi. Doli nga ana e pasme dhe, nga dera anësore që të shpinte në bodrum, hyri brenda. Sa herë që kthehej në orët e vona të natës, gjithmonë hynte nga ajo derë. U ngjit shkallëve dhe arriti në katin e katërt. Pa trokitur, hyri në dhomën e “Big-mamas”. Ishte një grua e trashë, rreth të dyzetave. Vinte nga Afrika. Kishte vite që e ushtronte këtë zeje. Ishte vartëse e Besimit dhe shefe kryesore e prostitutave. Disa herë kishte qenë e burgosur për delikte të tilla. Kishte marrë pjesë në disa plaçkitje dhe vjedhje. Merrej edhe me shitblerjen e drogave. Kishte një vajzë që para ca vitesh ia kishin marrë policia, për shkak se, kur kishte qenë nën ndikimin e drogës, në mes të natës e kishte nxjerrë vajzën e mitur nga dhoma, duke e lënë gjysmëlakuriq në mes të rrugës. Vajza kishte qarë. Pas mesit të natës, të lajmëruar nga dikush, kishin ardhur policët dhe e kishin arrestuar atë bashkë me dashnorin e saj, kurse vajzën e kishin dërguar në një jetimore të qytetit. Prostitutat, që

nuk i zbatonin urdhrat e saj, i shkallmonte grushte. Të gjithë e quanin Big-mama. Emrin e vërtetë askush nuk ia dinte. Kishte tipare mashkullore.

Big-mamaja ishte duke përgatitur një shirit koka-ine mbi syprinën e tavolinës. Kur Besimi hyri brenda, ajo ktheu kokën rrëmbyeshëm dhe me një buzëqeshje të shfrenuar zgjati dorën drejt tij. Besimi ia zgjati dorën dhe pastaj u ul fare pranë saj, duke shikuar me admirim shiritin e bardhë të drogës të zgjatur mbi tavolinë.

“Nuk kam tjetër, por e ndajmë së bashku,“ – tha ajo, duke ia ledhatuar flokët butësisht.

“Kam unë!”

“Ma jep, pra! E sheh se edhe ashtu kam pak!”

“Merre!” – dhe ia zgjati një qeskë të vogël me pluhurin e bardhë në fundin e tij.

Big-mamaja e mori najlonin dhe e hapi shpejt, duke e derdhur me kujdes dhe duke e tërhequr zgjatshëm mbi tavolinë. Pastaj, ajo afroi hundën mbi tavolinë, fare pranë fillit të pluhurit. Me një tërheqje të rrufeshme frymëmarrjeje, ajo e tërhoqi pluhurin, duke e thithur përmes vrimës së hundës. Sikur të kishte pirë ndonjë pije të lezetshme, me një “ah” të lehtë dhe duke fërkuar hundët u largua nga tavolina, duke ia lënë radhën Besimi, i cili përsëriti veprimin e saj.

“Si shkojnë punët këtu?” – pyeti Besimi pastaj.

“Mirë. Vajzat shqiptare kanë më se shumti kërkesa, sidomos nga bashkëvendësit e tyre. Por, mua po me brengos një gjë: klientët shqiptarë, pasi t’i kenë shfryrë epshet e tyre mbi to, ulen e iu mbajnë ligjërata patriotike, duke ua marrë kohën. Kjo s’po me pëlqen aspak. Ju të gjithë me dukeni se jeni të njëjtë. Fshehurazi jeni



seksualisht të tërbuar, kurse haptas paraqiteni moralist të përkryer!... Bionden ta kam rezervuar. Të them të drejtën, ajo nuk të do ty. Pse e do pikërisht atë. Eja të unë,“ - dhe zgjati duart drejt tij, duke e tërhequr nga vetja dhe vazhdoi: – „Prapë më ka thënë se... ”

“E di se ç’thotë ajo. Është vetëm në dhomë?”

“Po. Është shumë e shqetësuar sonte. Ka një brengë, por nuk ma tha.”

“Do t’ia largoj unë brengat... shkova!”

“Nëse të kundërshton, të lutem mos e nga. Eja të unë! Ka disa ditë që më është ankuar se ti po e nget... si te të them, me duket se po e tepron!”

“Atë e di unë!” - tha Besimi me nervozë dhe doli.

U afrua afër derës së biondinës dhe për disa çaste qëndroi i heshtur. Pasi u bind se ajo vërtet flinte, e shytyu derën. Vajza flinte e qetë. Ishte e shtrirë në bark. Flokët e gjata dhe të verdha iu kishin shpërndarë butësisht mbi jastëkun me lule, kurse disa blej i rrinin të shpupurishura mbi supin lakuriq. U afrua ngadalë dhe ia hodhi lehtë dorën mbi sup. Pastaj, ngadalë, e ngjiti lartë deri të qafa, duke i përzier gishtat me flokët e saj të buta si mëndafshi. Ajo u shkund pakëz dhe vazhdoi gërhitjen e qetë. Besimi e lëvizi prapë dorën, por kësaj radhe në tjetër kahe. Pëllëmba e tij tani kishte zënë vend mbi vithet e saj. Ajo u përmend dhe befas, sikur ta kishte sulmuar dikush, me një klithje trishtuese u rrotullua, duke u ulur në shtrat e frikësuar.

“Lugat! Me trishtove! Të lutem, më lër të qetë. Nuk ndjem mirë. Të lutem!”

“Shshsht! Qetësohu një herë!”

“Më lër të qetë, pra! Të lutem!... Nuk e ndjej veten mirë!... shko tani... ik!...”

„Për këtë punë të paguaj,“ – tha qetë Besimi, dhe me dorën e djathtë e rrotulloi mbi shtrat. Vajza kundërshtoi. Besimi, pa e zgjatur, i ra shuplakë fytyrës dhe prapë e shtriu në shtrat. - „Rri si të them unë, se të plasa!“ – u kërcënua ai, pasi që me pëllëmbën e djathtë e kishte shtrënguar rreth fytyrës së saj të hollë. Ajo nuk lëvizti më. E shtrirë në shtrat, me kokën e kthyer nga muri, me duar të hapura sikur ishte duke pritur dikë që e donte ta merrte në përfaqim, ndjeu peshën e trupit të tij mbi vete. Lotët i rridhnin tatëpjetë mollëzave, duke e lagur cepin e veshit dhe të vëthit të saj, që shkëlqente në dritën e kuqërremtë të abazhurit.

Disa herë kishte tentuar të largohej nga ky ferr, por kishte dështuar. Paratë që kishte mundur t’i sajonte për ikje, gjatë një kontrolli ia kishte konfiskuar Besimi. Pastaj Big-mamaja e kishte keqtrajtuar fizikisht. Kurrë nuk kishte menduar se do të binte në një rrjetë të tillë. Kur ishte nisur nga shtëpia, kishte menduar se po shkonte në një shtet të civilizuar, për të punuar për tre muaj me leje studentore të qëndrimit dhe pastaj, me paratë që do të fitonte, do t’i vazhdonte studimet në vitin e tretë.

Kishte një muaj që nuk e kishin lejuar të dilte as në rrugë, as në ndonjë park të qytetit, që të merrte pak ajër të pastër. Eh, sikur të dinte mamaja se ku ndodhem unë!... Dhe prapë vala e lotëve...

Pas përfundimit të epsheve të tij, Besimi me nervozë ia përplasi këmbët për muri, duke i shkaktuar dhem-

bje. Ajo u mblodh kruspull. Me dorë tërhoqi batanijen, duke e mbuluar edhe fytyrën. Tani qante me dënesë. Besimi, ashtu i ngurtë siç ishte, doli. Pasi i mori paratë që i kishte mbledhur Big-mamaja gjatë asaj dite, iku në banesë, ku e priste Koli.

\*

Kaherë gota e birrës kishte mbetur e zbrazur. Për të dytën herë erdhi kamerierja, për të marrë porosi të re. Besimi nuk pranoi. Jam në pritje, tha. Vonesa nuk ishte e zakonshme. Ai, kur vonohej, e lajmëronte. Do të pres edhe pak, mendoi. As vetë nuk e kishte besuar se do të priste kaq gjatë. Disi një lloj frike në mënyrë tinëzore i kishte hyrë në tërë qenien e tij. Mbrëmë kishte pasur një natë të keqe. Kishte parë ëndrra të tmerrshme. Tani edhe kjo pritje sesi ia shtonte edhe më shumë dyshimin.

Në tavolinën matanë kishte zënë vend një i ri me flokë të gjata dhe të përlyera. Kishte veshur një xhaketë xhins dhe në dorë mbante një qese të vogël me ngjyrë të verdhë. Mbante kokën ulur, duke lexuar gazetë. Disa herë Besimi e ndjeu peshën e shikimit të tij. Ç'më shikon ashtu? Sigurisht kërkon drogë, shanky.

Kësaj radhe kishte vendosur të ikte. Thirri kamerieren dhe bëri pagesën. Në rrugë e ndjente veten me të sigurt, në mes të asaj tollovi. Sakaq e gllabëroi turma, e cila ishte shtuar çuditërisht në kohët e fundit. Ishte buzë mbrëmjeje. Orari zyrtar i punës kishte përfunduar. Njerëzit të lodhur nga dita e gjatë e punës, si dhe nga vapa vraponin secili që të gjente një vend të qetë për të kaluar atë pushim të shkurtër të buzëmbremjes dhe për

t'u freskuar në freskun e mbrëmjes që po avitej.

Pranë një vitrine ndaloi. Ju bë se pa një fytyrë të njohur në mes të asaj turme. Vrapoi pas saj, duke bërë një rreth të gjerë, por duke e mbajtur gjithnjë në sy të njohurën. I doli përpara. Nuk ishte gabuar. Ishte Bardha. Ajo çapitej me atë stilin e saj të njohur dhe shumë të dashur për të. Dukej e qetë pranë babait dhe Dafinës. Sa qenka rritur Dafina? O zot, si po kalonin vitet! Për një çast mbeti si i mpirë. Vërtet ishte Bardha. Iu duk se ishte bërë edhe më e bukur. Kishte veshur një fustan ngjyrë vjollce dhe një bluzë të bardhë, të qëndisur me lule në të dy anët dhe e stolisur me sedefe. Në mes të gjoksit të fryrë dhe të bukur, kishte të pikturuar një figurë vajze. Besimit iu duk se flokët i kishte më të gjata dhe, ashtu të lëshuara, i valëviteshin mbi supe. Kur ajo kaloi pranë, në profil pa edhe gushën e saj të bardhë dhe vëthin të varur në vesh. Sa do ta dëshironte atë gushë të bukur, atë faqe të lëmuar dhe atë trup, që ju bë se kishte shtuar pak në peshë. Ajo ia ktheu shpinën me të njëjtën çapitje dhe Besimit nuk i shpëtoi dot pa i vërejtur lëkundjet e lehta të vitheve. Duke biseduar me babanë, kaloi fare pranë tij. Ia dëgjoi edhe zërin kur i thoshte t'et:

“...të kthehem në shtëpi, se ndoshta do të lajmërohet në telefon...” - dhe nuk e dëgjoi më, sepse ajo u largua. Besimit ju duk se ndjeu edhe erën e njohur të flokëve të saj. Ishte një erë që në çast ju duk e ëmbël, e njohur, një erë që i ndolli kujtime dhe mall. Sa paskam pasur mall për të dhe nuk e kam ditur! Të shkojmë në shtëpi, tha. Do të thotë se ajo banon në Luzern. Sa e bukur që ishte. O Zot, si u bëra budalla dhe e humba! Si

ta kthej prapë ë? Ç'të bëj? Ta përcjell deri në shtëpinë e saj, së paku të çmallem me të nga distanca!

Si i çmendur vraponte pas tyre dhe, kur i arrinte, kalonte në anën tjetër të trotuarit, pastaj, ashtu i strukur prapa vitrinave, shikonte si i shastisur. Edhe frika që pak më parë ia kishte mbështjellë tërë qenien e tij, tani i qe larguar si t'ia kishte hequr dikush me dorë. Edhe merakun për mosardhjen e Zefit e kishte harruar fare. Tani në kokë i ziente vetëm një mendim: Si të zbulonte se ku banonte ajo dhe si të bënte që ta rikthente prapë. Kjo duhet të ndodhë patjetër. Do t'i kërkoj falje dhe pastaj do të largohem së bashku me të nga ky vend. Bashkë do të fillojmë një jetë të re. Fundi i fundit, ajo akoma është gruaja ime. Kam kurorë me të. Sa mirë. Vetëm të mos rrëmbehem, të mos bëj ndonjë marrëzi pastaj t'i bëj punët m...! Sa mirë që e pashë!

Sa vinte dhe mbrëmja po afrohej. Dritat e neonit ishin ndezur. Flladi i mbrëmjes ishte shtuar si pui e lehtë, që butësisht ia thithte djersët, duke ia mbushur mushkëritë me freski. Që larg u dëgjua sirena e trenit. Në rrugë lëviznin veturat dhe, në dukje të parë, kishe përshtypjen se shkonin me një shpejtësi të madhe. Poshtë, te kryqi, pa kur u mbyll semafori për kalimin e këmbësorëve. Bardha ndaloi. Edhe kalimtarët e tjerë ndaluan. Besimi deshi të kalonte rrugën në një vend tjetër, për t'i prerë rrugën edhe një herë Bardhës. Si nëpër ëndërr iu bë se pa atë fytyrën e "shankyt", që e kishte parë në restorant. Ktheu kokën edhe një herë për të vërejtur më mirë. Ishte e njëjta fytyrë. Si është e mundur që edhe ky të ketë arrirë kaq shpejt këtu? Nuk pati kohë as të mendonte më gjatë, sepse "shanky"

afrohej me një shpejtësi marramendëse. Mendjen e kishte të Bardha, që akoma ishte duke pritur te semafori. Shanky ishte afruar tani fare pranë, duke zgjatur dorën që në të e kishte akoma atë qesen e verdhë dhe u bë gati të fliste. Sigurisht do të me pyesë për ndonjë rrugë, apo atë fjalën e tyre të njohur “Häsch etwas?” kur kërkojnë drogë. Dorën që e kishte të lirë, e futi në xhep. Besimi mendoi se për një çast ai do të nxirrte ndonjë letër, në të cilën do të kishte të shënuar pyetjen, që do t’ia bënte, dhe sakaq u kthye nga ai.

“Kriminal polizei!“ – tha ai që deri në atë moment e kishte quajtur shanky. - „Ausweis bitte!“

Besimi hodhi një shikim të rrufeshëm në drejtim të semaforit, që sapo ishte hapur. Bëri sikur e fuste dorën në xhep për të nxjerrë letërnjoftimin dhe, me sa fuqi që pati, me të dy duart e shtyu shankin, duke ia dhënë vrapit në drejtim të semaforit. Porsa i kaloi këmbësorët dhe u ndodh në mes të rrugës automobilistike, se nga doli edhe një tjetër burrë, duke e kapur fuqishëm nga dora. Besimi i dha krahut që të shkëputej nga ai, por ishte e pamundur. Tani aty kishin mbërritur edhe dy burra tjerë. Sakaq e pa veten të shtrirë përtokë. Njëri ia vuri këpucën e rëndë në qafë, duke shqelmuar thuaja me krejt peshën që kishte, kurse revolen e gatshme për zjarr ia mbante mbi kokë. E hetoi kur një tjetër ia vuri prangat. Ndoshta ishte shanky, mendoi kalimthi. Pasi e tërhoqën, duke u ngritur në këmbë, pa Bardhën. Ajo e njohu dhe instinktivisht e vuri dorën të goja, duke lëshuar një “uaa” nga habia.

Çudi, gjithë ai ngazëllim i mëparshëm, gjithë ajo dëshirë për të qenë pranë saj, ajo mahnitje për atë bu-

kuri të harruar, ajo dëshirë për ta parë nga afër, ai afsh i papërmbajtur për ta prekur, për ta ledhatuar atë trup që ju bë se e kishte harruar fare, gjithë ai mall u shua sakaq, si një flakë kashte, duke ju kthyer në urrejtje të papërmbajtur. Iu bë se e tëra ishte një grackë e përgatitur enkas nga ajo, dhe asgjë më tepër! Dëshiron të më heqë qafe, mendoj trishtueshëm.

Nga brezi ia nxorën revolen, që nuk kishte pasur kohë as dorën ta shtrinte drejt saj. E tërhoqën në drejtim të një veture, që ishte e ndaluar në trotuarin matanë rrugës. Pasi e futën dhunshëm në veturë, ktheu kokën dhe pa edhe një herë nga Bardha, e cila akoma mbante vështrimin nga ai dhe të dy duart në faqe. Uli shikimin poshtë, i turpëruar. Të paktën ajo të mos më kishte parë, mendoj.

\*

Muzgu i asaj mbrëmje e zuri në një qeli të vogël burgu në qytetin Luzern. Ndërtesa e rrethuar me kangjella hekuri dhe me tela katrore, që ndodhej në qendër të qytetit, i qe dukur e njohur. E dinte se deri afër saj kishte qenë disa herë. E kishte ditur se aty është stacioni qendror i policisë kriminale. Shumë herë, kur kishte kaluar pranë saj, mornica të ftohta ia kishin përshkuar tërë trupin. Vetë puna e tij e kishte detyruar që po thuj çdo javë ta vizitonte këtë qytet.

Në qeli ishte edhe një burrë tjetër, me flokë të gjata dhe të thinjura, që sorollatej sa poshtë-lartë, duke i shpupuritur flokët me dorë. Porsa hyri Besimi, ai i kërkoi cigare. Besimi nxori kutinë dhe ia zgjati. Ai e mori. Duke e futur cigaren në gojë, i tha faleminderit.

Qelia e burgut ishte mesatare. Në anën e djathtë, pranë derës së hyrjes, ishte dera e banjës. Pak më tutje, po në të njëjtin krah, ishin dy shtretër të vendosur njëri mbi tjetrin. Në krahun e majtë ishte një tavolinë e përforcuar në betonin e dyshemesë dhe dy karrige, po ashtu të përforcuara në murin anësor. Mbi tavolinë ishte edhe një grumbull gazetash. Besimi u ul në njërën nga karriget dhe, pa e pasur mendjen aty, filloj t'i shfletonte gazetat.

“Ç’të ka ndodhur?” – pyeti burri hutueshëm.

“Asgjë. Në rrugë më arrestuan. Ndoshta ju ngjaj në ndonjë person në kërkim. Po ju?” – pyeti Basimi, duke e shikuar me mospërfillje.

“Për tatim. Jam guvernator i një banke private dhe me akuzojnë se gjoja unë nuk ia kam paguar tatimin shtetit,“ – u përgjigj tjetri.

Ra heshtje. Si nëpër ëndërr, Besimit iu duk se dëgjoi muzikë. Nuk ia kishte vënë veshin, sepse muzika që në fillim kishte qenë e pranishme. Në murin e majtë, pranë derës së hyrjes, pa të vendosur një pllakë, të cilës burri iu afrua dhe, duke shtypur një sustë, i dha më shumë zë radios. Muzika paralajmëronte fillimin e lajmeve. Besimi deshi të fliste diçka, por burri, duke e afruar gishtin tregues te hunda, ia bëri shshshsh!

Besimi nuk foli. Sytë i hodhi prapë mbi gazetë. Spikerja vazhdonte të lexonte lajmet. Pas pak iu bë se dëgjoi emrin e një rruge të njohur, pastaj njoftimin se nga kati i katërt i një ndërtese kishte kërcyer një vajzë njëzetvjeçare, me kombësi çeke. Pastaj prapë muzika. Se si i erdhi ky njoftim, disi i njohur. Për një çast mbeti i hutuar. Sytë i kishte zgurdulluar, duke e shikuar bur-



rin që prapë kishte filluar të sorollatej poshtë-lartë qelisë, duke ju rënë flokëve me dorë. Burri e hetoi se ai ishte kureshtar të dinte diç, por nuk e kishte të qartë se ç'kërkonte. Pasi ndaloi pak hapin, duke vënë buzën në gaz, e pyeti:

“Nuk ndihesh mirë? Mos u merakos. Edhe unë ditën e parë të arrestimit kam qenë në këtë gjendje. Do të kalojë.”

“Jo, jo, por më fal se nuk e kuptova mirë, ç'ka ngjarë me atë vajzën që e tha pak më parë spikerja në lajme?”

“Aha. Një çeke ka bërë vetëvrasje, duke u hedhur nga kati i katërt,” – u përgjigj burri. – „Kjo ka ndodhur mbrëmë, pas mesit të natës. Tërë ditën, në çdo emision të lajmeve e kanë dhënë njoftimin.”

“Ku ka ndodhur rasti?” – pyeti Besimi i shqetësuar në vete, por me një mospërfillje të shtirë.

“Në Zürich, përtej qytetit të vjetër, buzë një mali.”

“Aha!” – ia bëri Besimi, prapë duke ulur kokën mbi gazetë, sikur donte të lexonte. Kurse thellë në shpirt ndjeu një shkepëputje. Iu bë se edhe fryma do t'i zihet. Si një valë e nxehtë, përvëluese, i erdhi ky njoftim, duke ia përshkuar gjithë trupin. E kishte të qartë tani se ç'kishte ndodhur mbrëmë me vajzën që kishte pasur marrëdhënie pa dëshirën e saj. E ndjeu se kjo do t'ishte humbja më e madhe dhe më e rëndë në jetën e tij, nëse është fjala për atë vajzë! Vuri të dy duar mbi mollëzat e faqeve dhe u kërrus edhe më, duke u bërë një me tavolinën. Nuk dinte se nga t'i fillonte mendimet. Si të gjendej. O zot! ... Lule isha dje, ku rashë sot!

Nuk i kujtohej sa kohë kishte qëndruar në këtë agoni. Kishte harruar se në atë dhomë ndodhej edhe një person tjetër. U përmend vetëm atëherë, kur ai i foli diçka. Pasi nuk e mori vesh se çfarë i tha, Besimi e pyeti:

“Si the, të lutëm?”

“Thashë, është koha për të fjetur. Tani i fikin dritat. Këtu ka rregull!” – tha ai, duke i dhënë fjalës një ton ironik.

U shtri edhe vetë. E kishte të qartë se gjumi nuk do ta zinte, por, megjithatë, rregulli... Ah, sikur ta kisha ditur më herët, mua nuk do të me kishin zënë fare, mendoj i trishtuar.

Koha kalonte dhe gjumi nuk i vinte. I bëhej se nganjëherë i afrohej, duke iu rënduar qepallat, por sakaq, disi rrëmbimthi, sikur ta kishte goditur dikush i padukshëm, i tretej në gjysmerrësirën e qelisë, që i ngjante si një varr i hapur, kurse shtrati si tabut. Burri në shtratin poshtë tij kishte kohë që gërhiste lehtë. I bëhej se ishte duke u përkundur si në një anije dhe para sysh prapë i dilte skena e një natë më parë, duke bërë krahasimin. Deshi të shikonte orën. Pasi e zgjati dorën, iu kujtua se edhe atë ia kishin konfiskuar. Mbrëmë isha... kam qenë i droguar, mendoj ai, dhe iu bë se këto fjalë ishte duke ia thënë hetuesit. Qepallat iu kishin rënduar. Sytë filluan t'i mbylleshin vetë. Në fillim iu bë se pas gjithë asaj lodhjeje, do të flinte i qetë, por ishte zhgënjyer. Prapë, te cepi i shtratit, iu bë se ishte vajza.

Në atë gjendje boshe siç ishte, as vetë nuk e dinte më se për të satën herë e solli atë ngjarje trishtuese nëpër mend. Iu duk se ishte duke i ngjitur shkallët e

vjetruara të “Klubit” të tij. Që larg, në korridor dëgjoheshin të qeshurat e gëzuara të vajzave. Ishin mbledhur në dhomën e Big-mamasë dhe bisedonin. I kënaqej syri duke i parë lëvizjet e tyre, bisedat dhe të qeshurat e tyre. Ato sikur dridheshin të tërat nga hareja, duke fërkuar lehtë flokët dhe pjesët delikate gjysmëlakuriq të trupit. Kënaqej duke i shikuar dhe e ndjente se ato vetëm ia shtonin edhe më tepër epshin. Sa mirë të jesh në mesin e tyre, të kënaqësh me ledhatimet e tyre, me fërkimet, gudulisjet dhe puthjet...

Hapi sytë. Në atë gjendje gjysmëndërritëse, kujtoi se ishte gdhirë. Ishte mashtruar. Drita vinte nga jashtë. U çudit, kur pa veten në atë dhomë të mugët. Për një çast nuk iu kujtua se ku ndodhej. Filloi t’i dalonte orenditë e pakta të dhomës, pastaj iu duke se e pa veten diku lartë, duke qëndruar pezull. Ktheu kokën drejt qiellit, por shikimi i tij u ndesh me tavanin, që e kishte fare pranë. Zemra ju ndrydh në çast. Ishte në qeli.

Psherëtiu thellë. Ishte një psherëtimë e thatë. Doli si nga një zgavër e vetmuar, kurse dufti që kishte filluar t’i shtresohej prapë, ngeli brenda mureve të qenies së tij, aty fare pranë zemrës, ku zakonisht zë vend.

Prapë u rikthye të ngjarja. Iu bë se ndjeu zërin e saj: “Lugat! Me trishtove! Të lutëm me le të qetë. Nuk ndjehem mirë. Të lutëm!” dhe pastaj u ngrit dhe doli nga dhoma, duke e lënë vajzën të qetë. Hapi derën, ku ndodhej Big-mamaja dhe, pa një pa dy, iu hodh sipëri. Ajo e dëshironte dhe iu bë se dëgjoi të qeshurën e saj... Eh! Psherëtiu mjerueshëm. Vërtet do të ishte mirë të kishte ngjarë kështu. Ndjeu se aty pranë zemrës shtre-

sa e dufit zinte shtresa të reja, palë-palë.

Kishte filluar të agonte. E vetmja shpresë për të ishte të përfitonte nga ndonjë rast që t'i jepej dhe të arratisej.

Si në agoni, ndjeu kur u hap dera. Kishte dremitur prapë. Hapi sytë. Shoku i qelisë ishte ngritur dhe vazhdonte ecejaket nëpër dhomë. U hodh poshtë pa vullnet dhe shpejt u vesh. Në derë qëndronte një burrë. Ia bëri me dorë që ta ndiqte pas. Posa doli në korridor, ia vunë prangat në duar, prapa shpine. Pastaj, duke e mbajtur nga të dy krahët, e shoqëruan në autoburgun e policisë.

Vetura çante nëpër rrugët e qytetit, por se ku ishte dhe ku po e çonin, nuk e dinte, sepse nuk shihte asgjë. Pas pak vetura ndaloi. I dëgjoi dyert të hapeshin. Prapë dy burrat civilë. E kapën nga të dy krahët dhe së bashku me të, u nisën drejt një dera të madhe. Nuk vonoi dhe e dërguan në një dhomë, te e cila arritën duke zbritur një palë shkallë. E mori me mend se ishte ndonjë podrum. Ia hapën një derë të rëndë dhe, pasi ia zgjidhen duart, e futën në një qeli boshe. Të vetmet orendi ishin një karrige e vogël, e përforcuar në murin anësor, dhe një tavolinë. Në ballë ishte dritarja me hekura të kryqëzuar. U afrua dhe e hapi. Fresku që erdhi nga jashtë ia ledhatoi fytyrën e lodhur. Në dukje të parë hekurat e kryqëzuar ju dukën të rrallë, por për të depërtuar nuk ishte i sigurt. Ta provoj një herë, mendoi dhe e afroi kokën pranë hekurave. Ishte i sigurt se aty ku depërton koka, mund të depërtojë edhe trupi. Gjatë shtyrjes së dhunshme, pati dhembje. Për një çast pati përshtypjen se do të mbetej i bllokuar në mes hekurash, sepse nuk

ishte më në gjendje as të depërtonte e as të tërhiqej. Koka i kishte mbetur në mes hekurash dhe në çast iu duk se e kishte vënë kokën e vet në karamanjollë dhe tani pritej vetëm tehu i mprehtë i shpatës. Djersë të ngrohta valë-valë ia përshkuan kokën, duke i rrjedhur tatëpjetë faqeve dhe qafës dhe për një çast ndaloi manovrimin. Kishte mbetur pezull. Nuk ishte në gjendje as të tërhiqej, as të vazhdonte para, kurse nga ana tjetër kishte frikë nga dera, nga ardhja e atyre. I dha edhe një herë vetit zor. Edhe nëse me mbetët një pjesë e lëkurës së kokës, ndoshta edhe veshët, sepse tani kishte dhembje pikërisht në vesh, me duhet të depërtoj. Më e vlefshme është koka se veshët, mendoi. Koka, është ajo që me duhet tani, dhe i dha me sa fuqi që pati... dhe, hop. Mrekulli! Koka depërtoi. Tani i mbetej trupi. I kthyer nga krahu i majtë, i dha trupit me gjithë fuqi që pati. Duke rrëshqitur dhe duke i duruar dhembjet, arriti të depërtonte. U shkëput dhe sakaq u gjend në tokë. Tutje ishte rrethoja me kangjella të hekurt, që nuk ishte ndonjë vështirësi për ta kaluar. Shikoi majtas e djathtas se mos e kishte parë dikush dhe me të shpejt ua dha këmbëve. Me një të hedhur u gjend jashtë murit të ulët rrethues. Me vrap iku, duke pritur se tani apo më vonë do të dëgjohej alarmi i veturave të policisë.

Arriti të gjente pak para nga një plakë dhe nga një kabinë telefoni ju lajmërua Belit. I dha adresën se ku ndodhej dhe mbeti i fshehur prapa një ndërtese të mënjanuar, në pritje të tij.

Nuk kishin kaluar as dhjetë minuta, kur pranë vendit ku ishte i strehuar, arriti një veturë. Burri që doli nga vetura thirri në emër. Besimi doli nga skuta

dhe shkoi drejt tij. Sa shpejt erdhi, mendoj i gëzuar!  
Beli ka një organizim të mrekullueshëm, mendoj dhe,  
sakaq u gjend në veturë.

## VIII

*Happy birthday to you,  
Happy birthday dear Dafina!...*

Dafina i fryu qirinjtë e vegjël, që ishin të ngulur në anën e epërme të tortës. Nuk u fikën të gjithë. Një mbeti i ndezur. Dafina u mbush prapë me frymë dhe e fryu. Qiri u fik. Të pranishmit, që pak më parë kishin kënduar në kor këngën e njohur të ditëlindjes, duartrokitën gëzueshëm.

“Mami, qiriu që nuk u fik për të parën herë, tregon fat, a po jo?”

“Besoj se po!” – u përgjigj Meri.

“Mami, kjo është shoqja ime më re. Quhet Zana!” – tha Dafina, duke qëndruar një copë herë bri saj.

Zana u skuq lehtë.

“Sa emër të bukur paske, moj bijë! E gëzofsh!”

“Të faleminderit!” – u përgjigj ajo.

“Si quhet nëna jote?” – pyeti Meri, duke ia hedhur lehtë dorën mbi sup. Vajza u tkurr pak, duke u tërhequr prapa. Instinktivisht vuri duart në faqe, duke e mbuluar fytyrën. Me kokën ulur, shikimin e kishte mbërthyer në një pikë të pacaktuar, diku në mesin e qilimit. Ajo dukej e hutuar. Hareja që pak më parë i kishte lëvizur gëzueshëm në fytyrë, iu zhduk në çast.

“Nuk kam nënë!... e vranë shkijet!...” – tha vajza, duke u shtyrë edhe më prapa dhe duke u mbështetur fort pas mbështetëses së butë të minderit. Në çast Dafina e tërhoqi nga dora dhe të dyja së bashku ikën në dhomën e saj.

Ra zilja. Në korridor doli plaku, babai i Mentorit. Apartamenti ku banonin ishte i madh. Ishte një shtëpi e vjetër, pak e mënjanuar, në periferi të qytetit. Pas kërkesës për azil politik, Mentori ishte vendosur në këtë shtëpi, në fillim me babanë, pastaj kishin ardhur Meri me fëmijët dhe me Bardhën, kurse tani, të larguar dhunshëm nga forcat ushtarake serbe, kishin arritur edhe prestarët e tjerë të familjes.

Në derë ishte Agimi me Lulen dhe me fëmijët e tyre. Që nga koha kur Agimi kishte ushtruar detyrën e policit, bashkë me Ferin, Lulja nuk i kishte shkëputur lidhjet e vjetra me Bardhën. Kjo lidhje sikur ishte forcuar edhe më, kohëve të fundit, kur familja e Lules ishte masakruar thuaja e tëra. Kishte shpëtuar vetëm një çun dhjetë vjeç, i cili, pas shumë vuajtjeve dhe me ndihmën e Agimit, kishte arritur pranë hallës së tij. Edhe ai sonte ndodhej në mesin e tyre. Rrinte i mënjanuar dhe i heshtur, pa bezdisur askënd me pikëllimin e tij. Ulej zakonisht pranë Lules dhe herë pas here ia merrte dorën, sikur kishte frikë se edhe ajo, e vetmja shenjë e familjes dhe e fisit të tij, do të zhdukej nga çasti në çast.

Lulja e puthi lehtë Dafinën, duke ia lëshuar në dorë një dhuratë, një pako të mbështjellë me letër të shkëlqyer dhe të lidhur me një fjongo të kuqe.

Pasi u përshëndeten me t’pranishmit, zunë vend në divan. Përballë tyre u ul plaku, kurse në të djathtë



rrinte në këmbë Bardha, duke u dëshiruar mirëseardhje. Pranë Lules u ul nipi i saj, i cili ia mbante akoma dorën, i heshtur dhe kokulur. Shyqyr që nuk ishte më parë, kur u këndua kënga e ditëlindjes, se do të mërzitej, mendoi Bardha, duke u afruar pranë tij dhe duke ia ledhatuar këndshëm flokët e tij të zezë.

Që kur kishte filluar lufta në Kosovë, nuk kishte ndodhur që një mbrëmje të kalonin vetëm për vetëm me anëtarët e familjes. Para se të fillonte lufta, shtëpia e tyre kishte qenë vendtakim për shumë patriotë, e veçmas për ushtarakët. Ata, megjithëqë të degdisur nëpër vende të ndryshme nuk i kishin shkëputur lidhjet me njeri-tjetrin, duke gjetur mënyrë për t'u takuar herë pas here. Kishte edhe nga ata që vërtet ishin veshur trashë me rrobat e dimrit politik, që po afronte, i rënduar dhe i acartë si asnjëherë më parë. Kjo veshje politike kishte bërë që si pykë në mes tyre dhe politikanëve të futej thika e përçarjes. Megjithatë, kishte edhe nga ata që nuk i kishin ndërruar uniformat e tyre ushtarake me kostumet politike.

Mentori ndodhej në luftë, bashkë me shumë shokë. Në shtëpinë e tyre venin e vinin shumë njerëz. Dikush vinte thjeshtë për kuriozitet. Dikush vinte për ngushëllim. Disa vinin për t'u dhënë zemër. Kishte edhe nga ata që vinin për t'i dëshpëruar edhe më keq. Mirë t'u behët edhe nëse ai vritet atje. Vet i kanë fajet, zhelja e tij do të merret me politikë. Kush? Ky në luftë? E paça n'qafë! Jam i sigurt se ai është diku i fshehur, në ndonjë hotel atje në Tiranë. Po çfarë lufte bënë ai!?

Sa vinte dhe zërat e këtyre të fundit pakësoheshin dhe dita-ditës pjesa më e madhe e tyre e ndjente për

turp për ato që kishin thënë dikur. Koha i kishte nxjerrë shumë gjëra në pah. Nuk kishte familje shqiptare në mbarë Kosovën që nuk ishte luajtur nga vendi, që nuk ishte dridhur nga tmerri, që nuk kishte humbur të dashuritë e tyre, që nuk ishte plaçkitur, dhunuar, gjakosur, poshtëruar e shndërruar nga barbaritë serbe.

Prapë ra zilja. Derën e hapi Bardha. Ishte zonja Hegmann. Si gjithmonë, e qeshur dhe e hareshme. Të linte përshtypjen se ishte një grua që nuk kishte brena fare. Pas puthjeve të zakonshme që ia bëri Bardhës, ajo puthi ëmbël Dafinën, duke i lëshuar në dorë një dhuratë.

“Mirë se na erdhe, zonja Hegmann!” – tha Bardha në çastin që ju duk se të gjithë mysafirët kishin zënë vendet.

“Mirë se ju gjej!” – tha zonja Hegmann me shqipen e saj të thyer me një theks të veçantë gjerman.

Kishte shumë vite që zonja Hegmann punonte si koordinatore sociale pranë qendrës së pranimi të refugjatëve. Ajo kishte një konsideratë të jashtëzakonshme për shqiptarët në përgjithësi. Kur Mentori kishte vënë kërkesën për azil politik, ajo i kishte ndihmuar në sistemimin dhe në inkuadrimin në rrjedhat e jetës. Pastaj, Mentori kishte treguar një zgjuarsiri të pashoqe, duke e mësuar shpejt dhe rrjedhshëm gjuhën gjermane. Duke e parë talentin e tij, zonja Hegmann e kishte marrë pranë zyrës së saj, për t'i ndihmuar në sistemimin e shumë refugjatëve shqiptarë, që pareshtur vinin në tokën zvicerane. Më vonë kishte ardhur Bardha dhe Meri. Ajo i kishte angazhuar edhe ato, të cilat tani ishin krah i fortë në sistemimin e refugjatëve. Veç kësaj, Bardha

ndihmonte edhe në integrimin e familjeve shqiptare në kulturën e vendit, të atyre familjeve që kishin probleme të theksuara, si fjala vjen probleme ndërmjet burrit dhe gruas, apo ndërmjet prindërve dhe fëmijëve. Në rastin e parë shkaktar për problemet në familje ishte gruaja. Kulturën e vendit ajo e kthente në përdalie imorale, që Bardhën e kishte dëshpëruar pa masë.

Pas urimeve dhe përshëndetjeve, më në fund me një zë të qetë, plaku i ftoi të pranishmit të shkonin në kuzhinë. Ishte shenjë se darka ishte gati. Të gjithë u ngritën njëri pas tjetrit. Meri, si gjithmonë në këso rastesh, që në shtëpinë e tyre tani ishin bërë të përditshme, rrinte në këmbë, duke u gjendur herë të tryeza e fëmijëve, herë të tryeza e mysafirëve. Bardha nuk ishte ulur bashkë me mysafirët. Edhe ajo rrinte në këmbë, duke sjellë ndonjë pjatë, apo duke ua mbushur gotat mysafirëve me ujë mineral apo me verë. Lulja, herë pas here ngrinte kokën duke e shikuar me admirim fytyrën e hijshme të Bardhës. Dëshironte të mbetej vetëm për vetëm me Bardhën dhe të bisedonte por... nuk gjente se nuk gjente ndonjë rast të përshtatshëm.

“Bardha, dua te të them diçka!” – i tha pranë veshit, kur Bardha ishte kërrusur të merrte pjatën boshe të supës, që Lulja e kishte larguar një çikë tutje.

“Fol, Lule,” - tha ajo po ashtu qetë, me zë pëshpëritës.

Lulja e ndjeu se në zërin e saj kishte një pezëm, një brengë që e mundonte. Në fillim, kur kishte ardhur nga Kosova, Bardha kishte qenë vërtetë shumë e dëshpëruar. Kishte pasur një brengë të atillë që edhe po të donte t’i qasej dhe të merrej seriozisht me të, nuk

kishte pasur hapësirë veprimi. E dëshpëruar për shkak të dhunimit, disa herë kishte menduar t'i jepte fund jetës. Pastaj, sikur të mos mjaftonte e gjithë kjo, befas e kishin molepsur edhe më keq paudhësitë e të shoqit, që deri në një kohë e kishte gënjyer shpresa se ai do të kthehej dhe do të fillonin një jetë të re, në një vend dhe në një kohë tjetër. Këto ndjenja ishin shkalafitur, kur familja e tij e ngushtë, përmes gazetës e kishte dhënë njoftimin se nuk e njihnin për bir të tyre, për shkak të tradhtisë që kishte treguar kundër popullit të tij. Në pamundësi shkurorëzim, bashkë me familjen e saj, Bardha kishte marrë vendim të njëjtë më atë të familjes së Ferit, duke u distancuar prej tij përmes një komenti të shkurtër të botuar në gazetë. Që nga ajo kohë Bardha kishte jetuar e lirë.

E dekurajuar, nuk dëshironte as të bisedohej për martesë. Kishte marrë frikë, një lloj irritimi për meshkujt në përgjithësi, sa që, kur i kujtoheshin rrjedhat e jetës së saj në mes të tre burrave, mallkonte veten dhe nënën që e kishte lindur. I bëhej se ishte e lindur vetëm për të vuajtur, për ta nëpërkëmbur të tjerët, duke luajtur me fatin e saj. Sikur kishte lindur që me trupin e saj të bukur t'ua shuante epshet shtazarake njerëzve të poshtër. I kishte ndodhur që, kur ishte puna për të shkatërruar lidhjen e saj edhe ashtu të brishtë, ishin të pranishëm shumë njerëz, kurse tani, kur vinte puna për ndihmë, atë ia kishin kushtëzuar me nderin e saj. Këtë sjellje të keqe e kishin pasur edhe disa nga miqtë e shtëpisë. Shumë herë pendohej para t'et për egërsinë dhe tonin e rëndë të fjalëve që ia thoshte, kur ishte në kulmin e dëshpërimit, me ç'rast nuk i harronte as

këta “miq”. Ai, me kokën ulur, dëgjonte ato që thoshte Bardha, por nuk bëzante dhe, nën peshën e rëndë të fajit, sytë i mbusheshin me lot. Kur e shihte Bardha në këtë gjendje, i vinte keq për të dhe, duke i kërkuar falje, shkruhej në vaj.

Në sallonin e madh u dëgjua zilja e telefonit. Bardha hodhi vështrimin nga i ati. Ai ngriti pak kokën dhe vështrimin ia hodhi Merit, sikur donte t’i thoshte: merre, moj bijë, merre, pse më shikon ashtu? Meri, fët, u gjend në dhomën e ndejës, ku ishte telefoni. Zëri i saj arrinte i qetë deri në kuzhinë:

“Urdhëroni!...po, këtu është. Po luan me Dafinën. Në dhomën tjetër. Si urdhëro, menjëherë!...” - dhe ngriti kokën, duke e shikuar Bardhën. Pastaj iu drejtua asaj, pa e larguar dëgjuesen nga veshi, por duke e mbuluar me dorë mikrofonin. - „Lajmëroje Zanën, të kërkon babi, i thuaj!... ja tani po vjen, natën e mirë, s’ka gjë!...” – dhe e largoi dëgjuesen e telefonit nga veshi. Nga dhoma matanë dëgjohej zëri i Bardhës, duke i thënë Zanës se e kërkonte babai. Zana erdhi me vrap.

“Alo, babi. Mirë, po luaj. Babi, Dafina ma ka bërë një dhuratë të bukur... ëhë. Sa mirë është këtu, babi, si në shtëpinë tonë, atje në Kosovë!... ëhë, po babi. Menjëherë? Babi, të lutëm vetëm edhe pak dua të rri këtu!... E di që do të bëhet natë, por mua deri në banesë me shoqëron... me shoqëron...” - dhe shikimin e hodhi nga Meri, e cila qëndronte në këmbë pranë saj, duke e shikuar me dashuri e dhembje bashkë. Meri e kuptoi se çfarë dëshironte të thoshte me atë shikim, ndaj ia bëri më kokë në shenjë pohimi. Zana, me një shndritje të beftë fytyre, vazhdoi: - „Më shoqëron deri te banesa

nëna e Dafinës... të betohem, babi, besa-besë!“ – dhe prapë vështrimin e ndali mbi fytyrën e Merit, e cila i dha prapë të njëjtën shenjë. – „Edhe dy orë... jeeee! Të faleminderit, babi. Mirupafshim, babi!“ – dhe e lëshoi dëgjuesen e gëzuar. Dora-dorës me Dafinën ikën në dhomën tjetër.

Derisa Zana fliste në telefon, nga kuzhina arritën mysafirët, duke u ulur secili në vendin e vet. Zonja Hegmann erdhi e fundit. Të gjithë u ngritën në këmbë, duke ia lëshuar rrugën të ulej në vendin e saj. Ishte e mësuar me sjellje të tilla të shqiptarëve. Thellë në shpirt ndiente një lloj krenarie për këtë respekt, të cilin në fillim e kishte quajtur respekt i tepruar.

Lulja kishte dëshirë të gjente ndonjë rast të përshtatshëm për të biseduar me Bardhën, por në kohën kur po bëhej gati të fliste, tingëlloi si i molisur zëri i zonjës Hegmann, që i drejtohej Agimit:

„Me gjithë përpjekjet e mija që arrestimet e fundit të disa shqiptarëve të mos shpalleshin në shtyp, nuk arrita dot. Mediat e tjera e dhanë njoftimin, duke mos e dhënë identitetin e të arrestuarve, kurse e vetmja gazeta “Blick” e shpalli publikisht identitetin e tyre. Të them të drejtën, në këtë situatë, ky njoftim ishte skandal për luftën e drejtë të popullit tuaj. Këto arrestime i vërtetojnë deklaratat e disa zyrtarëve perëndimorë, të cilët UÇK-në e paraqesin organizatë marksiste-leniniste të implikuar thellë në trafikun e drogës dhe që fitimet i përdor për blerjen e armëve në tregun e zi, duke e zbehur rezistencën e luftëtarëve separatistë.“

„Kjo është e vërtetë. Por ata që merren me trafikim droge janë të pakët në krahasim me numrin e

shqiptarëve që jetojnë këtu. Nga njerëzit e ndershëm ata janë të mënjanuar dhe realisht nuk kanë asnjë lidhje me luftëtarët e lirisë. Në kemi lista të përpiluara në detaje se nga e kanë burimin paratë që janë grumbulluar për blerjen e armëve. Kemi edhe raporte konkrete se ku dhe si janë blerë armatimet.“

„Unë ju kuptoj, por në këtë rast nuk do t’ju kuptojnë ata që janë kundër luftës suaj.“

„Ata që janë kundër luftës sonë të drejtë, nuk duan ta kuptojnë realitetin e ri që është krijuar. Vendimet e Konferencës së Rambujës për Kosovën e vërtetojnë këtë. Me të drejtë ne mendojmë se në sfondin e kësaj konference është pavarësia e Kosovës,“ – tha Agimi, duke shikuar herë nga zonja Hegmann, herë fytyrën me rrudha të plakut, i cili fjalët e tij i miratonte me luhatje koke.

Ra heshtja. Dëgjoheshin vetëm lëvizjet e Merit, që ishte duke i mbledhur filxhanët dhe pëshpëritjet e Lules, e cila i thoshte diçka Bardhës fare pranë veshit. Sikur të ishte trembur nga ajo qetësi e beftë, ajo uli edhe më tepër zërin.

“...Agron e quajnë! Është i mrekullueshëm, ka qenë drejtor shkollë të ne!... bisedojmë një herë tjetër!...” – tha Lulja, duke ia vënë lehtë dorën mbi sup Bardhës, e cila ishte hera e parë që nuk ishte nevrikosur me këtë bisedë, edhe pse ajo i fliste hapur për një mashkull.

„Njëri nga të arrestuarit është arratisur nga burgu,“ – tha zonja Hegmann.

„Dëgjova, por nuk e mora vesh identitetin e tij,“ – tha qetë Agimi, duke shikuar hutueshëm fytyrën e

zonjës Hegmann.

“Shqiptar ishte!” – tha ajo.

Plaku ishte ngritur në këmbë dhe, me gotën e verës në dorë, me buzën në gaz, iu drejtua nga mysafirët:

“Epo, gëzuar dhe mirë se na keni ardhur!” – tha dhe ngriti dollinë.

“Gëzuar, për shëndetin e Dafinës, të Mentorit që gjendet në front dhe të mbarë familjes suaj!” – tha Agimi, duke e ngritur i pari dollinë.

Bardha la gotën dhe u hodhi një sy të pranishmëve, duke e ndalur vështrimin të Lulja. Ajo rrinte në kujtime. Në këso rastesh ajo ishte e prekshme dhe e gatshme për të qarë.

Ra rapë zilja e telefonit. Meri e mori receptorin.

“Urdhëroni! si je Mentor?” – ngriti zërin Meri. – „Ne mirë jemi... mirë, po i dëgjoi... po, po dëgjohej shumë mirë. Shokët si janë?... Si? Po, e kemi marrë vesh në lajme. Edhe në gazetë ishte! Urime! Po, kemi mysafirë. E festojmë ditëlindjen e Dafinës! Alo! Mentor, nuk dëgjohesh fare... alo!... u ndërpre! E kishin përfunduar me sukses betejën. Kishin pasur shumë të vrarë!... O Zot, si dëgjoheshin të shtënat!”

Më në fund mysafirët u ngritën njëri pas tjetrit, duke u uruar natën e mirë. Zana kishte mbetur akoma në korridor, duke pritur se kush do ta shoqëronte deri në shtëpinë e saj. Ishte e gëzuar se kishte qenë në këtë darkë, që kishte lozur me shumë shoqe, por ishte e merakosur, disi e pikëlluar se e kishte lënë babin vetëm në shtëpi. Ajo asnjëherë nuk e kishte lënë babin kaq gjatë vetëm. Shumë herë, kur ishte kthyer nga shkolla, e kishte gjetur babin të mbytur në lot. Ai qante për mamin,



për Dylin e vogël, për Vjollcën që i kishin masakruar para syve të tyre, pastaj për gjyshen plakë, që e kishin djegur të gjallë në shtëpi. Ajo, e dëshpëruar ulej pranë tij dhe të dy bashkë qanin... shumë qanin, nuk e din-te se sa gjatë qanin, por qanin derisa i zinte gjumi... Ndoshta edhe sonte do ta gjente babin duke qarë. Dhe sytë ju mbushën me lot.

“Eja, Zana,” – i tha plakui, duke ia zgjatur dorën. Zana, pasi iu uroi natën e mirë dhe pasi iu falenderua Merit, Bardhës dhe të tjerëve, ia zgjati dorën plakut dhe bashkë dolën në rrugë.

Bardha e mbylli derën prapa krahëve të tyre. Ishte vonë. E ndiente veten të lodhur. Pasi tha natën e mirë, ajo u shtri në shtratin e saj. Nesër është ditë pushimi, mendoi, duke u lëkundur lehtë mbi shtrat. E ndiente se nuk do ta zinte gjumi. Kjo i vinte si trazim i shkaktuar nga sihariqi i Lules për një Agron të imagjinuar, por pa pasur mundësi për sqarime të mëtejme dhe fjalët e frikshme të zonjës Hegmann, se i arratisuri nga burgu ishte shqiptar.

\*

Ju bë se ishte pranë tij. Ishte e humbur krejt në atë përqaftim. E ndjente. Ai e ledhatonte dhe e shtrëngonte. Sa e dëshironte atë ledhatim! Ishte aq e molepsur, sa që, nga frika se mos ishte në ëndërr, pyeti veten: Jam në ëndërr, apo e zgjuar? Megjithatë, përqaftimi dhe ledhatimi i tij vazhdonte. O Zot, nga erdhi ky këtu? Sa mirë që jam pranë tij. Iu bë se hapi sytë hutueshëm. E pa në sy. Në fillim ishin po ata sy, po ajo fytyrë, po ai shikim, po ajo buzëqeshje dhe disi ishte e çuditur që nuk e kishte

harruar pas kaq vitesh. Por pas pak e pa se ai po ndryshonte. Kishte një fytyrë të vrazhdët, me një shikim të egër dhe mallëngjyes një herësh. Kishte një pamje të trishtë dhe të frikshme, për të mos thënë të shëmtuar. Por ishte e sigurt se ai ishte. Edhe me këtë pamje ajo e dëshironte. E shikoi ngultas në sy dhe... e sigurt, ai ishte... oh sa mirë!... dhe zgjati dorën për ta prekur, por ai befasi e tërhoqi fytyrën tutje, u largua... Zgjati dorën më fort. Ai u tërhoq edhe më larg. I dha dorës fuqishëm për ta kapur, por ndjeu dhembje. E kishte goditur murin. E dëgjoj edhe trokitjen. Hapi sytë. Natë. Errësirë. E vetme në shtrat. Zgjati dorën dhe ndezi abazhurin. Drita e solli në vete. Kishte ëndërruar. U përpoq edhe një herë të rikujtonte ëndrrën. Ishte vërtetë e mrekullueshme. Sa do të dëshironte tani ta kishte pranë. Me të dy duart shtrëngoi lehtë gjinjtë e saj të fryrë, pastaj i zbriti duart poshtë trupit, duke ledhatuar lehtë zonat erogjene. Ëndërr, tha me vete dhe iu kujtua Lulja dhe ai Agroni i imagjinuar. Ndoshta emri i tij e kishte stimuluar drejt ëndërrimit. Kishte lexuar diku se truri i njeriut ka nevojë të vazhdueshme për stimulim. Gjatë ditës truri stimulohet nga jashtë, kurse gjatë natës, kur nuk ka stimul të jashtëm, truri bën vetë përpunimin e atyre imazheve, që i ka hasur gjatë ditës dhe pason ëndrra. Si në vegjime, iu kujtua se, para se të ndodhte bastisja dhe dhunimi i saj, kishte parë ëndërr dy gjarpërinj të mëdhenj që e kishin sulmuar. Në atë mugëtirë kaltëroshe ajo ishte fshehur, por në mënyrë dinake, prapa krahëve, e kishte sulmuar njëri gjarpër, duke e kafshuar në këmbë. Ç'janë këta gjarpërinj në këtë mugëtirë, kishte pyetur veten dhe mendja i kishte shkuar te gjyshja plakë, e cila

i kishte thënë se gjarpërinjtë nuk lëvizin në errësirë. E tmerruar ishte shkundur dhe kishte arritur që të ikte prej tyre, por befasisht kishte rënë në një pus të thellë dhe kishte mbetur e vetmuar. Edhe pse ajo nuk kishte qenë kurrë besëtyte, disi ata gjarpërinj dhe ai pus i frikshëm për një kohë të gjatë nuk iu kishin shqitur nga mendja.

Gjumi i qe larguar fare. Ngadalë u ngrit nga shtrati. Një copë herë ndenji në mes të dhomës, pa ditur se çfarë të bënte. Pastaj e shikoi orën. Tre pa një çerek. Hapi dritaren. Fresku i mesnatës ia ledhatoi faqet. Ç'të bëj tani, pyeti veten. Ndezi poçin elektrik. Vështrimin e hodhi rreth e qark dhomës së mobiluar thjeshtë, pastaj vështrimin e ndali mbi dollapin e vjetër, që ishte i montuar në mur. I bardhë dhe i ftohtë. Hapi derëzën ngadalë dhe filloj të gjurmonte. Rroba të vjetra, gazeta që për ndonjë artikull i ruante akoma Mentori, libra, rroba të trasha dimri, ombrella, këpucë... o Zot, çka s'ka këtu, mendoj. Ato që nuk përdorehin, i hidhnin në këtë dollap, ashtu pa kujdes. Po të kërkoje diç në këtë rrëmujë, së pari duhej që të nxirreshin gjysma e tyre, derisa të gjeje atë që e kërkoje. Kishte edhe shumë dokumente të t'et. Befas ju kujtua se ai, para disa ditësh, i kishte thënë se ato dokumente duhej të nxirreshin nga dollapi dhe të bëhej një seleksionim i tyre, sepse kishte edhe të atilla që nuk kishin më ndonjë vlerë, si fletëpagesa të banesës, të rrymës, të sigurimit shëndetësorë etj..

Duke nxjerrë njërin pas tjetrit dosjet, në mesin e tyre gjeti një zarf të madh, mbi të cilin ishte i shkruar emri i saj. Shkrimi ishte i të atit. E mori në dorë. E hapi me kureshtje. Nuk ju prit derisa ta fuste dorën brenda dhe t'i nxirrte gjërat një nga një, por ashtu siç ishin

i zbrazti mbi syprinën e komodinës, ku ishte abazhuri. Nga brendia dolën copa letrash dhe kasetat të magnetofonit.

“Ua!” – bëri Bardha, e çuditur dhe e gëzuar bashkë. - „Letrat e Agronit, që m’i ka marrë atëherë Ademi. Sa mirë që i gjeta! Edhe kasetat qenkan këtu!” – tha me zë të ulët. Ishin kasetat që ia kishte incizuar të atit, kur ishte në shkollë, me epet dhe vjershat që i kishte recituar. Për një çast i harroi letrat, duke kërkuar me sy magnetofonin. Nuk e pa. Tani iu kujtua se mbrëmë e kishte marrë i ati për të dëgjuar lajmet në “Zërin e Amerikës”. Kasetat i dëgjoi më vonë, mendoi dhe sakaq vështrimin e hodhi mbi letrat. E njohu shkrimin. Ishin letrat që dikur i kishte gjetur të fshehura në zgavrën e murit, atje prapa pojatës së vjetër, që ia kishte shkruar Agroni. – „Sa mirë që i gjeta. Përse i ka ruajtur babi këto!” – pyeti veten e çuditur. Gjetej edhe letrën e vet, që ia kishte shkruar Agronit, e cila kurrë nuk i kishte rënë në dorë, sepse Ademi ia kishte rrëmbyer nga çanta e librave të saj. Do t’i lexoj të gjitha me radhë, mendoi.

Atë qetësi nate e theri kambana e kishës, që vinte nga qendra e qytetit pak e venitur, me tonin e saj të hekurit. Diku larg, gati e shurdhër, u dëgjua sirena e trenit. Nga rruga matanë, si të përgjumura, dëgjoheshin lëvizjet e rralla të veturave. Bardha ndjeu të ftohtë. La letrat mbi komodinë dhe u shtri në shtrat, i cili ende ruante ngrohtësinë e trupit të saj. Ndjeu se një palë mornica ia përshkuan trupin. Ishte e sigurt se ato letra do t’i sillnin nostalgji për t’kaluarën, por megjithatë e dëshironte atë nostalgji. Shikimin e hodhi mbi to. Ju duken të dashura, të afërta, por një herësh edhe të heshtura, të ftohta,

indiferente. Ato nuk thoshin asgjë. Po i more në dorë dhe fillove t'i lexosh, ato do të flasin. Do të flasin një gjuhë, kuptimin e së cilës e di Bardha, e di babi, e di edhe Ademi, që dikur i kishte grabitur ato letra nga çanta e saj dhe ia kishte dhënë t'et për provë se vajza e tij e ka thyer kodin e moralit familjar dhe ka dashuruar. Turp, kishin thënë atëherë. Faqja e zezë. Marrja e zotit!... Kurse sot? Ata jetojnë të lumtur. Ju gëzohen fëmijëve të tyre, i gëzohen dashurisë së fëmijëve të tyre dhe për ata nuk është turp, nuk prishet kodi i moralit familjar, foli me vete, duke e kthyer kokën anash, për tu siguruar se nuk kishte askënd pranë. Nga këto kujtime të zhveshura iu bë se nuk e kishte pranë as veten e saj.

\*

Edhe ditët e verës në këtë vend ishin si ditët e marsit. I bëhej se brenda ditës ndërroheshin të katër stinët e vitit. Pastaj, dy ditë bënte mot i mirë, me diell dhe vapë. Në fushat e blerta pranë lumenjve dëgjohej zëri i ngjirur i gjinkallës. Rrugët e asfaltuara dukeshin si vegime të ujta nga vapa. Dhe, befas, qielli mbushej me re të dendura dhe të stërngarkuara. Fillonte të murmuronte. Pas pak ia fillonte shiu me rrëmbim.

Pas disa ditësh të ftohta dhe të mërzitshme, më në fund kishte aguar një ditë e bukur. Dielli kishte lëshuar rrezet e ngrohta. Natyra, si e përgjumur pas një dushi të ftohët, dukej edhe më e blertë dhe e freskët. Gjethet dhe bari ishin akoma të lagura dhe ruanin freskinë e shiut. Rreth e qark parkut të bukur, të mbushur plot

me lisa dhe bar të njomë, dëgjohej cicërima e zogjve. Tutje, në anën e djathtë, shkëlqente si pasqyrë faqja e valëzuar e liqenit. Në anën e majtë, lart në shpat, dukeshin vilat e bukura, që tani pothuaj pjesa më e madhe e tyre ishin të boshatisura, sepse pronarët e tyre kishin ikur në pushimet e verës. Edhe në qytet kishin mbetur pak njerëz. Kjo vërtetohej nga rrugët, sheshet, dyqanet, parqet, që kishin mbetur pothuaj fare bosh. Në rrugë lëvizjet e kalimtarëve ishin të pakta. Bile edhe nga shqiptarët kishin mbetur pak. Pjesa më e madhe ishin kthyer nga kishin ardhur, kurse një pjesë, që me vite të tëra e kishin pasur të ndaluar të shkonin në vatrat e tyre, tani të mallëngjyer kishin shkëlqur tokën e djegur të të parëve. Kishte pasur një thyerje masive që e kishte mahnitur mbarë botën. Derisa fëmijët luanin, Bardha e ulur në një stol druri, e kishte hedhur vështrimin drejt ndërtesave gri të qytetit. Ditëve të para, kur kishte ardhur, i kishte kaluar në këtë park, me një pikëllim të pa përshkruar. Sa herë kishte qenë e mërzitur, kishte ardhur në këtë park. Ishte ulur në një skaj dhe ishte tretur në kujtime të largëta. Edhe fillimi i një jete të re në këtë dhe të huaj për të kishte qenë një problem më vete. Shumë herë e dëshpëruar kishte kaluar nëpër rrugicën e shtruar me gjethe, që binin me fëshfëritje dhe ishte kënaqur me fluturimin marramendës të zogjve. Vetëm cicërimat e zogjve ishin të njëjta me cicërimat e zogjve që i kishte lënë në atdheun e saj. Të tjerat ishin krejt ndryshe. E kishte ndjerë veten të humbur dhe të mjerë në mes të atyre ndërtesave gri. Gjuha, zakonet, kultura, muzika, disiplina, orari, serioziteti,

pastërtia, siguria ishin krejt ndryshe.

Tani që Mentori pritej të kthehej nga dita në ditë, ajo ndiente një gëzim të pa përshkruar. Ishte kënaqësi e madhe të kesh një vëlla si ai, që e lirë, pa ndrojtje, ia shprehë atë që të mundon. Dhe ai të do, të këshillon, s'të lë vetëm, të jep zemër, të gëzon...

Hodhi vështrimin nga fëmijët që luanin. Pa Dafinën që luante me Zanën. Një copë herë nuk e hoqi vështrimin, duke u kënaqur me lojën e tyre. Pranë vajzave, i ulur në barin e njomë, pa një burrë. Ai lexonte gazetë me kokën ulur. Ishte në distancë dhe nuk ia dallonte dot fytyrën, por disi ndjeu se zemra ju trazua. Ishte një fytyrë që e kishte parë diku, e njohur, e dashur, e paharruar, por tani disi i dilte e deformuar. Ndoshta ishte vetëm ndonjë ngjashmëri rasti, mendoi dhe hoqi vështrimin.

“Babi, dua akullore” – erdhi i thekshëm zëri i Zanës.

“Sa shoqe i ke me vete, Zana?” – pyeti burri. Zëri i tij e bëri Bardhën të dridhej. Sakaq ktheu kokën. O zot! Jam në ëndërr, apo e zgjuar, pyeti veten. Agroni!... Të jetë ky Agroni? Për një copë herë mbeti duke shikuar. Ishte e molisur. Sesi i erdhi një dëshirë të ishte më afër tij. Edhe pse e shikonte, nuk u besonte syve. Shikimin nuk e kishte larguar. Me vëmendje pa çdo lëvizje të tij. Ai, pasi ia dha paratë Zanës, duke marrë përsëri gazetën në dorë, pa nga Bardha. Pas një shikimi të shkurtër, vuri buzën në gaz. Ishte ai. Ju bë se e pa në mes të grave dhe të vajzave me aparatën në dorë, që edhe atëherë kishte pasur të njëjtën buzëqeshje. Ju bë

se dëgjoi zërin e këngëtarëve: “Çou Rexho çou djallo...” dhe refreni tjetër ishte pikërisht shikimi i tij, të cilit edhe tani ia ndiente peshën.

Ai u ngrit në këmbë dhe me hap të lehtë dhe, disi të çalë fillojë të afrohej nga Bardha. O Zot, mendoi Bardha me vete, duke u ngritur në këmbë. Pasi ai ia kishte zgjatur dorën, ashtu e hutuar siç ishte, Bardha kishte bërë të njëjtin gjest.

“Si je Bardha?” – pyeti ai, pasi në dorë e kishte shtrënguar dorën e saj.

“Mirë. Ti, mirë je?” – foli Bardha që në çast iu duk se nuk ishte zëri i saj dhe, si pa dashje, uli sytë.

“Eh!” – ofshani ai në vend të përgjegjës. Bardha e shikoj në sy. Ai ishte si i mpirë. – „Lufta mi vodhi të gjitha. Nuk më ka mbetur askush në këtë botë, vetëm Zana. M’i vranë të gjithë... m’i vranë edhe nxënësit... eh, ç’kam përjetuar! Kurse unë... ja kështu, siç me sheh, gjysmë njeriu!”

“Mirë më dukësh! – tha Bardha e çuditur.

“Mirë! Por me mungon njëra këmbë! Kam protezë. Edhe ti e vetme Bardha?” – pyeti befas.

“Po!” – u përgjigj ajo me vështrimin përdhe.

“Me ka treguar Lulja. M’i ka treguar të gjitha. Nuk e kam zënë në gojë fare lidhjen tonë të dikurshme. Megjithatë, pajtohem me propozimin e saj.”

“Cilin propozim?” – pyeti Bardha e hutuar

“S’të ka thënë gjë Lulja?” – pyeti Agroni, në vend të përgjegjës.

“Po, me ka thënë, por unë... unë nuk jam për ty!” – tha Bardha, pa mundur të ndalte vajin. Agroni ia vuri lehtë dorën mbi sup, duke e tundur lehtë.



“Ç’pate, moj ti? Bardha, të lutëm, mos qaj!... “

“Me beso se unë të dua, por... nuk jam për ty... nuk jam!” – dhe peshën e rëndë të dorës se tij e ndjente mbi supin e saj. Ishte pesha e një dore që e digjte flakë. Ishte një peshë që me lehtësinë më të madhe dhe me lumturin më të dëshirueshme do ta mbante të varur mbi supin e saj tërë jetën. – „Jam e dhunuar...” - tha dhe sakaq ia dha të qarës me ngashërim. Ajo, edhe pse e mbytur në lot, pesha e dorës që ishte akoma mbi shpatullën e saj, e përligjte atë vaj. Ndjeu se dora e tij filloi të humbte peshën dhe sa më e lehtë bëhej, aq më tepër largohej shpresa. Në momentin kur pritej shkëputja definitive e asaj dore, e asaj shprese magjepse që me vite e kishte ëndërruar me shpresa të zhveshura, befasi, si në një ëndërr të bukur pranvere, ndjeu peshën e saj të dyfishuar, të trefishuar... që jo vetëm ia rëndoi shpatullën, por e tërhoqi furishëm duke ia humbur ekuilibrin dhe duke e mbështetur furishëm në gjoksin e tij. Ishte një shenjë, një shpresë, që moti e kishte shpallur të mbyllur, të humbur... por që tani befasi po rikthehej me gjithë vrullin e saj, me gjithë afsh dhe dashuri. Ndoshta akoma nuk do të ishte vonë për ta shijuar atë dashuri që të tjerët padrejtësisht ia kishin ndërprerë, posa kishte filluar ta shijonte nektarin e saj, që në gjenezë!

Nuk i kujtohej më sa kishin qëndruar në atë gjendje. U përmendën vetëm atëherë, kur panë fëmijët që i kishin rrethuar, duke i shikuar në atë gjendje pakëz të çuditur. Bardha, e skuqur lehtë dhe me lotët në cepat e syve që akoma nuk iu kishin terur, u shkëput nga ai përfaqim që deri në ato momente kishte qenë vetëm imagjinatë e këndshme.

“Njiheni ju që më parë?” – pyeti Dafina.

“Po. Qysh kur ishim fëmijë të moshës suaj.” – u përgjigj Bardha.

“Sa bukur dukeshit njëri pranë tjetrit!” – tha Dafina me një shikim të ngazëllyer, kurse Zana uli kokën e skuqur.

## IX

Vetura ndaloi pranë restorantit „Podgorica“, që ndodhej në periferi të qytetit. Pasi e shtypi sustën e ziles, derën e hapi një vajzë e veshur me uniformën e kamerieres. Hyri brenda, kurse ajo e mbylli derën me bravë. Në korridorin e ngushtë e priti pronari. Ishte një burrë rreth të pesëdhjetave, me mustaqe dhe flokë pis të zeza, të bojatisura. Ishte malazez, i ikur nga Shqipëria para tridhjetë vitesh, i lindur dhe i rritur në një fshat në rrethin e Shkodrës. E fliste rrjedhshëm gjuhën shqipe.

Pasi kaluan tri shkallë, u ndodhën para banakut modern. Prapa tij i përshëndetën dy vajza. Kaluan sallën e madhe dhe të rregulluar bukur. Tavolinat ishin të radhitura në pesë rreshta dhe të mbuluara me cohë të bardhë. Në ballë ndodhej një derë e madhe pakëz e hapur. Kaluan në sallën tjetër, e cila ishte edhe më e madhe dhe më e gjerë se e para. Në fundin e saj shiheshin dy pastruese, duke rregulluar karriget dhe duke pastruar rrëmujën e një nate më parë. Kjo sallë përdorej si kabare, apo rezervohej nga miq të zgjedhur, për orgji, darka dhe ahengje të porositura. Në ballë ndodhej skena me perde të hapura dhe në brendi shiheshin instrumente muzikore. Në këndin e djathtë ishin shkallët e ndërtuara në mënyrë rrethore, që të shpinin në katin e

dytë. Ishin të veshura me tepih, ndërsa mbajtëset anësore të metalta dhe me ngjyrë të artë shkëlqyese.

Ngjiten shkallët. Kaluan korridorin e gjatë dhe u gjendën përballë një dere. Pronari e shtyu derën. Ndaloi jashtë pragut, duke i dhënë shenjë me dorë, me një përlule të lehtë, në shenjë respekti, që ai të hynte i pari. Dhoma ishte e madhe, e shndritshme dhe e mobiluar bukur. Në këndin e majtë ishte një tavolinë e madhe në formë të germës “L”. Mbi tavolinë shiheshin dosje të hapura dhe shkresa, si dhe monitori i madh i kompjuterit. Në anën tjetër të tavolinës ishte një kolltuk i veshur me saftjan, kurse pranë dritares një vazo e madhe me kurorën e blertë të një limoni. Në ballë ishte i vendosur një televizor i madh, kurse pranë tij një divan dhe një tavolinë e ulët.

Pronari i dha shenjë të ulej në divan, pastaj duke ngritë receptorin e telefonit lajmëroi kamerieren që të vinte për të marrë porositë.

Derisa kamerierja ishte duke i marrë porositë, pronari fiku televizorin që ishte duke transmetuar hyrjen triumfale të trupave ndërkombëtare në Kosovë.

“Këtu je në vend të sigurt,” – tha pronari i buzëqeshur, sikur donte t’ia tërhiqte vëmendjen nga pamjet në televizor.

“Ju faleminderit”, – ia ktheu Besimi, me një çudi të përmbajtur. Pikërisht në këtë restorant ishte zënë me serbët para ca vitesh dhe pikërisht ky burrë që tani ndodhej i ulur ballë tij e kishte shpëtuar. Të ketë qenë e tëra një kurdisje, apo është një rrjet që unë nuk jam i njoftuar për të? Dhe vazhdoi: – „Të gjitha shpresat i kam të varura te ju.”

“Ke arsye të plotë, miku im. Ja, e sheh! Unë rrezikoj veten për të mbrojtur ty. Ne jemi si vëllezër, ndaj ia kemi me borxh njëri-tjetrit ndihmën.”

„Ashtu është.“ – tha Besimi mendueshëm.

Dera u hap. Ishte kamerierja. Me tabaka në dorë dhe me hapa të shpejtë i solli pijet e porositura. Ajo, pasi ju tha “ju bëftë mirë”, doli. Pronari u ngrit dhe prapë mori dëgjuesen e telefonit.

“Çdo gjë është në rregull. Mirupafshim!” – tha dhe lëshoi dëgjuesen mbi aparat. Pastaj, me hapa të lehtë, u ul në vendin e vet, duke marrë gotën në dorë. – „Epo, gëzuar, dhe mirë se na erdhe!”

“Gëzuar dhe mirë se ju gjeta!” – tha duke ngritur gotën e konjakut. Vetëm sa i çiku buzët dhe e la mbi tavolinë. E ndjeu se ishte i uritur. Pronari sikur e kuptoi.

“Dëshironi të hani diç?”

“Oh, me gjithë dëshirë!”

“Me fal, se po ju lë vetëm për pak kohë,” – tha pronari dhe doli.

I dukej si në ëndërr. Me një gëzim të përmbajtur u shtriq, duke ngritur duart lartë. Shpëtova kësaj radhe, mendoi. Befas i shkuan sytë te ora e madhe e varur në murin përballë. Nëntë pa një çerek. Ishte e mundur të jetë kaq herët?

Pronari i solli mëngjesin. Në tabaka ishte edhe gazeta ditore. Dashamirësia dhe sjellja e ëmbël që e kishte pasur në fillim, i kishte tretur. Vetullat i kishte varur mbi sy. Gojën e kishte kyçur. Pasi i vuri tabakun përpara, me gishtin tregues i tregoi geramat e zeza mbi gazetë. Njoftimi ishte rrëqethës. Një palë mornica të ftohta ia përshkuan tërë trupin. Në vend që të hante,

ai mori gazetën. Në faqen e parë, me titull të madh shkruante:

“U arrestua dhunuesi dhe vrasësi i bukuroshes çeke”

Pasi e lexoi njoftimin, ngriti kokën drejt pronarit. Një palë djersë të ftohta ia përshkuan ballin, edhe ash-tu të verdhë. Sytë sikur ju fikën. Tëmthat ju bë sikur i kullonin gjak nga plagët që kishte marrë gjatë depër-timit në mes të hekurave dhe për një çast iu bë se akoma e kishte kokën në mes të atyre hekurave vertikalë, që ia shtypnin pa mëshirë. Një frikë tinëzare ia përshkoi gjithë trupin. Mendimet i vinin të shpeshta, duke mos ia lëshuar vendin njëra-tjetrës, por duke u grumbullu-ar njëra mbi tjetrën, të paqarta, të ngatërruara dhe të frikshme. Asnjë ide pozitive, sado e vogël, nuk i vinte e kthjellët, e pastër dhe e arsyeshme për momentin. Të largohet nga këtu? Ku të shkonte? Vetura i kishte mbetur në qytet, bile edhe sikur ta kishte pranë, nuk do të guxonte ta përdorte! Të qëndronte, ishte fare pranë atyre që e kërkonin dhe ishte rrezik jo vetëm për të, por edhe për të tjerët. Të kthehet në atdhe, ishte frika tjetër edhe më e rëndë sesa burgu këtu! Ishte frika e hakmarrjes, e vrasjes! Pfffiiuuu! psherëtiu i dëshpëru-ar! I vetmi shteg i hapur për momentin iu duk se ishte e kthyer e tij atje ku ishin urdhërdhënësit e tij. Balli i shndriti nga hareja! Kjo zgjati vetëm disa çaste. Prapë u zymtua! Si të shkonte në gojën e tyre, në këtë kohë që ata nuk ia kishin më nevojën. Ata e kishin shtrydhur si limonin, deri në pikën e fundit, ndaj mbetjen e tij do ta hidhnin në koshin e plehrave. Ishte hera e parë që ia mori inat Belit. Qysh nga fillimi e kishte mbajtur me

lajka se edhe ai do t'i ndihmonte në planet e tij, por sa herë që ia kishte kujtuar premtimin, ai i kishte ikur bisedës me mjeshtri, duke e shtyrë deri në pafundësi. Pa dashur, mendja i shkoi të thesari i tij i fshehur në bodrumin e Muradifit. Sigurisht se Beli tani do t'i bartë në ndonjë vend të sigurt. Pastaj, e kishte njoftuar që të vinte vetë e ta dërgonte në një bazë të sigurt, për të cilën sa e sa herë i kishte folur, e jo të organizonte njerëz të tjerë dhe t'i ngatërronte edhe më keq punët. Sigurisht është i zënë me... Instinktivisht, me dorën e djathtë, fshiu gjakun në tëmtha që i shkonte rrëke tatëpjetë faqes. Pastaj, me sy të zgurdulluar shikoi dorën. Nuk ishte gjak, por djersë. Djersë që i rridhnin nga frika.

“Është kohë trazirash, që as qeni nuk e njeh të zonë, ndaj unë mendoj se ti duhet të largohesh në një shtet tjetër, të përzihesh me të dëbuarit e tjerë shqipëtarë dhe të kërkosh azil politik,” – tha pronari, duke u përpjekur ta merrte veten.

“Ashtu kam menduar edhe unë, por do ta pleqërojmë edhe me Belin,” – tha Besimi, duke shikuar nga ora. Dukej se kishte ndalur. Iu bë se ishte mëngjesi më i gjatë që kishte përjetuar ndonjë herë në jetën e tij.

\*

Mugëtira e trishtë që e rrethonte, si dhe zhurma tipike e muzikës serbe që vinte nga salla e madhe, e bënë Besimin të ndjehej i mërzitur. Kënga buçiste hovehove, duke e dridhur lehtë dyshe-menë nën këmbët e tij. I mërzitur dhe i frikësuar tej mase, lëshoi rëndë trupin e tij amorf mbi divan. Iu bë se edhe ajri u zhvendos, duke i lëkundur lehtë gjethet e fikut.

Dera trokiti lehtë dhe akoma pa arritur që të thoshte “hyr”, ajo u hap ashtu lehtë, siç kishte trokitur. Besimi brofi në këmbë, kur e pa Belin. Si gjithmonë i heshtur dhe serioz. Pasi u përqaftuan shqiptarçe, u ulën të dy ballë njëri-tjetrit. Pas përshëndetjeve të zakonshme, Besimi i tregoi në imtësi se si i kishte ndodhur. Beli në fund i vuri dorën lehtë mbi sup, pastaj duke e goditur në shenjë miqësie, i tregoj në pika të shkurtra për planet që i kishte:

“Jemi në një kohë krize, ndaj ne duhet të tërhiqemi, pa rënë në duart e policisë vendase,“ – e nisi bisedën i qetë Beli. Pasi u kollit një dy-tri herë, sikur donte që përmes kollës t’i nxirje fjalët që edhe ashtu i kishte të pakta, vazhdoi me të njëjtin ton: – „Ka ardhur koha që punën tonë t’ua lëmë të tjerëve. Pjesën më të madhe të inventarit, lëndën e parë si dhe produktet finale që i kemi të deponuara në magazinat tona, duhet t’i shesim. Laboratorin e kam shitur me një çmim premtues. Çdo gjë që mund të shndërrohet në para të gatshme, ne duhet ta bëjmë dhe atë një orë e më parë. Një pjesë të thesarit, si fjala vjen pikturat e shtrenjta, xhevahiret, orët dhe të gjitha bizhuteritë që i kemi, duhet t’i marrim me vete. Këtu nuk guxojmë t’i qesim në shitje, kurse atje të ne i ha pazari!...”

“Si do të organizojmë transportin?“ – pyeti Besimi.

“E kam rregulluar. Përmes ndihmave humanitare. Doganimin e tyre e kanë marrë përsipër njerëzit tanë të konsullatës.”

Mugëtira e mbrëmjes kishte zënë të trashej. Pas një dite me vapë, mbrëmja sikur kishte sjellë me vete



freskun. Ajri, nga dera e hapur e ballkonit hynte i qetë, duke e mbushur dhomën me freski, si dhe duke i tundur perdet e lehta.

Dera u hap, duke sjellë me vete edhe një insert të zhurmshtëm të muzikës që vinte pa ndërprerë nga sallaja poshtë, ku, siç dukej, tani kishte filluar me tension të shtuar orgjia dhe ahengu. Në dhomë u duk pronari, kurse pas tij ishte një grua e re, e veshur me një fustan të shkurtër dhe me gotën e shampanjës në dorë. Belit i ndriti fytyra. Lehtë u ngrit në këmbë duke ia zgjatur dorën e tij të mbushur plot me mansheta gruas së re, kurse në gisht Besimi pa unazën e tij të madhe, me një gurë rubini në mes, që shkëlqente në dritën e poçit elektrik.

Ata nuk u ulën. Biseda zhvillohej në këmbë. Edhe Besimi rrinte në këmbë. Asnjëherë nuk e kishte parë më të hareshëm se tani Belin. Ai fliste, qeshte dhe bënte shaka, pastaj të tre qeshnin me të madhe. Besimi dëgjonte pa ndonjë përshtypje, bile çuditej se nga ju vinte gjithë ai disponim. Po, helbete, ata nuk e kishin hallin e tij.

Nuk i kujtohej sa kishte zgjatur ajo bisedë dhe ato shaka pa kripë, por u përmend vetëm atëherë kur dëgjoi Belin të thoshte se po ikim. Pronari nuk e kundërshtoi. Pasi hapi derën, nga poshtë erdhi vala e muzikës. Në korridor dëgjohej edhe më e theksuar. Kaluan përmes sallës së madhe, gjysmë të errët, që buçiste nga të goditurat e tupanëve dhe zallahia e instrumenteve të tjera dhe, sakaq, u gjendën në oborrin e gjerë. Besimi u kthye nga pronari, duke ia zgjatur dorën dhe duke e falënderuar përzemërsisht për ndihmën që ia kishte ofruar në çastet më kritike. Gruaja e re nuk kishte dalë

fare për t'i përcjellë. Hynë në veturën e tipit “Cryssler”, që ndodhej e parkuar prapa ndërtesës. Në kabinën luksoze, lartë në mes të xhamit të përparmë ishte i varur një flamur me shkabën dykrerëshe në formë trekëndëshi e me thekë të verdhë. Në anën e djathtë të kabinës, po ashtu në xhamin e përparmë, ishte e varur një xhufkë e mbështjellë me fjongo të ngjyrave kuq e zi, pastaj në mënyra të çrregullt vareshin edhe shumë xhingla të tjera, që as në gjoksin dhe duart e tij nuk ishin të pakta. Beli ndezi motorin.

Pasi e nxori veturën në rrugën kryesore dhe mori drejtimin e qytetit Zürich, Beli zgjati dorën dhe futi kasetën në manjetofon. Buçiti muzika. Pastaj, me një zë si të përvaishëm, filloi kënga me melos turk, por me fjalët shqip. Muzika vazhdonte me ritmet e saj, Beli e ndiqte me vërshtëllimë. Besimi kishte thartuar turinjtë dhe pa e bërë të gjatë zgjati dorën dhe ia uli zërin manjetofonit. Beli ktheu kokën nga ai, por pasi nuk vërejt gjë në fytyrën e tij sepse ishte errësirë, shtypi gazin më vrull, duke dalë nga rruga kryesore në autostradë.

Tani, pasi i dukej se e kishte kaluar rrezikun, Besimin e hante merakun i thesarit. Nuk i kishte mbetur asgjë në këtë jetë, vetëm ato gjëra të çmueshme që për fitimin e tyre e kishte futur edhe kokën sa e sa herë në rrezik.

“Ç’u bë me thesarin tim?” – pyeti më në fund Besimi, duke shikuar nga Beli me ata sytë e tij të akullt, por pasi nuk arriti të dallonte gjë në fytyrën e Belit, iu bë se edhe sytë e tij e kishin harruar zakonet e vjetër të zhbirimit. Vite të tëra ai nuk kishte bërë gjë tjetër, por vetëm kishte zhbiruar, hetuar e spiunuar njerëzit,

duke i marrë në qafë. Kishte akoma nga ata, që për shkakun e zhbirimit të syve të tij, kalbeshin në burgjet e ftohta dhe të largëta serbe, kurse fëmijët e tyre kishin mbetur barkthatë, zhele-zhele dhe vaji i sokakut. Por, kësaj radhe ai nuk e kishte hedhur shikimin drejt Belit për zhbirim, për hetim, për spiunim por e kishte hedhur thjeshtë për kuriozitet.

“Si gjithmonë. Ç’do gjë është në vend të sigurt!” – tha Beli pa prishur fare terezinë e vet për shqetësimin e tij.

“Ndodhen në bodrumin e Muradifit, apo i ke larguar që andej?” – pyeti prapë Besimi.

“I kam larguar... me t’u dhënë lajmi për vetëvrasjen e vajzës çeke, unë të kërkova, por pasi nuk të gjeta, shkova e lajmërova Kolin dhe me ndihmën e tij të gjitha gjësendet i rregulluam në bazë,” – sqaroi Beli.

Besimi sikur u qetësua pak. Ktheu prapë kokën drejt tij. Edhe pse nuk arriti të dallonte gjë, prapë i erdhi një valë gëzimi në gjithë qenien e tij. Shikonte me admirim shpëtimtarin e tij. Por, sakaq, vala e gëzimit sikur u tret. Vendin e saj e zuri vala e frikës dhe shumë pyetjeve që sa e sa herë ia kishte shtruar vetës, por pa përgjigje. Shpëtimtari nuk mund ta mbronte gjithë jetën, këtë e kishte të qartë! Ai e kishte nxjerrë nga dallgët e shfrenuara të rrebeshit dhe ishte i sigurt se do ta tërhiqte deri në bregun e qetë! Po pastaj? Ç’të bënte pastaj? Ku të mbytej? Nga t’ia mbante? Të qëndronte akoma në këtë shtet, ishte e pamundur. Të shkonte në një shtet tjetër, ishte e mundur, por thesarin s’e merrte dot me vete. Ta linte në duart e të tjerëve, ishte një punë që nuk bëhej. Nuk ia kishte besën askujt. Tani kishte

filluar të dyshonte edhe në Belin. Ky dyshim nuk i vinte nga ndonjë mashtrim sado i vogël nga ana e tij, por në natyrën e tij tani më ishte krijuar një bindje e tillë. Pastaj, fjala e tij, se do ta merrte me vete gjithë bizhuterinë, sikur zgjuan një ndjenjë frike në shpirtin e tij. Po unë ku do të mbetëm? Ndoshta edhe unë do të udhëtojë me të, mendoj dhe thellë në shpirt sikur ndjeu një lehtësim.

Vetura doli nga magjistranja, duke e ngadalësuar shpejtësinë. Pasi hyri në rrugën kryesore, u pa se shpejt do të futej në unazën periferike të qytetit të madh. Dritat e neonit shndrisnin rrugët, tani pothuaj të boshatisura. Semaforët ishin shkyçur, duke lëshuar dritë të verdhë. Në udhëkryqin e parë vetura mori në të majtë, në një rrugë të klasës të dytë, që të shpinte thellë në zonën periferike të qytetit plak. Krejt rrugës, derisa arritën pranë një ndërtese buzë mali, nuk folën. Vetura ndaloj në oborrin e ngushtë të një shtëpie përdhese. Pasi Beli fiku motorin, si dhe dritat, vendin përreth e mbuloi një shtresë e trashë errësire, sa që Besimi nuk pa se ku po e hidhte këmbën. Kur u afruan pranë shkallëve të betonit, në mënyrë automatike u ndez drita që ishte e varur mbi derën e hyrjes. Nga jashtë Besimi dalloj një vilë të bukur, të rrethuar me kangjella hekuri që dukeshin të vendosura mbi një mur të ultë çimentoje. Beli hapi derën. Në korridorin e gjerë në këmbë i priste një vajzë e re, me një pelerinë nate të hedhur krahëve, pa kujdes. Ishte hera e parë që Besimi vizitonte shtëpinë ku banonte Beli. Ishte një apartament luksoz, me orendi druri të skalitura me mjeshtri të lartë artistike. Në dhomën e gjerë të pritjes ishte një divan i madh, i mbështjellë

me lëkurë të zezë, kurse në ballë kishte zënë vend një televizor i madh i tipit “Philips” me madhësi 16:9, fjala e fundit e teknikës.

Vajza, pas përshëndetjeve në gjuhën serbe, iku në kuzhinë duke u çapitur me hapin e saj të ëmbël. Për një çast Besimit i mbetën sytë në vithet dhe kofshët e saj gjysmë lakuriq, që pelerina nuk i mbulonte dot. Pasi ajo ishte zhdukur në kuzhinë, Beli gjithë ngazëllim ju drejtua Besimit, duke u përpyjekur të mos linte asnjë shteg dyshimi:

“Është nga Serbia. Pas arrestimit tuaj, domosdo edhe mua m’u desh të kërkoj vend më të sigurt, ndaj erdha në banesën e saj!” – tha Beli me zë të ulët që mos të dëgjonte ajo.

“Epo, mirë bëre ti!” – ia ktheu Besimi. Deshi të thoshte edhe diç, por prania e saj në derë e bëri Besimin të ndërpriste bisedën, duke ia hedhur një vështrim dashamirës vajzës, e cila me tabaka në dorë afrohej drejt tavolinës së ulët. Në çdo hap që hidhte, kofsha e djathtë, e bardhë dhe e plotë shfaqej jashtë cepit të shtrëmbër të pelerinës, që si pa dashur e ngacmoi këndshëm epshin e fjetur të Besimit. Ajo u përkul lehtë për t’i vendosur kafetë mbi syprinën e tavolinës, ku edhe kësaj radhe Besimi mbërtheu si pa të keq shikimin e tij plot epsh të përmbajtur në gjoksin e saj të bardhë, që varej këndshëm nën këmishën e natës. Për sa kohë ajo qëndroi në atë pozitë, Besimi lëbyri sytë duke zgjatur turinjtë si feçkë thiu. Ajo e kishte diktuar me kohë peshën e vështrimit të tij, ndaj në mënyrë edhe më provokuese, si pa dashje, zbulonte një çikë pjesët e trupit dhe pastaj me naze i mbulonte si pa të keq.

Pasi hëngrën darkë, vajza solli verë. Biseda filloi e qetë. Vajza pyeti për të kaluarën e tij, pastaj për gjendjen e tanishme. Beli, pasi kishte thartuar turinjtë, e ndërroi bisedën, duke i treguar Besimit për laboratorin, si dhe shumë detaje që për Besimin ishin të panjohura. Ai nuk kishte pasur asnjëherë rastin ta vizitonte laboratorin, sepse detyra e tij kishte qenë shpërndarja dhe gjetja e mënyrave për shitjen e drogave që prodhoheshin aty. Pasi e pa se Besimi nuk e kishte të qartë, Beli futi video-kasetën në rekorder dhe, duke i parë pamjet, Beli i sqaronte për funksionin e aparaturave. Befas syri i zuri Zefin, duke punuar në një repart me një epruvetë në dorë. Pa i kaluar habia e parë, pa edhe Hutin.

“Edhe këta punojnë këtu!?” – pyeti Besimi, pa mundur ta fshehë kureshtjen.

“Po, pse a s’ të kanë treguar, a?” – tha Beli, edhe ai i habitur me padijen e tij.

“Jo!” – tha Besimi i prekur në sedër.

“Ëëë?!... Po ata e kanë blerë laboratorin!” – tha si pa të keq Beli.

“Si!? E kanë blerë laboratorin, kurse ti bën incizime private?... E di ç’do të thotë kjo kasetë, po ra në duart e policisë?” – tha Besimi i tronditur, dhe mendja i shkoi te tragjedia që e kishin pësuar anëtarët e familjes së Hutit në Kosovë. Ata ishin masakruar brutalisht nga “tigrat” për shkak se Huti nuk kishte mundur t’ua paguante borxhet për drogën që e kishte marrë prej tyre veresie! Sikur nuk mjaftonte kjo që i kishte ndodhur, tani edhe incizimi i tij në laborator!... o zot, po kjo të bën të çmendësh!

“Harroje! Brenda dy apo tre ditësh, ne do të ikim

që këtej. Pastaj edhe kasetën do ta zhdukim! ”

“Po, po, por ai do të vazhdojë të mbetet këtu dhe...” – tha Besimi disi i ndrojtur

“Ju lutëm, lëni ato biseda. Unë u gëzova kur ju pashë. Beli me ka folur sa e sa herë për ju...ziveli!” – e ndërpreu vajza e pakënaqur me bisedën e tyre, duke e ngritur lart gotën e verës.

“Ziveli...” - ia kthyen të dy gati njëzëri.

Biseda rrodhi tek pikturat që Beli i mbante të fshehura në bazën e tij. Ato ishin piktura të vjetra dhe të rralla, të punuara nga autorë të mëdhenj. Kishin një vlerë të madhe artistike. Qysh tani ishin të shitura. Dy prej tyre ia kishte shitur politikanit rus Zhirinovski, kurse të tjerat do t’i dërgonte në Serbi, ku do t’i shiste përmes porosisë.

Pasi gjatë bisedës kishin kthyer edhe disa gota me fund, vajza u ngrit, dhe ashtu duke u kalamendur nga pija, arriti pranë radio-studios duke lëshuar muzikë. Pastaj arriti te dera, duke fikur dritat. Vendin e zuri drita e mekur e ca qirinjve, që ishin vendosur në shandanë në këndin e dollapit. Drita vinte edhe nga televizori, ku tani shfaqeshin skena erotike, të cilat të pranishmëve edhe më tepër u ndillnin epsh.

“Këtu jemi të veçuar nga rrethi dhe fqinjët, ndaj, nëse dëshironi, ne mund të bëjmë muzikë dhe të hedhim valle deri në mëngjes,” – tha vajza, duke mos e përcaktuar se me cilin fliste.

Pa i dhënë përgjigje propozimit të saj, ata hynë në valle. Rakia, muzika, dëfrimi sikur e kishin bërë të veten. Vajza, ashtu e hallakatur siç ishte, e hoqi pelerinën duke mbetur vetëm në këmishën e hollë të natës. Be-

simit i shndritën sytë. Dëshira ia donte të jetë i ngjitur për trupin e saj, por prania e Belit... E ndjeu se ishte i tepërt në këtë mes, ndaj kërkoi të largohej. Gruaja e re e tërhoqi nga vetja, duke e puthur. Beli këqyri me buzë në gaz. Pastaj ajo u afrua edhe më pranë tij dhe me lëvizje të ngathëta të gishtërinjve të saj të hollë filloj t'ia shpërthekonte kopsat e këmishës. Kurse Beli kishte filluar ta zbaviste, duke ia ledhatuar shpinën dhe belin. Pasi Beli ia hoqi nga trupi atë tis të hollë që e mbulonte akoma trupin e saj të bëshëm, duart e tij plot mansheta, zinxhirë e unaza ia përkëdhelnin vithet e saj nga prapa, kurse Besimi e ledhatonte me dorë gushën dhe faqen e saj. Një “ah” plot epsh dhe si e mbytur doli nga goja e saj...

\*

Zilja e telefonit binte me ngulm. Besimi u përmend. Pas pak pushoi. Drita e diellit kishte rënë nga dritarja drejt e në shtratin e përbashkët, ku ishin të shtrirë që të tre. Ajo ishte e shtrirë fare pranë tij. Flokët e saj të shpupuritura ishin shpërndarë butësisht mbi jastëk dhe, pa dashur, ia kujtuan flokët e arta të Bardhës. Me një nostalgji të theksuar psherëtiu. Prapë ra zilja e telefonit. Besimi ngriti kokën. Në anën tjetër të shtratit nuk e pa Belin. Vajza vazhdonte gjumin e shkujdesur. Besimi e tundi. Ajo u përmend. Porsa u bë gati të merrte telefonin, ai u ndërpre. Ajo prapë e futi në përfaqim Besimin. Pas pak telefoni ra përsëri.

“Ku është Beli?” – pyeti ajo.

“Nuk e di,“ - u përgjigj Besimi.

“Izvolte!” – tha ajo, pasi e kishte marrë telefonin.



Besimi iku në banje. Zhurma e njohur e ujit, si dhe shkuma e sapunit, për një çast ia larguan të gjitha mendimet që e torturonin sa herë i kujtonte. Edhe zbavitja e një nate më parë kishte qenë mrekulli jetëshkurtër në shpirtin e tij të trazuar. Iku pija, iku mrekullia, mendoi. Derisa po rruhej, fytyra e tij e mbuluar me shkumën e sapunit i dukej si gjithherë normale, por pasi ishte rruar dhe fytyra i kishte mbetur e lëmuar, pa shkumë e pa qime, iu duk se ishte shfaqur lakuriq, ashtu siç ishte në të vërtetë, pa maskë, e zbehtë, e mjerë, e frikësuar. Pa dashje iu bë se i qe çjerrë maska e dyfytyrësisë së tij. E vërteta lakuriqe se cili ishte dhe se çfarë misioni kishte kryer deri tani, kishte dalë në shesh. Pasi e kishte parë edhe Bardha këtë çjerrje maske, ishte e kotë të përpiqueshe ta mbuloje këtë të vërtetë të hidhur. Nuk mbulohet dielli me shoshë. U plaka para kohe, tha, por për të mos e dëshpëruar edhe më keq veten, e ndryshoi në çast: u zbulova para kohe! Kishte frikë nga ajo e vërtetë, sikur nga xhebraili. Pranë pasqyrës pa fytyrën e vet. Sytë iu dukën të menduar dhe të trishtuar bashkë, disi të rritur çuditërisht, të fryrë, apo të mbufatur nga pija e mbrëmshme dhe gjumi i gjatë dhe i shqetësuar, që e kishte bërë derisa e kishte zgjuar ai telefon i mallkuar. Por, brengat nuk kishte fuqi që t'i dëbonte nga qenia e tij. Nuk i largonte dot as rakia, as ekstaza as... o Zot!... – dhe psherëtiu i dëshpëruar.

Pasi u kthye në dhomën e ndejës, pa vajzën që ishte veshur bukur. Fustani i saj ishte i shkurtër, mini. Bluza ishte e ngushtë dhe e shkurtër dhe një pjesë e barkut shfaqej lakuriq. Flokët i kishte lidhur me një fjongo mëndafshi me ngjyrë të verdhë. Buzët i kishte

mbushur me bojë të kuqe, ndërsa kapakët e syve i kishte shminkatur me ngjyrë vjollce. Një copë herë Besimit i mbetën sytë e gozhduar mbi fytyrën e saj të bukur. Për një çast mbeti i nemitur nga ajo bukuri. Vallë, ishte ajo që mbrëmë?...

“Të pëlqen ky model?”

“Shumë!” – u përgjigj shkurt Besimi.

“Ua, se gati harrova! Beli tha mos të dalësh nga shtëpia, derisa të kthehet ai.”

“Mirë. Të tha gjë, kur kthehet?”

“Dikur në mbrëmje. Në dollap ka bukë. Përgatit çka të duash dhe ha drekë. Mirupafshim...” - tha ajo, duke ia kthyer shpinën plot naze.

Besimi mbeti prapë në vetminë e tij të trishtë dhe të frikshme. Sikurse edhe një ditë më parë, edhe sot duhej të rrinte fare i vetmuar. Ishte një rreth që i ndillte frikë dhe trishtim bashkë. Në rrethin e tij, edhe pse ishte i vetmuar, gjente shokë dhe dita i kalonte rrufeshëm, pa u ndierë fare, bile shumë herë çuditej se sa shpejt ikte. Kjo ndodhte kur së bashku me ta luante letra, barbut, apo ndonjë lojë tjetër bixhozi.

Nga dritarja me grila të kaltra vinte zhurma, tutje nga rruga. Dita kishte filluar të zymtohej. Ca re të errëta ishin shfaqur në pjesën veri-perëndimore të qytetit. Një erë e lehtë kishte filluar t’i rrihte pamëshirshëm grilat, zhurma e të cilave e bëri nervoz, me atë zukatje mbytëse që lëshonin. Ai mbylli dritaret, pastaj si nëpër ëndërr iu kujtuan skenat e laboratorit me Zefin dhe Hutin, që një natë më parë i kishte parë në videokasetë. Nga kureshtja u ulë pranë televizorit dhe duke kontrolluar kasetat me radhë, u dha të gjente kasetën

që i kishte të incizuara ato pamje të rrezikshme. Kishte shumë kaseta. Një pjesë e madhe e tyre nuk kishin asnjë mbishkrim. Një pjesë tjetër ishin origjinale, me foton e ndonjë aktori të njohur. Në mesin e tyre gjeti edhe shumë filma pornografikë të metrazhit të gjatë. Kishte edhe shumë filma jugosllavë, pastaj koncerte, këngë, valle e muzikë klasike. Por atë që e kërkonte, nuk e gjeti se nuk e gjeti. Këqyri edhe në pjesët e tjera të dollapit duke hallakatur, por nuk gjeti gjë.

Mugëtira ishte trashur. Të bëhej se tani kishte filluar të binte nata, edhe pse ishte mesi i ditës. Befas qiellin e çau një shkrepimë, sa që për një çast i ndriti edhe dhomat gjysmë të errëta dhe pothuaj në të njëjtën kohë, plasi një gjëmim i fortë, sa që për një çast Besimit ju bë se e gërreu krejt atë vend, duke e rrotulluar dheun, sikur plugu kur e lëvron tokën. Nga gjëma e fortë edhe xhamat e banesës u dridhen dhe sakaq ia plasi një shi i rreptë, i shoqëruar me breshër dhe me furtunë. Një si mjegull e dendur e mbështolli krejt shtëpinë. Nga rruga matanë nuk dallohej asgjë. Vetëm kokrrat e breshëri dhe pikat e shiut dukeshin si një litar i gjatë, i pandërprerë, që fillin e kishte diku lart në qiell dhe fundin në tokë, ja, aty pranë mureve të shtëpisë. Iu bë se ata ishin litarë shpëtimi, litarë që do ta largonin një herë e përgjithmonë nga këto vuajtje të rënda të tokës dhe do ta degdisnin atje lartë, në një vend të sigurt... në amshim! Pa dashur i buçitën në vesh, por tani me zërin e bubullimës, fjalët e t'et: "Ti për ne je i vdekur!"

Nuk i kujtohej se sa kishte qëndruar në këtë gjendje. Shiu kishte pushuar, por jo edhe mugëtira dhe gjëma e motit që përsëritej herë pas here. Me hap të rëndë u

afrua pranë dritares. Poshtë, në fundin e kopshtit, prapa tarabave pa një grua. Ajo shikonte në drejtim të tij. Për një copë herë Besimi nuk ia shqiti sytë, pastaj me një frikë në palcë u largua nga dritarja. Me duket se me njohu, tha i fiksuar dhe prapë ktheu kokën nga andej, nga kopshti. Gruaja nuk ishte më aty. Duhet të largohem nga ky vend i mallkuar, mendoj dhe me shpresa të humbura u shtri në shtratin, ku e kishte kaluar natën. Nuk i kujtohej sesi këmbët veta e kishin futur në këtë dhomë.

Ashtu i shtrirë siç ishte, iu bë së dëgjoji derën të hapej, pastaj zëra burrash. Hapi sytë i frikësuar. Erdhën, i paska lajmëruar gruaja, që më pa pak më parë. Në maje të gishtërinjve u afrua pranë dritares, që të hidhej jashtë, në rast se do ta sulmonte dikush. Pasi vuri re edhe një herë, zërat erdhën më të qartë dhe me të kapshëm. Ishte zëri i Belit kurse zëri i bashkëbiseduesit të tij ishte i panjohur.

Hapi derën ngadalë. Tani e kuptoi se ishte vërtetë Beli me një burrë tjetër. Me hapa të plogësht, sikur kishte dhembje në të dy këmbët, hyri në dhomën e ndejës. Beli ishte me kurriz nga dera, kurse mysafiri me fytyrë. Kur e pa Besimin, ai zgurdulloi sytë i çuditur. Beli vërejti ndryshimin e tij, ndaj ktheu kokën nga dera.

“Si e kalove ditën, u mërzite?” – pyeti Beli në shqip, porsa shikimi i tij u ndesh me shikimin e Besimit.

“Mirë, besa. Të faleminderit për ndihmën që me ke ofruar,” – tha Besimi, duke u afruar pranë Belit. Burri, pasi ia shtrëngoi dorën, ia tha emrin:

“Gorani. Gëzohem që ju njoha. Me ka folur Beli

për ju,” – tha Gorani duke u rehatuar edhe më mirë në kolltukun ku ishte ulur.

“Edhe mua me vjen mirë që ju njoha,” – ia ktheu shkurt Besimi.

“Nga Kosova jeni?” – pyeti Gorani.

“Me falni, ç’doni të pini?” – pyeti Beli, pasi ishte ngritur në këmbë.

“Ç’të ketë... ndonjë lëng, ju lutëm,” – tha Gorani.

“Ashtu edhe unë, ndonjë lëng!” – tha Besimi dhe vazhdoi, duke iu drejtuar Goranit: – „Po, nga Kosova.”

“Nga cili qytet?” – pyeti me kureshtje Gorani.

“Nga rrethi i qytetit P.”

“Atje kam shërbyer disa vite. E di ku gjendet fshati Eshkë?”

„Po. Është fqinj me fshatin tim. Njih ndonjërin nga ky fshat?”

„Ekzakt jo, por kam shërbyer për një kohë të gjatë,” – tha ai duke e shikuar ngultas në sy.

Besimi për një çast mbeti i hutuar. Ishte i sigurt se para veti kishte një fytyrë të njohur, por assesi nuk i kujtohej se ku e kishte takuar.

“E njih Ker Ademkurtin?” – pyeti Gorani, duke shikuar nga dera, sikur donte t’i largohej shikimit të turbullt të Besimit.

“Po. Ç’të lidh ty me të?”

“Asgjë, vetëm e njoh pak...”

“Ky ka shërbyer në Kosovë,” – ndërhyri Beli qëllimisht, dhe deshi të vazhdonte, por zilja e telefonit bëri që biseda të ndërpritej. Beli mori dëgjuesen.

“Izvolte...stooo!?!... “ – dhe për një çast fytyra e tij mori një pamje të vrarë. Fytyra iu bë edhe më e ngrysur. Largoi dëgjuesen nga veshi, edhe pse zëri nga ana tjetër dëgjohej si zukatje zekthi. Pastaj, pa e bërë të gjatë, e lëshoi dëgjuesen mbi aparat. Me një lëvizje të ngadaltë u kthye nga t’pranishmit. Vetullat i kishin rënë mbi sy. Buza e poshtme ju dridh lehtë, përvajshëm. Duart ju dukën të tepërta dhe me nervozë i lëvizte, duke mos gjetur pozicion të përshtatshëm sesi t’i mbante.

“O, Zot, është e mundur kjo? Aleksii...!? Aleksii është gjetur i vrarë në veturën e tij, buzë një mali, jo larg hotelit të tij. Kohë e keqe. Atje u gjend i vrarë Nebojska, kurse këtu Aleksii...” – tha me zë të përvajshëm dhe me dhembje të papërmbajtur. Filloi të vërtitej sa lartë poshtë, pa gjetur ngushëllim.

Lajmi ra si bombë në mesin e tyre. Këto vrasje të kreut sekret serb ishin ndjellakeqe. Ishte e pamundur që në këto vrasje të kishte ndonjë ndikim nga jashtë. Bëheshin nga brenda radhëve të tyre dhe kjo vinte si pasojë e ndonjë xhelozie të çmendur, apo nga ndonjë qërim hesapesh nga rivalët e tyre mafiozë.

“Kur është vrarë?” – pyeti Gorani me një pikëllim të heshtur në fytyrën e tij.

“Sot në mëngjes është gjetur nga kalimtarë të rastit. Policia thotë se ka gjasa të jetë vrarë natën e fundit,” – sqaroi Beli.

Pas gjithë asaj shtrëngate që kishte derdhur si me shtambë ujin mbi tokën e ngrohtë nga dielli, tani retë kishin filluar të zvarriteshin tufa-tufa e të çrregullta, si një ushtri e thyer në vijën e frontit. Beli një copë herë nuk u ndje, u ngrit në këmbë dhe, ashtu i heshtur, doli.

Pas tij u ngrit edhe Gorani.

“Pas kësaj tragjedie, jam i shtrënguar të marr masa. Me duhet të takohem me një shok për këshilla. Ti, Besim, qëndro këtu. Nuk do të vonohem dhe do të kthehem me një vendim të koordinuar për veprime të mëtejshme. Mirupafshim!” – tha Beli, duke nxjerrë vetëm kryet në derë.

“Mirupafshim,” – ia ktheu, Besimi duke u tkurrur edhe më tepër nën trysninë e misterit.

Për disa çaste mbeti si i ngrirë në mes të dhomës. Nuk dinte se nga t’ia fillonte mendimeve. Gjërat ishin të ngatërruara, sa për një çast iu bë se të gjitha këto i lëvizte një dorë mekanike e fshehur dhe tinëzare. Befas një shkendi dyshimi i erdhi krejt e vetme, por e largët. Goranin, që pak më parë e kishte pranë, e kishte parë diku, ishte fytyrë e njohur dhe, si një shirit filmi, kujtesa filloi t’ia shkoqiste gjërat: Iu kujtua kafeneja në qendër të qytetit, pronari i saj Ejup Agiq, pastaj... “Është i ulur në të majtë të derës, i vetëm fare. Ai gjithmonë rri i vetmuar dhe në kujtime. Thonë se është rritur jetim,“ – i buçitën këto fjalë në vesh. Po, po! Ky është. Gorani i tmerrshëm! Një frikë tinëzare ia mbështolli krejt qenien e tij. Shumë mendime të frikshme dhe ndjellakeqe i loznin në trurin e tij të lodhur. Tani ishte i sigurt se ai ishte dërguar nga policia sekrete për ta vrarë atë, edhe Aleks Peroviçin... Po Keri? Ç’hynë këtu Keri? Pse më pyeti? Dale një herë, dale! Dhe u ngrit në këmbë. Tani vërejti se dhoma ishte e errët fare. Vetë këmbët e shpurën drejt derës dhe, pasi ndrydhi sustën, ndezi llambën elektrike. Dhoma u mbush dritë dhe nga drita e fortë puliti sytë, duke i ulur në dysheime. Në divanin

përballë, ku pak çaste më parë kishte qenë i ulur Gorani, pa xhaketen e tij të stilit ushtarak, të hedhur ashtu pa kujdes. Pasi shikoi nga dera, me rrëmbim u afrua pranë dhe me një shpejtësi të rrufeshme me dorën e tij të stërvitur për kontrollë të shpejta, sa hap e mbyll sytë, i nxori nga xhepat të gjitha gjësendet. Në fund fare gjeti letërnjoftimin të lëshuar nga organet zvicerane. E hapi me të shpejtë. Nuk desh t'u besonte syve: Name: Ademkurti, Vorname: Agron, Geburtsdatum: 9. 08. 1975, Ort: Eshkë...

Një ngazëllim i beftë ia përshkoi gjithë qenien. Tani ishte i sigurt se ai nuk ishte i dërguar për vrasjen e tyre, por sigurisht është duke u hakmarrë kundër atyre që e kanë sjellë në këtë gjendje. Mendja prapë i fluturoi në shtëpinë e tij. Iu kujtuan flakët dhe pa babanë e plagosur në mes të oborrit. Dhe iu bë se pa me sytë e tij Goranin e tmerrshëm, duke ia futur flakën shtëpisë së tij. Pastaj thesarin në dorën e Babiqit...

Pa e bërë të gjatë, i futi të gjitha gjërat në xhepa, ashtu siç kishin qenë. Disi i lehtësuar, me buzën në gaz, fiku dritën dhe doli në ballkon.

Nga ajo kodrinë, ku ndodhej vila, si në shuplakë të dorës shiheshin dritat si një prushanë e madhe që vezullonin në qytet. Në rrugën matanë qarkullonin automjetet me fara të ndezur. Një freski e lehtë bëri gjethet e pemëve në kopsht të shushuritnin dhe mendja sakaq i shkoi në selishtën e tij që ishte para shtëpisë. Një aromë e këndshme i gëdhulisi flegelat e hundës. Ishte aromë e trëndafilut që kishte shpërthyer plot me gonxhe atje tutje, në kopsht, kurse errësira sa vinte e bëhej më dendur.



\*

Serbja e bukur kishte kohë që ishte kthyer në banesë. Ajo kishte përgatitur darkën dhe bashkë me Besimin kishin ngrënë, duke cakërruar gotat e verës. Biseda zhvillohej e qetë. Besimi ishte liruar krejt nga stresi i frikës. Hezitimet, mëdyshjet dhe ankthi dukej se i qenë darovitur. Tani e ndiente veten shumë të sigurt, pasi zbulimi që kishte bërë ishte një udhërrëfyes. Ishte i sigurt se Gorani, i konvertuar tanimë në Agron, do të ishte një mburojë e gjallë dhe një shpëtim i sigurt, që, siç dukej, vetë Zoti ia kishte dërguar si një engjëll për ta shpëtuar nga fatkeqësitë dhe për t'i rrëfyer rrugën drejt shpëtimit të sigurt, deri në largimin nga ky vend i mallkuar. Tani nuk i kishte mbetur asgjë, vetëm ta vazhdonte dëfrimin e një nate më parë, por tani vetëm ai me serben e bukur.

Pas pijes dhe dëfrimit, kishte ardhur koha e gjumit. Kokën e kishte të rënduar, por mendjen ende të kthjellët. Pështja e rëndë e natës sa vinte dhe rëndohej mbi qepallat e tij. U shtri të flinte në një dyshek që ia sollti vajza, kurse ajo u mbyll në dhomën e saj. Dua të fle e patrazuar nga askush, tha ajo, duke i uruar natën e mirë me një puthje të lezetshme.

Nuk i kujtohej se sa kishte fjetur, kur dëgjoi derën të hapej vajtueshëm. Si një hije e frikshme, në maje të gishtërinjve, ajo u afrua pranë dyshekut ku ishte i shtrirë Besimi. Në atë gjysmerrësirë, Besimi njohu Belin.

“Në gjumë je?” – pyeti Beli me një zë pëshpëritës.

“Isha, por tani sa u zgjova. Ç’kemi?”

“Ngrehu! Me duket se na kanë rënë në gjurmë. Sipas informatave që kam, nesër herët në mëngjes... shpejt, shpejt!”

“Kush të tha?” – pyeti Besimi, me sy të zgurduluar. Beli nuk vërejti gjë në mimikën e tij, por nga zëri e njohu se i kishte hyrë frika në palcë.

“Eja, shpejt! Pasi të dalim jashtë, të tregoj çdo gjë! Ngutu, ngutu!”

Besimi tani ishte në këmbë, i gatshëm për të dalë. Beli priu i pari dhe sakaq u gjend në Ballkon. Me një të kërcyer u gjend në kopsht. Pas tij u hodh edhe Besimi. Fresku i natës ia përshkoj ballin e djersitur. Jashtë vazhdonte të binte një shi i imtë dhe herë pas here qiellin e çante ndonjë vetëtimë gjarpërore. Pas saj, si e mbytur, dëgjohej krisma e largët e motit me një gërrhamë të venitur.

Pasi kaluan mes për mes kopshtit me lule, u gjenden në skajin verior. Regëtima e dritës së neonit, që mezi arrinte deri të cepi kopshtit, ua mundësoi t’i gjenin kangjellat dhe, pasi u ngjitën fort pas tyre, ata u gjendën jashtë kopshtit, në rrugën e ngushtë. Me hapa të lehtë dhe të shpejtë, ata u afruan pranë parkingut të veturave. Beli hapi derën. Sakaq të dy u gjendën në veturë. Pasi u rehatua mirë në ulësen e tij, Beli ndezi motorin. Ju duk një zhurmë alarmuese gërrhama e motorit. Beli nuk pati kohë të merrej me atë gërrhamë. Duke i lëvizur me shpejtësi duart mbi timon, sakaq u gjend në rrugë.

Kur vetura u gjend në rrugën kryesore, dritat e neonit depërtonin në kabinën luksoze të veturës. Besimi, porsa hapi gojën për t’i treguar Belit për sa kishte

parë në xhepat e Goranit, vëmendjen ia tërhoqi ndryshimi i vogël në kabinën e veturës, që e bëri të ndërronte mendje, duke mos nxjerrë zë. Në vend të flamurit shqiptar, në xhamin e përparmë ishte i varur flamuri serb, kurse xhufka në anën tjetër nuk ishte fare aty. Në dorë, jashtë zakonit të tij, Beli kishte vënë dorëza. Për t'u bindur se ky ndryshim ishte i pranueshëm, pa pyetur fare Belin, shtyu kasetën duke e lëshuar manjetofofonin. Kabinën e mbushën tingujt e një kënge çetnike. Kjo e papritur e bëri të dyshonte, se diç nuk ishte në rregull. Duke u përballur me një ndryshim të theksuar dhe duke e marrë parasysh frikën e tij të tepruar se gjoja kishin rënë në gjurmët e policisë, disi e ndjeu veten të futur në një grackë. Pa dashje iu bë se akoma koka e tij gjendej në mes të hekurave. Tëmthat iu bë se iu frynë dhe e ndjeu se zemra i rrihte me një ritëm të shpejtuar.

“Ku po me çon?” – mori zemër më në fund dhe pyeti.

“Mos ke frikë. E vërejta shqetësimin tënd. E kam ndryshuar kabinën, sepse sot gjithë ditën kam pasur punë me njerëzit e konsullatës. Tani unë po të dërgoj në një zonë kufitare, që nuk kontrollohet natën dhe ti, sakaq, do të gjendesh në anën tjetër të kufirit. Atje të presin njerëzit e mi. Çdo gjë është e organizuar mirë. Thesarin në përgjithësi e kam nisur. Pasi të kalosh Austrinë, do t'i bashkohesh karvanit të kamionëve dhe bashkë me ndihmat humanitare, ti si përcjellës i tyre, do të jesh në Beograd. Edhe dokumentet e udhëtimit i ke gati. Pasi të kalojmë kufirin, do ti marrësh dhe... mirupafshim në tokën e lirë!” – tha Beli me një qeshje të papërmbajtur

Vetura mori një kahe që të nxirrte në një zonë kufitare. Në tabelë mundi të lexonte: Zoll 40 km. Pas ka kohë mjaft, mendoi. Frika iu kishte darovitë. Pas fjalëve të Belit, e ndiente veten më të sigurt. Nuk e kishte të qartë akoma se sa do të qëndronte Beli në këtë vend, por tekefundit kjo nuk kishte ndonjë rëndësi të veçantë. Rëndësi tani kishte largimi i tij nga ky vend dhe atë sa më parë. Pastaj, të gjitha rregullohen. I shkujdesur ndezi një cigare për veti e një për Belin.

Shiu vazhdonte të binte. Rrallë, tek-tuk, vinte ndonjë veturë nga ana e kundërt. Diku larg, fare prapa tyre, u dukën dritat e gjata të një veture që vinte pas tyre, me një shpejtësi të madhe. Beli shau nëpër dhëmb, sepse dritat e gjata nga reflektimi i pasqyrave i binin në sy. Vetura u afrua dhe doli në anën e kundërt, duke i kaluar me një shpejtësi marramendëse.

Derisa u afruan buzë malit, ata nuk folën fare. Pasi Beli e ndaloi veturën, i fiku dritat dhe me një shpejtësi të vogël filloi ta ngiste drejt malit. Nga errësira e dendur mezi dallohej rruga. Beli mbante mesin e rrugës. Mali nuk ishte larg. Vetura sa vinte dhe afrohej. Beli fiku edhe motorin. Vetura tani ecte ngadalë, se rruga kishte marrë të tatëpjetën. Fare buzë malit, në një shesh të gjerë në anën e majtë, Beli e parkoi veturën.

“Është mirë që këtë pjesë të shkurtër rruge ta bëjmë në këmbë. Vetëm një zhurmë sado e vogël në këtë qetësi nate, do të mjaftonte për të na zbuluar.”

“Mirë, ecim në këmbë. Është larg që këtej?”

“Rreth njëqind metra. Eja pas meje, në distancë,“ – tha Beli dhe sakaq u zhduk në dendësinë e malit. Besimi e ndiqte pas. Errësira ishte e madhe. Ata ecnin në

një distancë, por pa mundur ta shquanin njëri-tjetrin. Beli ndezi pranë këmbëve të tij llambën e xhepit, që e kishte marrë me vete, para se të dilte nga vetura.

Shiu vazhdonte të binte me intensitet të shtuar. Dëgjoheshin vetëm pikat e shiut, që binin mbi gjethet e lisave, me zhurmë monotone, si dhe hapat e tyre. Befas Beli ndaloi. Pasi e hodhi dritën rreth e qark tij, u kthye nga Besimi, i cili ishte afruar tani fare pranë.

“A ke marrë armë me vete?” – pyeti Beli me zë të ulët.

“Jo. E harrova, por besoj se nuk do të kem nevojë për të,” – u përgjigj po ashtu me zë të ultë Besimi.

“Ti nuk do të kesh nevojë për të, kurse unë që kam nevojë, e kam marrë me vete, ja ku e kam!” – dhe sakaq e nxori armën nga brezi.

Në dritën e llambës Besimi pa revolen në dorën e tij. Ju duk se ishte e madhe, me tytë të gjatë. Por nuk pati kohë të mendonte gjatë për formën e saj, sepse ai vrullshëm e ktheu tytën në drejtim të tij.

“Kështu, pra, këtu përfundon misioni ynë shoku Fer Gergjlekaj.”

“Cili mision!?” – pyeti i hutuar dhe i fiksuar Besimi.

“Misioni sekret!” – u përgjigj qetë, ndërkaq drita e llambës luajti duke ndërruar pozicionin. Pastaj dëgjoj zhurmën e njohur të hekurt, gjatë tërheqjes së çarkut.

“Ç’pate!?!... Mos luaj me armë, Ylber!...” – tha me zë shpotitës, që ju bë se nuk ishte zëri i tij. Mornica të akullta ia përshkruan tërë trupin, duke iu ngjitur nga fundi i këmbëve, deri në tepën e kresë, por atje arritën të nxehta, të përvëluara, sa që djersët i dolën nga

ankthi, duke u bashkuar me ujin e pikave të shiut që i shkonte rreke ballit dhe faqeve. Leqet e këmbëve zunë t'i dridheshin.

“Nuk jam Ylber Kraça, por jam Moma... Momçילו Milivojeviq!”

“Si!?... kurse unë?!...”

“Po, pikërisht. Kështu i kemi pasur rolet!”

“Ç’kërkon nga unë?” – tha Besimi me zë lutës.

“Në emër të Serbisë...” - dhe fjalët e tjera nuk i dëgjoji. Dëgjoj vetëm një vërshëllimë të shurdhër, të shoqëruar me një flakë regëtuese, si dhe dhembjen djegëse në mes të barkut. Pastaj ndjeu edhe një therje tjetër të zjarrtë në gjoks dhe instinktivisht u bë gërmuq, duke mbajtur plagët me të dy duart. Ndjeu se sytë po i errësoheshin, kurse drita e llambës sa vinte e venitej. E pa se nuk do të mbahej dot në këmbë, ndaj zgjati ngadalë dorën e majtë, për ta mbështetur sado pak diku në tokë, por tani as tokën nuk e gjente dot. Nuk e dinte se në ç’formë ishte duke qëndruar në mes të asaj hapësire të errët dhe të patrajtë. Drita e llambës filloi të sillej dhe të merrte trajta të ndryshme, ndërsa dheu dhe balta e lagur ju përplas pamëshirshëm fytyrës. Ndjeu pikat e shiut që i binin mbi fytyrë. Iu bë se ato po ia freskonin faqet dhe ballin që i digjeshin flakë. Qenkam i shtrirë mbi kurriz, mendoi, dhe u përpoq të ngrihej, por trupi nuk ju bind. Gjuha iu kishte trashur, kurse goja i qe mbushur me shije gjaku. Si në ëndërr hetoi një palë duar që po e tundnin. E mori me mend se ishin duke ia marrë gjësendet e pakta që i kishte nëpër xhepa. Ato lëvizje i ndjeu edhe mbi dorë që rrëshqitshëm ia nxorën orën, unazën, pastaj ia hoqën gjerdanin nga qafa. Si

në agoni dëgjoj hapa që largoheshin, por disi ata hapa ishin të rëndë, të largët e të humbur. Qerpikët i kishte plumb të rëndë. Me mundim arriti t'i hapte sytë. Asgjë nuk dalloi. Errësirë dhe qetësi. I mbylli prapë sytë. Kishte dëshirë të flinte, të pushonte dhe pastaj... nga me erdhi kjo shije e gjakut në gojë që s'po me shqitet? Ah, sikur të kisha një pikë ujë!...

Shiu vazhdonte me ritmin e tij. Shushurima e gjetheve nën pikat e shiut dukej se e prishte atë heshtje varri. Qiellin e çau një vetëtimë gjarpërore, pastaj e vonuar, gati e shurdhër u dëgjua gjëma e motit, si gërrhatje gjumi dimëror. Tutje, në fundin e rrugicës malore, u dëgjua refreni i këngës çetnike, pastaj ushtima e motorit të veturës, duke e shuar fare atë zë të çjerrë e të frikshëm, që iu bë se vinte nga amshimi. Diku, në mesin e pyllit, u dëgjua cicërima e një zogut. Pastaj iu bë se dëgjoi zërin e qyqes. Vallë, kë e vajton ajo qyqe me atë zë të trishtuar? Por, këto zëra shpezësh nuk ishin ndonjë vajtim. Ishin shenjat e para se po agonte dita e re.

\*

Kishte kohë që priste në atë lokal të vogël në periferi të qytetit. Ndodhej pranë rrugës kryesore, që çonte drejt qytetit, jo larg „hajmit“ të azilantëve. E priste Berlin, pastaj së bashku do të shkonin pranë një magazine, ku ishin të deponuara shumë ndihma humanitare, që u dedikoheshin refugjatëve serb nga Kosova. Aty do të bëhej ngarkesa në kamionë të mëdhenj. Gorani ishte caktuar në një detyrë speciale dhe ishte vartës i Belit. Në fshehtësi të thellë do të merreshin me ngarkimin e një kamioni, jo me ndihma, por me thesar të vjed-

hur dhe para të fituara nga kontrabanda e drogës, që kapnin një shumë rreth pesëmbëdhjetë milionë dollarë. Për këtë detyrë ishin caktuar njerëzit më besnikë, kurse kontrolli bëhej nga policë sekret serbë të veshur me petkun diplomatik.

Kafenë e kishte pirë kaherë. Vështrimin e mbante drejt rrugës. Mendimet i shkonin vërdallë. Kishte disa ditë që nuk e kishte takuar Besimin, të cilin e kishte trajtuar si e vetmja lidhje që mund t'i ndihmonte në gjetjen familjes së tij, pastaj kishte edhe shumë gjëra që duhej t'ia sqaronte, të cilave ai qorras iu besonte. E kishte pyetur Belin, por ai i kishte thënë se e kishte dërguar në një bazë më të sigurt, sepse krejt policia ishin vënë në kërkim të tij.

Për disa ditë rresht Beli qëllimisht ishte mënjanuar nga Gorani. Këtë e kishte bërë gjoja për shkaqe sigurie. Goranit nuk iu kishte mbushur mendja. Kishte kërkuar të takohej me ish-kolegun e tij të punës, detektivin Mariq, që tani shërbente si nëpunës i konsullatës. Sipas bisedës, dilte se Beli atë e kishte mënjanuar për shkaqe korrupsioni. Ishin marrë të gjitha masat që kjo gjendje të evitohej.

Kishte filluar të mërzitej me pritjen e gjatë. Me nervozë mori njërën nga gazetatat që ndodhej në raftin pranë banakut. Pasi filloi të shfletonte, pa një fotografi dhe iu duk e njohur. Pasi ia picërroi mirë sytë, nën të ishte dhënë emri: „Mal Dalani, u gjet i vrarë me dy plumba në gjoks, dhjetë km larg kufirit gjerman“. Fytyra në fotografi ishte e Besimit. Ai ishte në dijeni se ai para organeve vendase kishte emër tjetër. Tani e kishte të qartë sesi kishin rrjedhur ngjarjet. “Beli”, tha me



vete dhe u ngrit në këmbë i xhindosur, duke turfulluar nga inati. Pasi bëri pagesën, me nguti doli nga lokali. Por, sakaq, u step. Beli kishte arrirë dhe tani po dilte nga vetura. Ai i buzëqeshi, kur e pa dhe prapë u ul në vendin e vet. Pas tij, në veturë hyri Gorani. I shtrengoi dorën, pa mundur ta fshehte zemërimin. Beli këtë zemërim të tij e mori si shkak të vonesës. Ai, pa shikuar fare, merrej me një video-kasetë që e rrotullonte nëpër duar, duke kërkuar mënyrën më të përshtatshme për ta futur në një zarf që ishte shumë më i madh se sa video-kaseta. Pasi e futi disi, e mbylli zarfin, pa vënë re shikimin zhbirues të Goranit, mori lapsin dhe mbi të, me germa të mëdha e të shtrembëruara, shkënoi: Kripo – Zürich. Pastaj, si pa të keq, ia lëshoi në dorë zarfin dhe ndezi motorin. Vetura doli në rrugë, duke u përzier me lumin e madh të veturave dhe makinave të tjera. Pasi hynë në qytet, Beli ndaloi veturën pranë një kutie poste. Mori zarfin nga dora e Goranit dhe e hodhi në kuti, pastaj qetë-qetë vazhduan rrugën.

Vetura doli nga qyteti dhe u fut në qarkun periferik të anës tjetër. Kaluan një fushë futbollit, të rrethuar me tela katrorë. Pastaj iu futën rrugës që shpinte në një zonë industriale. Ndërtesat e mëdha dhe sheshe të gjëra para, si dhe postblloqe të mëdhenj të shpeditcionit. Derisa arritën në cak, pranë një magazine të tillë shpeditive, ata nuk folën fare.

Depoja ishte e madhe. Mallrat ishin të paketuara në pako mesatare dhe të njëjta. Ishin të ndara në dy grumbuj. Beli mori dokumentacionin dhe, në bazë të etiketave të ngjitura mbi pako, i krahasonte duke shikuar në dokumentet sekrete, që i mori me vete nga vetura.

„Fillo të ngarkosh nga pakot e fundit,“ - i tha Beli një burri që rrinte i ulur mbi një pako të madhe. – „Së pari bjere pakon këtu, të bëj regjistrimin në notes,“ – vazhdoi ai me zë të lartë, pasi që burri ishte larguar. – „Kurse ti, Goran, merri ato pako dhe sa më shpejt hidhi në kamion. Renditi sa më mirë, në mënyrë që në fund të ketë vend për të gjitha. Ku janë të tjerët?“ – iu drejtua burrit që tani ishte afruar fare pranë tij, me pako në dorë.

„Në kthinën tjetër, duke bërë ambalazhimet e fundit!“ – u përgjigj burri.

„Ka shumë për t’u ambalazhuar?“

„Jo. Pjesën më të madhe e kemi ambalazhuar sot në mëngjes. Tani kanë mbetur fare pak.“

„Mirë! Shpejt! Shpejt, se koha nuk pret,“ – bërtiti Beli, duke ju drejtuar dy burrave që posa u dukën në fundin e errët të repartit dhe me ton kërcënues iu drejtua Goranit, që kishte marrë në dorë një pako dhe e çonte drejt kamionit. – „Jo atë, jo! Ku dreqi i ke sytë, hej?! Mos i përziej si lesh arapi, se pastaj nuk i ndanë dot. E sheh se të gjitha janë të njëjta? Këtë grumbull pakosh nuk guxon ta ngarkosh fare. Aty janë të paketuara ilaçet, të cilat mbesin këtu, kurse këtu është i paketuar thesari, që duhet ngarkuar, a more vesh tani?“ – tha Beli duke treguar me dorë nga grumbujt e mëdhenj të pakove.

„Si urdhëron!“ – tha Gorani, me sedër të prekur, duke lëshuar pakon aty ku e kishte marrë dhe duke shikuar me një urrejtje të papërmbajtur. Shpejt do te të dërgoj të miku juaj, Aleksi, mendoj dhe me një shikim përbuzës u drejtua nga grumbullit i pakove që Beli ia kishte treguar me dorë.

Që nga koha kur e kishte zbuluar prejardhjen e tij, nuk e duronte dot komandën e të tjerëve. Kjo i vinte ndoshta se ishte rritur duke zbatuar urdhra nga më të ndryshmit, pastaj gjatë shërbimit nuk kishte bërë gjë tjetër vetëm kishte zbatuar urdhra, duke vrarë e duke sakatosur të tjerët, për tekat e çmendura të urdhërdhënësve të tij. Kishte shumë raste që urdhrat i kishte pranuar, duke ia sharë nënën, motrën, zotin... dhe zbatimi i urdhrave i kishte ardhur në maje të hundës. Edhe ky urdhër-kërcenim i Belit i vinte i tillë, edhe pse ishte akoma pa të shara, por kjo nuk do të thoshte se ai nuk do të shante.

Pas ngarkimit, kamioni doli nga postblloku, duke lënë prapa gërrhamën mbytëse të motorit dhe tymin e zi. Kopjet e fletudhëtimit, fletë doganimit dhe dosja sekrete ishin aty. Gorani e pa kur Beli i futi me kujdes në dosjen kryesore, me kapak blu.

Ishin duke e pastruar lokalin, kur Beli la dosjen në zyrën e vogël, që ishte e ndarë nga reparti i gjerë i magazinës. Pasi mbylli derën me bravë, ai u largua, duke marrë veturën e tij dhe duke ju vënë në përcjellje kamionit gjer sa të arrinte në bazë dhe të bashkohej me karvanin e kamionëve të tjerë.

Gorani u afrua pranë derës së zyrës së vogël. Në anën e djathtë të derës ishte dritarja e vogël, që shërbente si sportel. Ajo kishte mbetur pakëz e hapur. Me mundim Gorani zgjati dorën, duke marrë dosjen në dorë. Shikoi majtas e djathtas dhe, pasi u siguria se askush nuk ishte afër, edhe pse nga thellësia e reparitit dëgjoheshin zëra, hapi dosjen me kapak blu. Sakaq nga brendia e saj nxori komplet dosjen sekrete, të cilën pak më parë Beli e kishte deponuar aty me një kujdes

të veçantë. Pastaj e ktheu dosjen në vendin e mëparshëm.

Nuk vonoi dhe Beli u kthye bashkë me një burrë që Gorani nuk e kishte parë asnjëherë. Tani, siç dukej, rreziku kishte kaluar. Këtë e shprehte më se miri sjellja e Belit, si dhe hareja që tregonin sytë e tij.

“Kamionët kanë marrë rrugën drejt Austrisë. Jam i sigurt se rreziku ka kaluar. Prandaj, vëllezër, e meritojmë një pushim të shkurtër. Shkojmë!” – tha Beli krenar. Pastaj, duke hapur derën, mori dosjen dhe pas pak u gjend në veturën e tij. Gorani mbeti duke shikuar në mes të sheshit të gjerë, para magazinave.

“Goran, eja me veturën e Ivanit!” – dëgjoj zërin e Belit, kur makina e tij i kaloi fare afër këmbëve.

Gorani shikoi rreth e rrotull, duke kërkuar me sy se cili ishte Ivani. Pasi asnjëri nuk u lajmërua, disi e ndjeu veten të lehtësuar. Nuk e bëri të gjatë, por me hapa të rënd dhe mospërfillës u drejtua kah rruga kryesore. Pasi kaloi një shteg që ishte i shënuar enkas për këmbësorë dhe për biçikleta, Gorani u gjend ballë një stacioni të autobusëve.

Pritja në këtë stacion iu duk tmerrësisht e gjatë. Një plak qëndronte i ulur në stolin e stacionit periferik, duke thithë duhan me llullë. Pranë i rrinte qeni trupmadh, i cili kishte nxjerrë gjuhën jashtë nga vapa. Veturat qarkullonin pa nda. Herë pas here i bëhej se ishte vetura e Belit që e kërkonte, dhe mornicat i shkonin nëpër trup. Pasi kalonte vetura pranë tij, disi e ndjente veten të liruar, dhe prapë... Kur në rrugë që larg dalloi se nuk kishte vetura që vinin nga drejtimi i qytetit, nga xhepi nxori fletët e bardha dhe një laps, duke shënuar mbi fletën e bardhë numrin e tabelës së kamionit.

Pasi i palosi mbi faqen që nuk kishte të shkruar asgjë, shënoi: Kripo-Zürich Express, dhe e futi në xhepin e xhaketës.

Autobusi erdhi. Pasi zuri vend fare në fund, vështirimin e hodhi tutje nga rruga. Në mes të atyre pak udhëtarëve, disi e ndjeu veten më të sigurt. Iu bë se bashkudhëtarët nuk kishin brenga. Ata dukeshin të lumtur, të hareshëm, të dashur, mikpritës, të padjallëzuar, edhe pse ishin të mbyllur në seriozitetin e tyre.

Pranë stacionit kryesor të policisë, në qendër të qytetit, në kutinë e postës hodhi dosjen sekrete, në të cilën ishin të shënuara të gjitha bizhuteritë, orët, ari, pikurat e vjedhura që kërkoheshin nga policia, si dhe dokumentacioni i doganimit që ishte bërë me ndërhyrjen e konsullatës. Në fund ishte i shënuar edhe numri i autotargës së kamionit.

I kënaqur, pasditen e kaloi duke lozur futboll me fëmijët e refugjatëve shqiptarë. Herë pas here u jepte para për të blerë akullore apo pije tjera freskuese. Kishte vendosur që gjithë thesarin që e kishte sjellë me vete, t'ua shpërndante fëmijëve të refugjatëve.

Fresku i mbrëmjes ia ledhatoj faqet. Veturat në rrugën kryesore sa vinin e pakësoheshin. Mugëtira e mbrëmjes kishte filluar të binte mbi qytetin e madh. Fëmijët akoma luanin. Agron Ademkurti rrinte ulur në divan në dhomën e tij të ngushtë. Para vetes kishte një shishe të vogël birre dhe herë pas here duke shikuar televizorin ngrinte shishen duke pirë në qetësi të plotë.

Në televizor, në emisionin e lajmeve të orës dhjetë, që transmetohej çdo mbrëmje, dëgjoi njoftimin, që krejt atë pasdite e kishte pritur me shqetësim:

“Sot, nga policia kriminale u kap një laborator dhe një sasi e konsiderueshme droge. Me këtë rast u arrestuan dy shqiptarë nga Kosova. Ndërsa në orët e para të pasdites, për qërim hesapesh, u gjend i vrarë i quajturi Ylber Kraqa. Policia dyshon se i vrari është kriminel i shumëkërkuar nga Interpoli, Milivojeviq Momçillo, alias Moma. Po të njëjtën ditë, në mesin e konvoit me ndihma humanitare që u dedikoheshin refugjatëve serbë nga Kosova, u zbulua një thesar i madh stolish, si diamante, orë të markës IWC, bizhuteri ari e argjendi, piktura të shtrenjta të artistëve klasikë, si dhe para të pastruara që kapin një vlerë rreth pesëmbëdhjetë milionë dollarë. U bënë shumë arrestime. Hetimet vazhdojnë.”

Agroni fiku televizorin dhe me shishen e birrës në dorë doli në oborrin e gjerë të „hajmit“. U ul në stolin e drunjtë dhe me një buzëqeshje të papërmbajtur që shprehte gëzim, ngriti dorën lartë, duke e shoqëruar me fjalën “gëzuar”, që iu drejtua ca të rinjve, të cilët akoma bisedonin dhe bënë shaka me njëri tjetrin, kurse me vete mendoj: Më në fund, ndodhi ajo që e kam pritur për një kohë kaq të gjatë ... Eh, si qenka jeta! Linda shqiptar, u rrita, u edukova dhe luftova serb dhe... tani jetoj dhe dua të vdes shqiptar!... Me fal, o Zot! Me fal o popull shqiptar, o populli im! Me fal, o nëna ime! Me falni, ju, o vëllezërit e motrat e mia... e di që liria që e fituat me gjak e sakrifica do t’ua shërojë plagët, do tua lehtësojë dhembjet, por vrragët e atyre plagëve, therjet e atyre dhembjeve do të mbesin gjithë jetën e jetëve, në kujtesën tuaj dhe të brezave që do të vijnë pas! Kurse unë do të luftoj gjithë jetën për ta fituar atë që e humba

gjatë asaj lufte... qetësinë shpirtërore!

Lëvizjet e veturave tutje nga rruga tani nuk i bënin përshtypje fare. As fresku i asaj nate të bukur vere, me atë pui të këndshme, nuk e joshte më. As zogjtë që cicëronin të fshehur ndër gjethet e lisave, diku prapa shtëpisë së madhe, nuk i sillnin më nostalgji si dikur. Kurse gota e birrës, që e mbante në dorë, iu bë se nuk ishte e freskët. Edhe peizazhi i mugët që shfaqej para tij, kishte filluar t'i ndërronte trajtat valëvitshëm, duke i lakuar ato objekte në formë rrethore, kurse dritat e neonit buzë trotuarit sikur largoheshin tutje, duke lënë prapa një vijë të lakuar drite, që regëtinte e venitur. Vonë e kuptoi se ndërrimi i atyre trajtave bëhej vetëm nga shikimi i tij, sepse sytë i kishte me lot.

## EPILOG

Mugëtira e mëngjesit pranveror sa kishte filluar ti shuante yjet që regëtinin në qiell, kur në oborrin e mbushur plot bar e lule ndaloi makina.

Nga rruga e gjatë dhe e mundimshme Bardhës akoma i ushtonin veshët. Pasi doli jashtë, fresku ia përshkoi lehtë fytyrën, duke ia shpupurishur flokët butësisht. Ato pamje, në atë dritë të mugët të mëngjesit pranveror, për një çast iu duken të pabesueshme. Ishte e mundur, vallë, që shkatërrimi i çdo gjëje njerëzore të ketë arrirë deri në këtë pikë? Përballë ndodheshin gërmadhat e shtëpisë, kurse para murit shquheshin grumbuj mbeturinash të karbonizuara, thëngjij të shuar dhe mbi to, si me qesëndi, kishte gufuar hardhia, e cila sikur nuk kishte dashur të pajtohej me katrahurën.

Në këndin e murit rrethues pa derën e vogël dhe iu bë se ishte gjysmë e hapur. Ishte pikërisht ajo derë që dikur, përmes saj, për herë të parë kishte hyrë nuse në këtë shtëpi. Fare pranë derës iu bë se pa gjyshen plakë të Agronit, e cila afrohej me hapin e saj të ngadaltë, duke pëshpëritur si më vete, me atë zërin e saj të mekur: Ç'nuse zeza, oj loke!

Nga ana e lindjes qielli kishte filluar të përflakej. Yjet ishin shuar fare, kishte mbetur akoma i vetmuar,



i shndritshëm dhe vezullues Ylli i Karvanit. Sa vinte e më tepër kristalizoheshin konturet e trishta të shtëpive të shkatërruara dhe, për një çast, ndjeu në vete një trishtim dhe dhëmbje bashkë, duke iu mbushur sytë me lot. Përbri saj, si në ëndërr, erdhi zëri i Agronit, që nuk i përngjante fare zërit të tij. Iu bë se dëgjoji një murmurimë të njeriut që flet me veten e tij, dhe zëri i mbytur ishte si i dalë nga ai grumbull shkrumbi, kurse ai që fliste ishte pjesë përbërëse e atyre gërmadhave. E tëra u dridh nga ky mendim dhe sakaq fërkoji sytë, sikur donte të largonte atë tis të hollë që ju kishte veshur si vegim para syve e nuk i shqitej dot.

Kishte kohë që kishin filluar të këndonin gjelat. Agroni ishte zhdukur fare, diku në brendi të shtëpisë së shkatërruar, kurse Bardha kishte mbetur si e humbur në mes të oborrit. Për një çast u shtang, kur pa se dera e vogël cijati vajtueshëm dhe që andej u shfaq silueta e një burri plak, që Bardhës ju bë se ishte fantazmë. Ai afrohej me shikimin e mbërthyer drejt saj. Bardha nuk lëvizi. Kishte mbetur në një situatë që nuk e dinte se çka ishte më mirë të vepronte: t'i dilte përpara të porsaardhurit dhe t'i uronte mirëseardhje, apo të zhdukej në brendi, ku ishte Agroni...? Nga kjo situatë, sikur ta kishte porositur dikush, e nxori vaji i Dylit. Bardha u gjend pranë veturës.

“U zgjove nga gjumi, pëllumbi i nënës?!” – tha Bardha, pasi kishte marrë ndër duar foshnjën. Sa herë e merrte në përqafim Dylin, i kujtoheshin fjalët e ish-burrit të saj, që i thoshte herë pas here me ironi: “Shterpë!” Dhe, ashtu, me Dylin ndër duar, u kthye nga i porsaardhuri.

“Mirëmëngjesi!” – tha plaku, që tani më ishte afruar fare pranë Bardhës.

“Mirëmëngjesi!” – ia ktheu Bardha, duke ia zgjatur dorën dhe duke e shikuar hetueshëm fytyrën e tij.

“Mixha Sylë!” – befaz klithi Zana, që pa u vërejtur kishte zbritur nga vetura dhe sakaq iu hodh plakut në gjoks. Ai e shtrëngoi fuqishëm me duart e tij të tha-ta, duke ia përkëdhelur flokët.

“Zanë, moj bijë!... të dija të vdekur... të kam vajtuar edhe ty, bashkë me të tjerët, edhe pse nuk... ah, u gëzoftë kjo ditë!...” - dhe zëri filloi ta humbte atë buçimën e mëparshme, duke u dridhur lehtë, përvajshëm. Bardha pa se plakut po i dridhej buza e poshtme. Iu bë se e kishte takuar diku atë plak... ah, po! “Nuk të paska gënjyer syri, Agron!” i ushtuan në vesh fjalët e tij, kur e kishte takuar ditën e parë që kishte shkelur pragun e kësaj shtëpie.

Nga thellësia e gërmadhave doli Agroni. Me hapa të shpejtë u sul drejt plakut, i cili vjedhurazi përpiquej t'i fshinte sytë, që ju kishin mbushur me lot.

“Sa të kam kërkuar, more bir!... të dinim të vdekur!...” – tha plaku i ngashëryer.

Bardha kishte mbetur si e hutuar. Ajo shikonte ato pamje dhe mendja i vajti të gjyshja e saj e ulur në divan prapa stufës, e cila, kur mërzitej për ata që i kishte dashur dikur dhe që me kohë kishin vdekur, qante në heshtje, ja, si sot mixha Sylë...

“Po kjo? Kush është kjo?” – pyeti plaku, duke shikuar nga Bardha me sy të përplotur.

“Është Bardha.”

“Bardha!?...”

“Po, mixha Sylë, është ajo Bardha që dikur...”

“Bardha e bukur?!“ – ia preu fjalën plaku, duke e marrë në përqafim Bardhën dhe duke ia ledhatuar flokët, siç ia kishte ledhatuar pak çaste më parë edhe Zanës. Plaku nuk u përmbajt dot kësaj radhe. Duke dënesur, i turpëruar, u largua drejt gërmadhëve të shtëpisë. Të gjithë kishin mbetur të heshtur, me kokat ulur. Vaji i plakut e theri Bardhën mu në zemër. I vetmi në këtë mes që nuk e vrisnin aspak këto emocione, ishte Dyli.

\*

Vetura kaloi fare pranë oborrit të shkollës. Bardha hodhi vështrimin andej. Ndërtesa e vjetër e shkollës nuk ishte më. Në vendin e saj kishte filluar ndërtimi i shollës së re. Oborri i shkollës ishte po ai që kishte qenë dikur, por tani i mbushur me material ndërtimor, kurse muri rrethues me kangjellat e ndryshkura dhe të shtrembëruara i kishte qëndruar kohës. Edhe kaçuba e dikurshme prapa murit rrethues ishte po aty, por tani ishte rritur, ishte bërë lis. Si në vegime iu bë se pa Besën, duke biseduar dora-dorës me Kerin. Vallë, ku ndodhet ajo tani, pyeti veten dhe trupin ia përshkuan mornica të flohta, kur ju kujtua tragjedia e Rinës, për të cilën i kishte treguar Agroni.

Kur vetura u gjend fare pranë shtëpisë së shkatërruar të Gjergjekajve, pa ish- vjehrrin dhe ish-kunatin që merreshin me një fill armature të zgjatur rrugës. Ata u mënjanuan skajit të rrugës, për t'i bërë rrugë makinës, dhe... e njohën! Bardha nuk reagoi fare në habinë e tyre, por shtypi gazin, duke lënë prapa një re pluhuri. E ndjeu veten të lumtur që, pas kaq vitesh, nuk duhej

të kthente drejt atyre shtëpive, tani më të shkatërruara nga lufta.

Pasi e ndaloi veturën prapa pojatës së vjetër, që i kishte shpëtuar çuditërisht katrahurës, Bardha zbriti. Për një copë herë mbeti si e nemitur, duke kundruar tutje nga lajthishta. Ishte e shkatërruar, e prerë dhe e djegur. Filizat dhe pinjollët e rinj që kishin gufuar pas gjithë asaj furtune, shushuritnin qetë nën peshën e lehtë të fladit pranveror. Ju bë se nga larg, si i venitur, i erdhi refreni i këngës që kushëriri i saj e këndonte me gjithë afsh, kur ishte i dashuruar. Për një çast ndjeu një trishtim në tërë qenien e saj. E dinte se atë zë nuk do ta dëgjonte kurrë më.

Muri rrethues i pojatës ishte aty. I shkretë, i ftohët dhe indiferent. Edhe zgavra në mur ishte aty, e mbyllur, ashtu siç e kishte lënë vet dikur. Bardha zgjati dorën dhe hoqi rrasën dhe çuditërisht i lindi një dëshirë që aty të gjente diç, siç kishte gjetur dikur. Sa herë e kishte gëzuar ajo zgavër, por më shumë e kishte dëshpëruar dhe mbytur në lot! Ajo kishte qenë gëzimi i saj, shpresa dhe ëndrra e saj... dashuria e saj!

Oborri i shtëpisë ishte i boshatisur, i mbushur me bar. Nuk dëgjoheshin të lehurat e qenit, as kakarisjet e pulave atje pranë kotecit. Mani i vjetër në mes të oborrit nuk ishte më. As stoli i drunjtë i gjyshes, nën hijen e tij, nuk ishte. Nuk ishte as gjyshja. Kishte vite që trupi i saj kalbej nën dhe. As Ademi nuk ishte më. Trajtohej i zhdukur. Tutje, nga selishta, pa pjeshkën që kishte shpërthyer me lulet e saj të bukura. Çeljen e kësaj pranvere e kishte pritur me një gëzim të papërmbajtur. I bëhej se kjo ishte pranvera më e bukur e jetës së saj.

Tani që ndodhej në mes të luleve, të gjetheve të mu-  
gulluar, mbi barin e njomë dhe në mes të cicërimave  
të lirshme të zogjve, disi ndjeu se ishte e mallëngjyer.  
Iu bë se ajo pamje aq e bukur, aq e dashur për të, ato  
lule që kishin shpërthyer me aromë e gonxhe të reja,  
selishta e blertë e plot lule ngjyra-ngjyra po valëvitej si  
në vegime të blerta e të ujëta, të përthyer si ngjyrat e  
ylberit, duke ndërruar ngjyrën dhe trajtën. Pasi i fshiu  
sytë me dorë, pa se jashtë qenies së saj nuk kishte lëvi-  
zur asgjë. Selishta me pemë e lule ishin aty, e qetë. Çdo  
gjë kishte qenë tronditje, që kishte ndodhur në brendi  
të shpirtit të saj të mallëngjyer dhe pikat e lotëve e bënë  
të kuptonte se ishte duke qarë. Por, kësaj radhe qante  
nga mallëngjimi.

Fund  
13. 01. 2000

Muharrem Blakaj  
M I S I O N I S E K R E T  
Roman

Redaktor teknik  
Ramadan Mehmeti

Realizimi kompjuterik  
ARS poetika  
Adriana Mehmeti - Bajrami

U shtyp në shtypshkronjën  
PROGRAF  
Prishtinë  
2004

Katalogimi në publikim - (CIP)  
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18-31

BLAKAJ, Muharrem

Misioni Sekret: Roman / Muharrem Blakaj.- Prihtinë:  
Rozafa, 2004 (Prishtinë: „Prograf“).- 271 fq.; 20 cm.- (Biblio-  
teka Kuteli)

ISBN 9951-02-047-X





## Autori për veten dhe veprën e tij

Biografia ime ngjan me biografitë e shumë të rinjve nga gjenerata ime. Varfëri, represion i pushtetit, shkollim i ndërprerë, aktivitet politik ilegal, ekzil e kështu me radhë. Dhe një qëndrueshmëri e vazhdueshme në synimet themelore, që Kosova të jetë e lirë, duke marrë para sysh të gjitha sakrificat.

Kam lindur më 6. 01. 1959 në fshatin Vrellë, komuna e Istogut. Gjatë viteve 1976-1978 mora pjesë aktive në lëvizjen ilegale në Kosovë, duke u inkuadruar në grupin ilegal Levizja Çlirimtare Patriotike e Shqiptarëve në Jugosllavi, të cilën e drejtonte Jusuf Gërvalla. Në vitin 1979, pas përfundimit të shkollës së mesme, u regjistrova në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, në degën gjuhë dhe letërsi shqipe. Për shkak të burgosjes për veprimtari politike më 14. 12. 1979, m'u ndërpreu studimet, të cilat nuk arrita t'i vazhdoj më. Në nëntor të vitit 1986 rrethohet shtëpia jonë në Vrellë dhe me këtë rast arrestohet vëllau im Xhemaili, të cilin gjatë torturave e mbysin në burgun e qarkut në Pejë. Pas vrasjes së tij, më 5. 02. 1987, më arrestuan edhe mua, por në mungesë të provave, më liruan. Pas një tentim atentati kundër meje, të organizuar nga njerzit e UDB-s, u detyrova të largohem nga Kosova, në tetor të vitit 1987.

Me shkrime jam marrë që në shkollë së mesme. Kam pasur në dorshkrim disa skica, një përbledhje me tregime me titull "Monolog i një komiti" dhe dy novela me titull "Balta me gjak" dhe "Besa", të cilat, gjatë bastisjes me rastin e arrestimit të Xhemailit, u konfiskuan nga policia dhe nuk u këthyen asnjëherë.

Tani jetoj në Zvicër. Kohën e lirë e kaloj duke shkruar ose duke lexuar. I kam të botuara disa tregime në revisten "Fjala e Lirisë", e cila botohej në Zvicër, dhe në të përditshmen "Bota sot", që synoj t'i botoj në një përmbledhje të veçantë. Kam të përgatitur për botim edhe vepra të tjera. Romani "Misioni sekret" është i mbështetur në ngjarje të rastit. Përsonazhet janë të trilluar.